


UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULETI I FILOLOGJISË



MA QËNDRESA JAKUPI

**STRUKTURA E INFORMACIONIT
BRENDA FJALISË: TOPIKA DHE FOKUSI
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2023

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

MA QËNDRESA JAKUPI

**INFORMATION STRUCTURE WITHIN THE
SENTENCE: THE TOPIC AND THE FOCUS
IN THE ALBANIAN LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA QËNDRESA JAKUPI

**STRUKTURA E INFORMACIONIT
BRENDA FJALISË: TOPIKA DHE FOKUSI
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentorja:

Prof. dr. Lindita Sejdiu-Rugova

Prishtinë, 2023

REZYME

Qëllimi i këtij studimi është ta hetojë mënyrën se si kodifikohet struktura e informacionit në gjuhën shqipe brenda fjalisë. Struktura e informacionit në literaturë nënkuptohet si një ndarje midis fokusit dhe topikës së një fjalie. Sipas Halliday, “çdo tekst [. . .] është i organizuar në ato që mund të quhen njësi informimi [. . .] dhe kjo nuk është përcaktuar [. . .] sipas strukturës përbërëse. Përkundrazi, mund të thuhet se shpërndarja e informacionit specifikon një strukturë të veçantë në një plan tjetër” (1967: 200).

Prandaj, për ta hulumtuar mënyrën e kodifikimit të strukturës së informacionit në gjuhën shqipe këtë punim të doktoratës e kemi ndarë në gjashtë kapituj, duke përfshirë hyrjen dhe përfundimet:

Në kapitullin e HYRJES (0) shtjellohet së pari koncepti i strukturës së informacionit, objekti i studimit, hipotezat e studimit si dhe metodat dhe detyrat. Qysh në fillim të këtij kapitulli është synuar të definohet koncepti i strukturës së informacionit brenda kornizave të gjuhësisë, duke i shpjeguar edhe ndërfaqet e strukturës së informacionit me fushat e tjera të gjuhësisë, si: sintaksa, semantika, prozodia dhe pragmatika, për të treguar se përdoren strategji të përziera që të strukturohet informacioni brenda një fjalie dhe struktura e informacionit si koncept nuk mund të funksionojë si e vetme pa ndërvepruar me domenet e lartpërmenduar në disa pika të caktuara. Tutje, pas definimit të konceptit, është synuar të përkufizohet objekti i studimit përmes të cilit provohet të shpjegohet se si informacioni është i organizuar brenda një fjalie të shqipes, dhe në veçanti se si sintaksa, semantika, prozodia dhe struktura e informacionit ndërveprojnë në kodifikimin e informacionit në gjuhën shqipe. Me ç’rast këto supozime nxisin hipoteza se shqipja përdor strategji të ndryshme, për ta kodifikuar strukturën e informacionit, të cilat do të shihen në vazhdim. Të gjitha këto strategji që përdoren për të mundësuar dhe hetuar veprimin topikë/fokus është përdorur një metodologji heterogjene, për shembull: për të hetuar topikën në një fjali janë përdorur analiza sintaksore dhe semantike, njësoj edhe për të hetuar fokusin etj.

Brenda boshtit të *kapitullit të parë* hulumtohet hollësisht nocioni i temës/topikës në gjuhën shqipe. Së pari, ofrohet një studim i shkurtër historik i cili do të tregojë disa nga përkufizimet e temës/topikës në literaturën e gjuhësisë. Pastaj, do të shqyrtohen karakteristikimet e ndryshme dhe motivime që qëndrojnë pas tyre. Me ç'rast shqyrtohen propozime që lidhen me nocione të tilla, si: karakteristika tipike të topikës, rrethimi sintaktik, referencat diskursive, dija paraprake në diskurs dhe konteksti, si dhe ato që imponojnë disa kufizime sintaktike të tilla. Po ashtu, mënyra e realizimit të të sintagmës së topikës në gjuhën shqipe.

Në *kapitullin e dytë* një nocioni tjetër që trajtohet brenda boshtit të këtij disertacioni është nocioni i fokusit/remës. Për të cilin do të shqyrtohet pozicioni i tij në fjali, si dhe me çfarë mjete markohet në gjuhën shqipe. Po ashtu, do t'u kushtohet rëndësi disave prej llojeve të fokusit që janë propozuar në literaturë (Lambrecht 1994). Detyra e identifikimit të fokusit të një fjalie mund të duket më e lehtë sesa e identifikimit të një topike, pasi në krahasim me topikën, fokusi nuk markohet vetëm fonologjikisht përmes theksit siç është pretenduar deri më tani. Pra, jo të gjithë elementet që e përcojnë fokusin theksohen, disa elemente që marrin theks nuk e përcjellin domosdoshmërisht fokusin. Madje, elementet që fokusohen mund të jenë elemente që përcjellin informacione jo krejt të reja për dëgjuesin dhe se disa sintagma të fokusit mund të paraqiten në pozicionin fillestar të fjalisë. Prandaj, do të bëjmë analizë semantike në kuadrin gjenerativist përmes llojeve të pyetjeve për të gjetur fokusin.

Megjithëse, topika dhe fokusi janë trajtuar si nocione kryesore të strukturës së informacionit, prapëseprapë këto nocione nuk i përtheqojnë studimet mbi të, sepse ky nuk është përdorimi i vetëm i mundshëm i termit informacion, pasi ai gjithashtu mund ta përshkruajë mënyrën e përgjithshme në të cilën strukturohet informacioni i çfarëdo lloji qoftë. E, po ashtu, struktura e informacionit markohet gjuhësisht ndryshe në gjuhë të ndryshme. Siç supozon edhe Vallduví (1996: 460), paketimi i informacionit është një strukturim i fjalive me mjete sintaksore, prozodike ose morfologjike që lind nga nevoja, për t'i përmbushur kërkesat komunikuese të një konteksti ose diskursi të veçantë.

Me këto nënkuptojmë se struktura e informacionit realizohet nga një bashkëveprim i shumëllojshëm i mjeteve apo strategjive gjuhësore. Faktorët semantikë, pragmatikë, sintaksorë dhe prozodikë ndërthuren në pasqyrimin e paketimit të informacionit, i cili nga ana tjetër siguron depërtim, jo vetëm, në ndërfaqet e këtyre përbërësve, por gjithashtu, në mënyrën sesi gjuhët e ndryshme e kodifikojnë informacionin e tillë (Gürer 2020: 3).

Prandja, dy nocionet që u përmendën më parë, topikë dhe fokus, nuk janë elementet e vetme që e përbëjnë boshtin e këtij studimi, por ky bosht plotësohet edhe nga mekanizma të tjerë gjuhësorë, me të cilët supozohet se realizohet struktura e informacionit në gjuhën shqipe. Ndër mekanizmat gjuhësorë, që mendohet se luajnë rol në kodifikimin dhe strukturimin e informacionit në gjuhën shqipe, janë: mjetet prozodike që hamendësohet se e markojnë fokusin (FocP), duke e dalluar atë nga topika (TopP); tjetër mekanizëm është dyfishimi i kundrinave nëpërmes klitikëve përemërorë, për të cilin pretendohet se e kodifikon topikën ose informacionin e dhënë më parë në diskursin paraprak; një strategji tjetër që besohet se përdor shqipja për ta realizuar strukturën e informacionit është konfigurimi variacional i fjalive, meqë është një gjuhë deri diku me rend të lirë.

Prandaj, brenda kapitullit të dytë provohet nëse shqipja i përdor **mjetet prozodike**, për ta kodifikuar strukturën e informacionit, pra nëse në gjuhën shqipe markimi i fokusit bëhet nëpërmjet elementeve mbisegmentare përfshirë frekuencën themelore (F0), intensitetin dhe gjatësinë e tingullit të fjalës së dhënë. Dhe nëse fjala e dhënë e përmban tonin H*+ L, do të merret si fokus i fjalisë, pra kjo fjalë (**F-marked**) e bart theksin sipas teorisë autosegmentale metrike të intonacionit.

Në kapitullin e tretë synohet të vërtetohet nëse dyfishimi i kundrinave përmes përemrave klitikë e markon topikën, pasi nga disa studime (Kallulli 2000, 2008; Kapia 2010) që janë bërë më parë, është thënë se dyfishimi me klitikë i kundrinave të drejta nuk është një fenomen fakultativ në gjuhën shqipe. Si dhe është supozuar se dyfishimi i klitikut e prodhon dhe kodon strukturën e informacionit në mënyrë sistematike, në mënyrë që kundrinat e dyfishuara interpretohen qartësisht si topikë.

Tutje, një mekanizëm tjetër sinatksor që do të trajtohet në kapitullin e katërt ka të bëjë me konfigurimet variacionale të fjalive në raport me strukturën e informacionit se sa ndikon në kodifikimin e kësaj të fundit. Shqipja llogaritet të jëtë gjuhë me rend të lirë, ndërsa rendi kanonik i fjalëve konsiderohet të jetë ai SVO. Nga një hulumtim i bërë nga Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu (2018) del se shqipja *tregon një fleksibilitet të madh në renditjen e përbërësve të fjalisë. Për shkak të këtij fakti, ajo është përmendur shpesh si një gjuhë "me rend të lirë", me rendin SVO të përbërësve që paraqitet si themelor, por edhe jo i detyrueshëm*. Pra, zbatimi i disa veprimeve të lëvizjes opsionale mund të japë edhe renditje të ndryshme fjalësh (**SVO, OSV, OVS, VSO, VOS, SV, VS**), që tregon se shqipja është një gjuhë “scrambling”. Dukuria “scrambling”, e cila së pari u përcaktua si rend i lirë i fjalëve, shihet si rezultat i operacioneve lëvizëse krejtësisht opsionale nga disa gjuhëtarë (si: Chomsky, Rizzi, Bošković), dhe si rezultat i veprimeve të caktuara të lëvizjes së detyrueshme nga disa të tjerë (si: Güreer; Şener). Ndërsa në gjuhën shqipe ndryshimet e mundshme të renditjes së fjalëve shpesh janë konsideruar si konfigurim variacional me qëllim për ta ndryshuar ose rritur peshën e informacionit (Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu 2018; Xhaferi 2005).

Prandaj, këtu do të argumentohet nëse të gjitha operacionet e lëvizjes, që realizohen ndryshe nga struktura e përgjithshme e fjalive në shqip, drejtohen nga tipare të bazuara në diskurs; dhe nëse ka vend për ndonjë operacion që e ndryshon rendin linear të përbërësve në mënyrë të rastësishme dhe/ose pa përfshirjen e një tipari diskursiv. Pra, nëse ndërrimet e rendit të fjalëve përcaktohen plotësisht nga motive diskursive-pragmatike nëpërmjet të cilave kodifikohet struktura e informacionit.

Për t’i analizuar dhe hulumtuar të gjitha këto që i thamë më lart janë përzgjedhur tre korpuse: gazeta **Koha**; emisioni **Pressing** (30 maj 2022); filmi i metrazhit të gjatë **Një tregim Prishtine**; dhe komentimi i ndeshjes së futbollit **Serbi – Shqipëri** (14.10.2014 Beograd). Këto lloje tekstesh janë përzgjedhur me qëllim, pasi janë ndërtuar mbi stile të ndryshme që kanë funksione të ndryshme, e poashtu dallojnë për nga këndvështrimi folës, i cili së bashku me stilin mund të llogariten si dy faktorë të jashtëm, që luajnë rol në kodifikimin e strukturës së informacionit.

Gjatë hulumtimit, po ashtu, përdoren metoda deskriptive, statistikore (në kapitullin e tretë), analitike, krahasimtare dhe e vëzhgimit të drejtpërdrejtë.

Fjalët kyçe: strukturë informacioni, topikë, fokus, TopP, FocP, markimi-F, dyfishimi klitik, konfigurim variacional i fjalëve në fjali

SUMMARY

The purpose of this study is to investigate the way in which the information structure is codified in the Albanian language within the sentence. Information structure in literature is understood as a division between the focus and the topic of a sentence. According to Halliday, "every text [. . .] is organized into what may be called information units [. . .] and this is not defined [. . .] according to the constituent structure. Rather, it can be said that the distribution of information specifies a separate structure on another plane' (1967: 200).

Therefore, in order to investigate the way of codification of the information structure in the Albanian language, this doctoral thesis has been divided into six chapters, including the Introduction and the Conclusion:

In the INTRODUCTION chapter (0) the concept of the structure of information, the object of the study, the hypotheses of the study, as well as the methods and tasks are elaborated first. From the very beginning of this chapter, there is an intention to define the concept of information structure within the framework of linguistics, while explaining the interfaces of information structure with other fields of linguistics, such as: syntax, semantics, prosody and pragmatics, in order to show that mixed strategies are used to structure information within a sentence, and information structure as a concept cannot function alone without interacting with the aforementioned domains at certain points. Further, after defining the concept, it is intended to define the object of the study through which it is tried to explain how information is organized within an Albanian sentence, and in particular how syntax, semantics, prosody and structure of information interact in the codification of information in the Albanian language. Consequently, these assumptions lead to the hypothesis that Albanian uses different strategies to codify the structure of information, which will be seen in the following chapters. All these strategies that are used to enable and investigate the topic/focus action denote that a heterogeneous methodology

is used, for instance: in order to investigate the topic in a sentence, a syntactic and semantic analysis is used, as well as to investigate the focus, and so on.

Within the axis of the first chapter, the notion of topic/topic in the Albanian language is explored in detail. First, a brief historical survey is provided which will show some of the definitions of theme/topic in the linguistics literature. Then, the various characterizations and motivations behind them will be examined. In this case, propositions related to such notions as: typical characteristics of the topic, syntactic context, discursive references, prior knowledge in discourse and context, as well as those that impose some such syntactic constraints, are examined. Also, the way of realizing the syntagm of the topic in the Albanian language.

In the second chapter, another notion that is treated within the axis of this dissertation is the notion of focus/rheme. Thus, its position in the sentence will be examined, as well as by what means it is marked in the Albanian language. Also, attention will be paid to some of the types of focus that have been proposed in the literature (Lambrecht 1994). The task of identifying the focus of a sentence may seem easier than identifying a topic, since compared to topics, focus is not marked phonologically only through stress. So not all elements that carry focus are highlighted, some elements that get focus don't necessarily carry focus. In fact, focus elements may be elements that convey information not entirely new to the listener, and some focus phrases may appear in sentence-initial position. Therefore, we will do semantic analysis in the generativist framework through question types to find the focus.

Although the topic and focus have been treated as the main notions of information structure, these notions still do not underline studies on it, because this is not the only possible use of the term information, as it can also describe the general way in which information of any kind is structured. Also, the structure of information is linguistically marked differently in different languages. As Vallduví (1996: 460) assumes, information packaging is a structuring of sentences with syntactic, prosodic or morphological means that arises out of necessity, to meet the communicative requirements of a particular context or discourse.

By these we mean that the information structure is realized by a diverse interaction of language tools or strategies. Semantic, pragmatic, syntactic and prosodic factors intertwine in reflecting the packaging of information, which in turn provides insight, not only into the interfaces of these components, but also into how different languages codify such information (Gürer 2020: 3).

Therefore, the two notions that were mentioned before, topic and focus, are not the only elements that make up the axis of this study, but this axis is also complemented by other linguistic mechanisms, with which it is assumed that the structure of information in the Albanian language is realized. Among the linguistic mechanisms, which are thought to play a role in the codification and structuring of information in the Albanian language, are: prosodic tools that are assumed to mark the focus (FocP), distinguishing it from the topic (TopP); another mechanism is the doubling of opposites through pronominal clitics, which is claimed to codify the topic or information previously given in the preceding discourse; another strategy that is believed to be used by Albanian to realize the structure of information has been the variational configuration of sentences, since it is a language with somewhat free order.

Therefore, within the second chapter, it is proven if Albanian uses prosodic tools to codify the structure of information, that is, if in the Albanian language focus marking is done through suprasegmental elements including the fundamental frequency (F0), intensity and length of the sound of the given word. And if the given word contains the tone H*+ L, it will be taken as the focus of the sentence, so this word (F-marked) carries the accent according to the metrical autosegmental theory of intonation.

In the third chapter, the aim is to prove whether the doubling of adverbs through clitic pronouns marks the topic, since in several studies (Kallulli 2000, 2008; Kapia 2010) that have been done before, it has been claimed that the doubling of adverbs with clitics is not an optional phenomenon in the Albanian language. Also, it has been assumed that clitic doubling produces and encodes information structure in a systematic way, so that doubled opposites are clearly interpreted as topical.

Further, another syntactic mechanism that will be treated in the fourth chapter has to do with the variational configurations of the sentences in relation to the structure of the information as it affects the codification of the latter. Albanian is considered to be a language with free order, while the canonical word order is considered to be SVO. From a research done by Sejdiu-Rugova and Simitçiu (2018) it appears that Albanian shows a great flexibility in ordering the components of the sentence. Because of this fact, it has often been referred to as a “free-order” language, with the SVO order of the constituents appearing as fundamental but also not mandatory. So, the implementation of some optional movement actions can also give different word orders (**SVO, OSV, OVS, VSO, VOS, SV, VS**) which shows that Albanian is a "scrambling" language. The "scrambling" phenomenon, which was first defined as a free word order, is seen as the result of completely optional movement operations by some linguists (such as: Chomsky, Rizzi, Bošković) and as the result of certain compulsory movement actions from some others (like: Güreş; Şener). While in the Albanian language possible changes in the order of words are often considered as variational configuration in order to change or increase the weight of information (Sejdiu-Rugova and Simitçiu 2018; Xhaferi 2005).

Therefore, here it will be argued whether all movement operations, which are realized differently from the general structure of sentences in Albanian, are governed by discourse-based features; and whether there is room for any operation that changes the linear order of the constituents randomly and/or without the inclusion of a discursive feature. So, if word order changes are fully determined by discursive-pragmatic motives through which the structure of information is codified.

To analyze and research all that we said above, three corpora have been selected: *Koha newspaper*; the show **Pressing** (May 30, 2022); the feature film *A Story of Pristina*; and the commentary of the football match *Serbia - Albania* (14.10.2014 Belgrade). These types of texts have been selected on purpose, as they are built on different styles that have different functions, and they also differ from the speaker's point of view, which together with style can be considered as two external factors that play a role in the codification of information structure.

During the research, descriptive, statistical (in the third chapter), analytical, comparative and direct observation methods are also used.

Key words: information structure, topic, focus, TopP, FocP, F-marking, clitic doubling, variational configuration of words in the sentence

MIRËNJOHJE

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	15
SHKURTESA.....	18
0. HYRJE	21
0.1. Koncepti i strukturës së informacionit.....	21
0.2. Objekti i studimit.....	35
0.3. Hipotezat e studimit.....	36
0.4. Metodologjia dhe detyrat e studimit.....	37
1. TOPIKA	41
1.1. Histori e shkurtër për evoluimin e nocionit të topikës.....	41
1.2. Topikë = Kryefjalë & Fokus = Kallëzues?!.....	42
1.3. Analiza e karakteristikave apo vetive tipike të topikave.....	48
1.3.1. Karakterizimet diskursive të topikës.....	49
1.3.2. “Për çfarë bëhet fjalë në fjali?” (Aboutness).....	49
1.3.3. Referentët diskursivë.....	51
1.3.4. Diskursi paraprak (Discourse-oldness).....	52
1.3.5. Lidhja kontekstuale.....	54
1.4. Karakterizimet sintaksore.....	56
1.4.1. Kriteri: pozicioni fillestar i fjalisë.....	56
1.4.2. Kryefjalë-topikë.....	59
1.4.3. Format përemërore.....	62
1.5. Kodimi i topikës në gjuhën shqipe.....	64
1.5.1. Sintagma e topikës.....	64
1.5.2. Topika e realizuar me kryefjalë boshe (<i>null subject</i>).....	66
2. FOKUSI	80
2.1. Përkufizimi i fokusit nga këndvështrimi semantik.....	80
2.2. Topkë = Presupozim?!.....	84
2.3. Informacion i dhënë = Presupozim?!.....	85
2.4. Presupozimi dhe fokusi sipas Rooth-it (1985).....	90
2.4.1 Semantika alternative.....	91
2.4.2. Semantika alternative dhe një operator interpretimi për fokusin.....	93
2.4.5. Alternativat kundrejt presupozimit ekzistencial.....	96
2.4.6. Përfundim: FOKUSI NË SEMANTIKËN ALTERNATIVE.....	99
2.5. Diagnostikimi më i thjeshtë i fokusit.....	101
2.5.1. Heuristika: ngjallja e kontekstit.....	101
2.5.2. Pyetjet-wh.....	102
2.5.3. Testi Q-A (Kasimir 2005).....	103
2.5.4. Përgjigjet e fragmentuara.....	106

2.5.5. Pyetjet alternative	107
2.6. Realizimi prozodik i fokusit.....	108
2.6.1. Rreshtimi (Alignment-Align XP)	111
2.6.2. Kufizimi WRAP-XP.....	113
2.7. Realizimi prozodik i fokusit në gjuhën shqipe.....	114
2.7.1. Metodologjia e analizës	115
2.7.2. Analiza (Shembujt e marrë nga emisioni <i>Pressing</i>)	115
2.7.3. Fokusi special apo emfatik	119
2.7.4. Përfundimi	124
2.8. Vetitë sintaksore të fokusit.....	125
2.8.1. Pozicionet e fokusit në fjali	127
2.8.2. Ndërtimet <i>cleft</i>	128
2.8.4. Strategjitë e fokusit ballor në gjuhën shqipe.....	131
2.9. Përfundim:.....	132
3. Roli i dyfishimit të përemrave klitikë dhe struktura e informacionit.....	135
3.1. Përemrat klitikë dhe roli i tyre në strukturën e informacionit.....	135
3.2. Rishikimi i literaturës.....	136
3.3. Pyetje kërkimore	137
3.4. Metoda	137
3.5. Rimarrja ose dyfishimi i kundrinave në rrafshin diakronik	138
3.5.1. Përemrat klitikë të shqipes (paradigmat):	141
3.6. Ndërtimi dhe pozita e dyfishimit të klitikëve në fjali	142
3.6.1. Si realizohet dyfishimi i klitikëve?	142
3.6.2. Imperativi dhe klitikët.....	148
3.7. Përemrat klitikë dhe roli i tyre në strukturën e informacionit.....	148
3.7.1. Fakticiteti, dyfishimi klitik dhe IS	151
3.7.2. Klitikët e vetës së tretë në dhanore e kallëzore	152
3.8. Analiza.....	155
3.8.1. Metodologjia.....	155
Shembuj nga filmi i metrazhit të gjatë <i>Një tregim Prishtine</i> :	162
Shembuj nga komentimi i ndeshjes së futbollit <i>Serbi – Shqipëri</i> (14.10.2014, Beograd).....	164
3.9. Përfundimi	167
4. KONFIGURIMI VARIACIONAL I RENDIT TË FJALËVE DHE NDIKIMI I STRUKTURËS SË INFORMACIONIT	170
4.1. Funkcioni komunikues i fjalisë (si formë) dhe rendi i fjalëve	173
4.2. Rendi kanonik i fjalëve dhe variacionet konfiguracionale në gjuhën shqipe.....	175
4.3. Periferia dhe hartografia majtas	176
4.4. Aletërnimi i XP-ve në pozitën e fokusit dhe topikës	179
4.5. Veçoritë e lidhura me diskursin dhe shpërndarja e [OP] në shqip.....	184
4.6. Efektet diskursive-pragmatike në konfigurimet variacionale	186
4.7. Renditja kanonike e fjalëve në gjuhën shqipe.....	186

4.8. Konfiguracionet variacionale të SOV dhe OSV në gjuhën shqipe	188
4.8.1 Rendi OSV.....	188
4.8.3. Konfiguracioni VS.....	193
4.9. Përfundim:.....	197
5. PËRFUNDIME	198
BIBLIOGRAFIA	209
Indeksi i emrave	215

SHKURTESA

(ϕ)	Tiparet-phi
Align-Foc, R	Rreshtimi i fokusit djathtas
Align XP, R	Rreshtimi djathtas
CD	Dyfishimi klitik
Cl	klitik
CLLD	Dyfishimi klitik majtas
CP	Sintagmë komplementuese (Complementizer Phrase)
DA	Discourse anaphoric
DO	Kundrinë e drejtë
DP	Sintagmë determinative
Finiteness	Shquarësia
Foc	Fokus
FocP	Sintagma e fokusit

Force	Forca
IO	Kundrinë e zhdrejtë
IP	Infleksioni
O	Objekt (Kundrinor)
OP	Sintagma operatore
ϕ	Sintagmë fonologjike
Pro	Përemër bosh (Silent Pronoun)
S	Subject (Kryefjalë)
SCI	Sintagmë klitike (Clitic Prhase)
SE/NP	Sintagmë emërore
SF/VP	Sintagmë foljore
SI	Struktura e informacionit
SP	Sintagmë parafjalore
Stress XP	Sintagma që bart theksin

Top	Topikë
Topic	Topika/Tema
TopP	Sintagma e topikës
V	Verb (Folje)
Wh-question	Fjali pyetëse
WRAP-XP	Sintagmë mbështjellëse
XP	Sintagmë leksikore
λ	kuantifikim
OT	Teoria e optimalitetit

0. HYRJE

0.1. Koncepti i strukturës së informacionit

Në gjuhësi termi *strukturë e informacionit*, ose siç quhet ndryshe *paketim i informacionit*, e përshkruan mënyrën në të cilën informacioni paketohet formalisht brenda një fjalie (Lambrecht 1994). Ky term në gjuhësi u prezantua për herë të parë nga Halliday (1967), ndërsa vetë koncepti i ka rrënjët në antikitet (shih von Heusinger 1999). Termi është përdorur për një numër dukurish të ndryshme. Por, në këtë tezë për termin *strukturë informacioni* ndiqen teoritë e gjuhëtarëve, si: Halliday (1967), Chafe (1976), Lambrecht (1994), Erteschik-Shir (2007), në të cilat u prezantua nocioni i paketimit të informacionit, për t'iu referuar mënyrës sesi paraqitet informacioni, në kontrast me vetë informacionin që përcillet. Më konkretisht, me termin strukturë informacioni kuptohen aspekte të gjuhës natyrore që i ndihmojnë folësit ta vlerësojë gjendjen aktuale të informacionit të adresuesit, dhe kështu lehtësohet rrjedha e komunikimit. Përmes kësaj pikëpamje nënkuptohet se komunikimi mund të shihet si ndryshim i vazhdueshëm i *sfondit/topikës së përbashkët*, d.m.th., i informacionit që dihet reciprokisht se ndahet në komunikim; folësit i planifikojnë thëniet e tyre në lidhje me sfondet/topikat e përbashkëta që kanë. Po e marrim një shembull konkret:

(1) *Unë kam një mace dhe më duhej ta çoja macen time te veterineri.*

Klauza e parë në (1) e paraqet informacionin që folësi ka një mace brenda sfondit të përbashkët. Pra, sintagma emërore *macen time* në klauzën e dytë e presupozon këtë; folësi mund ta përdorë këtë frazë, sepse referenca e tij mund të supozohet se është e spikatur/theksuar në sfondin e përbashkët pas shqiptimit të klauzës së parë. Klauza e dytë

e shton informacionin që folësi duhej ta sillte macen te veterineri në *sfondin e përbashkët* që kanë folësi dhe dëgjuesi. Adresuesi e pranon informacionin. Kështu, sfondi i përbashkët pasurohet vazhdimisht gjatë komunikimit (Krifka 2012: 1). Pra, gjithmonë ekziston një bazë e përbashkët e infomacionit midis folësit dhe adresuesit. Sfondi i përbashkët midis folësit dhe adresuesit ndryshe quhet topikë, ndërsa pjesa që i shtohet sfondit të përbashkët quhet fokus. Prandaj, në bazë të shembullit që u dha më lart, termi strukturë informacioni këtu nënkuptohet si një ndarje midis fokusit dhe topikës së një fjalie. Sipas Halliday, *çdo tekst [. . .] është i organizuar në ato që mund të quhen njësi informimi [. . .] kjo nuk është përcaktuar [. . .] sipas strukturës përbërëse. Përkundrazi, mund të thuhet se shpërndarja e informacionit specifikon një strukturë të veçuar në një plan tjetër* (1967: 200). Po e analizojmë fjalinë më poshtë:

(2) *Unë* _{TopP} [*kam një mace*]_{FocP}

Pra, secila fjali ndahet në dy njësi informimi **topika** (apo tema: *unë*) dhe **fokusi** (apo rema: *e kam një mace*). Fokusi dhe topika janë nocione strukturore të rëndësishme të informacionit gjuhësor, pasi ato pasqyrojnë kufizimet e paketimit të informacionit në realizimin formal të fjalive. Termi strukturë informacioni zakonisht përdoret në një mënyrë përafërsisht ekuivalente me temën/remën dhe dallimin midis sfondit e fokusit ose topikës dhe komentit.

Megjithëkëtë, vetëm këto nocione nuk i përthekojnë studimet mbi strukturën e informacionit, sepse ky nuk është përdorimi i vetëm i mundshëm i termit informacion, pasi ai gjithashtu mund ta përshkruajë mënyrën e përgjithshme në të cilën strukturohet informacioni i çfarëdo lloji qoftë. Madje, një nga gjërat e pakta mbi të cilat pajtohen plotësisht dhe praktikisht të gjithë studiuesit që merren me strukturën e informacionit është se terminologjia me të cilën përshkruhet struktura e informacionit është shumë e paqëndrueshme dhe konfuze (Bott 2007:1).

Prandaj, hulumtimi mbi raportin temë – remë nuk është i mjaftueshëm, për ta përshkruar strukturimin e informacionit në një gjuhë, pasi gjuhët përdorin mjete të ndryshme për ta strukturuar informacionin brenda një fjalie. Siç supozon edhe Vallduví (1996: 460), paketimi i informacionit është një strukturim i fjalive me mjete sintaksore, prozodike ose morfologjike që lind nga nevoja, për t'i përmbushur kërkesat komunikuese të një konteksti ose diskursi të veçantë. Në veçanti, paketimi i informacionit tregon se si informacioni i përcjellë me mjete gjuhësore përshtatet me kontekstin ose diskursin (në modelin mendor të dëgjuesit). Kur komunikon një fjali φ , një folës mund ta kuptojë atë me anë të strukturave të ndryshme sentenciale sipas bindjeve të tij/saj në lidhje me njohuritë e dëgjuesit dhe gjendjen e vëmendjes në lidhje me φ .

Së këndejmi, në bazë të këtij supozimi të Vallduví -t (1996), në këtë disertation provohet të argumentohet që shqipja përdor strategji të përziera, për ta strukturuar informacionin brenda një fjalie.

Nga ajo që u tha deri tani, nënkuptohet se struktura e informacionit markohet gjuhësisht ndryshe në gjuhë të ndryshme (Bott 2007: 21). Po i vështrojmë disa gjuhë, për shembull, në gjuhën japoneze dhe koreane, sistemi morfologjik është përgjegjës për sinjalizimin e fokusit ose statusit të temës. Në japonishte, pjesëza *wa* funksionon si shënuese e temës dhe pjesëza *ga* si shënuese e fokusit (krh. Kuno 1973). Ndërsa në koreanisht, për shembull, pjesëza e patheksuar *nun* e shënon topikën e fjalisë (shih Choe 1995, dhe Hetland) (cit. sipas Schwabe; Winkler 2007: 3). Ndërsa, sipas Katz dhe Selkirk (2011), anglishtja e kodifikon strukturën e informacionit sipas njësive prozodike, pra, dallimi midis përbërësve të rinj në diskurs dhe fokusit kontrastiv pasqyrohet përmes prozodisë, në atë fokus kontrastues ka një ngritje dhe gjatësi më të lartë se e përbërësve të tjerë të rinj të diskursit. Po ashtu, **rirenditja sintaksore** e fjalëve është një strategji tjetër e përdorur, për ta shënuar paketimin e informacionit. Në italisht, frazat e topikave lëvizëse apo zhvendosëse (aboutness), kontrastive dhe të zakonshme shfaqen në një fjali në këtë rend hierarkik (Frascarelli dhe Hinterhölzl 2007). Në rumanisht, katalanisht dhe hungarisht, pozicioni i menjëhershëm preverbal është sugjeruar për të qenë pozicioni identifikues në pozitën e fokusit kontrastiv (Kiss 1998) (cit. sipas Güerer 2020). Një tjetër mënyrë për ta kodifikuar strukturën e informacionit, është përdorimi i **strategjive të**

përziëra përmes të cilave e nxjerr në pah statusin e informacionit të përbërësit në fusha të ndryshme të gramatikës, meqë struktura e informacionit (IS) është konceptuar si një “fushë kognitive” që ndërvepron me sintaksën, fonologjinë dhe morfologjinë e moduleve gjuhësore nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, me aftësi të tjera njohëse që kontrollojnë, përditësojnë dhe nxjerrin përfundimin e bashkëbiseduesve. Besimet e përbashkëta (Zimmermann & Féry 2010), për shembull, në hungarisht, frazat me fokus të kufizuar i nënshtrohen lëvizjes në pozicionin e menjëhershëm preverbal. Ndërsa, Genzel, Ishihara dhe Surányi (2014) vërejnë se në domenin prozodik, frazat me fokus të kufizuar kanë vlera më të larta f0 dhe gjatësi më të madhe, kur krahasohen me përbërësit në të njëjtin pozicion në fjalitë që kanë fokus të gjerë. Për më tepër, frazat me fokus kontrastiv tregojnë më shumë zbritje të vijës melodike gjatë shqiptimit të elementeve para-fokale dhe post-fokale sesa frazat e fokusit jokontrastiv.

Me këto nënkuptojmë se struktura e informacionit realizohet nga një bashkëveprim i shumëllojshëm i mjeteve apo strategjive gjuhësore. Faktorët semantikë, pragmatikë, sintaksorë dhe prozodikë ndërthuren në pasqyrimin e paketimit të informacionit, i cili nga ana tjetër siguron depërtim, jo vetëm, në ndërfaqet e këtyre përbërësve, por gjithashtu, në mënyrën sesi gjuhët e ndryshme e kodifikojnë informacionin e tillë (Gürer 2020: 3). Prandaj, hulumtimi që do të bëhet këtu i ndërthur disa fusha.

Po e analizojmë një shembull në gjuhën shqipe, për të parë se si bashkëveprojnë faktorët pragmatikë, sintaksorë dhe prozodikë, për t’i strukturuar njësitë e infomacionit.

1a. Vajza këndon një KËngë. (SVO)

fonologjikisht e markuar

sintaksisht dhe fonologjikisht

1b. Një këngë këndon VAjza. (OVS)

e markuar

1c. Vajza një këngë këndon. (SOV)

sintaksisht e markuar

Të tri strukturat në (1) e shprehin të njëjtin kuptim semantik: ekziston një individ i caktuar, pra vajza që e ka vetinë e të kënduarit të këngës. Le të supozojmë se struktura në (1a) është përgjigja e pyetjes ‘çfarë ka ndodhur?’ dhe kështu ajo është pragmatikisht neutrale në sajë të përfshirjes në këtë kontekst neutral. Si rezultat, struktura në (1) parashikohet të prodhojë konturin e paracaktuar intonacional dhe strukturën e paracaktuar sintaksore. Krahasuar me (1a), strukturimi i informacionit i (1b) dhe (1c) është i ndryshëm. Kjo do të thotë, / *vajza* / në (1b) është prozodikisht e spikatur dhe kështu që do të parashikohej të ishte e shquar edhe pragmatikisht. Meqenëse / *vajza* / është prozodikisht dhe pragmatikisht e spikatur, intonacioni dhe interpretimi i (1b) parashikohet të mos jetë i njëjtë me konturin intonacional dhe interpretimin e (1a). Në të njëjtën mënyrë, interpretimi dhe gjithashtu realizimi sintaksor i (1c) nuk është identik me të dy (1a) dhe (1b). Kjo sepse / *vajza* / in (1c) zhvendoset majtas sintaksisht. Meqenëse njësitë / *vajza* / dhe / *një këngë* / janë zhvendosur majtas, statusi i këtyre fjale supozohet të jenë të spikatur në diskurs më parë. Si rezultat, interpretimi i diskursit i (1c) është i ndryshëm nga (1a).

Transformimet e tilla, sipas Rugova dhe Sejdiu-Rugova (2015: 118), në rendin e fjalëve të fjalisë nën a, si në: b, dhe c janë variante të së parës dhe në rrafshin gramatikor janë korrekte, ndonëse shembulli i fjalisë së parë në gjuhën shqipe është më i pritshëm. Pra, këto janë konfiguracione variacionale dhe dallojnë për nga mënyra se si e markojnë strukturën e informacionit.

Në **domenin semantik**, përmes alternativave semantike dhe semantikës gjenerative, që do të diskutohen në kapitullin e tretë (shih Chomsky 1971; Jackendoff

1972) nëpër gjuhë është synuar të nxirret në pah përcaktimi i pikës ndarëse midis fokusit dhe topikës. Siç e thamë më lart, termi strukturë informacioni nënkuptohet si një ndarje midis fokusit dhe topikës së një fjalie. Një nga gjërat e pakta mbi të cilat pajtohen plotësisht e praktikisht të gjithë studiuesit që merren me strukturën e informacionit është se terminologjia me të cilën është përshkruar SI është shumë kontraktore dhe konfuze. Termi strukturë informacioni zakonisht përdoret në një mënyrë përafërsisht ekuivalente me temën-remën, sfondin e fokusit ose dallimin e temë-koment (Bott 2007). Dihet se fjalitë tregojnë një artikulum informativ ku ka një pjesë më pak informuese - tema ose topika – dhe pjesë më shumë informuese - fokusi ose rema. Njohja e kësaj ndarjeje ka marrë forma të ndryshme dhe janë sugjeruar dikotomitë e mëposhtme: temë – remë; topikë – koment; topikë – fokus; fokus – presupozim, fokus – propozim i hapur; ose fokus – sfond. Siç ka theksuar Vallduví (1990), këto propozime bien dakord për ekzistencën e një ndarjeje brenda fjalive, ato ndryshojnë në pikën e ndarjes dhe llojin e kësaj ndarjeje (vazhdimësi / ndarje). Disa nga këto dikotomi – temë - remë dhe topikë –koment – e ndajnë temën ose topikën nga pjesa tjetër e fjalisë. Të tjerët e veçojnë fokusin nga pjesa tjetër e fjalisë, së cilës i referohemi si presupozim, propozim i hapur ose sfond (Casielles – Suarez 2004).

Pra, brenda kuadrit të semantikës do të hulumtohet hollësisht nocioni i temës/topikës. Së pari do të ofrohet një studim i shkurtër historik i cili do të tregojë disa nga përkufizimet e temës/topikës në literaturë. Pastaj, do të shqyrtohen karakterizimet e ndryshme dhe motivimin që qëndron pas tyre. Me ç'rast do të shqyrtohen propozime që lidhen me nocione të tilla, si: rrethimi sintaktik, referentët diskursivë, dija paraprake në diskurs dhe konteksti, si dhe ato që imponojnë disa kufizime sintaktike të tilla, si të qenit subjekt/kryefjalë, duke qenë në pozicionin fillestar të fjalisë ose duke u shprehur me formë përemërore ose përmes mbaresave vetore. Po ashtu, do të shqyrtohen mënyrat me të cilat gjuha shqipe i kodon *frazat ose sintagmat topike*. Nocioni tjetër që do të shqyrtohet këtu është ai i topikës kontrastive.

Po ashtu, përmes alternativave semantike dhe semantikës gjenerative do të trajtohet hollësisht nocioni i fokusit/remës. Pastaj, do të shqyrtohet pozicioni i fokusit në fjali, si dhe me çfarë mjete markohet në gjuhën shqipe. Po ashtu, do t'u kushtohet rëndësi disave prej llojeve të fokusit që janë propozuar në literaturë (Lambrecht 1994). Detyra e

identifikimit të fokusit të një fjalisë mund të duket më e lehtë sesa e identifikimit të një teme, pasi në krahasim me temat, fokusi markohet fonologjikisht përmes theksit. Por, jo të gjithë elementet që e përçojnë fokusin theksohen, disa elemente që marrin theks nuk e përcjellin domosdoshmërisht fokusin. Madje, elementet që fokusohen mund të jenë elemente që përcjellin informacione jo krejt të reja për dëgjuesin dhe se disa fraza të fokusit mund të paraqiten në pozicionin fillestar të fjalisë. Teknikat e tjera që e nxjerrin në pah fokusin lidhen me çiftin pyetje – përgjigje, me ç’rast përgjigjja është e barabartë me fokusin. Janë disa lloje pyetjesh që bëhen për ta nxjerrë fokusin që do t’i rendisim në kapitullin e dytë. Sipas Jenneke (2016), pyetjet-wh kërkojnë gjithmonë informacion të ri, ose, më formalisht, prezantojnë një variabël në propozim, për të cilën sinjalizohet mungesa e njohurive, për shembull, *Kush e nget makinën?* prezanton një grup përgjigjesh të mundshme të formës *X apo filani e nget makinën*. Jenneke (ibid. 5), duke e cituar Zimmermann dhe Onea (2011:1663) shprehet se, për sa i përket semantikës alternative, *një përbërës i fokusit X shpreh informacion të ri, nëse [kuptimi (i zakonshëm) i X] prezanton një element alternativash në terrenin e përbashkët dhe nëse alternativat ndaj [kuptimit të X] nuk kanë qenë në mënyrë eksplícite të paraqitura në diskursin paraprak*.

Andaj, është e domosdoshme që brenda domenit të semantikës, ku trajtohet nxjerrja në pah e fokusit dhe topikës, të trajtohet edhe se si organizohet informacioni i njohur dhe informacioni i panjohur ose i ri brenda fjalisë. Tema e rema (ose topika dhe fokusi) janë mjetet strukturore me të cilat paraqitet mesazhi i klauzës. Kurse mjetet semantike janë njësitë e informacionit, siç njihen ndryshe e dhëna dhe e reja. Secila njësi informacioni përbëhet nga një element **i dhënë** i shoqëruar nga një element **i ri**. Por janë dy rrethana të shmangies së këtij parimi, me ç’ rast elementi i ri gjithmonë është i domosdoshëm, ndërsa elementi i dhënë është opsional, pasi elementi i dhënë mund të mos shprehet për shkak se e bën të qartë konteksti, ose edhe për shkak të elipsës (Halliday 1985: 116). Sipas Halliday (ibid. 120), edhe pse ato janë të lidhura, e dhëna + e reja dhe tema + rema nuk janë e njëjta gjë. Sipas tij, konteksti krijon kushte lokale që e anashkalojnë modelin global të përkimit të temës me informacionin e dhënë dhe të remës me informacionin e ri. Sipas Halliday, tema është ajo që folësi zgjedh për ta marrë si pikënisje. E dhëna është ajo që ti, dëgjuesi, tashmë ke njohuri ose je në dijeni për të. Tema / rema është e orientuar kah folësi, ndërsa e dhëna/e reja është e orientuar kah dëgjuesi. Për

shembull, në fjalinë *E kom nesër ni takim mas shkolle*, nëse tema është *E kom nesër* dhe rema *ni takim mas shkolle*, nuk d.m.th që tema është informacioni i dhënë dhe rema informacioni i ri. Edhe e dhëna edhe e reja këtu vendosen në bazë të kontekstit prej marrësit, varësisht cilën pjesë e cilëson ai si të re ose të dhënë.

<i>[E] kom nesër</i> Tema	<i>ni takim mas shkolle</i> rema	
E dhëna	E reja	Marrësi 1
E reja	E dhëna	Marrësi 2

Interpretimi i mesazhit nga marrësi varet nga konteksti i situatës: marrësi e përcakton atë që është e re dhe atë që është e dhënë, varësisht nga baza e përbashkët e bashkëbiseduesve, mbi njohuritë e përbashkëta ekzistuese ndërmjet tyre.

Në gjuhën shqipe është sqaruar dallimi ndërmjet informacionit të vjetër/të ri dhe njësisve tematike temë/remë nga Rugova dhe Sejdiu-Rugova (2015), me ç'rast kriteri i kontekstit është marrë si vendimtar për nxjerrjen e njësisve të informacionit.

Pra, në kapitullin për *Fokusin* do të trajtohen hollësisht nocionet informacioni i njohur/i ri, meqë diagnostifikimi i fokusit është më i lehtë kur ai lidhet me informacionin e ri. Edhe pse nuk ka ndonjë konsensus të qartë se si përkufizohen këto nocione në përgjithësi ekziston një mendim se faktorët që përcaktojnë një entitet si diçka të dhënë apo të njohur janë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë (Prince 1981), e të cilët krijojnë një bashkëveprim kompleks.

Kur flasim për informacionin e njohur dhe të panjohur është e pamundur t'i anashkalojmë **përbërësit anaforikë dhe kataforikë të diskursit**. Përbërësit anaforikë dhe kataforikë të diskursit janë njësi strukturore të informacionit që shqiptohen ose jepen në diskursin paraprak, siç janë përemrat, për shembull. Neeleman dhe Vermeulen (2012) sugjerojnë që nocioni i topikës i përdorur nga Rizzi (1997) në të vërtetë mbulon përbërësit anaforikë të diskursit, pasi topika përcaktohet si një përbërës i përmendur më parë në diskurs “(...) që shpreh normalisht informacionin e dhënë disi të disponueshëm dhe të spikatur në diskursin e mëparshëm” (Rizzi 1997: 285). Përbërësit anaforikë të diskursit në këtë tezë janë në përputhje me nocionin e topikës së njohur të përcaktuar nga Frascarelli dhe Hinterhölzl (2007: 2) si një përbërës “(.. ..) i dhënë ose i njohur (Chafe 1987), i cili zakonisht realizohet nëpërmjet formave pronominale”. Le të marrim shembuj në gjuhën shqipe:

1. ***Djali** shkon në shkollë. **Ai** mëson shumë.*
2. ***Ai** mëson shumë. **Petrit** quhet.*

Në shembullin e parë, sipas Rugova dhe Sejdiu-Rugova (2015: 139), përemri *ai* i referohet fjalës *djali* dhe, meqë elementi referues hyn në ligjërim pas njësisë, të cilës i referohet, llogaritet si referencë anaforike. Ndërsa në shembullin e dytë, sipas Rugova dhe Sejdiu-Rugova (ibid. 140), meqë elementi referues vendoset para të referuarit përbën kataforë.

I përmendëm më herët mjetet prozodike si një ndër strategjitë gjuhësore që përdoren për ta realizuar fokusin, andaj në kapitullin për *Fokusin*, po ashtu, do të provohet nëse shqipja i përdor **mjetet prozodike**, për ta kodifikuar strukturën e informacionit.

Halliday e vështron një strukturë klauze si një grup të organizuar të njësive të informacionit të cilat janë të pavarura nga përbërësit sintaksorë. Kjo do të thotë se një njësi kuptimplote e informacionit në një klauzë nuk formon domosdoshmërisht një përbërës në sintaksë, por një grup tonesh në fonologji, po. Hetimi i realizimit prozodik të frazave të

fokusit ka qenë një çështje intriguese, pasi gjuhët zgjedhin strategji të ndryshme fonologjike ose fonetike, për të shënuar frazat e fokusit. Për shembull, markimi i fokusit bëhet nëpërmjet elementeve mbisegmentare përfshirë frekuencën themelore (F0), intensitetin dhe gjatësinë e tingullit të fjalës së dhënë. Një fjalë e theksuar shënohet me **F-marked** (Selkirk 1995: 555) dhe sipas tij (ibid.), e nënkuptojmë fjalën e cila bart theksin sipas teorisë autosegmentale metrike të intonacionit. Pra, fokusi mund të përcaktohet si përbërësi më i spikatur në një shprehje. Përbërësi i shënuar me F (**F-marked**) i një fraze duhet të përmbajë fjalën ritmikiisht më të spikatur në atë frazë. Varësisht nga njësia që e përmban tonin H*+ L, do të merret si fokus i fjalisë. Po e marrim një shembull me fjalinë *Vajza këndon një këngë*, për të cilën do ta shohim edhe konturin e skematizuar më poshtë:




Fig.1

Në fjalinë e dhënë *Vajza këndon një këngë* (SV_F[O]), VP markohet si fokus i ngushtë (F-marked), pasi theksi bërthamor sinjalizon IP-në fundore.

Pra, në pikën e derivacionit ku një fraze XP i është caktuar [+ foc] - tipari, XP duhet të licencohet si i-fokus, duke markuar me F disa njësi të tjera të përfshira brenda saj, të cilat janë të aftë ta projektojnë F (fokusin) dhe kështu ta markojnë me F një XP.

Prandaj, ky kapitull, sa i përket nivelit prozodik në raport me strukturën e informacionit paraqet punën eksperimentale mbi kodifikimin prozodik të fokusit të informacionit dhe fokusit kontrastiv (domethënë, aspektet e SI-së, konceptet që lidhen me shpërndarjen e informacionit ‘të ri’ dhe ‘kontrast’). Këto do të hartohen sipas qasjes autosegmentale-metrike, duke u bazuar edhe në Teorinë e Optimalitetit.

Në **domenin sintaksor** do të analizohen mekanizmave sintaksorë me të cilët supozohet se realizohet struktura e informacionit në gjuhën shqipe, siç janë **dyfishimi me klitikë** dhe **renditja e fjalëve në fjali**. Pra, në këtë pjesë do të provohet të argumentohet se sa këta mekanizma sintaksorë ndikojnë në kodifikimin e strukturës së informacionit.

Sa i përket dyfishimit me klitikë, nga disa studime (Kallulli 2000, 2008; Kapia 2010) që janë bërë më parë është thënë se dyfishimi klitik i kundrinave të drejta nuk është një fenomen fakultativ në gjuhën shqipe. Si dhe është argumentuar se dyfishimi i klitikut prodhon dhe kodon strukturën e informacionit në mënyrë sistematike, në mënyrë që kundrinat e dyfishuara interpretohen në mënyrë të qartë si topikë. Sipas këtij definicioni, dyfishimi ndodh kur i klitiku referohet një referenti që tashmë është i pranishëm në diskurs. Kushti i nevojshëm për dyfishim është që DP-ja të prezantohet më parë diskurs, duke u bërë kështu referent konkret i disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të dyfishimit. Për ta parë se sa e saktë është kjo teori, në këtë punim do të bëhet një hulumtim pragmatik ku analizohen lidhjet anaforike dhe kataforike të referuesit me elementin të cilit i referohet dhe, po ashtu, nëse referenti është prezantuar më herët në diskurs. Pasi mendohet se nuk mjafton vetëm sintaksa, për t'i definuar argumentet e lartdhëna, pra nuk mund të argumentohet pa u analizuar edhe rrethanat e kontekstit në të cilin nuk ka referencë ndërmjet referuesit dhe referentit. Në bazë të një hulumtimi të më hershëm, ka dalë se jo gjithmonë dyfishohet klitiku i kundrinës së drejtë edhe kur referenti prezantohet më parë në tekst. Pra, edhe kur DP-ja është e njohur për dëgjuesin/marrësin, pra është topikë, sepse është dhënë më parë në tekst. Për shembull, po e marrim mbititullin dhe titullin nga gazeta *Koha*.

Mbititull: *Bllokimi i aktiviteteve ekonomike dhe rënia e konsumit ulin importet dhe eksportet.*

Titulli: **Pandemia ul deficitin tregtar për 37 për qind** (fq 2; 25 maj; nr. 8206)

Në këtë shembull, bazuar në supozimet që jep Kallulli (2000, 2008) DP-ja (deficitin), meqë nuk po përsëritet përmes klitikut, do t'i përkasë informacionit të ri. Por, bazuar në kontekst, qysh në mbititull DP-ja (deficitin tregtar) prezantohet te lexuesi përmes kolokimit (*importet dhe eksportet ~ deficit tregtar*), prandaj ne e kategorizojmë atë brenda

kufijve të informacionit të njohur, edhe pse nuk rimerret përmes trajtës së shkurtër të përemrit vetor (e).

Pra, supozohet që dyfishimi me klitikë të ndodhë kur klitiku i referohet një referenti tashmë të pranishëm në ligjërim (p.sh., kjo është ajo çka nënkuptohet zakonisht me lidhjen D (*D – linked*), dhe kur ky referent zgjidhet nga një grup më i madh. Kusht i nevojshëm atëherë është që grupi më i madh të prezantohet më parë, duke e bërë kështu referentin konkret të disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të dyfishimit klitik. Gjë që po del ndryshe.

Në studimet nga Kallulli (2000, 2008) dhe Kapia (2010) për lidhjen e dyfishimit me klitik dhe strukturën e informacionit shihet njëfarë tendence, për ta normëzuar përdorimin e klitikut aty ku DP-ja, në funksionin e kundrinës së drejtë, njihet nga diskursi paraprak.

Sa i përket **rendit të fjalëve në fjali**, shqipja hyn në kuadrin e gjuhëve jokonfiguruese, ngase deri diku ka rend të lirë, ndërsa, sipas Erteschik-Shir (2007: 80), zakonisht gjuhët konfiguruese, si anglishtja, përbërësit e temës dhe të fokusit i markojnë nëpërmjet mjeteve prozodike. Kjo nuk do të thotë që renditja e fjalëve nuk luan kurrë një rol në identifikimin e temës dhe fokusit në gjuhët konfiguruese.

Shqipja, pra, është një gjuhë jokonfiguruese, por rendi kanonik i fjalëve konsiderohet të jetë ai SVO. Nga një hulumtim i bërë nga Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu (2018) del se shqipja *tregon një fleksibilitet të madh në renditjen e përbërësve të fjalisë. Për shkak të këtij fakti, ajo është përmendur shpesh si një gjuhë "me rend të lirë", me rendin SVO të përbërësve që paraqitet si themelor, por edhe jo i detyrueshëm.* Pra, zbatimi i disa veprimeve të lëvizjes opsionale mund të japë edhe renditje të ndryshme fjalësh (**SVO, OSV, OVS, VSO, VOS, SV, VS**), që tregon se shqipja nuk është një gjuhë “scrambling”. Dukuria “scrambling”, e cila së pari u përcaktua si rend i lirë i fjalëve, shihet si rezultat i operacioneve lëvizëse krejtësisht opsionale nga disa gjuhëtarë (si: Chomsky, Rizzi, Bošković), dhe si rezultat i veprimeve të caktuara të lëvizjes së detyrueshme nga disa të tjerë (si: Gürer; Şener.). Ndërsa në gjuhën shqipe ndryshimet e mundshme të renditjes së


fjalëve shpesh janë konsideruar si konfigurim variacional me qëllim për ta ndryshuar ose rritur peshën e informacionit (Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu 2018; Xhaferi 2005).

Sa u përket ndryshimeve të mundshme të renditjes së fjalëve në gjuhët me rend të lirë, është argumentuar se ajo është një pasojë që shkaktohet nga lëvizja *A-bar*. Edhe pse në periudhat e mëparshme të traditës gjenerativiste, fenomenet e rendit të lirë të fjalëve në fjali u konceptuan si një “rirenditje stilistike” të realizuara jashtë sferës së gramatikës thelbësore. Chomsky (1965), megjithëse nuk e mohon rëndësinë e alternimeve të rendit të fjalëve për gjuhësinë e përgjithshme, propozon që ato të ndahen nga gramatika e kompetencës. Ross (1967) propozon një model që dallon gramatikën kryesore (ose sintaksën) nga rregullat stilistike. Ai pretendon se të dyja rendi i lirë i fjalëve dhe rendi i ngulitur i fjalëve kanë të njëjtin lloj gramatike me të njëjtat lloje transformimesh dhe rregullash. Për gjuhët me rend të lirë të fjalëve, ajo që është përgjegjëse për ndryshimin e rendit është një "përbërës stilistik" i veçantë, dhe rendi i lirë i fjalëve rezulton nga zbatimi i një rregulli të quajtur 'scrambling'. Scrambling është një term që përdoret shpesh për t'iu referuar rasteve të ndryshimit të renditjes së fjalëve në një gjuhë të veçantë veçanërisht, kur shkaktarët formalë ose funksionalë të një ndryshimi të tillë mbeten të panjohur (shih Bošković 2004).

Në kundërshtim me argumentin e Bošković, Gürer (2020) vlerëson se ndryshimet e renditjes SOV dhe OSV në gjuhët me renditje të lirë të fjalëve me të gjitha kodifikimet strukturore të informacionit të mundshëm i ilustrojnë që operacionet e lëvizjes të cilat drejtohen vetëm nga qëllime të lidhura me diskursin.

Prandaj, gjykimet që japin Bošković (2004) dhe Gürer (2020) e përbëjnë çështjen specifike që do të shqyrtohet në këtë disertacion e që ka të bëjë me rolin e diskursit-pragmatikës në ndryshimin e renditjes së fjalëve. Po ashtu, do të argumentohet nëse të gjitha operacionet e lëvizjes në shqip drejtohen nga tipare të bazuara në diskurs; dhe nëse ka vend për ndonjë operacion që e ndryshon rendin linear të përbërësve në mënyrë të rastësishme dhe/ose pa përfshirjen e një tipari diskursiv. Pra, nëse ndërrimet e rendit të fjalëve përcaktohen plotësisht nga motive diskursive-pragmatike. Ndërsa, lëvizjet, që shkaktohen në strukturën e fjalisë, do të bazohen në parimet minimaliste. Dhe në këtë

studim sugjerohet që [topika] dhe [fokusi] janë një tipar formal që lidhet me diskursin dhe strukturën e informacionit, për shembull, topika është e koduar në sintaksë, duke projektuar kështu strukturën e saj të frazës si **TopP** (Rizzi, 1997). Në shqip, zakonisht topika realizohet në periferinë e majtë të një fjalie dhe karakterizohet nga një ton i ulët dhe kur një kundrinë topikalizohet, pra zhvendoset majtas shkaktohet një operacion i lëvizjes sintaksore, kështu shfaqet një alternim i renditjes së fjalëve. Po e marrim një shembull, si: *Këngën këndon vajza* dhe po e paraqesim sipas parimeve minimaliste. Fjalja më poshtë e ilustron topikalizimin e një kundrine të drejtë në shqip:



Karakteristika diskursive-konfiguruese (δ) në C e tërheq operatorin e topikës në Spec, CP. Operatori e lidh topikën mbi të me pozicionin më të ulët brenda TP (Miyagawa, 2017). Kjo tregohet përmes bashkekzekutimit të pozicionit bazë dhe operatorit. Prandaj, kundrina e drejtë *këngën* bart një veçori [+ topikë], duke futur tematikën (aboutness) në

përgjigje. Ajo ngrihet në Spec, TopP në mënyrë që të mund ta kontrollojë tiparin e saj dhe të marrë tonin përkatës. Meqenëse nuk është e mundur që ky përbërës ta plotësojë tiparin e tij të lidhur me diskursin në pozicionin që ka, ai i nënshtrohet një lëvizjeje të hapur, duke ndryshuar kështu rendin linear. Operacioni i topikalizimit më lart e ilustron lëvizjen e kundrinës së drejtë te specifikuesi i kokës së TopP. Prandaj, struktura i nënshtrohet lëvizjes, në të cilën objekti drejtues i paraprin lëvizjes së kundrinës së drejtë, duke formuar shtigje kalimi në derivacion. Prandaj, përbërësi i temës renditet në mënyrë hierarkike në përputhje me kontekstin e dhënë.

0.2. Objekti i studimit

Çështjet që i diskutuam më lart e përbëjnë boshtin e kësaj teze. Pra, kjo tezë provon të shpjegojë se si informacioni është i organizuar brenda një fjalisë të shqipes, dhe në veçanti se si sintaksa, semantika, prozodia dhe struktura e informacionit ndërveprojnë në kodifikimin e informacionit në gjuhën shqipe. Në nivelin e fjalisë, sintaksa dhe struktura e informacionit janë përgjegjëse, për ta bërë një fjali të përshtatet në kontekstin pararendës dhe në bazën e përbashkët. Mjetet prozodike e nxjerrin në pah fokusin si njësia më e spikatur e klauzës. Për shembull, markimi i fokusit bëhet nëpërmjet elementeve mbisegmentare përfshirë frekuencën themelore (F0), intensitetin dhe gjatësinë e tingullit të fjalës së dhënë. Ndërkaq, bashkëveprimi i semantikës me strukturën e informacionit i definon konceptet, si: informacioni i ri, informacion i njohur, topikë kontrastive, fokus kontrastiv etj., me të cilët vepron SI brenda organizimit të fjalisë. Prandaj, për ta vërtetuar nëse shqipja përdor mekanizma të ndryshëm gjuhësorë, për ta kodifikuar strukturën e informacionit, kjo tezë ka për qëllim:

- Ta përshkruajë veprimin topikë – fokus (temë – remë); informacion i njohur/ i ri në gjuhën shqipe, duke e analizuar mikrostrukturën e secilit tekst të korpusit tonë;
- Ta nxjerrë në pah përcaktimin e pikës ndarëse midis fokusit dhe topikës në gjuhën shqipe;

- Të gjejë se si shqipja e kodifikon strukturën e informacionit: A përdor ajo strategji gjuhësore të përziera?
- T'i përshkruajë mekanizmat gjuhësorë me të cilët realizohet struktura e informacionit;
- Të tregojë sa ndikojnë mekanizmat sintaksorë në kodifikimin e strukturës së informacionit; A realizohet struktura e informacionit përmes *dyfishimit klitik të DP-ës dhe alternimeve në rednitjen e fjalëve në fjali?*
- Të tregojë sa ndikojnë mjetet prozodike në kodifikimin e strukturës së informacionit, duke e paraqitur përmes punës eksperimentale mbi kodifikimin prozodik të fokusit të informacionit dhe fokusit kontrastiv;
- Të tregojë sa ndikojnë faktorët pragmatikë e diskursivë në kodifikimin e strukturës së informacionit;
- Të shpjegojë nëse ndryshimet që shkaktohen në rendin kanonik të fjalëve nëpërmjet lëvizjeve opsionale dirigjohen nga faktorë pragmatikë ose diskursivë.
- Të gjejë nëse ka gjedhe të caktuara në ndërtimin e njësive të informacionit sipas llojeve të tekstit (në korpusin tonë), duke u mbështetur në stilin e tekstit dhe këndvështrimin folës.
- Ta përcaktojë vendin e njësive të informacionit në fjali sipas stilit të tekstit dhe këndvështrimit folës.
- Të gjejë nëse ekziston gjithmonë një përputhje midis njësive të strukturës tematike dhe atyre të informacionit në gjuhën shqipe.

0.3. Hipotezat e studimit

Ky hulumtim nisët nga disa hipoteza, të cilat janë vëzhguar në mënyrë josistematike:

- Veprimi topikë – fokus (temë – remë); realizohet në mënyra të ndryshme bazuar në stilin dhe këndvështrimin folës;

- Shqipja përdor strategji të ndryshme, për ta kodifikuar strukturën e informacionit:
 - Njësia e fokusit gjithmonë markohet nëpërmjet elementeve prozodike. Ajo e bart theksin bërthamor;
 - Alternimet në renditjen e fjalëve në fjali janë konfigurime variacionale që shkaktojnë kodifikimin e strukturës së informacionit;
 - Dyfishimi me klitik i DP-ës në një fjali e sinjalizon topikën ose informacionin e njohur;
 - Ndryshimet që shkaktohen në rendin kanonik të fjalëve nëpërmjet lëvizjeve opsionale të *A-bar* dirigjohen nga faktorë pragmatikë ose diskursivë;
 - Nuk ekziston gjithmonë një përputhje midis njësive të strukturës tematike dhe asaj të informacionit në gjuhën shqipe;
 - Organizimi i një teksti përsa u përket funksioneve të *informacionit i dhënë/i ri* dallon nga stili i vet tekstit.
 - Për t'i përcaktuar elementet e strukturës së informacionit nuk na shërben vetëm hulumtimi në aspektin sintaksor, por edhe në aspektin semantik, pragmatik e prozodik.

0.4. Metodologjia dhe detyrat e studimit

Për ta përshkruar veprimin temë – remë; informacion i njohur/ i ri, si dhe mekanizmat gjuhësorë me të cilët realizohet struktura e informacionit janë përzgjedhur katër korpuset: gazeta *Koha*; emisioni *Pressing* (30 maj 2022); komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014 Beograd) dhe filmi i metrazhit të gjatë *Një tregim Prishtine*. Këto lloje tekstesh janë zgjedhur me qëllim që të analizohet organizimi i teksteve në nivelin e mikrostrukturës, pra sa u përket njësive të informacionit i njohur/i ri, siç është lajmi, një shmangie nga rregullat dhe norma, sepse paraqet ndonjë ngjarje që nuk

është e zakonshme nga e rëndomta e përditshmërisë (Whitaker et al. 2004; cit. sipas Rugova 2016: 97). Pikërisht në një tekst të tillë mund të vëzhgohet organizimi i strukturës së informacionit. Po ashtu, organizimi i tekstit, sa u përket njësive të informacionit në një tekst, siç është gjuha e filmit e cila është e mbushur me **referenca ekzoforike**, do të jetë një material i bollshëm, për ta përshkruar strukturimin e tyre, kur një element gjuhësor i referohet një njësie jashtë tekstit (Rugova, Sejdiu – Rugova 2015). Ndërsa, gjuha e përdorur te komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* është përzgjedhur me qëllim që të analizohet strukturimi i njësive të informacionit, në një korpus ndryshe, siç është gjuha e sportit që përbën një kod më vete, e ky kod është një njësi e përcaktuar nga konteksti...*I cili paraqitet përmes parimeve rregullative të tekstit, siç janë efikasiteti dhe efektshmëria* (Rugova 2006; 2016). Pra, te këto lloje tekstesh të ndryshme, supozohet se stili dhe këndvështrimi folës ndikojnë në strukturimin e informacionit.

Përveç stilit dhe këndvështrimit folës si faktorë jashtëgjuhësorë, në këtë hulumtim do të analizohen edhe faktorët gjuhësorë, që kanë ndikim në strukturimin e informacionit, në tri rrafshje të ndryshme.

Në domenin semantik, përmes **alternativave semantike**, prohet të shpjeghet përcaktimi i pikës ndarëse midis fokusit dhe topikës në gjuhën shqipe, pra midis njësive të strukturës tematike. Po ashtu, të vëzhgohet nëse ka dallime midis strukturës së topikës dhe të fokusit në të tri llojet e teksteve që e përbëjnë korpusin, pasi supozohet që në strukturën e tyre rol të veçantë kanë stili i tekstit dhe këndvështrimi folës.

Për të parë se si prozodia e formëson fokusin ose informacionin e ri në korpusin e folur, emisioni *Pressing* (30 maj 2022) dhe komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014 Beograd), do të analizohen të gjitha fjalitë dhe identifikohen llojet e fokuseve dhe mënyra se si janë kodifikuar fokuset ose informacioni i ri brenda fjalive dhe nëse theksi bërthamor shtrihet brenda kufijve të FocP. Markimi i fokusit bëhet nëpërmjet elementeve mbisegmentare përfshirë frekuencën themelore (F0), intensitetin dhe gjatësinë e tingullit të fjalës së dhënë. Një fjalë e theksuar shënohet me **F-marked** (Selkirk 1995: 555) dhe sipas tij (ibid.), e nënkuptojmë fjalën e cila bart theksin sipas teorisë autosegmentale metrike të intonacionit. Pra, fokusi mund të përcaktohet si përbërësi më i

spikatur në një shprehje. Ky përbërësi i shënuar me F (**F-marked**) i një fraze duhet të përmbajë fjalën ritmikisht më të spikatur në atë frazë. Varësisht nga njësia që e përmban tonin H*+ L, do të merret si fokus i fjalisë.

Puna eksperimentale për këtë kapitull hartohet sipas qasjes autosegmentale-metrike dhe Teorisë së Optimalitetit. Sa i përket llojit të analizës, në këtë pjesë përdoret analiza sasiore, pasi do të bëhen matje sasiore për fjalitë të cilat prozodia e formëson fokusin dhe luan rol në identifikimin e tij.

Ndërkaq, për ta parë se sa e saktë është teoria për kodifikimin e strukturës së informacionit përmes dyfishimit të kundrinave me klitikët përemërorë, do të bëhet hulumtim pragmatik e sintaktik, me ç'rast analizohen lidhjet anaforike dhe kataforike të referuesit me elementin të cilit i referohen dhe, po ashtu, nëse referenti është prezantuar më herët në diskurs. Pasi ne mendojmë se nuk mjafton vetëm sintaksa për t'i definuar argumentet e lartdhëna, pra nuk mund të bëhet pa u analizuar edhe rrethanat e kontekstit në të cilin nuk ka referencë ndërmjet referuesit dhe referentit. Në bazë të disa vrojtimeve që janë bërë, ka dalë se jo gjithmonë dyfishohet klitiku i kundrinës së drejtë edhe kur referenti prezantohet më parë në tekst. Pra, edhe kur DP-ja është e njohur për dëgjuesin/marrësin, pra është topikë, sepse është dhënë më parë në tekst. Referenca mund të jetë anaforike dhe kataforike. Është **anaforike** kur elementi referues hyn në ligjërim pas njësisë, të cilës i referohet (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 139). Ndërsa **kataforike**, kur njësia referuese i vihet përpara njësisë së referuar (ibid. 139). Pra, një klitik anaforik është një morfemë e lidhur morfologjikisht me një përbërësi të përmendur më parë, i referohet atij dhe e plotëson pozicionin e një DP-je në një klauzë, për shembull: *Librin e lexoi dje*. *Librin* është njësia e referuar dhe *e* është njësia referuese e që po ashtu lidhen morfologjikisht mes vete. Ndërsa, një klitik kataforik është një morfemë e lidhur morfologjikisht me një përbërës që do të përmendet pas tij në ligjërim, i referohet atij dhe e plotëson pozicionin e një DP-je në një klauzë, për shembull: *E lexoi librin*.

Ndërsa, sa u përket ndryshimeve të mundshme të renditjes së fjalëve në gjuhët me rend të lirë, pra konfigurimeve variacionale është argumentuar se këto janë një pasojë që shkaktohet nga lëvizja *A-bar*. Prandaj, për t'i vëzhguar alternimet në renditjen e fjalëve i

referohemi Programit Minimalist të Chomsky-t (1993, 1995) nëpërmjet të cilit analizohen lëvizjet që shkaktohen në strukturën e fjalisë. Sipas këtij programi, strukturat janë ndërtuar përmes “Merge”. “Merge” klasifikohet më tej si “external merge“ (EM) dhe “internal merge“ (IM). Chomsky (2008: 140) sugjeron që "(...) EM jep strukturë të përgjithshme të argumentit (rolet theta, hierarkitë kartografike); dhe IM jep veti të lidhura me diskursin, siç janë informacioni dhe specifikimi i njohur, së bashku me efektet e fushave. “Në një kuptim, fazat, kokat e të cilave janë vendi i të gjitha tipareve, rrjedhin përmes “external merge”. Pra, varësisht nga gjendja e “external merge” ndryshon edhe struktura e përgjithshme e “internal merge”. Prandaj, në një gjuhë si shqipja është e nevojshme të studiohet struktura e frazave, duke iu referuar Programit Minimalist, pasi operacionet e lëvizjes shkaktohen nga qëllime të lidhura me diskursin.

1. TOPIKA

1.1. Histori e shkurtër për evoluimin e nocionit të topikës

Tradicionalisht besohet se fjalitë në një gjuhë tregojnë një artikulum informativ të përbërë nga dy pjesë, njëra më pak informuese (topika/tema) dhe tjetra më shumë informuese (fokusi/rema). Pjesa më informuese ose *fokusi* e ndjek pjesën më pak informuese ose *topikën*. Përveç nocioneve *topikë dhe fokus* që i referohen ndarjes së fjalisë në njësi informative, në literaturën e gjuhësisë ekzistojnë edhe dikotomitë, si: *Theme-Rheme*, *Topic-Comment*, *Focus-Presupposition*, *Focus-Open Proposition* ose *Focus-Background* (Vallduví 1990). Të gjitha këto propozime dikotomish për artikulumin informativ, sipas Vallduví-t (ibid. 35), u përkasin shkollave të ndryshme të gjuhësisë, prandaj midis tyre shfaqen nuanca papajtueshmërie, megjithëkëtë e përbashkëta e tyre është se të gjitha këto i referohen ndarjes informative të fjalisë midis një pjese më informuese dhe një pjese më pak informuese, edhe pse asnjëra prej shkollave të këtyre nocioneve nuk ka një marrëveshje që e demarkon saktësisht kufirin midis njërës pjesë dhe pjesës tjetër.

Për ta analizuar ndarjen e fjalisë në njësi informative në gjuhën shqipe ky punim mbështetet te konceptet *topikë dhe fokus* që mbrohen nga Shkolla e Pragës e cila përkufizimet e topikës dhe fokusit i ka formuluar në bazë të kufijve kontekstualë ose lirisë kontekstuale, me ç'rast emementi gjuhësor që lidhet me kontekstin supozohet të jetë më lehtë i qasshëm për dëgjuesin, pasi ai tashmë është i aktivizuar në kujtesën e folësit nga diskursi paraprak (Vallduví ibid. 44).

Ky kapitull e heton nocionin e topikës në detaje, duke filluar me një studim të shkurtër historik përmes të cilit do të tregohen disa nga përkufizimet e topikës në literaturë, pastaj shqyrtohen disa karakterizime tipike të topikës në përgjithësi. Tutje, shqyrtohen mënyrat në të cilat shqipja i kodon sintagmat e topikës. Këtu si sintagma të topikës llogariten të gjitha ato elemente gjuhësore që janë aktivizuar më herët në diskursin paraprak. Po ashtu, diskutohen disa karakteristika të shfaqes së sintagmave të topikës lidhur me disa nocione diskursive, si: ajo për të cilën bëhet fjalë në fjali (aboutness); referencat

diskursive; diskursi paraprak dhe konteksti; si dhe disa kufizime sintaktike të shfaqes së topikave, si: të qenit kryefjalë e fjalisë; pozicioni në fillim të fjalisë; si dhe shfaqja e saj përmes formave përemërore.

1.2. Topikë = Kryefjalë & Fokus = Kallëzues?!

Ndarja e fjalisë në njësi informuese, të dallueshme nga kategoritë sintaksore, si kryefjala dhe kallëzuesi, u bë temë diskutimi që nga shekulli i XX, edhe pse hetimi për dallimin e tyre rrënjët i ka të shkrimi i Henri Weil-it, *De l'ordre des mots dans les langues anciennes comparées aux langues modernes* (1844), ku thekson se “marshimi sintaksor nuk është marshimi i ideve” me ç’ rast i referohet ndarjes informative si diçka e ndryshme nga ndarja e kategorive sintaksore, subjekt-predikat. Ai sugjeron se ka “një pikënisje, një nocion fillestar që është po aq i pranishëm dhe i njohur si për atë që flet dhe për atë që dëgjon, i cili formon, si të thuash, terrenin mbi të cilin takohen të dy inteligjencat; dhe një pjesë tjetër e ligjërit që e bën të plotë thënien (l’*énonciation*). Kjo ndarje, sipas tij, gjendet pothuajse në gjithëka që themi.” (cit. sipas Casielles-Suárez 2004).

I ndikuar fuqishëm nga këto ide të H. Weil, Mathesius, pastaj edhe pasuesit e tjerë, pas tij, si Fibras e gjuhëtarë të tjerë të rrethit të Pragës i çuan më tej idetë e H. Weil. Që në vitin 1911, duke u përqendruar në dallimet midis çekishtes e anglishtes, Mathesius vuri re gjuhën universale të çdo thënie që kishte një temë (topikë) dhe një remë (fokus), prandaj formuloi parimet bazë të asaj që do të emërohej më vonë si FSP (Perspektiva e funksionale e fjalisë) (Firbas 1971; Adam 2010).

Sipas Mathesius (1975: 85), topika dhe fokusi duhet të dallohen nga kryefjala dhe kallëzuesi i fjalisë, pasi, sipas tij, në gjuhën angleze topika dhe fokusi përkojnë me kryefjalën dhe kallëzuesin dhe gjasat janë shumë të mëdha që topika dhe fokusi të shprehen përmes këtyre kategorive sintaksore. Por, sipas tij, një gjë e tillë nuk ndodh në çekishte. Në këtë gjuhë, “tema është e vendosur në pozicionin fillestar të fjalisë, dhe cilado kategori sintaksore e fjalisë mund ta shprehë atë, pra mund të jetë edhe kundrinë, ndërkaq sipas tij, pjesa tjetër e fjalisë është e rezervuar për remën”. Për ta sqaruar praktikisht këtë, diskutohen

dy shembuj nga Mathesius (1975), me ç'rast në shembullin e parë topika dhe fokusi përkojnë me rendin e kategorive sintaksore, subjekt-predikat, ndërsa në shembullin e dytë përbërsi sintaksor që qëndron brenda kufijve të topikës është një SE në funksion të kundrinës.

Shembulli 1. *Tatínek napsal tenhle dopis.*

“Father wrote this letter”

“Babai e shkroi këtë letër”

Në këtë rast topika është *tatínek* (babai), ndërsa fokusi është *napsal tenhle dopis*. Siç shihet, topika këtu shtrihet brenda kufijve të një SE-je që funksionon si kryefjalë dhe pjesa tjetër, pra fokusi, që shtrihet brenda një SF-je, e që funksionon si kallëzues. Përkimi topikë-kryefjalë dhe fokus-kallëzues, sipas tij, ndodh zakonisht te gjuhët që kanë rend të ngulitur të fjalëve në fjali, siç është anglishtja.

Shembulli 2. *Tenhle dopis napsal tatínek.*

“This letter wrote father”

“Këtë letër e shkroi babai”.

Shembulli i dytë në çekishte, sipas Mathesius (1975:85), përdoret kur duam të themi se personi që e ka shkruar letrën është babai, prandaj edhe e ndryshojmë rendin e fjalëve në fjali, dhe topika shtrihet brenda një përbërësi sintaksor që funksionon si kundrinë dhe jo kryefjalë. Një gjë e tillë ndodh edhe me shqipen, pasi rendi i fjalëve në fjali është fleksibil (shih Rugova dhe Simitçiu 2018). Në anglisht, ndryshime të tilla në rendin e

fjalëve janë të papranueshme, pasi kryefjala, si rregull, nuk duhet të qëndrojë në fund të një fjalie, pas foljes (kallëzuesit). Kështu, vetëm e para nga dy fjalitë në çekishte ka një formë analoge në anglisht, d.m.th. *Babi shkroi këtë letër*, ndërsa në fjalinë e dytë, nëse do të kapërcehet konflikti midis strukturës gramatikore dhe këndvështrimit funksional të fjalisë, duhet të përdoret ndërtimi pasiv (*Kjo letër është shkruar nga babi*) ose perifraza sintaksore (*Ishte babi ai që shkroi këtë letër*).

Kështu, sipas Mathesius, tema ose topika dhe rema ose fokusi nuk shprehen dhe nuk lidhen me kategoritë sintaksore. Topikën ai e përcakton si pikën fillestare të fjalës (východisko), si “atë që është e njohur ose së paku e qartë në situatën e dhënë dhe nga e cila folësi flet (1939: 234). Pra, topika është themeli i fjalës (základ / téma) përkufizohet si diçka “për të cilën po flitet në fjali”. Pra, për Mathesius topika dhe fokusi ose tema dhe rema janë elemente mjaft diskrete.

Ndryshe nga pikëpamja e Mathesius për topikën dhe fokusin, në pikëpamjen e gjuhëtarit tjetër të rrethit të Pragës, Jan Firbas, elementet tematike dhe rematike nuk bëhen edhe aq të dallueshme. Në këndvështrimin e Firbas, fjalia është një fushë e marrëdhënieve semantike dhe sintaksore që nga ana e saj ofron një fushë shpërndarëse të shkallëve të dinamizmit komunikues (CD); Firbas përcakton një shkallë të CD-së si “shkalla në të cilën elementi kontribuon në zhvillimin e komunikimit”, dhe kjo e nënkupton temën (1964, 270). Sipas Firbas (1964: 272), tema është ai element i fjalisë që mban shkallën më të ulët të CD [dinamizmit komunikues] brenda fjalisë. Ai shton: “Nga ky përkufizim rrjedh se tema nuk duhet domosdoshmërisht të përcjellë informacione të njohura ose të tilla që mund të mblidhen nga konteksti verbal dhe situacional. Mund të përcjellë edhe informacione krejtësisht të reja dhe të panjohura” (ibid. 272). Nga kjo perspektivë, artikulimi i informacionit shihet si ndarje, por duke përfshirë elemente të tilla si tema, tema e vërtetë/e duhur (proper), tranzicioni, rema dhe rema e duhur (proper). Ai e zëvendëson dikotominë temë/remë me shkallën e dinamizmit komunikativ. Sipas tij, rema/fokusi e përfshin “*pjesën më të spikatur të informacionit e cila është > pika më e lartë e mesazhit, d.m.th. elementi më dinamik; elementet e tjerë të fjalisë janë më pak dinamike (kanë një shkallë më të ulët të CD-së). Shkallët e CD-së përcaktohen nga ndërveprimi i faktorëve të FSP-së*” (Adam 2010).

Ky vizion i paqartë i Firbas për ndarjen e njësive të informacionit gjithashtu është refuzuar në mënyrë eksplicite nga Dahl, Sgall, pra menjëherë nga pasuesit e tij. Kështu, Contreras (1976: 16) argumenton se ky nocion i dinamizmit komunikativ është mjaft arbitrar dhe bazuar në Chafe (1974) propozon që “topika përmban ato elemente që supozohen nga folësi, për të qenë të pranishme në ndërgjegjen e adresuesit”.

Përveçse në Evropë, trendi i studimit për ndarjen e fjalisë në njësi informacioni nisi edhe në Amerikë, me ç’rast pioner i kësaj pune ishte Charles Hockett-i, i cili në vend novioneve të temë-remë, prezanton termat *topikë* dhe *koment*. Hockett-i supozon për një lidhje midis temës dhe komentit dhe ndërtimeve predikative, duke sugjeruar që tema dhe komenti në përgjithësi karakterizojnë përbërësit e drejtpërdrejtë (IC) të këtyre ndërtimeve. “Folësi e paraqet një temë dhe më pas thotë diçka për të.” (1958:201). Pra, ai i barazon topikë – subjekt dhe predikat – kallëzues. Hockett-i vëren se në anglisht dhe në gjuhët e tjera të Evropës, topikat zakonisht janë subjekte, por kjo nuk vlen gjithmonë për të gjitha gjuhët. Për shembull, ai thekson se në fjalinë *Këtë libër të ri të Thomas Guernsey akoma nuk e kam lexuar*; ajo që e specifikon se çfarë do të flasë folësi: është tema e fjalisë (Këtë libër të ri të Thomas Guernsey), megjithëse nuk është kryefjala e fjalisë (ibid. 201).

Një koncept i përpunuar i temës/topikës andej Atlantikut gjendet te Halliday (1967). Halliday e vështron një strukturë klauze si një grup të organizuar të njësive të informacionit të cilat janë të pavarura nga përbërësit sintaksorë. Kjo do të thotë se një njësi kuptimplote e informacionit në një klauzë nuk formon domosdoshmërisht një përbërës në sintaksë, por një grup tonesh në fonologji, po. Halliday ofron shembujt e mëposhtëm, të cilat tregojnë se madje edhe një gjuhë me një rend të ngulitur të fjalëve në fjali, siç është anglishtja, lejon tematizimin e elementeve që nuk janë subjekt i fjalisë ose pjesës emërore e saj:

- a. Gjoni e pa lojën dje.
- b. Dje Gjoni e pa këtë shfaqje.
- c. Shfaqja që Gjoni e pa dje.

Për Halliday (1967: 212), tema është ajo që vjen e para në klauzë. Është gjithashtu ajo për të cilën po flitet në fjali; pika e nisjes për klauzën si një mesazh. Halliday bën dallimin midis temës dhe informacionit të dhënë më parë. Informacioni i dhënë është ajo “për të cilën po flisja më parë”, ndërsa tema/topika është ajo “për çfarë po flas tani”. Kështu, termi temë është konceptuar si një gradient ose element diskret. Si element diskret, tema është përcaktuar në kuptimin e asaj për të cilën bëhet fjalë në fjali (*aboutness*), në kuptimin e pozicionit fillestar në fjali ose në kuptimin e informacionit të dhënë më parë në diskurs.

Pothuajse në të njëjtën kohë një studim tjetër mbi strukturën e informacionit në gjuhësi nga (Chafe 1976) e lidh topikën me statusin “i njohur” ose “i dhënë” i informacionit ose me pozicionin fillestar të fjalisë që merret si pozicioni tipik i temës/topikës.

Definicionin e Chafe-s e kundërshton Reinhart, ajo argumenton se temat nuk mund të përcaktohen në terma të informacionit të vjetër. Reinhart (1981: 80) sugjeron se temat janë “(...) hyrje referente sipas të cilave ne i klasifikojmë propozimet në grupin e kontekstit dhe propozimet nën hyrje të tilla në grupin e kontekstit përfaqësojnë atë që ne dimë rreth tyre në këtë grup”.

Ndërkaq, sipas Strawson (1964:97-8), tema ka tre veti qendrore:

- (a) Tema është ajo për të cilën bëhet fjalë në një fjali.
- (b) Tema përdoret për të nxjerrë “njohuri që duhet t’i zotërojë një audiencë.”
- (c) Fjalia vlerësohet si informacion i supozuar për temën e saj.”

Duke e cituar Daneš (1974), Erteschik-Shir përvijon tri lloje temash (2007: 2–4). E para është “zinxhirimi i temës”, ku tema e një fjalie është e njëjtë me temën në atë të mëparshme. E dyta është “lidhja e fokusit”, ku një temë rrjedh nga një fokus në fjalinë e mëparshme. E treta është një “temë kufizuese” (2007: 49–50) (e referuar si “hipertemë” në

terminologjinë e Daneš-it), ku një temë “rrjedh nga një grup elementesh të kufizuar në mënyrë diskursive” (2007: 3).

Një lloj teme veçanërisht i rëndësishme është “tema e skenës”. Nevoja për tema skenike është e qartë nga dëshmitë e fjalive tetike ose “e fjalive që përmbajnë vetëm fokusin”, fjali pa një temë të qartë, siç është Erteschik Shir (2007: 16). Por këto lloje nuk do t’i trajtojmë më gjatë tani.

Ndërsa, sa u përket studimeve për topikën në gjuhën shqipe, nuk ka pasur deri më tani, përveç disa supozimeve që janë bërë nga Gramatika e Akademisë II (AShAK 2002) bazuar në sfondin e tyre tradicional, ndarjen e fjalisë në temë dhe remë e quajnë gjymtyrëzimi aktual i fjalisë, me ç’rast tema është kryefjalë logjike dhe pikënisja e thënies, ndërsa rema është kallëzuesi logjik që tregon të panjohurën. Një definicion tjetër për temën dhe remën në gjuhën shqipe në kuadër të gjuhësisë së tekstit e kanë bërë B.Rugova dhe L.Sejdiu-Rugova (2015). Sipas tyre, tema dhe rema janë mjete të organizimit tematik brenda teksit. Tema e përcjell informacionin e njohur, ndërsa rema e përcjell informacionin e ri. Ndërkaq, Rrokaj (2009), temën dhe remën i trajton në kuadër të semantikës dhe i lidh të dy konceptet me njësitë e informacionit, duke e shpjeguar që tema në gjuhën shqipe lidhet me informacionin e dhënë, ndërsa rema me informacionin e ri.

Pra, siç po shihet nga supozimet më lart nocioni i temës/topikës duket mjaft konfuz, pasi ky koncept ka qenë dhe vazhdon të kuptohet në mënyra të ndryshme dhe nganjëherë të papajtueshme midis tyre. Andaj, për ta qartësuar më tej këtë nocion, i janë bërë disa analiza sa u përket karakterizimeve të topikave, të cilat do t’i shohim në vazhdim. Dhe po ashtu ky koncept ka marrë shumë dimensionë:

1.3. Analiza e karakteristikave apo vetive tipike të topikave

Për të vendosur se cilët elemente duhet të përcaktohen si tema, duhet të krijojmë një mënyrë të pavarur për t'i identifikuar ato, duke u bazuar në karakteristikat e tyre. Autorë, si: Li dhe Thompson (1981: 86) dallojnë nga dy karakteristika semantike dhe formale të topikave. Sipas tyre, karakteristika semantike të topikave janë këto: ato (topikat) vendosin një kornizë në emërtimin e asaj për të cilën bëhet fjalë në fjali; dhe ato duhet të jenë ose të përcaktuara ose të përgjithshme. Ndërsa njëra karakteristike formale e topikave, sipas tyre, lidhet me vendosjen e topikës në pozicioni fillestar të fjalisë (përveç nëse paraprihet nga një konektor që e lidh atë me fjalinë paraprake); dhe tjetra karakteristike formale është se topika mund të ndahet nga pjesa tjetër e fjalisë (i quajtur koment) me një pauzë ose me një pjesëz.

Ndërkaq, një analizë më të thellë mbi karakteristikat e topikave e ka bërë Eugenia Casielles-Suarez- (2004). Në fillim të analizës ajo e jep një karakterizim të përgjithshëm për topikën. Sipas saj, topika ka tendencë të jetë ajo për të cilën bëhet fjalë në fjali; të jetë pikënisje për fjalinë; ajo nuk hyn në kufijtë e fokusit; vendoset në të majtë të fjalisë; shpesh barazohet me një SE që është në funksion të kryefjalës; shpesh është e aktivizuar ose e spikatur në diskurs; shprehet shpesh nëpërmjet përemrave dhe sintagmave leksikore të patheksuara. Problemet zakonisht lindin kur duhet të vendosim se cilat nga këto prirje janë të mjaftueshme ose të nevojshme për të identifikuar temën e një fjalie në një gjuhë të caktuar, sepse shpesh sipas (Casielles 2004, Erteschik-Shir 2007) shumë karakterizime përfundojnë duke kombinuar disa veçori fonologjike, sintaksore, semantike dhe/ose pragmatike. Megjithatë, kërkesa përcaktuese në shumicën e rasteve priret të jetë ose sintaksore ose e lidhur me diskursin. Prandaj, për ta bërë një karakterizim të përgjithshëm për topikën në gjuhën shqipe do të merren në konsideratë edhe analizat, diskutimet dhe studimet që janë bërë për topikën në gjuhë të tjera, siç është studimi i Casielles (2004).

1.3.1. Karakterizimet diskursive të topikës

Sa u përket karakterizimeve diskursive të shfaqjes së topikave, sipas Casielles-Suarez (2004), merren parasysh katër karakterizime të ndryshme të diskursit në të cilin shfaqen elementet topike. Ata kanë të bëjnë me nocionet e mëposhtme, si: *aboutness*, referencat diskursive, vjetërsia në diskurs dhe lidhshmëria kontekstuale.

1.3.2. “Për çfarë bëhet fjalë në fjali?” (Aboutness)

Nocionin *aboutness*, Reinhart e quan nocion pragmatik. Në nivelin pragmatik, një temë zakonisht njihet si “për çfarë flitet në fjali dhe i referohet një diçkaje për të cilën folësi supozon se personi që e dëgjon atë ka disa njohuri paraprake për të” (Li dhe Thompson 1981: 15). Ky nocion është propozuar për herë të parë nga Mathesius, i cili e sheh temën ose bazën e shprehjes si element për të cilin thuhet diçka. Ndërkaq, Lambrecht (1994: 117) e merr si element bazë për identifikimin e topikës në një fjali. Ndërsa për Casielles (2004), është shumë e vështirë që ky përkufizim të bëhet një mjet i dobishëm në identifikimin e temës së një fjalie, pasi nuk është gjithmonë e lehtë të gjesh një përbërës në një fjali që shpreh atë për të cilën bëhet fjalë. Lidhur me nocionin *aboutness* janë hartuar disa teste me qëllim të identifikimit të temës (e kuptuar si fjalë), për shembull, Gundel (1974) (1985) i propozon dy teste për ta identifikuar më lehtë topikën (Prince 1999).

(i) Testi “As-for X” (Sa për X): një element mund të konsiderohet një temë, nëse mund të zhvendoset dhe të paraprihet nga “sa për”, me ç’rast X është topikë.

(ii) Testi “What about X?” (Po X?): një element mund të konsiderohet temë, nëse fjalia mund t’i përgjigjet pyetjes “Po X?”, me ç’rast X është përbërës i topikalizuar.

(iii) Testi “Said-about X” (tha për X): një element mund të konsiderohet temë, nëse mund të futet si X në kornizën “ai dha për X atë “koment”. Testi “Said-about X” (tha për X) është një tjetër test që lidhet me identifikimin e përbërësit të topikalizuar që u propozua nga Reinhart (1981). Ajo pretendon se SE-ja më e majtë

në një topikalizim është topikë. Testi dhe pretendimet e Reinhart u mbështeten nga Erteschik-Shir (2007).

Këto teste janë parë me rezerva në literaturën gjuhësore dhe janë kontestuar nga disa studiues, si: Prince (1999), Ward, pasi disa shmembuj nuk i kalojnë këto teste dhe përmes këtyre testeve, përveç që identifikojnë topikën, ato identifikojnë edhe elemente të tjera përpos tyre. Për ta hedhur poshtë vleshmërinë e tyre, për shembull, Prince (1999), e teston një shembull, si klauzën: *Disa më kanë munguar, dreqin* (Some I missed, darn.). Ajo e teston këtë me tri llojet e testeve:

“[U1]Faleminderit për të gjithë ata që iu përgjigjën shënimit tim, duke pyetur për dorezat. [U2]Nuk e shikova këtë bb për disa ditë dhe u habita që kishte 11 përgjigje. [U3]Disa që më kanë munguar, dreq. [U4]Nuk e di nëse jam mjaftueshëm i guximshëm, për të punuar pa doreza.”

- (I) **#As for some, I missed them, darn.**
- (II) **#What about some?**
- (III) **#She said about some that she missed them.**

Njësoj sikur Prince, edhe Ward thekson se 69% e topikalizimeve në korpusin e tij dështojnë në testin "As-for" dhe 53% dështojnë testin "What-about" (Ward 1988: 19-20 cit. Casielles). Ward shton se funksioni i topikalizimeve (dhe mekanizmave të tjerë preposing) në anglisht nuk është të shënojë temat e fjalive, por të shënojë elementin e parashtruar si të spikatur më përpara në diskurs.

Për ta parë nëse na përgjigjet ky lloj testi në gjuhën shqipe mund ta marrim fjalinë: *Borë po bie maleve* (nga konteksti: Jashtë është ftohtë. Borë po bie maleve).

- (IV) **#Sa për *borë, po bie maleve.**
- (V) **#Çfarë ndodhi me *borë?**
- (VI) **#Ai tha se bora po bie maleve.**

Siç po shihet, dy testet e para po dështojnë në identifikimin e topikës së fjalisë, pasi fjalitë që dalin nga këto teste dalin jogramatikore. Megjithëkëtë, fakti që ende mund të jemi të mangët në testet që mund ta identifikojnë çdo lloj teme, nuk do të thotë që ne duhet të harrojmë lidhjen mes nocionit të temës dhe konceptit *aboutness* (Casielles 2004).

1.3. 3. Referentët diskursivë

Një nocion tjetër i temës lidhet me elementin topik (topical element) të një referenti të diskursit. Megjithëse ka nocione të ndryshme të referencës së diskursit, në kontekstin e strukturës së informacionit, ai përdoret në përgjithësi për t'iu referuar entiteteve të diskursit (Casielles-Suarez ibid. 26). Ndërkaq sipas Prince 1988c, nëse një folës evokon një entitet në një ligjërim, ai së pari e postulon statusin e informacionit të atij entiteti në mendjen e dëgjuesit në lidhje me familjaritetin dhe rëndësinë. Sipas Lambrecht (1998), një propozim interpretohet se ka të bëjë me një entitet nëse kuptohet si përcjellje e informacionit përkatës në lidhje me këtë entitet, pra si rritje e njohurive të dëgjuesit për të. Marrëdhënia e temës është marrëdhënia e *aboutness* midis një propozimi dhe një entiteti diskursi. Referentët diskursivë gjithmonë janë tema. P.sh.: përemri projekton një referencë diskursi më vete, i cili kërkon një përbërës paraprak të përshtatshëm (Bott 2007). Për shembull:

Norvegjezi Haaland është vlerësuar se në tregun e transferimeve ka vlerë prej 101 milionë eurove. [Ai]_{TOPP} ka kontratë deri në vitin 2024...

Me fjalë të tjera, jo të gjitha entitetet që hyjnë në një ligjërim mund të kodohen njësoj në strukturën gjuhësore pasi ekzistojnë dallime thelbësore në statusin referencial të këtyre entiteteve. Entitetet mund të jenë të njohura për dëgjuesit, por jo të spikatura në kohën e shqiptimit, ato mund të jenë krejtësisht të reja për dëgjuesin, ato mund të jenë të konkludueshme nga ajo që dëgjuesi di, etj. Këto dallime në statusin referencial përcaktojnë formën gjuhësore të shprehjeve referuese që u referohen këtyre entiteteve dhe folësit mund

të përdorin NP-të të papërcaktuara, përemrat, anaforat, elipsat në disa gjuhë dhe kështu me radhë në varësi të statusit të entiteteve që kodojnë (Vallduví 1990).

Së fundi, në lidhje me tiparet e ndryshme të diskursit të temave, Lambrecht (1994) vë në dukje lidhjet e mëposhtme që shkojnë nga kodimi gramatikor në gjendjet kognitive:

a) kodimi pronominal dhe mungesa e theksit është e mjaftueshme, por jo e domosdoshme, mbi kushtet për aktivizimin e një referenti;

b) prania e një theksimi dhe kodimi leksikor janë të nevojshme, por jo të mjaftueshme, për kushtet për mosaktivizimin e një referenti;

c) shquarësia nuk është as kusht i domosdoshëm as i mjaftueshëm për statusin e identifikimit ose të aktivizimit, të paktën në gjuhën angleze, edhe pse tendenca është e fortë për referentët e paidentifikueshëm që do të kodohen si njësi të pashquara.

1.3.4. Diskursi paraprak (Discourse-oldness)

Një nga karakteristikat më të njohura të topikave/temave i barazon ato me informacionin e vjetër ose të dhënë është tipari discourse-oldness (Casielles-Suarez 2004). Në fakt topika mbulon shprehjet anaforike të diskursit, pasi tema përkufizohet si një përbërës diskursi “(...) që normalisht shpreh informacionin e vjetër disi të disponueshëm dhe të njohur në diskursin e mëparshëm (... .)” (Rizzi 1997: 285).

Erteschik-Shir (1997) ka sugjeruar se të qenit e njohur ose e supozuar është një kërkesë absolute për statusin e topikave/temave.

Ne duhet të përmbahemi nga kjo, edhe nëse në shumë raste, përbërësit e temës janë “të vjetër” në kuptimin e të qenit të konkludueshëm nga konteksti. Por, sigurisht që ka raste të temave që e përcjellin informacionin e ri. Fjalja e mëposhtme prezanton një entitet të ri në diskurs dhe, në të njëjtën kohë, e përdor atë si përcaktimin e një përbërësi teme, që përbën futjen e një karte të re në përmbajtjen e CG (Hulumto për CG-ën te Krifka 2008).

[Një miku im i mirë] _{TOPP} [u martua me Britney Spears vitin e kaluar] _{FoCP}.

Në këtë rast [Një mik i mirë /TopP] është topikë që e përcjell një informacion të ri, pasi nuk e specifikon cili mik dhe, po ashtu, nuk është përmendur më parë në diskurs ky mik. Por, megjithatë prapë mbetet topikë që jep sinjale për nisjen e një tematike të re. Andaj edhe sipas Komagata-s (2000) nuk është gjithmonë informacioni i njohur ai që e sinjalizon topikën ose temën, pasi sipas tij një element i përdorur në diskursin e mëparshëm mund të jetë remë.

Lambrecht (1994) dallon gjendjet e mëposhtme të referentëve diskursivë:

	I paankoruar	Joaktiv
(1) I paidentifikueshëm	(2) I identifikueshëm	I aksesueshëm
	I ankoruar	Aktiv

Referentët e paidentifikueshëm janë ata për të cilët ekziston një përfaqësim vetëm në mendjen e folësit. Një referent i paidentifikueshëm mund të ankorohet, nëse lidhet me anë të një SE-je tjetër, të përfshirë, siç duhet në të, me ndonjë entitet tjetër diskursi. Për shembull, “një autobus” do të ishte i paankoruar dhe “një djalë me të cilin punoj” do të ishte i ankoruar.

Nga ana tjetër, referentët e identifikueshëm janë ata për të cilët tashmë ekziston një përfaqësim i përbashkët në mendjen e folësit dhe të dëgjuesit në kohën e shqiptimit. Tani, të kesh një përfaqësim të një referenti është ndryshe nga të menduarit për të në kohën e shqiptimit dhe këtu hyn koncepti i aktivizimit. Kjo do të thotë, një dëgjues nuk po mendon për të gjithë referentët për të cilët ai ka një përfaqësim. Vetëm disa prej tyre janë aktivë, të spikatur. Lambrecht këtu e ndjek Chafe-n (1987:22) i cili dallon tre gjendje aktivizimi: aktiv, gjysmaktiv (ose të aksesueshëm) dhe joaktiv.

Referentë aktivë janë ata që aktualisht janë “të ndezur”/ “on”. Shprehjet referenciale të patheksuara kanë referencë aktive, megjithëse jo të gjithë referentët aktivë shfaqen si shprehje të patheksuara. Në mënyrë të ngjashme, të gjithë përbërësit përemërorë janë referentë aktivë, por jo të gjithë referentët aktivë shprehen përmes përemrave.

Referentët gjysmaktivë ose të aksesueshëm janë në vetëdijen periferike. Sipas Lambrecht (ibid.), ekzistojnë tre mënyra se si një referent mund të bëhet i aksesueshëm. Një referent mund të bëhet i aksesueshëm nëpërmjet çaktivizimit nga një gjendje e mëparshme, domethënë duke qenë aktiv në një pikë të mëparshme të diskursit. Ky referent është tekstualisht i aksesueshëm. Përndryshe, një referent mund të jetë i arritshëm në mënyrë konkluzive, nëse mund të konkludohet nga ndonjë referent tjetër aktiv ose i arritshëm në universin e ligjërit. Së fundi, Lambrecht (ibid.) pohon se një referent mund të jetë gjithashtu i arritshëm nga situata, domethënë prania e tij, spikatja në tekst dhe bota e jashtme mund ta bëjë atë gjithashtu të aksesueshëm. Referentët e aksesueshëm mund të kodohen ose si joaktivë, apo ose si aktivë në varësi të faktorëve të ndryshëm. Ata nuk kanë një korrelacion të drejtpërdrejtë fonologjik ose morfologjik, megjithëse mund të kenë një korrelacion indirekt në sintaksë.

Referentët joaktivë ose të paaktivizuar janë në kujtesën afatgjatë të një personi. Ato janë domosdoshmërisht relativisht të theksuar në mënyrë prozodike dhe zakonisht të koduar si SE të shquara. Që një referent të jetë i interpretueshëm si temë e një propozimi, referenti i temës duhet të ketë veçori të caktuara aktivizimi (Lambrecht 1994: 74-109).

1.3.5. Lidhja kontekstuale

Nocioni lidhje (lidhshmëri) kontekstuale ndryshon nga koncepti *discourse-oldness* që sapo u shqyrtua. Sipas këtij nocioni, jo të gjithë elementet e diskursit paraprak janë topikë dhe jo të gjithë elementet topikë i përkasin diskursit paraprak. Në këtë teori, temat/topikat nuk kufizohen si entitete diskursi. Në fakt, ato nuk kufizohen më saktësisht në elemente diskrete. Tema mund të përfshijë të gjithë elementet që lidhen me kontekstin, duke përfshirë edhe foljet. Për shembull, Sgall et al. (1986:57) thekson se përgjigjja e pyetjes „Çfarë ndërtojnë kastorët?“, - „Kastorët ndërtojnë“ do të konsiderohej si temë, ndërkaq DIGA është fokusi.

Sipas këtij nocioni, tema dhe fokusi mund të specifikohen, në rastin prototip, si artikuj CB (të lidhur me kontekstin) dhe NB (të palidhur me kontekstin) së bashku me

varëtis e tyre. Pra, lidhja kontekstuale është baza e strukturës së informacionit të fjalisë, d.m.th. e artikulimit të fokusit të temës (TFA). Në Përshkrimin Gjenerativ Funkcional (FGD), të përpunuar nga grupi kërkimor i gjuhësisë teorike të Universitetit *Charles* që nga vitet 1960-të, konsiderohet niveli i tektogramatikës si përbërës i nivelit të ndërfaqes, d.m.th. niveli i strukturës së fjalisë themelore, që mund të kuptohet si fillimpika e kuptimit (-pragmatike) në interpretimin e fjalive. Vendi i duhur sa i përket lidhjes kontekstuale dhe për TFA-në në strukturën gjuhësore mund të gjendet më pas në këtë nivel. Me fjalë të tjera, struktura e informacionit të fjalisë, duke e lidhur fjalinë me përmbajtjen e saj njohëse, si dhe me kontekstin e saj, shihet si një nga aspektet themelore të sintaksës së fjalisë (Hajičová, E., Sgall, P. & Veselá, K. 2012). Një element lidhet kontekstualisht, nëse është “i dhënë” ose i zgjedhur nga folësi midis artikujve që ai/ajo supozon se janë lehtësisht të arritshëm në kujtesën e dëgjuesit , d.m.th., i spikatur, i aktivizuar mbi pragun e sipërm në stokun e njohurive të përbashkëta” (Sgall et al. 1986:179). Në këtë përkufizim, “i dhënë/i njohur” nuk do të thotë domosdoshmërisht pjesë e diskursit paraprak. Siç kanë vënë në dukje kohët e fundit Hajičová et al, (1998), nuk mund të barazohet dikotomia “element i lidhur kontekstualisht (CB) dhe i palidhur kontekstualisht (NB)” me dikotominë kognitive midis informacionit “të dhënë” dhe “të ri”.

Hipoteza fillestare, që pikënisjen e ka nga nocioni i lidhjes kontekstuale, thotë se dyndarja e fjalisë temë /fokus mund të rrjedhë nga nocioni i kufirit kontekstual. Kështu, nëse fjalëve autosemantike të një fjalie u caktohet vlera CB (e lidhur kontekstualisht) ose NB (e palidhur kontekstualisht), mund ta nxjerrim automatikisht strukturën e fjalisë temë-fokus (Sgall, Hajičová dhe Panevová, 1986).

Siç pamë, nga karakteristikimet diskursive të topikave jo të gjitha elementet që e përcjellin informacionin e njohur arrijnë të bëhen topikë. Për të qenë topikë, një përbërës duhet të jetë i aktivizuar më parë në diskurs.

1.4. Karakterizimet sintaksore

Disa propozime në literaturë japin disa kufizime sintaksore mbi topikat. Kështu, krejt në fillim topikat janë barazuar me kryefjalët e fjalive; pastaj janë identifikuar me pikën fillestare të fjalisë dhe janë ndërlidhur me format përemërore. Secila nga këto karakterizime do të trajtohet në vazhdim.

1.4.1. Kriteri: pozicioni fillestar i fjalisë

Duket se shumica e gjuhëve e shfaqin tendencën për t'i renditur njësitë informative temë-remë. Ky pra është rendi kanonik edhe në gjuhën shqipe, siç e pamë edhe te B.Rugova dhe L.Sejdiu-Rugova (2015). Por, megjithatë nuk ka një konsensus të plotë për këtë në asnjërën gjuhë. Ndërsa nga studiuesit ka që kërkojnë me ngulm që topika të jetë pikënisja e fjalisë. Një ndër ta është Halliday (1967), për të cilin pozicioni fillestar i fjalisë është jo vetëm i nevojshëm, por i mjaftueshëm që një përbërës të konsiderohet tema ose topika e fjalisë. Domethënë, për të, të gjitha sintagmat fillestare të fjalisë janë temë, pavarësisht nga statusi i tyre diskursiv. Ai pohon se temat janë “informacione të dhëna” në rastin e pamarkuar, por nuk kanë nevojë që domosdoshmërisht të jenë “informacione të njohura”, ku “e njohur” kuptohet si ajo për të cilën folësi ose adresuesi po fliste më parë dhe “tema” ajo që është, folësi po e thotë tani për tani. Sipas tij, të gjitha elementet e fillestare të fjalisë në shembujt e mëposhtëm janë tema:

Shembuj të marrë nga Halliday (1967):

- a. Bill / e dërgoi paketën mbrapsht.
- b. Një re e madhe / u shfaq.
- c. Ai që thirri / ishte Alice.
- d. Një vajzë / e theu vazon.
- e. A thirri / ai?
- f. Kush / thirri?

- g. Mbylle / derën!
- h. Ju / mbylleni derën!

Siç po shihet, Halliday (1967) si topikë i trajton edhe foljet, ndajfoljet pyetëse, pjesëzat, vetëmse ato shfaqen në poziten fillestare të fjalisë, pa kërkuar ndonjë element tjetër shtesë, për t'i markuar ato si tema, për shembull, siç është, statusi informativ. Çfarë statusi informativ mund të përcjellin ato? A e mund të jetë folja temë?

Duke pasur parasysh faktin se në pozicionin fillestar në një fjali mund të vendosen përbërës të ndryshëm, autorë të tjerë kufizohen në pretendimin se pozicioni fillestar i fjalisë është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për statusin e topikës. Kjo do të thotë, megjithëse temat e zënë këtë pozicion, jo të gjitha sintagmat që vendosen në pikën e nisjes së fjalisë janë tema. Pra, edhe brenda këtij karakterizimi më lehtë të dallueshëm, pra pozicionit fillestar të fjalisë, ka pikëpamje të ndryshme.

Siç e kemi parë, për gjuhëtarët e sotëm të Shkollës së Pragës, për shembull, nocioni i i temës është më i gjerë. Ai lejon që materiali topik të shtrihet përtej një elementi dhe të mbulojë të gjithë materialin e lidhur me kontekstin. Kështu, duke pasur parasysh se duket të jetë e vërtetë që megjithëse temat priren të shfaqen në pozicionin fillestar të fjalisë, ato mund të ndodhin edhe diku tjetër në fjali, janë mbajtur dy pozicione: zgjeroni konceptin e temës në mënyrë që ajo të përfshijë të gjitha llojet e material aktual (Shkolla e Pragës) ose ndaje atë në dy elemente të ndryshëm (teoria e Vallduví-t).

Së fundi, ekziston një pikëpamje tjetër që sugjeron se, megjithëse disa tema ndodhin në pozicionin fillestar të fjalisë, nuk ka asnjë lidhje midis të qenit temë dhe atij pozicioni në kuptimin që nuk mund të përdoret për të përcaktuar ose njohur një temë. Ky është pozicioni i Lambrecht-it (1994). Ai pohon se temat nuk kufizohen sipas pozicionit fillestar të fjalisë. Sipas tij, temat shprehen gramatikisht me përemra (të plotë ose bosh). Duke marrë parasysh që përemrat zakonisht kanë një pozicion të caktuar në fjali (shpesh afër foljes), nuk ka kuptim të kërkohet që temat të jenë patjetër pikë e nisjes së fjalisë. Për shembull, imagjinoni një situatë në të cilën folësi dhe dëgjuesi po flasin për Gjonin. Folësi

dëshiron të shtojë se në fakt ai e pa Gjonin dje. Në këtë situatë, duke pasur parasysh që Gjoni është i spikatur, folësi mund të përdorë një përemër për t'iu referuar Gjonit, si në fjalinë më poshtë:

- E pashë dje

Pra, a duhet të konsiderohet klitiku “e” si temë e vetme vetëm sepse është në pozicionin fillestar të fjalisë, apo klitiku “e” është temë, edhe nëse nuk është në atë pozicion? Mund të thuhet se po, në gjuhën shqipe “e” është klitik përemëror dhe i referohet një elementi që është përmendur paraprakisht, pra ai e zëvendëson njësinë të cilës i referohet.

Një temë në pozitën fillestare të fjalisë nuk bën të ngërrohet me mekanizmat sintaksorë, siç janë zhvendosja e përbërësve në të majtë dhe topikalizimi, ndërtime të cilat supozohet se e kthejnë një përbërës në pozicionin e topikës edhe nëse ai përbërës nuk e bart statusin e informacionit të njohur paraprakisht. Për shembull:

- a) Kosovës i mungon puna ekipore në luftën kundër kancerit. (*Koha ditore*, 5 tetor 2014)
- b) *Dy raste të reja me koronavirus në Kosovë, numri i të prekurve shkon në 35* (*Koha ditore*, 23 mars 2020)

Në formën kanonike mund t'i kishim nën a) *Puna ekipore i mungon Kosovës...*dhe nën b) *Numri i të prekurve shkon në 35, dy raste të reja me koronavirus*. Një ndryshim i tillë nga forma kanonike në formën jokanonike të tyre ndodh për arsye se këta përbërës kalojnë nga pozicioni i fokusit në pozicion të tematikës, me qëllim të futen si tema të reja. Sipas Lambrecht (1994), këta elemente shfaqen në pozicionin fillestar të fjalisë, me qëllim që të promovohen në statusin e temës, dhe për arsye se shumë shpesh ekziston nevoja për një zhvendosje teme, ose sepse statusi topik i elementit nuk është mjaft i qartë, kështu që duhet të jepet një informacion më i gjerë për atë tematikë.

Së fundi, kur shqyrtojmë lidhjen ndërmjet asaj të të qenit temë dhe të qenit në pozicionin fillestar të fjalisë, duhet të kemi parasysh edhe faktin se te gjuhët me rend kanonik të fjalëve SVO ky pozicion është i uzurpuar gjithmonë nga kryefjala. Ndërsa te gjuhët që kanë rend të lirë ose fleksibil jo gjithmonë kryefjala vendoset në fillim të fjalisë. Në gjuhët si shqipja, kryefjala mund ta ketë pozicionin postverbal dhe normalisht nuk mund të jetë topika e fjalisë, në vend të saj si topikë mund të jetë një SE në funksion të kundrinës, një SP ose SM.

1.4.2. Kryefjalë-topikë

Siç e pamë më lart, në studimet e mëhershme për topikën gjithmonë ka pasur njëfarë unifikimi të saj me kryefjalën, andaj marrëdhënia topikë / kryefjalë mbetet pikë kyçe në hulumtimet mbi topikën.

Në gjuhët SVO, kryefjala, pothuajse shtrihet në kufijtë e topikës, meqenëse topika thamë që pozicionohet gjithmonë në fillim të fjalisë. Prandaj, kryefjala dhe topika gërshetohen. Sidomos në gjuhët sikur anglishtja, ku kryefjala e zë gjithmonë pozitën fillestare të fjalisë, megjithkëtë, siç vëren edhe Rochemont (1986), edhe në anglisht ka përjashtime, pasi ka raste ku kryefjala realizohet në pozitë postverbale, si shembujt më poshtë:

- a. Into the forest ran ROBIN HOOD.
- b. Next to the fireplace stood a large old SOFA.
- c. Less fortunate are the people without JOBS.
- d. Sitting on the bed was his long lost BROTHER.
- e. There was heading towards them, an ominous cloud with a long FUNNEL.

Në këtë raste, subjektet nuk interpretohen si topikë, por si fokus, meqë realizohen në pozitë pasfoljore.

Por, si qëndron raporti subjekt-topikë në gjuhën shqipe? Po i marrim disa shembuj:

- a. Librin e lexoi Ana.
- b. Blerta shkruan bukur.
- c. Në kopsht punon babai.
- d. Jashtë kishte mbetur Arta.

Nga këta shembuj si topikë mund të jenë në (a) *librin* së bashku me *klitikun*, (b) *Blerta*, rasti i vetëm nga shembujt e dhënë ku përrupthet kryefjala me statusin e topikës. Në (c) topikë është një sintagmë parafoljore që tregon vend; nën (d) topikë është një ndajfolje që e bart statusin e topikës së re, pra ajo shërben si vegëz për nisjen e një bisede. Prandaj, këto fjali duket se tregojnë se në gjuhën shqipe jo të gjitha kryefjalët e fjalive interpretohen si topikë dhe jo të gjitha sintagmat e topikës janë subjekte.

Një tjetër element që do të diskutohet ka të bëjë me motivimin e shqipes për të vendosur sintagma të topikës pa kryefjalë në pozicionin fillestar të fjalisë. Kjo do të thotë, edhe pse ne do t'i shqyrtojmë më në detaje më poshtë këta mekanizma topikalizues, por edhe motivimin pragmatik që vepron këtu.

Një nga motivimet për të vendosur elementet topikë në pozicionin fillestar të fjalisë e që vepron edhe në disa gjuhë të tjera me disa veçori si të shqipes, si italishtja dhe spanjishtja është heqja e tyre nga fusha e fokusit, në mënyrë që vetëm sintagmat që përbëjnë fokusin të shfaqen në pozitë pasfoljore. Domethënë, duke e vendosur kundrinën në pozicionin fillestar të fjalisë, me qëllim që kryefjala ta përçojë informacionin e ri, pra të interpretohet si fokus, si përshembull:

Librin e lexoi Arta.

Një tjetër diskutim që është ngritur viteve '80-të ka të bëjë me interpretimin e kryefjalës paraverbale të fjalisë gjithmonë si topikë. Do ta analizojmë këtë në gjuhën shqipe. Për shembull:

- Çka ka t'reja?
- Zana ka nisur studimet.

Një përgjigje për një pyetje të tillë si kjo më lart merret si një fjali e gjithanshme dhe nuk tregon asnjë topikë. Nëse kjo pra mund të provohet që një fjali e përdorur si përgjigje për një pyetje "Çka ka t're?" nuk nxjerr asnjë topikë - e gjithë fjalia, pra, është fokus. Me këtë mund të themi se kryefjalët në pozicion fillestar nuk janë gjithmonë topikë në gjuhën shqipe. Mund të ndodhë që një kryefjalë pasfoljore të jetë pjesë e fokusit dhe nuk mund të jetë kurrë topikë, dhe po ashtu një kryefjalë paraverbale të bëjë pjesë në të dyja polet. Dhe kjo na bën të qartë se nuk mund ta dimë, nëse një kryefjalë paraverbale është topikë ose jo në një fjali jashtë kontekstit. Për shembull:

- a. Zana ka nisur studimet. (e përdorur jashtë kontekstit)
- b. Ajo studion në një fakultet ku ka shumë studentë. Fakuleti i saj është pranë nesh.

Në rastin e parë kur fjalia përdoret jashtë kontekstit, ne nuk e dimë kush është Zana, prandaj kjo SE duke funksionuar si kryefjalë nuk mund të merret edhe si topikë. Ndërkaq, në rastin e dytë, në fjalinë e dytë, SE (fakultet) që funksionon si kryefjalë interpretohet si topikë, pasi ajo është aktivizuar më parë në fjalinë paraprake.

Sa i përket çështjes së fjalisë që realizohet jashtë kontekstit, për të cilën nuk dihet a ka temë a jo, apo e tëra interpretohet si fokus. Ka disa kundërshtime, për shembull, Lambrecht (1994) ka vënë në dukje se kjo lloj strukture e përgjigjes mund të ndahet në temë-koment pa problem. Ai sugjeron që nëse ngjarja që raportohet përfshin një topikë, elementi përkatës kuptohet shumë lehtë si temë nga dëgjuesi. Sidomos kur kemi një emër të përveçëm, si Zana. Sidoqoftë, kjo është e mundur me lloje të ndryshme të SE-ve, përveç emrave të përveçëm. Për shembull:

Vajza ka nisur studimet.

Një vajzë e lagjes sime ka nisur studimet.

Një vajzë ka nisur studimet.

Dikush ka nisur studimet.

Kjo do të thotë, duket sikur një temë parafoljore është “akomoduar” menjëherë si temë edhe në kontekstin e pyetjes së mësipërme “Çka ka t’rë?”. Kështu, duket se ka më shumë lidhje midis pozicionit fillestar të fjalisë dhe topikës sesa midis subjektit dhe topikës në kuptimi që vetëm subjektet në atë pozicion interpretohen si topkë, natyrisht, në një gjuhë ku pothuajse të gjitha subjektet janë në atë pozicion, si në anglisht, lidhja mes subjektit dhe topikës është e vështirë të mohohet (Casielles-Suarez 2004).

Megjithatë, siç u përmend në pjesën e mëparshme, megjithëse në shumë raste topika vendoset në pozicionin fillestar të fjalisë, materiali topik mund të shfaqet diku tjetër në fjali. Përveç kësaj, do të duhet të jemi më të qartë se çfarë nënkuptojmë me pozicionin fillestar të fjalisë. Së pari, ne duhet ta ndajmë atë pozicion teme nga një pozicion më i ulët parafoljor, i cili mund të presë fraza pyetëse dhe sintagma të fokusuara. Së dyti, do të na duhet gjithashtu të ndajmë pozicionin e temës parafoljore nga pozicioni ku vendosen elementet e dislokuara tematike (ibid.39).

1.4.3. Format përemërore

Karakterizimi i fundit sintaksor që lidhet me veçoritë e topikave janë përemrat. Lambrecht (1994), thekson se përemrat janë zakonisht topikë. E siç thotë edhe Casielles-Suarez (2004), është e vështirë të mohohet natyra topikale e trajtës së përemrit. Për shembull, ajo e merr fjalinë:

- E pashë dje.

Sipas saj, duket se ajo për të cilën bëhet fjalë në fjali, lidhet kontekstualisht. Në këtë fjali kemi referencë diskursive dhe, në kontekstin e përmendur më sipër, është i vetmi element topik në atë fjali, klitiku *e*. Nga ky këndvështrim, Erteschik-Shir (1997) ka

sugjeruar që përemrat duhet të interpretohen si tema. Por, jo gjithmonë. Casielles-Suarez (2004) na jep shembuj ku një trajtë përemërore mund të interpretohet si fokus: “këtu duhet të jemi të kujdesshëm, sepse në kontekstin e duhur, një përemër mund të jetë në fakt fokusi i thënies”:

Kë thirrën ata? Pati tha se ata e thirrën ATË.

Për më tepër, për sa i përket statusit informativ të elementeve përemërore, duhet të kemi parasysh jo vetëm pozicionin që ata zënë, por edhe ndryshimin midis përemrave të plotë, përemrave zero (*pro*) dhe klitikëve. Siç e kemi parë më lart, pozicioni i përemrave mund të ndryshojë nga gjuha në gjuhë. Kështu, në gjuhën shqipe një përemër mund të shfaqet para foljes në trup të foljes dhe pas saj.

E kuptoj mirë.

Tregomëni.

E pashë atë.

Veç kësaj, mund të kemi edhe përemra të dislokuar majtas: Librin e lexova dje.

Për ta qartësuar më tej nocionin e topikës dhe për të treguar se çka do të llogarisim topikë në këtë studim, do t'i japim këtu disa përkufizime të topikës nga autorë të ndryshëm:


- ❖ Tema është pikënisjeje, një nocion fillestar që është po aq i pranishëm tek ai që flet dhe tek ai që dëgjon, që formon, si të thuash, terrenin mbi të cilin takohen dy inteligjenca (Weil 1844:29).
- ❖ Ajo që është e njohur ose së paku e dukshme në situatën e dhënë dhe nga e cila folësi nis (východisko, Mathesius 1939: 234).
- ❖ Tema është ajo që vjen së pari në klauzë. Është ajo për të cilën po flitet; pika e nisjes për klauzën si një mesazh (tema, Halliday 1967: 212).
- ❖ Tema është ai informacion për të cilin folësi supozon të jetë tashmë i pranishëm në vetëdijen e adresuesit gjatë kohës kur flet. (informacioni i dhënë, Chafe 1974: 111)

- ❖ Topka e fjalisë e specifikon se për çfarë do të flasë folësi. (topika, Hockett 1958: 201).
- ❖ Një referent interpretohet si temë e një propozimi nëse në një situatë të caktuar propozimi është interpretuar si i lidhur me këtë referent, si shprehje e informacionit që është relevante dhe që rrit njohurinë e adresuesit për këtë referent (Lambrecht 1994: 131).
- ❖ Topika është pjesa e fjalisë që lidhet kontekstualisht; ajo korrespondon me artikujt që folësi supozon se janë aktivizuar në kujtesën e dëgjuesit në një moment të caktuar kohe (Sgall et al. 1986:29).

1.5. Kodimi i topikës në gjuhën shqipe

1.5.1. Sintagma e topikës

Tema/topika fillimisht është përkufizuar si “një element i veçuar në mënyrë karakteristike nga pjesa tjetër e klauzës me një zbritje intonacioni dhe normalisht duke shprehur informacionin e dhënë disi të disponueshëm dhe të spikatur në diskursin e mëparshëm” (Rizzi 1997: 285; Frascarelli & Hinterhoelzl 2007; Bianchi & Frascarelli 2010). Brenda një konfigurimi *spec* - kokë - komplement, koka e projeksionit funksional është një kokë *Top* (e realizuar haptazi në gjuhët natyrore të botës), sintagma e përparme është në pozicionin *spec* dhe komplementi përbën një koment/fokus për atë temë. Koka e temës (*Top*) tërheq ata elemente në klauzë që kanë një veçori [+ Top]. Po e japim më poshtë përmes diagramit:



XP= topikë

YP= koment/focus

Për një gjuhë si shqipja së pari mund të propozohet një ndarje themelore për mënyrën se si realizohen sintagmat e topikës. Sintagmat e topikës në gjuhën shqipe mund të kodohen në disa mënyra: topika mund të kodohet brenda një sintagme boshe, pra që nuk shprehet fonetikisht dhe, po ashtu, të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore.

Siç thamë, topika në gjuhën shqipe mund të realizohet nëpërmjet sintagmave apo përbërësve të tjerë sintaksorë që nuk shfaqen fare në strukturën sipërfaqësore, por në strukturën e thellë ata ekzistojnë. Zakonisht në këta përbërës të pasqyruar sipërfaqësisht fshihet elementi topik, prandaj, pikërisht, ato kategori sintaksore që shtrihen në kufijtë e topikës mund të mos realizohen në strukturën sipërfaqësore (Rizzi 1982, Caselles – Suarez 2004, Frascarelli 2007). Meqë këta përbërës sintaksorë (sintagmat e topikës) janë aktivizuar më parë në diskurs, janë enitete të njohura për dëgjuesin dhe folësin, nuk përsëriten, por mbesin enitete të heshtura/të pathëna (silent), por që realizohen në strukturën e thellë. Në gjuhën shqipe janë vënë re këto këto kategori *boshe* përmes së cilave realizohet topika:

a) *Genci nuk erdhi me ne. Ø Kishte shkuar më herët.* (kryefjalë me kategori boshe/null subject *pro*¹)

b) *Mos e fto Gencin! Nuk i flas Ø.* (kundrinë me kategori boshe/null object *pro*)

c) *Kur të paska humbur qeni? E pashë dje në oborrin tënd.* (kundrinë e realizuar përmes klitikut)

Për secilën prej këtyre rasteve flitet në nënkapitujt e ardhshëm.

1.5.2. Topika e realizuar me kryefjalë boshe (*null subject*)

Shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve ku vepron parametri i kryefjalës zero (*null subject language*), ku bëjnë pjesë edhe arabishtja, baskishtja, spanjishtja, italishtja etj. Sipas këtij parametri, në këto gjuhë, kryefjala nuk realizohet fonetikisht, por projektohet në mënyrë sintaksore, duke u plotësuar pozicioni i saj në strukturën e thellë nga një përemër zero (*pro*) (Chomsky 1981, Rizzi 1982, etj.). Sipas Rizzit (1986: 518-523), një përemër mund të mos shprehet fonetikisht, nëse:

a. *Licencimi*

pro është markuar me fleksionin e X^0y , ku y është i parametrizuar.


b. *Identifikimi*

pro i trashëgon vlerat e veçorive f (formale; TB) të X^0y (nëse ka veçori f ; nëse jo, *pro* merr një interpretim të paracaktuar, zakonisht arbitrar).

Për Rizzin një gjuhë e tillë si, për shembull shqipja, mund të zgjedhë INFL si licencues për *pro* në pozicionin subjekt dhe V për *pro* në pozicionin e kundrinës. Për sa i përket identifikimit, Rizzi argumentoi se *pro* si referent lejohet nëse INFL specifikohet për

¹ Në mënyrë konvencionale, kategoria bosh e pozicionit të kryefjalës ose kundrinës është shënuar si *pro* gjatë fazës historike të gramatikës gjenerative. Kategoria *pro* është veçori e gjuhëve me eptim.

veçorinë e agrimentit, pra të vetës e të numrit. Në diagramin më poshtë tregohet se specifikuesi i INFL drejtohet nga INFL, dhe identifikohet pastaj nga specifikuesi i marrëveshjes (agrimetit), për ta fituar vetën e parë, *kam dashur*.



Pra, *pro* në pozicionin e specifikuesit të *Infl* është në funksion të kryefjalës, ndërsa për të qenë topikë duhet ta plotësojë kriterin e lidhjes me diskursin [+D-linking] (Rizzi 2005). Pra, ajo kryefjalë boshe e ngritur në pozicionin e specifikuesit, për të qenë topikë duhet të jetë aktivizuar më parë në mendjen e dëgjuesit në diskursin paraprak, pra ta ketë një referencë në klauzat e mëparshme. Prandaj, specifikuesi interpretohet si një argument i lidhur me diskursin, për të cilin pastaj bëhet një koment.

Për të parë sesi realizohet në gjuhën shqipe topika përmes kryefjalës zero, merren disa shembuj mostra nga korpusi i studimit:

- 1) S4: Ajo vrasje ka qenë në ditar në lajm / ajo te dikush osht trishtuse / $\emptyset_{[TopP]}$ te dikush osht si ni model.
- 2) S5: $\emptyset_{[TopP]}$ Osht e pashmangshme / \emptyset nuk munesh mos me raportu \emptyset (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
- 3) Norvegjezi Haaland është vlerësuar se në tregun e transferimeve ka vlerë prej 101 milionë eurove. Ai ka kontratë deri në vitin 2024, *por*

$\emptyset_{[TopP]}$ nuk pritet të qëndrojë gjatë te Dortmundi. (Koha ditore, 23 mars 2020)

- 4) I lart topi brenda zonës / $\emptyset_{[TopP]}$ i larguar menjëher nga Xhaka. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)


Në shembullin 1. dhe 2., SE (ajo vrasje) shërben si referencë për dy *pro*-të që realizohet nga S4 dhe S5, d.m.th. aktivizohet njëherë në klauzën e parë nuk përsëritet fonetiki, pasi tashmë është përerës i njohur për folësin. Edhe në shembullin 3., pothuajse është situatë e njëjtë, SE përsëritet dy herë në atë kontekst njëherë përmes përemrit anaforik *ai*, dhe pastaj në klauzën e tretë realizohet përmes një *pro*-je, pasi tashmë nga konteksti po dihet se tema për të cilën po bëhet fjalë është *Norvegjezi Haaland*. Në rastin 4., SE-ja si topikë nuk realizohet, por dihet se referencën e ka në klauzën e parë. Mbetet bosh në klauzën e dytë, ndoshta për atë që Chomsky (1981) e quan ekonomi gjuhësore, meqë është një lojë futbollit, komentatori shpejton për ta nxënë aksionin që po ndodh në fushë.

Strukturat që na propozon Rizzi (1986, 1997) supozojnë se tema ose topika është një kategori rekursive, domethënë, nuk ka kufi për numrin e temave, për shembull, brenda një fjalie mund të ketë më shumë se një temë si rasti i shembullit të dhënë më lart: \emptyset nuk *munesh mos me raportu* \emptyset , ku i kemi dy topika të realizuara, e para realizohet përmes kryefjalës me kategori boshe dhe e dyta realizohet përmes kundrinës me kategori boshe. Pra, topika në gjuhën shqipe mund të realizohet edhe me një kundrinë që nuk është e pranishme në strukturën sipërfaqësore.

1.5.3. Topika e realizuar me kundrinë boshe (*null object*)

Kundrinat e foljeve transitive sikurse në shumë gjuhë të botës edhe në gjuhën shqipe mund të mos shfaqen në strukturën sipërfaqësore, pra të mbesin të pashprehura fonetiki, por aktive dhe të projektuara në mënyrë sintaksore. Sipas Rizzit (1986), pozicionin e *pro* ka projektuar Parimi i Projeksionit, sipas tij, *null objects (pro)* licensohen nga sintagma verbale (VP), dhe pastaj identifikohet përmes koindeksimit dhe përshtatet në

bazë të roleve θ (theta). Ai na jep dy struktura ku gjenerohet *pro* si komplement, nën a. në pozitë pas foljes dhe nën b. në pozitë paraverbale.



Mosekzistimin e kësaj *pro*-je në strukturën sipërfaqësore Mara Frascarelli (2007) e lidh me një lloj të veçantë teme. Sipas saj, mosrealizimi i kundrinës fonetiki lidhet me statusin e saj të topikës. Kur shtrihet brenda kufijve të topikës ajo nuk realizohet sepse njihet nga diskursi paraprak. Një gjë e tillë dallohet edhe në gjuhë shqipe. Po i marrim disa shembuj nga korpusi:

- 5) S4: *Ajo vrasje ka qenë në ditar në lajm.*
- 6) S5: *Osht e pashmangshme/ $\emptyset_{[TopP]}$ nuk munesh mos me raportu $\emptyset_{[TopP]}$* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
- 7) IKSHPK-ja apel të moshuarve: Mos dilni nga shtëpia ...“*Na ndihmoni pak që t’iu ndihmojmë shumë, së bashku ne mundemi dhe ia dalim $\emptyset_{[TopP]}$ ”*, thuhet në njoftim. (*Koha ditore*, 30 mars 2020)
- 8) Një top i rrezikshëm brenda zonës / $\emptyset_{[TopP]}$ e ka larguar më pas Mërgim Mavraj. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Në shembullin e 6., SE-ja në funksion të kryefjalës është njësia që *pro* i referohet, por vetë realizohet si kundrinë pasi licensohet nga V dhe përshtatet me veçoritë e foljes, pra folja kërkon kundrinë. Në rastin e dytë, nga konteksti bëhet me dije që *pro* i referohet *koronavirusit* (IO), pasi është edhe topika e diskursit. Por ky *pro* realizohet si kundrinë pas

kërkesave të foljes, pra u përshtatet tipareve morfo-sintaksore të foljes. Edhe rasti tjetër është i tillë, veçse këtu *pro* realizohet në pozicion para foljes.

1.5.4. Topika e realizuar me klitikë

Dyfishimi i kundrinës me klitik është një fenomen që ndodh kur përemri klitik dhe kundrina përkatëse XP shfaqen në të njëjtën klauzë, me ç'rast klitiku i kundrinës funksionon si marker i agrimentit, ndërsa kundrina (XP) i plotëson kushtet tematike dhe të rasës brenda vP (Gabriel dhe Rinke 2010: 58-59). Dyfishimi klitik e përfshin dyfishimin (ose "përsëritjen") e një përemri klitik të një argumenti foljor i cili "bashkëpunon" me klitikun brenda së njëjtës strukturë propozuese ose brenda të njëjtës klauzë (CP). Rolin "e bashkëpunëtorit" brenda argumentit foljor e luan një përemër, një shprehje referuese jopëremërore, si dhe një klauzë (CP). Kur argumenti foljor ose bashkëpunëtori është një përemër ose një DP, klitiku i bart të njëjtat tipare-phi (ϕ) sikur përemri ose DP, ndërsa, kur argumenti është CP, klitiku është një element i vetëm në akuzativ (Kallulli dhe Tasmoeski 2008: 1). Dyfishimi i kundrinave të drejta nuk është trajtuar vetëm si fenomen morfo-sintaksor, por edhe element që jep sinjale sa i përket strukturës së informacionit (Gabriel dhe Rinke 2010; Kallulli 2000; Fridman 2008; Kapia 2008). Është parë si "mekanizëm që e heq kundrinën nga komenti (fokusi) i fjalisë dhe bën atë pjesë të informacionit të dhënë (topikë) (Holton, Mackridge & Philippaki-Warburton 1997: 432). Pra, kundrina dhe klitiku e marrin statusin e topikës në fjali, pasi dyfishimi ndodh kur klitiku i referohet një referenti që tashmë është i pranishëm në diskurs. Domethënë, XP-ja prezantohet më parë në diskurs, duke u bërë kështu referent konkret i disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të dyfishimit. Realizimi i topikës përmes klitikut mund të shihet më poshtë në shembujt e nxjerr nga korpusi i hulumtimit:

- 9) *Po ti mos um_[TopP] fol për repin n' Amerik / po flasim për repin e Kosovës... / merre, dëgjoje_[TopP] ...* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
- 10) *Ja_[TopP] vodhi kuletën pasi tërhoqi para nga bankomati, policia arreston të dyshuarin brenda ditës.* (*Koha ditore*, 18 prill 2022)

- 11) **E**_[TopP] ka larguar (topin). (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Në shembullin 9. topika po realizohet përmes klitikut *e* në pozicion enklitik, pra kjo *e* i referohet repit në Kosovë. Në klauzën e dytë nuk nuk përsëritet më sintagma, por realizohet përmes klitikut. Në shembullin 10. topika si pikënisja e mesazhit realizohet përmes klitikut *i* që i referohet dikujt. Pra ai dikush është i panjohur për audiencën, por dihet që diçka i ka ndodhur dhe forma përemërore dikujt si topikë po kodohet përmes klitikut *i*. Edhe shembulli i fundit topika po kodohet përmes klitikut *e*.

1.5.5. Topika e realizuar përmes përemrit të plotë

Diskusi koherent shpesh përfshin një a më shumë referenca të përsëritura për të njëjtin entitet diskursiv (Ellert 2013), dhe kjo në gjuhën shqipe shpesh arrihet me përdorimin e përemrave vetorë, dëftorë, lidhorë. Përmes këtyre përemrave realizohet referenca. Referenca mund të jetë anaforike dhe kataforike. Është **anaforike** kur elementi referues hyn në ligjërim pas njësisë, të cilës i referohet (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 139). Ndërsa **kataforike**, kur njësia referuese i vihet përpara njësisë së referuar (ibid. 139). Pra, një klitik anaforik është një morfemë e lidhur morfologjikisht me një përbërësi të përmendur më parë, i referohet atij dhe e plotëson pozicionin e një DP-je në një klauzë. Po marrim shembuj nga korpusi:

- 12) *Një polic i njësisë antidrogë ka qëlluar aty rastësisht afër vendit të ngjarjes / e ka ndalu dorasin / **ai**_[TopP] ka arritë me goditë...* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
- 13) Norvegjezi Haaland është vlerësuar se në tregun e transferimeve ka vlerë prej 101 milionë eurove. **Ai**_[TopP] ka kontratë deri në vitin 2024... (*Koha ditore*, 23 mars 2020)
- 14) Nuk është kshtu sipas anglezit Dik Advokat... **i cili**_[TopP] qëndron në stolin e përfaqësueses serbe. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Më parë thamë që përemrat gjithmonë interpretohen si elemente topike, pasi çdoherë i referohen një njësie apo përbërësi që është aktivizuar më parë në tekst apo diskurs. Në shembullin a. topika në klauzën e fundit kodohet te përemri vetor ai, meqë ky përemër i referohet tash një sintagme që tashmë është një referent i aktivizuar si për folësin ashtu edhe për dëgjuesin. E njëjta gjë ndodh edhe me dy rastet e tjera, veçse në rastin e tretë topika kodohet me një përemër lidhor.

1.5.6. Topika e realizuar përmes zhvendosjes së përbërësit majtas dhe topikalizimit

Një ndërtim dislokimi (i quajtur ndryshe edhe ndërtim i shkëputur ose zhvendosur) është një strukturë fjalie në të cilën një përbërës ose referent që mund të funksionojë si argument brenda një strukture kallëzues-argument ndodh jashtë kufijve të fjalisë që e përmban kallëzuesin, qoftë në të majtë të saj (dislokimi majtas, ndryshe njihet si LD) ose në të djathtë të saj (dislokimi djathtas, këtej e tutje RD). Roli i denotatumit të përbërësit të dislokuar si argument ose komplement i kallëzuesit përfaqësohet brenda fjalisë nga një element përemëror i cili interpretohet si koreferent me sintagmën e dislokuar (Lambrecht 2001). Përshembull, në gjuhën shqipe kundrinë + klitik është ndërtimi më i zakonshëm.

15) *Kosovës* i mungon puna ekipore në luftën kundër kancerit. (*Koha ditore*, 5 tetor 2014)

Ndërkaq, nëpërmjet topikalizimit një përbërës kalon në pozicionin fillestar të fjalisë, pa asnjë thyerje prozodike ose anaforë brenda fjalisë; ruan formën dhe rasën që ka kur vendoset brenda dhe i paraprin të gjithë përbërësve, duke përfshirë ndajfoljet ilokucionare (Bortolussi, Sznajder 2014). Topikalizimi është një lëvizje sintaksore që bazohet në diskurs dhe pragmatikë. Për shembull:

16) *Sancho e Haaland*, lojtarët e rinj më të vlerësuar... (*Koha ditore*, 23 mars 2020)

17) *Dy raste të reja me koronavirus në Kosovë*, numri i të prekurve shkon në 35 (*Koha ditore*, 23 mars 2020)

Në formën kanonike mund t'i kishim nën a) *Puna ekipore i mungon Kosovës...*dhe nën b) *Numri i të prekurve shkon në 35, dy raste të reja me koronavirus*. Një ndryshim i tillë nga forma kanonike në formën jokanonike të tyre ndodh për arsye se këta përbërës kalojnë nga pozicioni i fokusit në pozicion të tematikës, me qëllim të futen si tema të reja. Sipas Lambrecht (1994), këto elemente shfaqen në pozicionin fillestar të fjalisë, me qëllim që të promovohen në statusin e temës, dhe për arsye se shumë shpesh ekziston nevoja për një zhvendosje teme ose sepse statusi topik i elementit nuk është mjaft i qartë, kështu që duhet të jepet një informacion më i gjerë për atë tematikë.

1.5.7.Sintagmat leksikore

Në gjuhën shqipe, siç thamë, topika nuk shprehet vetëm nëpërmjet subjekteve plotësisht leksikore, por edhe përbërësve që nuk funksionojnë si kryefjalë, të cilëve u jepet mundësia, për t'u interpretuar si elemente të topikës. Le të shqyrtojmë DO-të leksikore. Kur DO-të janë fraza leksikore në pozicionin e argumentit (kur ato nuk janë as të dislokuara djathtas ose majtas), ato nuk mund të interpretohen si topikë (Casiellas-Suarez 2004). Në të kundërt, subjektet kanë pozicionin e tyre të argumentit preverbal, kur janë topikë dhe pozicionin e tyre të argumentit postverbal, kur nuk janë. Kjo do të thotë, ndërsa një temë leksikore parafoljore interpretohet si topikë, dhe një pasfoljore si fokus, një DO e plotë leksikisht (jo e zhvendosur) interpretohet gjithmonë si fokus. Prandaj, në krahasim me subjektet, DO-të leksikore nuk duket se kanë një pozicion argumenti që mund të zënë kur janë topikë. Krahasoni fjalitë e mëposhtme:

18) “Plani evropian shumë pak i adreson kërkesat e serbëve në Kosovë” (3 mars 2023, Koha)

19) **Analistët serbë në veri e shohin Planin evropian si njohje të Kosovës** (3 mars 2023, Koha)

20) Tadić nuk e ndalë topin.

21) **Nuk arrin ta ndalë Ø dot Tadić** (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Sintagmat leksikore *plani evropian* dhe *Tadić* në (18 dhe 20) mund të interpretohet si topikë, edhe në mungesë të ndonjë konteksti, dhe si përgjigje për një pyetje të tillë, si “Çfarë ndodhi?” Megjithatë, objekti jopëremëror *planin evropian* dhe \emptyset (topin)në (18 dhe 20) nuk do të kuptohet si një element topik, përveç nëse është elipsë ose i zhvendosur majtas si në rastin e fundit.

22) Analistët serbë në Veri e shohin Planin Evropian si njohje të Kosovës
(3 mars 2023, Koha)

23) Nuk arrin ta ndalë \emptyset dot Tadić (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri,
14.10.2014)

Pra, duket se materiali leksikor brenda VP-së nuk mund të interpretohet si topikë si në rastin 22 dhe 23. Nga ky këndvështrim, ndryshimi midis një kryefjale leksikore parafoljore dhe një DO leksikore, në lidhje me mundësinë e tyre për t’u interpretuar si topikë, mund të jetë pasojë e pozicioneve të tyre të ndryshme. Ekziston, po ashtu, një përjashtim, të cilin e kemi përmendur tashmë: një DO leksikore e theksuar në pozicionin e argumentit mund të interpretohet si një element topik. Domethënë, kur ajo DO mban theks emfatik. Për shembull:

24) Ka probleme, ka probleme për KUkelin... ka marrë një goditje në pjesë të fytyrës (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

25) A mujna me qujt art?! - ROck muzikën... pse s mujna me qujtë art?!
(Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

26) E largon apo jo TOpin... e largon Ivanović (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Rastet më lart janë disa shkoputje nga korpusi ku për shkak të theksit emfatik që përmbajnë edhe pse janë pjesë e argumentit të foljes shtrihen në domenin e topikës, meqë janë pikërisht ato DO që duam t’i vëmë në pah dhe e përmbajnë kriterin *aboutness*. Kjo do të thotë, ky mekanizëm jo vetëm që shënon temën DO, por shënon çdo gjë përveç frazës së theksuar si topikale. Të tri rastet: KUkelin; ROck muzikën; dhe TOpin janë

domosdoshmërisht aktualë. Kjo ngre sërish problemin e dallimit ndërmjet temës dhe sfondit. Vini re se të njëjtat rezultate mund të merren duke u fokusuar në çdo frazë/sintagmë tjetër:

Fjalive më lart mund t'ua bëjmë edhe testet, për ta parë sa e saktë është kjo tezë.

Ka probleme, ka probleme për KUKelin... ka marrë një goditje në pjesë të fytyrës...

A mujna me qujt art?! - ROck muzikën... pse s mujna me qujtë art?!

E largon apo jo TOPin... e largon Ivanović.

a.24. Fjalja në (a) interpretohet si "për sa i përket Kukelit, ... ka marrë një goditje në pjesë të fytyrës".

b.25. Fjalja në (b) interpretohet si "për sa i përket ROck muzikës... pse s mujna me qujtë art".

c.26. Fjalja në (c) interpretohet si "për sa i përket topit... e largon Ivanović".

Siç po shihet, DO-të edhe pse të theksuara edhe pse argumente të VP-ve, ato janë topikë për shkak të kriterit *aboutness* që kanë. Në këto raste, në të cilat folja është e fokusuar, por jo e theksuar.

Do të duhet të shqyrtojmë gjithashtu një rast si (27), ku elementi i fokusuar është topikë dhe në fund të fjalisë.

(27) E ka larguar me nervozizëm **IvanoVIĆ** [TopP]

Kamera fokusohet tek Ivanović dhe tashmë dihet se ai e shtyu, e largoi Kukelin, prandaj kjo është topikë pasi e ka kriterit *aboutness*, por fokusi mbetet e *ka larguar* me nervozizëm. Siç do të shohim më në detaje në kapitullin 2, ku shqyrtohet nocioni i fokusit, ky rast është i ndryshëm, pasi fokusi në pozitën fundore mund të projektohet lart, ndërsa fokusi, pra të ndryshojë pozitën nga in-situ në ex-situ. Në fakt, do të shohim që në shqip (1) do të kishte një fokus VP që realizohet më lart se topika për shumë arsye që do t'i diskutojmë në vazhdim.

Një çështje që e trajton Eugenia Casiellas-Suarez (2004) e që mendoj se vlen edhe për shqipen ka të bëjë me krahasimin e kundrinave të patheksuara me kundrinat e zhvendosura djathtas në disa raste. Për shembull, sintagma *republikanët* mund të shtrihet dhe mund të jetë pjesë e topikës si në (28), ose pjesë e fokusit si në (29)?

(28) Motra ime urren *republikanët*.

(29) Motra ime i urren **ata**, *republikanët*.

Për Vallduví-n (1990) të dy DO-të në (28) dhe (29) më sipër do të ishin *tails* “bishta”. Megjithatë, ndërsa ai do të konsideronte një kundrinë të zhvendosur djathtas si në (30) një *tail*, ai do ta konsideronte një objekt të zhvendosur majtas një temë (link) (Për më tepër për termat *tail* dhe *link* shih Vallduví 1990).

(30) E pashë dje, vëllain tënd.

(31) Vëllain tënd, e pashë dje.

1.5.8. Sintagmat (frazat) e dislokuara

Siç e kemi parë, sintagmat e dislokuara mund të zhvendosen në të majtë ose në të djathtë. Sintagmat e zhvendosura majtas i diskutuam në pikën kur folëm për topikalizimin. Në shembujt më poshtë (1) dhe (2) kemi nxjerrë në pah një kryefjalë dhe një kundrinë të drejtë të zhvendosur ose të dislokuar djathtas:

(32) Policia prej atëherë ka dyshu që veturën e ka djeg tash viktima, *Hyseni* [TopP]
(Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

(33) Shikoni si e ka mbajtur *Mërgim Mavrajn...e* [TopP] ka tërhequr për krahu...
(Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Por siç vëren edhe Casiellas-Suarez (2004) për spanjishten, një gjë të tillë e kemi vënë re edhe për shqipen, se fraza e zhvendosur nuk mund të jetë vetëm leksikore, ajo mund të jetë edhe përemërore si në (a) dhe (b):

(a) E takova Mirën, shoqen tënde.

(b) Ai e mori vëllain tënd, Gencin.

Të gjitha këto që i diskutuam tani për sintagmat e dislokuara mbetet diçka ende e pasqaruar si për subjektet leksikore ashtu edhe për ato përemërore dhe jokryefjalore. Siç sugjeron Vallduví (1990), pastaj edhe Casiellas-Suarez (2004) nuk ka përgjigje për disa pyetje: Së pari, a janë sintagmat topike të dislokuara në thelb të ndryshme nga elementet topikë jo të zhvendosur? Së dyti, a ka ndonjë ndryshim thelbësor midis dislokimeve djathtas dhe majtas?!

1.6. Përfundimi:

Së pari, ofruam një studim të shkurtër historik, i cili na tregoi disa nga përkufizimet e temës/topikës në literaturë. Pastaj, i shqyrtuam karakteristikat e ndryshme sintaksore dhe diskursive si dhe motivimin që qëndron pas tyre. Duke e marrë parasysh rrethimin sintaktik, referencat diskursive, kontekstin, informacionin e njohur, kemi arritur ta përkufizojmë semantikisht dhe sintaksisht topikën dhe kodimin e saj në gjuhën shqipe. Në bazë të punës empirike topikën mund ta përkufizojmë në këto mënyra:

- Topika është pjesa e fjalisë që lidhet kontekstualisht; ajo korrespondon me artikujt që folësi supozon se janë aktivizuar në kujtesën e dëgjuesit në një moment të caktuar kohe (Sgall et al. 1986:29).
- Tema është ai informacion për të cilin folësi supozon të jetë tashmë i pranishëm në vetëdijen e adresuesit gjatë kohë kur flet. (informacioni i dhënë, Chafe 1974: 111)
- Një referent interpretohet si temë e një propozimi nëse në një situatë të caktuar propozimi është interpretuar si i lidhur me këtë referent, si shprehje e informacionit që është relevante dhe që rrit njohurinë e adresuesit për këtë referent (Lambrecht 1994: 131).


Ndërkaq, në bazë të analizave sintaksore e semantike, mund të konkludojmë se topika ose sintagma e topikës në shqipe realizohet në disa mënyra:

Për një gjuhë si shqipja mund së pari mund të propozohet një ndarje themelore për mënyrën se si realizohen sintagmat e topikës. Sintagmat e topikës në gjuhën shqipe mund të kodohet në mënyra: topika mund të kodohet brenda një sintagme boshe, pra që nuk shprehet fonetikisht dhe, po ashtu, të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore. Topika mund të realizohet me kryefjalë boshe, me kundrinë boshe, me klitikë, përmes përemrave, përmes zhvendosjes djathtas ose majtas, dhe përmes sintagmave leksikore.

Sa i përket realizimit të topikës përmes sintagmave boshe (me kryefjalë dhe kundrinë boshe), kemi bërë edhe analizë statistikore, për të parë se në cilin zhanër të tekstiti që kemi përzgjedhur për korpus po kodohet më shumë topika përmes sintagmës boshe. Siç mund të shohim në tabelën më poshtë, kodimi i topikës përmes sintagmave boshe në zhanrin gazetaresk (*Gazeta Koha ditore*) realizohet me një përqindje shumë më të vogël (23%) se në tipat e tjerë (Emisioni *Pressing* dhe ndeshja *Serbi-Shqipëri*) që e përbëjnë korpusin tonë. Kjo ndodh për disa arsye, e para, se në dy zhanret e tjera (Emisioni *Pressing* dhe ndeshja *Serbi-Shqipëri*) i përkasin gjuhës së folur, prandaj janë përplot referenca diskursive, dihet konteksti, njihet diskursi paraprak, prandaj edhe folësit në emision edhe komentatori shpejtojnë për ta nxënë diskutimin, për të cilin po dikutojnë dhe (komentatori) veprimet që po ndodhin në fushën e lojës.

Statistikat e nxjerra mund t'i shohim në tabelën më poshtë:

Realizimi i topikës përmes sintagmave boshe



2. FOKUSI

Studimet mbi fokusin njësoj si studimet mbi topikën kanë nxitur lindjen e terminologjisë heterogjene, si: *Rheme*, *Comment*, *Focus*, *Focus-Background* etj. Por ndryshe nga topika, studimet mbi fokusin kanë nxitur më shumë kontradikta. Këto studime e kanë definuar fokusin në shumë mënyra, duke e parë nga disa këndvështrime të ndryshme, si: semantike, fonologjike, sintaksore dhe pragmatike, duke e bërë fokusin kështu si një fenomen kompleks dhe ndryshe nga topika, duke mos e arritur që vetë nocioni i fokusit të ketë një përkufizim standard.

Në këtë pjesë, diskutohen dhe shqyrtohen shembuj ilustrues të secilës prej këtyre këndvështrimeve, për të arritur te një përkufizim më i thellë për fokusin në përgjithësi dhe fokusin në gjuhën shqipe.

2.1. Përkufizimi i fokusit nga këndvështrimi semantik

Fokusi është diskutuar gjerësisht brenda gjuhësisë si një aspekt kyç i komunikimit (shih Chomsky 1971, Jackendoff 1972, Gussenhoven 1983, Ladd 1983, Baart 1987, Rooth 1985, 1986, 1992, Kratzer 1991, Lambrecht 1994, Steedman 1994, Erteschik-Shir 1997, Büring 2007, 2016). I pari që e diskutoi semantikën e fokusit në një kornizë gjenerative ishte Chomsky (1971), i cili në fakt i ndau fjalitë në fokus dhe presupozim. Fokusi përkufizohet “si fraza që përmban qendrën e intonacionit” (Chomsky 1971: 200). Presupozimi përkufizohet si “informacioni në fjali që supozohet nga folësi, për t’u ndarë nga ai dhe dëgjuesi. Ai propozon që çdo fjali të lidhet me një klasë çiftesh (F, P) ku F është një fokus dhe P një presupozim që tregon gamën e interpretimeve të mundshme. Meqenëse funksioni i fokusit është të “përcaktojë lidhjen e thënies me përgjigjet, me thëniet ndaj të cilave krijohet një përgjigje e mundshme dhe me fjalitë e tjera në diskurs” (Von Heusinger 1999). Diapazonin e interpretimit të mundshëm mund ta shpjegojmë përmes shembujve më poshtë. Për shembull, më poshtë (2) është një përgjigje e duhur për (1a) pasi ato ndajnë të njëjtin presupozim dhe fokusin që kërkohet që *Linkolni u vra në teatër*.

Nga ajo që u tha më lart, kuptojmë se Chomsky e shpjegon dikotominë fokus-presupozim në mënyrën e mëposhtme. Shembujt më poshtë tregojnë se përgjigja (2) është një përgjigje e arsyeshme për (1a)-(1b), të cilat të gjitha e kanë presupozimin se *Linkolni u vra*. Presupozimi përshkruhet joformalisht si ajo pjesë e fjalisë që përcillet në mënyrë të pavarur nga akti i të folurit ose mohimi i bërë në fjali. Ai korrespondon me fjalinë minus elementin e fokusit. Chomsky propozon strukturën e thellë në (3) për (4) dhe (5), në të cilën presupozimi është fjalia e ngulitur dhe fokusi është pjesë e kallëzuesit të matricës që është *në teatër*. Për shembull:

(1a) *A u vra Linkolni në Shtëpinë e Bardhë?*

(1b) *Në Shtëpinë e Bardhë u vra Linkolni?*

(1c) *Linkoli nuk u vra në Shtëpinë e Bardhë.*

(1d) *Nuk është Shtëpia e Bardhë vendi ku u vra Linkolni.*

(2) *Jo, Linkolni u vra në teatër.*

(3) [vendi ku u vra Linkolni] [është teatri]

(4) presupozimi: *Linkolni u vra diku.*

(5) fokusi: *në teatër*

Në një sekuencë pyetje/përgjigje të mirëformuara, çdo përgjigje duhet të lejojë një zgjedhje të fokusit që është në përputhje me pyetjen, pra me atë që e kërkon pyetja, në kuptimin që një përzgjedhje e fokusit lejon të përcaktohet një presupozim që i përshtatet grupit të kontekstit. Tërheqja e këtij presupozimi qëndron në llogarinë që ofron për interpretimin e fokusit si informacion i ri. Pra, Chomsky e kupton se informacioni i ri në

një fjali është ai informacion në fjali që nuk është “i presupozuar” në kontekst (Erteschik-Shir 2007).

Kjo pikëpamje shumë e përgjithshme e Chomsky-t për fokusin në gramatikën gjeneruese u zhvillua në një teori semantike nga Jackendoff (1972), Höhle (1982) dhe të tjerë. Rrëfimi i Jackendoff (1972) do të merret si baza e teorive semantike të fokusit të paraqitura më poshtë.

Tutje, pra siç thamë, propozimi i Chomsky-t (1971) është zhvilluar në mënyrë të dallueshme edhe pse të ngjashme nga Jackendoff (1972), Akmajian (1973) dhe Williams (1980b), dhe të tjerë. E përbashkëta e të gjitha këtyre analizave është se ato marrin çdo zgjedhje të fokusit, për të identifikuar një “presupozim” përkatës, të nxjerrë për afërsisht duke zëvendësuar një variabël sasiore ekzistenciale në fjalinë me presupozim në vend (6 b), dhe fjalia (7) e identifikon diapazonin e presupozimeve në (8), secila e lidhur me një zgjedhje të ndryshme të fokusit në (7) (Rochemont 1986: 42).

Për shembull:

(6) a. JOHN ishte këtu.

(6) b. \exists (John) x (x ishte këtu)

(7) Lumi ndoqi Ralfin në dhomën e gjumit.

(8) a. \exists x (Lumi ndoqi Ralfin në x)

(8) b. \exists x (Lumi e bëri x)

(8) c. \exists x (x ka ndodhur)

Sipas Rochemont (1986), tërheqja e këtij propozimi qëndron në llogarinë që ofron për interpretimin e fokusit si *informacion i ri*. Intuita e qasjes, dhe ajo që zakonisht ruhet edhe jashtë kuadrit gjenerues (shih p.sh. qasja e shkollës së Pragës, siç përshkruhet në Firbas (1964, 1966)) është identifikimi i informacionit të ri si ai që nuk është *i dhënë*, ku

“i dhënë” merret si i përcaktuar në mënyrë kontekstuale. Të thuash se një informacion i caktuar është i vjetër/ i dhënë supozohet se është tërheqës për një element tjetër, sepse e bën të disponueshëm një diskurs paraprak, për të përcaktuar se çfarë llogaritet informacion si i vjetër/i dhënë, ashtu edhe sepse ai paraqet fokusin në një dritë të njohur, duke sugjeruar që problemet e veçanta që ai ngre bien së bashku me problemet në një fushë tjetër.

Jackendoff (1972) e shtjellon analizën e presupozimit të Chomsky-t (1971) më plotësisht. Ai e sugjeron λ -kuantifikimin e ndryshores së zëvendësuar të fokusit dhe përdorimin e shprehjes që rezulton për të nxjerrë presupozimin dhe pohimin e fjalisë si (9) dhe (10), respektivisht.

$$\exists x \text{Presupp}_s(x) \left\{ \begin{array}{l} \text{is a coherent set} \\ \text{is well-defined} \\ \text{is amenable to discussion} \\ \text{is under discussion} \end{array} \right\} \text{ in the present discourse}$$

$$\text{Focus} \in \lambda x \text{Presupp}_s(x)$$

Kështu, pohimi i një fjalie, sipas Jackendoff (1972), kërkon që fokusi të jetë një anëtar i grupit presupozues Presupp_s , domethënë grupit të shprehjeve të cilat kur zëvendësohen me x në $\lambda x \text{Presupp}_s(x)$ japin një propozim të vërtetë. Presupozimi (14) duhet të jetë i vërtetë nëse pohimi duhet të jetë kuptimplotë (Rochemont 1986: 42).

Jackendoff (1972) e njeh rolin e fokusit në interpretim dhe ofron një llogari paraprake, duke përdorur këtë përkufizim të fokusit si plotësues të presupozimit (Erteschik-Shir 2007:28). Prandaj, ai pranon paraprakisht karakterizimin e informacionit të ri nga Jackendoff (1972) si “informacioni në fjali që supozohet nga folësi që nuk duhet të ndahet nga ai dhe dëgjuesi” (ibid. 230).

Dhe tani për tani në kuptimin intuitiv të lexuesit për përdorimin e synuar të termit, duke iu rikthyer një karakterizimi më të saktë të kuptimit të "informacionit të ri" dhe interpretimit të fokusit. Duhet të jetë e qartë për lexuesin se ne jemi duke supozuar

paraprakisht, ashtu si Chomsky (1971) dhe Jackendoff (1972), se të qenit informacioni i ri në një fjali është një kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm për interpretimin si fokus.

Tradicionalisht, fokusi është identifikuar si përbërësi që i përgjigjet një pyetjeje (*wh-question*), me ç'rast informacioni që bart kjo pyetje është krejtësisht i ri (Erteschik-Shir 1997, 2007). Materiali në përgjigje që korrespondon me përbërësin në pyetjen-*wh* që është i fokusuar (Büring 2007). Ndërkaq, presupozimi është ai që e bart informacionin e dhënë.

2.2. Topkë = Presupozim?!

Me një fjalë, nga ajo që u tha më lart, Chomsky dhe Jackendoff i barazojnë nocionet *topkë-fokus* me *presupozim-fokus*. Por, këtë barazim të tyre e kundërshtoi Rochemont (1986).

Rochemont e kritikon hipotezën e Chomsky-t (1971) dhe Jackendoff-it (1972) që presupozimi është i barabartë me *topikën* dhe *informacionin e dhënë*.

Ai i ka tri arsye, për t'i hedhur poshtë analizat e Jackendoff-it (1972) dhe Williams (1980b). Sipas tij, së pari, ata nuk arrijnë të karakterizojnë në mënyrë të përshtatshme fokusin si vetëm informacionin e ri të fjalisë. Së dyti, ata nuk ofrojnë një përkufizim të saktë të informacionit të dhënë si presupozim, duke supozuar në vend të kësaj një nocion të papërcaktuar të presupozimit që lidhet në mënyra indirekte me përkufizimin logjik të presupozimit si një pohim që duhet të jetë i vërtetë, nëse fjalia që e përcakton atë do të gjejë një vlerë të vërtetë, ose në mënyrë alternative, nëse fjalia duhet të jetë e përshtatshme. Së fundi, ai ka argumentuar tashmë se fokusi dhe theksi nuk janë domosdoshmërisht të ndërlidhur. Të dyja analizat e përmendura këtu supozojnë gabimisht lidhjet që e nxjerrin presupozimi të barabartë me *topikën* dhe *informacionin e dhënë*.

2.3. Informacion i dhënë = Presupozim?!

Gjithashtu, Rochemont (1986) ka dhënë tre argumente kundër *presupozimit* si *informacion i dhënë*. Ai konkludon se ky term mund të përdoret vetëm në kontekstin e caktimit të fokusit nën një interpretim rrënjësor të ndryshëm, domethënë se informacioni i dhënë është “i presupozuar” vetëm nëse (1) është „në diskutim e sipër” ose (2) përfshin një kallëzues. As (1) as (2) më lart nuk korrespondojnë me kuptimin në të cilin presupozimi kuptohet normalisht, nën çdo interpretim të tij (krh. Wilson (1975), Kempson (1975), Gazdar (1979), Karttunen dhe Peters (1975, 1979) sipas Rochemont). Rochemont (1986) mendon se kuptimi më i thellë i diskursit për të nxjerrë presupozimin është në fakt i parëndësishëm për identifikimin e funksionit të fokusit në specifikimin e mirëformimit të diskursit. Me sa duket, janë vetëm (1) dhe (2) ato që luajnë ndonjë rol në këtë çështje. Arsyetimi i tij në përcaktimin e një kallëzuesi të veçantë është se nëse “presupozim” nuk e ka përdorimin e tij standard në lidhje me fokusin, atëherë pse ta përdorim atë në dikotominë fokus~presupozim. Prandaj, beson se përdorimi i këtij termi na çon në një konfuzion të konsiderueshëm në diskutimet e interpretimit të fokusit, duke shërbyer në mënyrë efektive, për të fshehur një sërë boshllëqesh themelore në llogaritë e ofruara. Pa elaborim të mëtejshëm, zëvendësimi i termit “presupozim” me “informacion të dhënë” vetëm e komplikon çështjen duke nënkuptuar se kërkesat kontekstuale për zgjedhjen e fokusit i nënshtrohen sistematikisht të njëjtave parime që rregullojnë përshtatjen e fjalive me presupozime të vërteta logjike (ibid. 46).

Siç u tha, i gjithë qëllimi i Rochemont në këtë kapitull është të ofrojë një përshkrim të bazuar në mënyrë empirike të “informacionit të vjetër” dhe një analizë përshkruese adekuate të interpretimit të fokusit. Tutje, ai përpara se t’i drejtohet kësaj detyre, fillon të diskreditojë tërësisht informacionin e vjetër në diskurs në lidhje me presupozimin, në kontrast me pikëpamjet e Chomsky-t (1971), Jackendoff-it (1972) dhe Williams (1980b), ndër të tjera.

Argumenti i parë i Rochemont (1986) mbështet te Schmerling (1976: 77), sipas tij, informacioni i vjetër nuk presupozohet asnjëherë. Sipas tij, ky argument varet nga ajo që komplementi i një foljeje *faktive*, ndonëse ende presupozohet në një kuptim logjik, por

që mund të fokusohet ende në një kontekst të caktuar. Për shembull, (1) presupozon që Blerta është artiste, pavarësisht nëse shfaqet në një kontekst si (2), në të cilin komplementi është i fokusuar dhe i spikatur, apo si (3), në të cilin nuk e ka asnjërën prej tyre:

(1)

Nuk e kuptova që Blerta ishte artiste.

(2)

A: Mendova se e kuptove që Blerta dridhej në skenë.

B: Po! Por nuk e KUPTOVA që Blerta ishte ARTISTE!

(3)

B: Genci më tha se Blerta shkëlqeu në skenë. Nuk e di si mund të shkëlqejë në skenë duke u dridhur aq shumë.

A: Por nuk e kuptova që Blerta ishte me të vërtetë artiste!

Duke e mbështetur Rochemont-i, Schmerling-un (1976), e lidh dallimin i fokusuar/jo i fokusuar me dallimin folje faktive/jofaktive.

Për shembull, edhe në shqipe janë foljet faktive, si: *besoj, kuptoj, shpresoj*, që nuk e detyrojnë plotësimin e saj me presupozim. Por disa fjali që kanë folje faktive si *besoj* shfaqin një model fokusimi saktësisht identik me atë të fjalive me foljen *realizoj*, siç mund të shihet duke krahasuar (4) dhe (5) me (2) dhe (3).

(4) Përgjigje: Gjoni beson vërtet shumë gjëra të çmendura.

B: Po, e di. Për shembull, ai beson se hëna është bërë nga DJATHI.

(5) A: Më thatë se Blerta po vinte në shtëpinë time.

B: BESOVA se po, por u gabova.

Problemi tjetër në lidhje me nocionin presupozim~informacion i dhënë është vënë në dukje edhe nga edhe më herët në Jackendoff (1972) dhe Rochemont (1978). Sipas tyre, një presupozim paraqet ekzistencën e një grupi me anëtarësi të paktën të barabartë me një tjetër, por pohon se anëtarësimi i këtij grupi është saktësisht i pavlefshëm. Është e qartë, megjithatë, (6) nuk është një kontradiktë. Si në rastin e më poshtëm.

Merrni parasysh një fjali si (6).

(6) Asnjë njeri nuk shkoi në teatër.

Këtë fjali po e paraqesim sipas Rochemont:

(7) $\exists x$ (x nuk shkoi në teatër)

Një problem i tretë për analizën e presupozimeve ka të bëjë me ato fjali në të cilat subjekti është një fokus i spikatur që përmban një theks emfatik.

(8) DIKUSH deshi t'ju takonte.

(9) MAVRAJ kontrollon topin.

Me këtë Rochemont tregon që presupozimi në dikotominë topikë~fokus dhe informacion i vjetër ~ i ri, pasi nuk mund t'i caktojmë pozitë apo vend të caktuar në fjali, për shembull, në dy shembujt më lart ne e shohim fokusin në fillim të fjalisë i cili bart një theks emocional dhe kjo d.m.th. këta dy përbërës nuk presupozojnë për shkak të kontekstit.

Po i paraqesim sipas skemës së Rochemont:

(9) $E x$ (x deshi t'ju takonte)

(10) $E x$ (x kontrollon topin)

Por në disa shembuj më poshtë që shfaq Rochemont në kontekste të ndryshme, që po ashtu përputhen me shqipen, subjektet që bartin theksin emfatik mund edhe të funksionojnë si presupozime, për shembull:

(11) Përgjigje: A më erdhi ndonjë gjë sot?

B: Oh po. Një LETËR erdhi për ty sot.

Në këtë rast, SE-ja një letër mund të shërbejë edhe si presupozim edhe si informacion i dhënë edhe si topikë nëse e llogarisim informacionin e dhënë të barabartë me topikën.

Siç po shihet deri më tani, nuk arrin ta trajtojë presupozimin në raport me fokusin dhe të përcaktojë një vijë të prerë, nëse identifikimi i presupozimit në një fjali ndihmon në identifikimin e fokusit, sikurse siç do të ndihmonte identifikimi i fokusit, prandaj ai e sheh se presupozimi nuk luan aq rol të fortë në identifikimin e fokusit.

Prandaj, edhe trajtimin e Chomsky-t në atë kohë e kritikon për ndarjen presupozim~fokus, sipas tij, Chomsky këtë ndarje e kishte bazuar te struktura sipërfaqësore, dhe, në veçanti, theksimi (në mënyrë kontrastive) i përbërësve të fokusuar, prandaj, nuk mund ta përcaktojë ose modifikojë interpretimin semantik, dhe këto linja i ndoqi edhe Jackendoff (1972), duke përpunuar disa nga iniciativat e Chomsky-t, por jo sipas një analize të thellë semantike.

Edhe për **Erteschik-Shir** (1997, 2007) topika jo gjithmonë barazohet me presupozimin. Ajo i jep disa shembuj kur topika përputhet presupozimin. Sipas saj, rrjedh gjithashtu se *foci* duhet të jenë të informacione të reja në diskurs. Pason edhe testi pyetje-përgjigje pasi përgjigja e pyetjes-wh është domosdoshmërisht e re, dhe pjesa tjetër e fjalisë, e cila duhet të jetë e pranishme në pyetje, është e presupozuar. Në shembujt më poshtë fokusi është me shkronja të mëdha, presupozimi me shkronja të pjerrëta:

Pyetje: Çfarë bëri Gjoni?

Përgjigje: AI LAU ENËT.

b Pyetje: Çfarë lau Gjoni?

A: Ai lau ENËT.

c Pyetje: Kush i lau enët?

Përgjigje: GJONI i lau.

d Pyetje: Çfarë ndodhi me enët?

A: GJONI i lau ato.

e Pyetje: Çfarë ndodhi?

A: GJONI LAU ENËT.

f Pyetje: Çfarë bëri Gjoni me enët?

A: Ai i LAU ato.

Në (a), vetëm subjekti është i supozuar dhe për këtë arsye është i vetmi kandidat për topikë. VP është fokusi. Në këtë shembull, hartëzimi i sintaksës - IS është i përsosur dhe, siç do të shohim në kapitull, ky është në fakt rasti i pashënuar. Në (d) tema identifikohet gjithashtu me presupozimin, megjithatë fokusi nuk formon një përbërës sintaksor. Ky është problem për ato teori që i konsiderojnë *foci* si një veti të përbërësve sintaksorë, por nuk është problem për përkufizimin semantik që identifikon *foci* si plotësues të presupozimit. Në (b) dhe (c) presupozimi dhe tema nuk mbivendosen. Këto fjali vlerësohen në lidhje me “Gjonin” dhe “pjatat”, përkatësisht. Nga kjo rezulton se tema përmbahet brenda supozimit në këta shembuj, por nuk mund të identifikohet me të. (e) ilustron një fjali me fokus të plotë pa asnjë supozim. Këto fjali kanë një temë skenike siç u argumentua më sipër. Në (f) presupozimi është “Gjoni bëri diçka me enët”, duke e lënë foljen si fokus.

Sipas Erteschik-Shir, tema jo gjithmonë përkon me presupozimin (2007: 28). Ajo e mbështet definicionin e Rooth-it. Ajo tërhiqet nga përkufizimi i vitit 1997 që kishte bërë vetë.

2.4. Presupozimi dhe fokusi sipas Rooth-it (1985)

Rooth 1985, duke zhvilluar idetë e Jackendoff, e përshtat përkufizimin e tij të fokusit në një përshkrim më formal të këtyre çështjeve. Këtu i lëmë mënjanë këto çështje semantike, megjithatë përkufizimi i Rooth është ende i rëndësishëm. Rooth përdor nocionin e grupeve alternativave që shqyrtohen në diskurs. Vlera semantike e fokusit të një fraze, sipas kësaj pikëpamjeje, është “bashkësia e propozimeve që mund të përftohen nga vlera e zakonshme semantike duke bërë një zëvendësim në pozicionin që korrespondon me sintagmën e fokusuar” (Rooth 1985: 33). Si ilustrim:

(1) Pyetje: Cilat rroba lau Gjoni?

A: Ai i lau BARDHËT.

Pyetja (1) parashtron një grup alternativash të tilla si: "Gjoni lau X-in në lavanderi", ku X mund të jetë rrobat me ngjyra, rrobat e bardha, rrobat e hollë, leshi, etj. Në përgjigjen "lavanderia e bardhë" është e zgjedhur për t'u zëvendësuar për X, dhe për këtë arsye është vlera e fokusit sipas përkufizimit të Rooth. Vini re fillimisht se gjithashtu rrjedh nga përkufizimi i Rooth se presupozimi dhe fokusi plotësojnë njëri-tjetrin. Një pikë tjetër është se grupi i alternativave përcaktohet në mënyrë kontekstuale.

Në punimin e tij Rooth propozon dhe heton një analizë të detyrueshme të lidhjes me fokusin e bazuar në funksionet e zgjedhjes: Fokusi prezanton një variabël të funksionit të zgjedhjes që vepron në një grup alternativash të dhëna kontekstuale dhe lidhet nga një operator i koindeksuar i ndjeshëm ndaj fokusit. Rezulton se kjo mënyrë për t'iu qasur sintaksës dhe semantikës së lidhjes me fokusin jo vetëm që përbën një gamë të gjerë të të dhënave përkatëse, por gjithashtu kap faktin se shoqërimi me fokusin, të pacaktuarat dhe frazat-wh in-situ janë të ndërlidhura në mënyra të ndryshme, veçanërisht dhe ndoshta më e rëndësishmja, duket se formojnë një klasë natyrore fenomenesh të *pandjeshme* ndaj kontekstit (Rooth 1996).

2.4.1 Semantika alternative

Brenda supozimeve të Semantikës Alternative, Rooth (1985, 1992, 1996) sugjeron se funksioni i fokusit është të evokojë alternativa. Në këtë qasje, ndarja fokus-presupozim zëvendësohet nga një grup propozimesh alternative. Propozimi i fjalisë përbën vlerën e zakonshme semantike siç ilustruhet më poshtë. Vlera semantike e fokusit rrjedh duke bërë një zëvendësim në pozicionin që korrespondon me sintagmën e fokusit. Propozimet alternative ndryshojnë vetëm në lidhje me sintagmën e fokusuar.

A dëshiron Ede çaj apo kafe?

Ede dëshiron [kafe]^F vlerë të zakonshme semantike

{Ede do kafe, Ede do çaj} vlera semantike e fokusit

{Ede do kafe, Ede do çaj}

Kush do kafe?

[Ede]^F dëshiron kafe. vlerë e zakonshme semantike

{Ede do kafe} vlera semantike e fokusit

{Ede do kafe, Maria do kafe, Gjoni do kafe. . .} (përshtatur nga Rooth 1996: 271)

(cit. sipas Gürer 2021)

Ideja themelore e semantikës alternative (Rooth 1985) është se funksioni i përgjithshëm i fokusit është të evokojë alternativa. Çdo shprehje tani do të ketë dy vlera të ndryshme semantike: vlerën e saj të zakonshme semantike dhe “vlerën semantike të fokusit”, ku vlera semantike e fokusit do të përbëhet nga një grup alternativash. Po i marrim dy shembuj nga Rooth (1996):

(14)

a. John introduced [Bill]F to Sue.

b. John introduced Bill to [Sue]F.

(15)

a. $\langle \lambda x [\text{introduce} (j, x, s)] , b \rangle$

b. $\langle \lambda y [\text{introduce} (j, b, y)] , s \rangle$

Vlera semantike e fokusit të (14a) më sipër do të jetë grupi i propozimeve të formës “Gjoni i prezantoi *x-in* Sue”; vlera semantike e fokusit të (14b) do të jetë bashkësia e propozimeve të formës “Gjoni e prezantoi Bill me *y-in*”. Vetia në (15a) është vetia e prezantimit nga John te Sue, dhe *b* është i markuar individualisht nga Billi. Vetia në (15b) është vetia e të qenit një *y* e tillë që Gjoni e prezantoi Billin me *y-in*, ndërsa *s* është individi i shënuar me Sue.

Roothi (1996) e përfaqëson vlerën e zakonshme semantike të α me $[[\alpha]]^0$ dhe vlerën semantike të fokusit të α me $[[\alpha]]^f$.

Vlerat e zakonshme semantike nuk ndikohen drejtpërdrejt nga fokusi: të dy variantet kontribuojnë në të njëjtin propozim si një vlerë e zakonshme semantike $[[\alpha]]^0$. Këtu është një rregull semantik për të deklaruar vetëm në termat e semantikës alternative:

Sipas Roothit, pra ekzistojnë disa raste, për shembull që kanë në përmbajtje pjesëzën *vetëm* (*only*) e cila, kur kombinohet me një fjali ϕ , jep pohimin $\forall p [p \in [[p]]^f \wedge \forall p \rightarrow p = [[\phi]]^0]$ dhe presupozimin p .

Sipas rregullit për vetëm të përmendur më lart, ajo që supozohet nga (4a) është se Gjoni prezantoi Bill-in me Sue-në dhe ajo që pohohet nga (4a) është se nuk ka asnjë propozim tjetër të vërtetë të formës “Gjoni prezantoi *x-në* Sue” përveç (4a) vetë, pra ai ku *x* është Bill.

Kjo do të thotë se *vetëm* ϕ presupozon që ϕ dhe pohon se ϕ është i vetmi anëtar i vërtetë i grupit alternativ të ϕ .

Një rregull tjetër që ndryshon nga ai më lart në atë që sasia është në nivelin e propozimeve: asnjë alternativë ndaj $[[\phi]]^0$ nuk është edhe e dallueshme nga $[[\phi]]^0$ dhe e vërtetë. Vlerat relevante semantike janë si më poshtë:

a. $[[\text{John prezantoi } [\text{Bill}]^F \text{ në Sue}]]^f = \text{bashkësia e propozimeve të formës "John prezantoi } x \text{ në Sue"}$

b. $[[\text{John prezantoi } [\text{Bill}]^F \text{ në Sue}]]^0 = \text{propozimi "John prezantoi Bill me Sue"}$

Rregulli semantik për *vetëm* mund të shprehet në semantikën alternative si më poshtë:

Në rastin e (a), John prezantoi *vetëm* $[\text{Bill}]^F$ te Sue, ϕ është (a), John prezantoi $[\text{Bill}]^F$ me Sue-n. Vlera e tij e zakonshme semantike, e cila është presupozimi i (a), është propozimi që Gjoni i prezantoi Bill-it Sue-së. Vlera semantike e fokusit të tij është grupi i të gjitha propozimeve ("alternative") të formës "John prezantoi x në Sue" (përfshirë propozimin që Gjoni i prezantoi Bill-it Sue).

2.4.2. Semantika alternative dhe një operator interpretimi për fokusin


Rooth (1992) zhvillon një teori të interpretimit të fokusit në termat e semantikës alternative të kufizuar, ku semantika e fokusit prezanton një kufizim të supozuar duke përdorur një operator të interpretimit të fokusit \sim . Një sintagmë fokusi (ose fjali) α ka një operator interpretimi fokusi me një ndryshore C ($\sim C$). C mund të tregojë ose individë ose grupe objektësh të të njëjtit lloj si markimi i α , të cilat janë elemente ose nëngrupe të vlerës semantike të fokusit të α (siç e kemi markuar deri më tani $[[\alpha]]^f$). C duhet të përmbajë vlerën e zakonshme semantike të α (siç e kemi markuar deri më tani $[[\alpha]]^0$) dhe të paktën një element ose nënbashkësi të C të dallueshme nga $[[\alpha]]^0$, që është elementi ose nëngrupi kontrastiv për $[[\alpha]]^0$. Rooth thekson se vlera e C -së është një entitet diskursi për të cilin C -

ja është anaforike dhe se pyetja e rëndësishme është se si ta kufizojmë atë. Kjo hap interpretimin e fokusit ndaj të gjitha llojeve të efekteve diskursive-pragmatike. Me C, Rooth i referohet një grupi propozimesh dhe me F i referohet një grupi entitetesh (individë ose grupe individësh).

Për ta shpjeguar më gjerësisht këtë lidhje ndërmjet C~F, Rooth (1992, 1996) përdor vetinë e kongruencës pyetje-përgjigje si një udhëzues për atë që mund të mungojë në teoritë thjesht semantike. Në rastin e pyetjeve dhe përgjigjeve, grupi alternativ relevant e ka bazën e tij në semantikën e pyetjeve: pyetjet përcaktojnë grupe përgjigjesh të mundshme. “Fokusi duket se evokon këtë grup alternativ në një mënyrë presupozuese, duke treguar se është i pranishëm për arsye të pavarura. ... Ndërfaqja ndërmjet konstruksioneve të ndjeshme ndaj fokusit dhe veçorisë së fokusit trajtohet [në Rooth (1992)] nga një operator i vetëm i cili prezanton një grup alternativ të supozuar:” (Rooth 1996. cit sipas Partee 2009).

Kur α është një sintagmë sintaksore dhe C është një variabël semantike e fshehtë sintaksorisht, $\alpha \sim C$ paraqet supozimin se C është një nëngrup i $[[\alpha]]^f$ që përmban $[[\alpha]]^o$ dhe të paktën një element tjetër. (Rooth 1996: 279).

Operatori “ \sim ” i përcaktuar më sipër është operatori i interpretimit të fokusit. Nuk e përcakton interpretimin e ndryshores C në mënyrë unike, por e kufizon atë. Në thelb thotë se sa herë që keni një fjali me diçka të fokusuar në të, supozohet se ka disa alternativa të rëndësishme në kontekst – ato duhet të jenë aty për një arsye të pavarur. Operatori që përcaktohet është “ \sim ” operatori i interpretimit të fokusit. Në paradigmen pyetje-përgjigje, do të kishte shtrirje mbi përgjigjen:



Ndryshorja C në diagramin më lart ose v_8 në paraqitjen e mësipërme, tregon një grup alternativ. Interpretimi i fokusit kontribuon në një kufizim në këtë variabël, megjithëse nuk e rregullon referencën e saj në mënyrë unike. Në çdo rast specifik, ndryshorja identifikohet me ndonjë objekt semantik ose pragmatik të pranishëm për një arsye të pavarur. Në paradigmen pyetje-përgjigje, paraardhësi për variablën e paraqitur nga interpretimi i fokusit mund të merret si vlera e zakonshme semantike e vetë pyetjes, duke pasur parasysh semantikën e duhur për pyetjet. Në rastin konkret, vlera e zakonshme semantike e pyetjes është një grup që përmban vetëm propozimet “Ede do çaj” dhe “Ede do kafe”. Kufizimi i paraqitur nga ~ në këtë rast është që v_8 të jetë një grup propozimesh të formës "Ede do y" që përmban “Ede do kafe” dhe diçka tjetër. Kështu, pyetja dhe përgjigja kontribuojnë në karakterizime të qëndrueshme të grupit të propozimeve v_8 . Nëse përgjigja në vend të kësaj do të kishte fokus në $[_{NP}Ede]$, interpretimi i fokusit do të diktonte një grup propozimesh të formës “x do kafe”, e cila do të ishte në kundërshtim me informacionin e dhënë nga pyetja, pasi “Ede dëshiron çaj” nuk është në formularin e kërkuar. Për ta interpretuar fokusin këtu prezantohet një ndryshore, e cila, si variablat e tjera të lira, duhet të gjejë një paraardhës ose t’i jepet një vlerë e ndërtuar në mënyrë pragmatike. Identifikimi i ndryshores me vlerën semantike të pyetjes është thjesht një çështje e zgjidhjes së anaforës. Ai supozon se fusha e kuantifikimit është një ndryshore e lirë e nënkuptuar, referenca e së cilës duhet të fiksohet sipas kontekstit.

Duke e shkruar këtë ndryshore mbi grupe propozimesh si C në shënimin vetëm (C), atëherë mund të supozojmë paraqitjen e mëposhtme, po e marrim një shembull:

John solli Tomin, Bill-in dhe Harrin në festë, por ai e prezantoi vetëm Billin_F me Sue, dhe po e paraqesim sipas Roothit:

[s[s John prezantoi vetëm (C) Billin_F me Sue] ~ C]]

Interpretimi i fokusit në nivelin e argumentit sintaksor për ndajfoljen *vetëm* kontribuon në një kufizim në C, domeni i nënkuptuar i kuantifikimit për *vetëm* Rooth (ibid.).

2.4.5. Alternativat kundrejt presupozimit ekzistencial

Në semantikën alternative të kufizuar, operatori i interpretimit të fokusit prezanton një grup alternativ të karakterizuar nga një kufizim presupozues. Mund të theksohet se kjo teori nuk e barazon semantikën e fokusit me presupozimin ekzistencial. Kjo do të thotë, në shembullin e mëposhtëm, fokusi nuk paraqet një supozim se dikush do të shkojë në darkë me shokun.

(1) John_{FocP} po shkon për darkë me shokun.

Duke supozuar se fokusi interpretohet në nivelin e klauzës, paraqitet një grup alternativash të formës "x do të shkojë në darkë me folësin". Kjo është më e dobët se një supozim ekzistencial, sepse alternativa të tilla mund të jenë relevante pa qenë domosdoshmërisht asnjëra prej tyre e vërtetë.

Në shembullin e mësipërm, në fakt është e vështirë të përcaktohet nëse semantika e dobët e prezantimit të alternativave duhet të preferohet, pasi në shumë kontekste do të përmbushej një presupozim ekzistencial. Për shembull, në kontekstin e pyetjes më poshtë, pyetësi mund të kuptohet si i mirëqenë se dikush do të darkojë me folësin.

(2) A: Kush do të darkojë me shokun?

B: John_{FocP} po shkon.

Për krahasim, merrni parasysh një përgjigje me një të çarë në vend të fokusit vetëm intonacional:

(2) Është Gjoni ai që po shkon. Fjalja e çarë është një përgjigje e përshtatshme për pyetjen e A në (1). Sipas supozimeve standarde, një çarje prezanton një presupozim ekzistencial (shih p.sh. Karttunen dhe Peters 1979). Pra, nuk do të kishte asnjë problem me supozimin se fokusi intonacional në (1) prezantoi një supozim ekzistencial, ndoshta përveç prezantimit të alternativave.

Një mënyrë standarde për të diagnostikuar praninë e presupozimit është një test projekcioni. Sipas shumicës së autorëve, presupozimi i plotësisimit të projekteve të pamundura për mjedisin global (p.sh. Karttunen dhe Peters 1979: 7). Klauza (3a) mbart një supozim që Maria është larg. Në kontekstin sintaksor (3b), ky supozim projektohet.

(3) a. Gjoni e di që Maria është larguar.

b. Nuk ka gjasa që Gjoni ta dijë që Maria është larguar.

Pasoja pragmatike është se dikush që përdor fjalinë (3b) zakonisht do të perceptohet si e mirëqenë që Maria është larguar. Kjo me të vërtetë duket e saktë; duke punuar mbrapsht, ne mund të përdorim intuitat tona në lidhje me presupozimin e fjalisë komplekse (3b) si një diagnostifikues për përcaktimin e presupozimit të (3a). Përsëri këtu Rooth supozon se ndërtimet *cleft* prezantojnë një presupozim ekzistencial. Ndërsa për ta shpjeguar ideidentifikimin e fokusit në shembullin më poshtë, ai thotë se bazohet në semantikën më të dobët të evokimit të alternativave, ku, sipas tij, ka pak punë për të bërë shpjegimin se si alternativat “x fitoi lojën e futbollit” licencohen nga konteksti i diskursit në (4). Meqenëse A bëri një pyetje të fragmentuar (të tipit po-jo) në vend të një pyetjeje-wh, nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt C-në me vlerën semantike të pyetjes. I njëjti problem lind në dialogje më të thjeshta, ku si pyetja me përgjigjet po/jo (4a) dhe pyetja-wh (4b) licencojnë një përgjigje me fokus të përshtatshëm për pyetjen-wh.

(4) a. A e fitoi dikush lojën e futbollit? – PO ose JO.

(4) b. Kush e fitoi lojën e futbollit?

c. Barcelona_{FocP} e fitoi atë.

Për qëllimet e tanishme, mjafton të vërehet se pragmatika e pyetjeve dhe përgjigjeve është e ndërlikuar, duke përfshirë gjëra të tilla si pyetjet e implikuara dhe përgjigjet tepër informuese. Një llogari e pragmatikës së alternativave të evokuara në dialogët pyetje-përgjigje do të duhet marrë parasysh këtë (Rooth 1985).

Kryesisht për të shmangur këtë përfundim, Rooth (1985) zhvilloi një semantikë “in-situ” për shoqërimin me fokusin që është etiketuar “semantikë alternative” në von

Stechow (1991). Ideja bazë është përafërsisht si vijon: Një përbërës i fokusuar prezanton një grup alternativash që, përbërja semantike moduluese, depërton (lart) në një simotër të pjesëzës së fokusit, e cila nga ana tjetër është në gjendje të marrë informacionin përkatës. Për të zbatuar këtë ide, Rooth (1985, 1992) postulon ekzistencën e një dimensionit të dytë interpretimi që llogaritet për çdo shprehje α grupin e alternativave të tij. Përveç funksionit të zakonshëm të interpretimit $[\cdot]$ ai prezanton një funksion vlerësimi rekursiv të fokusit të ndjeshëm $[\cdot]_f$ të përcaktuar si më poshtë:

$$(5) \text{ a. } [\alpha]_f = \{[\alpha]\}$$

$$\text{b. } [[[\alpha]_f]_f] = \{u \in D_\tau ; \tau = \text{lloji}(\alpha)\}$$

$$\text{c. } [[[\alpha \beta]_f]_f] = \{u; \exists a \in [\alpha]_f, \exists b \in [\beta]_f : u = a(b) \text{ ose } u = b(a)\}$$

Nëse α nuk është i fokusuar, α nuk prezanton asnjë alternativë, dhe për këtë arsye grupi i tij alternativ është thjesht grupi i vetëm elementi i të cilit është vetë α , kf. (5a). Por nëse α është i fokusuar, ai në mënyrë intuitive prezanton alternativa, dhe për këtë arsye grupi i tij alternativ është identik me të gjithë domenin që korrespondon me llojin logjik të α -së, cf. (5b), ose, përndryshe, në një nënbashkësi të kufizuar në kontekst. Së fundi, interpretimi i degëzimit binar: Kompletin alternativ që i korrespondon njëjës amë është identik me bashkësinë e të gjitha kombinimeve funksion-argument të mirëformuar me elemente të grupeve alternative të nyjeve bijë, krh. (5c). Nëse, për shembull, domeni i individëve është i kufizuar në Bill, John dhe Paul, dhe mekanika në (5) zbatohet në shembullin më poshtë, marrim grupin e alternativave të dhëna në (6) (Reich 2003:4).

$$(6) [[i \text{ prezantoi } [Bill]_f \text{ Marisë }]_f] = \{ia \text{ prezantoi Marisë Bill-in, e prezantoi Gjonin me Marinë, ia prezantoi Palin Marisë}\}$$

Pasi të kemi përcaktuar për çdo përbërës LF α grupin e alternativave të tij, hapi tjetër është që këto alternativa të jenë të disponueshme vetëm për pjesëzën e fokusit. Për këtë qëllim, Rooth (1992) supozon se një operator \sim së bashku me një ndryshore të kontekstit Γ i ngjitet me një simotër të vetëm, cf. (7b), dhe Γ i merret si i lidhur në mënyrë anaforike me variablin e kontekstit C_i , i cili, sipas supozimit, është i nënkuptuar në semantikën e vetëm.

(7) a. John prezantoi vetëm [BILL]f me Sue.

b. John [vetëm(Ci) [[prezantoi [Bill]f në Sue] ~ Γ i]]

Interpretimi i operatorit 'squiggle' ~ atëherë ka dy efekte të rëndësishme: Fokusi është i kufizuar nga përcaktimi, cf. (8b), dhe interpretimi i kufizimit kontekstual Ci kufizohet nëpërmjet koindeksimit me Γ i në një nënbashkësi të grupit të alternativave të njëjës simotër të vetëm, cf. (8c).

(8) a. [[[α [~ Γ]]]] = [α]

b. [[[α [~ Γ]]]]f = {[α]}

c. Presupozimi i [α [~ Γ]] : [Γ] \subseteq [α]f

Nëse, më në fund, jepet vetëm një semantikë përgjatë vijave të mëposhtme,

(9) $\forall x, w$: vetëm $w(C)(\alpha)(x) = 1$ nëse $\forall P \in C(Pw(x) = 1 \rightarrow P = \alpha)$,

ku nxirren kushtet e sakta të së vërtetës. Meqenëse këto mekanika nuk i referohen lëvizjes, asnjë kufizim në lëvizje nuk mund të shkelet. Si pasojë, kështu duket, supozimi se ekziston vetëm një lloj lëvizjeje, domethënë lëvizja e ndjeshme ndaj bashkësisë, mund të mbahet.

2.4.6. Përfundim: FOKUSI NË SEMANTIKËN ALTERNATIVE

Pra, qysh më 1985 Rooth propozoi që fokusi të interpretohet si një grup propozimesh alternative që përfshin kuptimin e zakonshëm dhe të paktën një propozim tjetër të ndryshëm. Rooth propozon një mënyrë kompozicionale për të shpjeguar këtë interpretim. Së pari, fokusi supozohet të prezantojë një tipar F në paraqitje në strukturën sipërfaqësore. Së dyti, kontributi i fokusit llogaritet semantikisht në LF në atë mënyrë që,

përveç kuptimit semantik të zakonshëm, të marrim edhe një kuptim alternativ. Për shembull:

(1) Genci shkoi në [Prishtinë]_{FocP}.

Kuptimi alternativ, që korrespondon me grupin e propozimeve të formës {1. Genci shkoi në Prishtinë, 2. Genci shkoi në Tiranë...} është ndërtuar me anë të rregullave të mëposhtme.

Rregullat themelore:

Kështu, semantika alternative nuk e ndan [F] fokusin dhe [T] topikën në nivel përfaqësimi. Vlera e fokusit ndërtohet drejtpërdrejt në dhjetëra alternativa semantike: Fokusi kontribuon me një grup alternativash - domethënë, grupi i propozimeve të marra (përafërsisht) duke zëvendësuar njësinë leksikore të fokusuar me një ndryshore që varion në një domen D të të njëjtit lloj si origjinali. Te studimi i Rooth-it (1992) janë paraqitur disa ndryshime. Në veçanti, propozohet që grupi alternativ që të mos jetë i gjithë grupi i propozimeve, por vetëm një nëngrup i tij:

(3) Atij i pëlqen lule [vjollca]_{FocP}

Ky shembull tregon se përcaktimi i nënbashkësisë së duhur në secilin rast është shumë i varur nga konteksti. Në veçanti, informacioni rreth diskursit të mëparshëm duket të jetë vendimtar. Duke pasur parasysh një thënie, për të përfutur nëngrupin përkatës të propozimeve alternative, duhet të ripërcaktojmë variablën e domenit, D. D është tashmë i kufizuar në një lloj të caktuar semantik, por kjo është e pamjaftueshme për të llogaritur koherencën e diskursit.

2.5. Diagnostikimi më i thjeshtë i fokusit

Shumë teste janë përdorur në nxjerrjen e konstruksioneve të fokusit dhe për të përcaktuar se çfarë lloj fokusi shpreh një strategji e caktuar gjuhësore. Ne do t'i prezantojmë disa, por së pari do të nisim me një teknikë elicitive që mund të përdoret si një heuristikë fillestare.

2.5.1. Heuristika: ngjallja e kontekstit

Duke qenë se fokusi i një fjalie varet kryesisht nga konteksti, një nga diagnostikimet më të lehta është t'u paraqitet folësve një fjali që përmban strategjinë që duhet testuar dhe të pyetet intuita e tyre se kur mund të nxirret fokusi në mënyrë më të përshtatshme.

Kjo shpesh jep një tregues të mirë të strukturës së informacionit të fjalisë, për shembull, kur folësit dalin me një pyetje të mëparshme, ose kur vijojnë klauzën e kundërt. Kjo më pas mund të përdoret si pikënisje për diagnostikimin e mëposhtëm. Një avantazh i këtij testi është se ai nuk i çon dëgjuesit në një drejtim të caktuar. Një shembull është dhënë më poshtë ku një interpretim kontrastiv dhe korrigjues shfaqet nga situatat e ofruara nga folësit dhe dëgjuesit (Jenneke 2016).

Konteksti: *Ka një problem për Andi Lilën//Një goditje që [Ø]_{TopP} ka marrë nga topi// [E]_{TopP} kanë goditur//*

Nga konteksti nënkuptohet se Andi Lila është ai që është lënduar dhe ka një problem. Ky problem që ndaloi ndeshjen ka të bëjë me lëndimin e Lilës që e mori nga goditja.

Çfarë problemi ka Lila? – E [kanë goditur]_{FocP}.

Teknikat e tjera që e nxjerrin në pah fokusin lidhen me çiftin pyetje – përgjigje, me ç'rast përgjigja është e barabartë me fokusin. Janë disa lloje pyetjesh që bëhen për ta nxjerrë fokusin. Do t'i rendisim më poshtë:

2.5.2. Pyetjet-wh

Pyetjet dhe përgjigjet e tyre janë testi më i përhapur dhe më i pranuar për fokusin, si dhe një metodë klasike për të përcaktuar madhësinë e domenit të fokusit (Dik 1997, Rooth 1992, Krifka 2007a, Lambrecht 1994, Kasimir 2005, Roberts 1996, dhe shumë të tjerë). Përgjigjet për pyetjet-wh janë metoda më e përhapur për të nxjerrë fokusin e informacionit. Megjithatë, kur studiohet sintaksa e fokusit, kjo metodë është problematike, sepse përgjigja më e natyrshme për një pyetje-wh është shpesh një përgjigje e fragmentuar që përfshin vetëm fokusin (Jenneke 2016).

Sipas Jenneke (2016), pyetjet-wh kërkojnë gjithmonë informacion të ri, ose, më formalisht, prezantojnë një variabël në propozim, për të cilën sinjalizohet mungesa e njohurive, për shembull, *Kush e nget makinën?* prezanton një grup përgjigjesh të mundshme të formës *X apo filani e nget makinën*. Jenneke (ibid. 5), duke e cituar Zimmermann dhe Onea (2011:1663) shprehet se, për sa i përket semantikës alternative, *një përbërës i fokusit X shpreh informacion të ri, nëse [kuptimi (i zakonshëm) i X] prezanton një element alternativash në terrenin e përbashkët dhe nëse alternativat ndaj [kuptimit të X] nuk kanë qenë në mënyrë eksplicite të paraqitura në diskursin paraprak*. Prandaj, nëse fokusi përkufizohet si informacioni i ri në një fjali, atëherë rrjedh se:

- a) sintagmat-wh janë të fokusuara në thelb; dhe
- b) në përgjigjen e një sintagme-wh, sintagma që e zëvendëson elementin *wh* është fokus (në kuptimin e sigurimit të informacionit që plotëson boshllëkun në informacionin e dhënë).

Në termat e Dik (1997), ky është fokusi “komplet”, pasi i jep një vlerë propozimit të lënë të hapur në pyetjen-wh përkatëse. Sipas supozimit të Lambrecht (1994: 207), fokusi është “elementi i informacionit ku presupozimi dhe pohimi ndryshojnë nga njëri-tjetri”.

Përveç testit *pyetje-wh*, Kasimir-i (2005) e zhvillon një test tjetër *pyetje-përgjigje (Q-A)*, për të cilin do të diskutojmë më poshtë.

2.5.3. Testi Q-A (Kasimir 2005)

Sipas Kasimir (2005: 12), nëse një pyetje kërkon disa X (X është një kategori sintaksore), në një përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj kësaj pyetjeje, fokusohet përbërësi që korrespondon me X.

Testi *pyetje-përgjigje (Q-A)* përdoret zakonisht në diagnostikimin e madhësisë së përbërësit të fokusit dhe për këtë arsye këto dyshe *Q-A* mund të ndihmojnë në përcaktimin se çfarë/ku është fokusi i fjalisë. Për ta ilustruar, merrni parasysh çiftet pyetje-përgjigje në tabelën më poshtë. Megjithëse përgjigja është segmentalisht dhe prozodikisht e njëjtë, me një theks të lartë në përbërësin *VETURA*, kontekstualizimi i pyetjes-wh tregon se cila pjesë është fokus: vetëm NP-ja *vetura* (fokusi i argumentit); sintagma foljore *u prish* (fokus-VP ose fokusi kallëzuesor) ose e gjithë fjalia *VETURA ime u prish* (fokusi i fjalisë). Prandaj varësisht nga ajo që do të nxjerrë marrësi po edhe të vë në pah dëgjuesi, dallojmë tri lloje fokusish që do t'i paraqesim në tabelën më poshtë:

Struktura e fokusit kallëzuesor (PREDICATE-FOCUS STRUCTURE)	
<p>What happened to your car?</p> <p>a. My car/It broke DOWN.</p>	<p>Çfarë i ndodhi veturës suaj?</p> <p>a. Vetura ime U PRISH.</p>
Struktura e fokusit të argumentit (ARGUMENT-FOCUS STRUCTURE)	

I heard your motorcycle broke down? b. MY CAR broke down.	Dëgjova se motocikleta jote u prish? b. VETURA ime u prish.
Struktura e fokusit të fjalisë (SENTENCE-FOCUS STRUCTURE)	
What happened? c. MY CAR BROKE DOWN.	Çfarë ndodhi? c. VETURA IME U PRISH.

Në shembujt e Lambrecht (ibid.) struktura e fokusit kallëzuesor shënohet nëpërmjet mënyrës prozodike, duke treguar kallëzuesin si domen të fokusit. Sidoqoftë, gjuhët përdorin gjithashtu mjete morfosintaksore për të dalluar temën nga përbërësi VP i fokusit.

Lloji i dytë i strukturës së fokusit është *fokusi i kufizuar*. Lambrecht-i, gjithashtu, i referohet atij si *fokus i argumentit* (1994). Në strukturën e ngushtë të fokusit, fusha e fokusit është e kufizuar në një përbërës të vetëm (kryefjalë, kundrinë, kallëzues). Për shembull:

Lloji i tretë i strukturës së fokusit është *fokusi i fjalisë*. Struktura e fokusit në fjali përdoret më shpesh në situata prezantuese, duke paraqitur ose një ngjarje / situatë të re ose një referencë të re, ose të dyja, si në shembujt e mëposhtëm. Për të nxjerrë fokusin e fjalisë, bëhet një pyetje nëpërmjet të cilës përgjigja nuk e jep presupozimin.

Po ashtu do t'i huazojmë disa shembuj nga testi *pyetje-përgjigje (Q-A)*, për ta sqaruar më tej llojin strukturor të fokusit:

a. (Çfarë lëngu piu djali?)

Ai piu [LËNG DARDHE] _{FocP}.

b. (Çfarë piu djali?)

Ai [PIU LËNG DARDHE] _{FocP}.

c. (Çfarë ndodhi këtu?)

[DJALI PIU LËNG DARDHE] _{FocP}.

Argumenti për a-në : Meqenëse NP “lëng dardhe” po korrespondon me atë që është kërkuar nga pyetja, atëherë nënkuptohet se pikërisht ky përbërës është markuar me FOC.

Argumenti për b-në : Meqenëse komplet VP “piu lëng dardhe” po korrespondon me atë që është kërkuar nga pyetja, atëherë nënkuptohet se pikërisht ky përbërës është markuar me FOC.

Argumenti për c-në : Meqenëse komplet fjalia “djali piu lëng dardhe” po korrespondon me atë që është kërkuar nga pyetja, atëherë nënkuptohet se pikërisht ky përbërës është markuar me FOC.

Përmes këtij testi do t'i analizojmë edhe disa shembuj nga korpusi ynë:

1. *Dy zyrtarë të Serbisë nesër me leje vizitojnë Kosovën.* (Koha Ditore, 19 prill 2018)

Varësisht nga vlera semantike e përbërësve sintaksorë në këtë fjali për lexuesin dhe varësisht nga ajo që do të nxjerrë lexuesi e formulon edhe pyetjen me të cilën e nxjerr përgjigjen, pra përbërësin sintaksor që e përmban fokusin. Për shembull:

Çfarë do të bëjnë zyrtarët serbë nesër?

- *Do ta vizitojnë Kosovën*/_{FocP}

Kur do ta vizitojnë?

- *Nesër*/_{FocP}

2. *Kukeli e kthen prapa tek Mavraj*. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Çfarë po bën Kukeli me topin?

- *E kthen prapa tek Mavraj*/_{FocP}

3. *Kendrick Lamar osht ni rep artist amerikan që tash osht në toplistë*.

(Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

Kush është Kendrick Lamar?

- *Osht ni rep artist amerikan*/_{FocP}

2.5. 4. Përgjigjet e fragmentuara

Përgjigjet kongruente lejojnë të ashtuquajturat përgjigje të shkurtra ose të fragmentuara (shih Merchant 2004; Krifka 2006). Meqenëse një përgjigje kongruente ndan të njëjtin sfond me pyetjen, nuk është e nevojshme të përsëriten këto pjesë të dhëna: elipsa e materialit të dhënë do të zbatohet natyrshëm, duke dhënë një përgjigje të fragmentuar.

Merchant (2004) argumenton se përgjigjet e fragmentuara rrjedhin nga fjalitë e plota nga pjesa e përparme e përbërësit të fokusit të fragmentuar në një projektion të dedikuar fokusi në periferinë e majtë të fjalisë dhe elipsa e përbërësit të mbetur të fjalisë në përgjigje, që korrespondon me TopP. Po e marrim një shembull:

18) A: Kujt i dha librin ajo?

B: [Gencit]_{FocP} ia dha.

Zakonisht është gjithashtu e mundur të jepet një përgjigje fragmentuar për një pyetje-wh (Merchant 2004). Për shembull, përgjigjja më e natyrshme për pyetjen: *Kujt i dha librin ajo?* do të jetë: *Gencit*, në vend që të përsëritet e gjithë fjalia: *Gencit ia dha*. Megjithëse, përgjigja e fragmentuar përfaqëson fokusin, ajo shpesh nuk hedh dritë mbi përdorimin e një strategjie gjuhësore për të koduar fokusin, sepse shumë strategji kanë nevojë për një klauzë të plotë. Edhe nëse përgjigja më e gjatë mund të mos jetë më e natyrshme, folësit kanë intuitë për përshtatshmërinë në kontekst, dhe për këtë arsye këto dyshe Q-A mund të ndihmojnë në përcaktimin se çfarë/ku është fokusi i fjalisë. *Testet Q-A* mund të përdoren në nxjerrje-për-përkthim, por edhe me ndihmën e stimujve vizualë, si në QUIS ku pjesëmarrësve u paraqiten fotografi dhe më pas u bëhet një pyetje-wh. Një mënyrë tjetër shumë produktive e mbledhjes së çifteve spontane Q-A është eksploruar nga Aria Adli, e cila shpiku një lojë ku pjesëmarrësit duhet të zbulojnë një histori detektive. Meqë kjo ndodh natyrshëm me anë të marrjes në pyetje, korpuset e tij për frëngjisht, spanjisht dhe persisht përmbajnë një mori materialesh për qëllime të strukturës së informacionit (Adli 2011, 2015).

2.5.5. Pyetjet alternative

Përveç pyetjeve-wh të hapura, ekzistojnë të ashtuquajturat “pyetje alternative” të formës: *A do Ede çaj apo kafe?* (Rooth 1996). Kjo mund të jetë gjithashtu pjesë e testeve që përfshijnë stimuj, si p.sh. fotografia QUIS e një gruaje që pret një pjepër, e shoqëruar nga një pyetje "a është një burrë apo një grua duke prerë pjeprin?". Ky lloj i veçantë pyetjesh kërkon një përzgjedhje nga një grup alternativash të dhëna. Përgjigja mund të

thuhet se shfaq *fokus selektiv* (Dik 1997). Një përbërës i fokusit X përdoret në mënyrë selektive nëse "ai fut një element të [bashkësisë alternative] në bazën e përbashkët dhe zgjidhet nga një nëngrup i kufizuar i [bashkësisë alternative], anëtarët e të cilit janë përmendur në mënyrë eksplicite në kontekstin e mëparshëm" (Zimmermann dhe Onea 2011: 1663). Fakti që alternativat janë të spikatura dhe zgjidhet njëra nga alternativat, p.sh., "Dua çaj", përjashton alternativën tjetër, "jo kafe". Mbetet një pyetje nëse ky përjashtim është domosdoshmërisht i pranishëm, duke pasur efekte të kushtëzuara të vërteta (semantikë), apo thjesht një implikacion (pragmatikë). Në fund të fundit, zgjedhja e çajit nuk do të thotë domosdoshmërisht se dikush nuk dëshiron kafe.

Do ta ilustruam përmes shembujve:

A: Do të shkojmë në Dhërmi a po në Jalë?

B: Në Dhërmi.

Për më tepër, pyetjet që kanë të njëjtën formë mund të kenë gjithashtu një interpretim të thjeshtë po/jo, në vend që të jenë alternativa. Wells (2006) dallon dy modele të ndryshme intonacioni në anglisht, ku njëra është qartësisht një pyetje alternative, ndërsa tjetra në fakt nuk ofron alternativa, por është një pyetje e thjeshtë po/jo. Për ta ilustruar, pyetja alternative ka një ngritje dhe më pas një rënie: 'A doni kafe/ose çaj\?' (d.m.th. njëren ose tjetren), ndërsa pyetja po/jo ka një ngritje të intonacionit në fund: 'A doni kafe/, apo çaj/?' (d.m.th. a doni të pini ndonjë gjë). Kjo pyetje e dytë jo-alternative mund t'i përgjigjet: "Faleminderit, ujë mineral, ju lutem".

2.6. Realizimi prozodik i fokusit

Në literaturën gjuhësisë prozodia është trajtuar si element që ka një rol kyç në kodimin e strukturës së informacionit (IS) (Selkirk 1995; Ladd 2008; Büring 2010, 2016; Féry 2008, 2010, 2013, 2016 Calhoun 2010; Lee 2013; Kügler, Calhoun 2021). Studimet që janë bërë mbi prozodinë si markere e fokusit mund të ndahet në dy qasje kryesore që

lidhen me njëra-tjetrën në shumë mënyra: 1) Linja e parë e punës fokusohet në lidhjen midis veçorive prozodike dhe statusit informativ të përbërësve në diskurs (Chafe 1976; Lambrecht 1994; Frascarelli/Hinterhölzl 2007). Qëllimi kryesor i këtyre punimeve është të përcaktojnë nëse statusi informativ i një referenti lidhet me veçori specifike prozodike, veçanërisht me praninë/mungesën e theksit. 2) Linja e dytë merret me rolin e theksit të fjalisë (i ashtuquajtur i theksi nuklear) në identifikimin e fokusit informativ (Heinz et al. 2018).

Në të dyja qasjet e mbi studimin e prozodisë në raport me fokusin mjeti prozodik më i studiuar për ta markuar fokusin është prania e theksit (bërthamor). Pasi supozohet se fjala e fokusuar në një thënie është më e spikatura prozodikisht (p.sh. Selkirk 1995; Ladd 2008; Büring 2010, 2016; Calhoun 2010).

Fonologjikisht, një fjalë është më e spikatura në një thënie sepse rrokja e saj kryesore e theksuar është koka e sintagmës më të madhe prozodike ku bën pjesë (zakonisht sintagma intonacionale, ι) (Ladd 2008). Koka e sintagmës ι bart një theks bërthamor. Nëse një sintagmë ι zgjedhet si fokusi i një fjalie S, theksi më i lartë në S do të jetë në rrokjen (ose morën, si në rastin e shqipes) e sintagmës ι . Ky theks bazuar në prominencë sinjalizohet nga sinjalet fonetike dhe fonologjike të cilat e rrisin prominencën e një fjale në lidhje me të tjerat në thënie. Sinjalet fonetike përfshijnë frekuencë më të lartë themelore (f_0), lëvizje më të madhe f_0 , zgjatje, intensitet të shtuar dhe anim më të lartë spektral në fjalë. Nga këto, shenjat f_0 në raport me fokusin janë më të studiuarat dhe janë të rëndësishëm nga ana perceptuese (Kügler, Calhoun 2020).

Prandaj, meqë theksi na qenka një veçori prozodike që ndërvepron drejtpërdrejt me domenet e fokusit, atëherë siç propozon edhe Samek-Lodovici (2005) për çdo XP_{Foc} dhe YP në domenin e fokusit të XP_{Foc} , XP_{Foc} është prozodikisht më e spikatur se YP.

Për ta shpjeguar më tej se si theksi e markon fokusin, Selkirk (1995): – propozon një rregull bazë fokusimi e cila thotë se: “Një fjalë e theksuar është e markuar me F(ocus)”. Më pas Selkirk propozon tre rregullat e mëposhtme të “Projeksionit të Fokusit”:

- a. Markimi-F i kokës së një sintagme fonologjike licencon markimin-F të sintagmës.
- b. Markimi-F i një argumenti të brendshëm të një koke licencon markimin-F të kokës.
- c. Markimi-F i një gjurme të mëparshme të lënë nga NP- ose wh-lëvizja licencon markimin-F të gjurmës (trace).

Për ta analizuar këtë që e ka thënë Selkirk (1995), po e marrim një shembull:

Vajza bleu ushqim_{Foc}[për]_F [qentë]_F]_{FOC}.

Markimi-F i parafjalës *për* licencon markimin-F të sintagmës parafjalore, e kështu me radhë. Markimi-F i kundrinës së drejtë *ushqim* e licencon markimin-F të foljes dhe kështu të të sintagmës foljore. Kjo teori e projeksionit të fokusit hipotezon se markimi-F i fokusit të një fjalie licenohet nga një zinxhir përbërësish të markuar me F në fundin e të cilit është fjala që mban theksin.

Nga këto kuptojmë se nëse një folje ose një kundrinë është e theksuar, atëherë projeksioni i fokusit licencon interpretimin e komplet VP-së si fokus. Sipas Rregullës Themelore të Fokusit, theksi në folje do të thotë që folja është e markuar me F(ocus). Sipas rregullës (a), pasi folja markohet me F(ocus), pra e fiton statutin e fokusit, licenohet edhe e tërë VP-ja të hyjë brenda domenit të fokusit. Rregulla (b) siguron që markimi F i kundrinës të licenjojë markimin-F të foljes, e cila, nga ana tjetër, sipas (a), licencon shenjën F të VP. Shenja F e VP, sipas Selkirk, licencon shënimin F të gjithë fjalisë nëpërmjet licencimit të kokave të ndryshme ndërhyrëse. Megjithatë, nëse tema është e theksuar, projeksioni i fokusit në elemente të tjerë të fjalisë bllokohet sepse tema është një argument i jashtëm dhe as (a) as (b) nuk e licencojnë projeksionin nga argumentet e jashtme. Rregulla (c) synon të shpjegojë pse fokusohet projeksioni që përmban kryefjalë.

Kështu, teoria e Selkirk (1986) për fokusin e bazuar në sintaksë supozon se një projeksion maksimal përafrohet me një sintagmë fonologjike dhe një fjali përafrohet me një sintagmë intonacioni.

Megjithëkëtë, e gjithë puna e bërë nga Selkirk (1995) u kritikua sepse barazoi gjithmonë një përbërës sintaksor me një përbërës prozodik si dhe ai nuk arriti të shpjegojë si ndikon theksi brenda një përbërësi sintaksor, si depërton fokusi nga një përbërës sintaksor në një tjetër përbërës sintaksor, ose si ngushtohet fokusi brenda një përbërësi sintaksor. Me një fjalë, nuk arriti t'i shpjegojë si ndërveprojnë edhe fushat e tjera në realizimin prozodik të fokusit.

Autorë të tillë, si: Truckenbrodt (1999); Samek-Lodovici (2005, 2006), Fery (2013); Lee (2013) procesi i realizimit të fokusit ndodh për shkak të ndërveprimeve midis strukturës prozodike, strukturës sintaksore, theksit dhe strukturës së informacionit. Andaj, sipas tyre ky realizim i fokusit mund të shpjegohet nëpërmjet tre kufizimeve: Align XP, Ërap-XP, Stress-XP që kanë lindur nga Teoria e Optimalitetit.

2.6.1. Rreshtimi (Alignment-Align XP)

Fokusi përgjithësisht priret të markohet duke u rreshtuar në mënyrë prozodike me skajin e djathtë ose të majtë të një domeni prozodik. Në rreshtimin e një përbërësi të fokusuar dhe një përbërësi prozodik, përfshihet edhe morfo-sintaksa, pasi skajet e përbërësve prozodikë shpesh bien në të njëjtën pikë me skajet e përbërësve sintaksorë (Fery 2013). Rreshtimi (Alignment) nënkuptohet si korrespondencë midis skajit të një përbërësi sintaksor dhe/ose fonologjik dhe pjesës së fokusuar të fjalisë. Në parim, siç u tha më lart të gjitha gjuhët priren të rreshtojnë fokusin në njërin skaj të një sintagme- τ . Më poshtë i kemi dy mënyrat që sipas, Fery (2013), përmes të cilave markohet fokusi nëpërmjet rreshtimit:

a. ALIGN-FOCUS R, τ -PHRASE R >> ALIGN-FOCUS R, ϕ -PHRASE R

b. ALIGN-FOCUS L, τ -PHRASE L >> ALIGN-FOCUS L, ϕ -PHRASE L

Por një grup gjuhësh, si: anglishtja, italishtja, por edhe shqipja priren ta rreshtojnë fokusin me skajin e djathtë të një τ -frazë. Siç propozon edhe Samek-Lodovici (2005) që një përbërës i fokusuar gjendet në skajin e djathtë të një sintagme intonacionale si pasojë e një kufizimi STRESS-FOCUS, meqenëse në gjuhët që kanë rend kanonik SVO (me theks

fundor) theksi është caktuar në skajin e djathtë të një fraze ι , dhe fokusi është rreshtuar në mënyrë që t'jheksi të bie në fokus. Si në rastin më poshtë:

(x) I	Konteksti: Çfarë ka bërë Drini?
(x) P	
Drini [ka notuar] _{FocP}	

Për t'iu përgjigjur pyetjes më lart “Çfarë ka bërë Drini?”, fokusi prek një përbërës të vetëm në përgjigje, përkatësisht atë që korrespondon me pyetjen të gjithë, pra komplet VP-në e përgjigjes përkatëse “ka notuar”. Kjo VP meqë tani e ka statutin e fokusit rreshtohet krejt djathtas, për t'iu përshtatur me theksin. Pasi kufizimi SF penalizon ata konkurrentë që nuk arrijnë të theksojnë fokusin. Pra, fokusi krejt djathtas ndodh sepse theksi kryesor supozohet të shtyhet më djathtas nga kufizimet prozodike dhe kjo nga ana tjetër e tërheq fokusin më së miri për ta plotësuar kufizimin e fokusit STRESS-FOCUS.

Por në disa gjuhë sikur edhe në gjuhën shqipe jo gjithmonë fokusi rreshtohet djathtas për shkak të disa kufizimeve sintaksore dhe prozodike që mund ta bllokojnë. Sipas Samek-Lodovici (2005:704) ka raste kur fokusi nuk mund të rreshtohet në mënyrë të përsosur për arsye sintaksore. Pra, fokusi nuk mund gjithmonë t'i paraprijë përbërësve të zhvendosur djathtas. Po e marrim një shembull në gjuhën shqipe:

//Edhe brenda ktij repi në Kosov ka [BËRLLLOG]_{Foc} artistik//

Në këtë shembull brenda domenit të fokusit futet vetëm NP-ja, ajo nuk është rreshtuar krejt në të djathtë të skajit të përbërësve sintaksorë. Kjo ndodh se nuk e lejon rregull sintaksore në gjuhën shqipe në këtë rast një SM nuk mund të jetë para një SE-je,

pasi fjalia del si jogramatikore. Siç shihet në këtë rast shkilet kufizimi Align Foc, R, por edhe një tjetër kufizim Wrap-XP, për të cilin do të flasim më poshtë.

2.6.2. Kufizimi WRAP-XP

Kufizimi Align XP ndërvepron në mënyrë thelbësore me një kufizim tjetër, që quhet WRAP-XP (Truckenbrodt 1999). Ky kufizim kërkon që:

Çdo XP të mbulohet me një sintagmë fonologjike (ϕ).

Duke ndërvepruar me kufizimin e rreshtimit (alignment), WRAP-XP bie në konflikt me disa (megjithëse jo të gjithë) nga kufijtë e kërkuar nga ALIGN XP, R. Më poshtë tregohen disa nga konfigurimet katërsintaksore të përbërësve sintaksorë që na paraqet (Truckenbrodt 1999: 229), të cilat nxirren nga rreshtimi ALIGN-XP, R, por që e shkelin kufizimin WRAP-XP:

Reaction of WRAP-XP to structures derived by ALIGN-XP,R

- | | |
|---|--|
| a. * () _P () _P
[XP ₂ X ₁] _{XP₁} | b. ✓ () _P
[X ₁ XP ₂] _{XP₁} |
| c. * () _P () _P
[X ₁ XP ₂ XP ₃] _{XP₁} | d. ✓ () _P () _P
[XP ₁ Fct XP ₂] _{FctP} |

Strukturat e përbërësve sintaksorë majtas në (a,c) e shkelin kufirin e WRAP-XP-it. Në strukturën nën a. kufiri i vendosur në të djathtë të XP₂ favorizohet nga ALIGN-XP,R, por jo nga Wrap-XP, pasi ky kufizim nuk i mbulon dy përbërës sintaksorë që kanë raporte varësie në dy përbërës fonologjikë (ϕ). Ndërsa nën (c) ALIGN XP,R favorizon kufirin e brendshëm ϕ pas komplementit të parë. Megjithatë, sintagma që rezulton në dy sintagma ϕ të veçanta bie ndesh me WRAP-XP, pasi projektioni më i madh XP₁ nuk është i mbështjellë/mbuluar me një sintagmë ϕ në këtë strukturë.

Një strukturë simetrike djathtas si në (b,) nuk çon në këtë konflikt midis ALIGN-XP,R dhe WRAP-XP. Këtu një sintagmë ϕ e vetme lejon që koka dhe komplementi vijues që të dyja XP1 dhe XP2 të jenë të lidhura djathtas me një sintagmë ϕ , ndërsa XP1 mbulohet në një sintagmë të vetme ϕ dhe XP2 mbulohet në një sintagmë të vetme ϕ .

Për ta shpjeguar shkeljen e kufizimit të Wrap-XP-it në gjuhë shqipe, po e marrim një shembull:

E [preu]_{FOCP} mollën me thikë.

Kjo strukturë gramatikore i përngjan rastit të dhënë nën (c), sipas të cilit V si projekcion kryesor nuk lejohet të hyjë brenda kufijve të së njëjtës sintagmë fonologjike me komplementët e saj.

2.7. Realizimi prozodik i fokusit në gjuhën shqipe

Mjetet prozodike janë trajtuar si elemente kryesore për markimin e fokusit nëpër gjuhë të ndryshme. Ndër to, theksi supozohet të ketë rol kyç në realizimin e fokusit. Studiuesit, si Selkirk (1995) supozon se realizimi i fokusit bëhet kur theksi ndërvepron me përbërësit sintaksorë dhe fonologjikë. Por studiues të tillë, si: Truckenbrodt (1999); Samek-Lodovici (2005, 2006), Fery (2013); Lee (2013) nuk pajtohen me hipotezën e tij, sepse, sipas tyre, fokusi realizohet me anë të ndërveprimeve midis strukturës prozodike, strukturës sintaksore, theksit dhe strukturës së informacionit. Sipas tyre, ky realizim i fokusit mund të shpjegohet nëpërmjet tre kufizimeve: Align XP, Wrap-XP, Stress-Focus që kanë lindur nga Teoria e Optimalitetit. Andaj, për ta hulumtuar realizimin prozodik të fokusit në gjuhën shqipe do të mbështetemi në këto nocione të kufizimeve për të parë ndërveprimet e domeneve të ndryshme gjuhësore në realizimin e fokusit **informativ** dhe **emfatik** përmes theksit në korpusin tonë, që e përbëjnë: Komentimi i ndeshjes **Shqipëri – Serbi (2014)** edhe emisioni **Pressing**.

2.7.1. Metodologjia e analizës


Për të parë se si po realizohet fokusi prozodikisht përmes theksit në gjuhë shqipe do të analizojmë edhe bashkëveprimin e tre kufizimeve kryesore: Align-XP, Wrap-XP, Stress-Focus, të cilat e shpjegojnë edhe bashkëveprimin e domeneve të ndryshme gjuhësore. Ne do t'i hetojmë rastet ku shkilen këto kufizime, prandaj edhe shembujt e marrë kryesisht i përkasin fjalive me renditje jokanonike të cilat së pari identifikohen fjalët që e marrin theksin. Theksi në gjuhën shqipe bie në morën e parafundit, jo në rrokje (Rugova 2019). Pastaj, identifikohet fokusi informativ, i cili analizohet në tri pozita sintaksore, si dhe fokusi emfatik i cili mund të realizohet në pozita e në përbërës të ndryshëm.

2.7.2. Analiza (Shembujt e marrë nga emisioni *Pressing*)

1. S1: // [Flitet]_{FOC} për nxitje t urrejtjes //

Tab.2

1. fronting focus	Align XP, R	WRAP-XP	Align-Foc, R
(x) I	✓	*	*
(x _) P			
[Vf [vp t [PP] GP]]			



Siç po shihet në Tab.2 kufizimi WRAP-XP po shkilet në këtë mostër, për shkak të strukturës sintaksore që ka shqipja, brenda një sintagme VP i kemi dy sintagma PP dhe GP njëra si komplement i V e tjetra (GP) si përcaktor i komplementit. Kjo strukturë V [PP] GP] VP përputhet me konfigurimin sintaksor (X₁ XP₂ XP₃) me të cilin, sipas Truckenbrodt (1999), është në konflikt kufizimi Wrap-XP, pasi kufizimi Align XP, R nuk kërkon kufij prozodikë të brendshëm të një projekcioni leksikor. Një mospërputhje midis domeneve të tyre llogaritet duke lejuar që ALIGN-XP, R dhe WRAP-XP të nxjerrin së bashku një strukture rekursive prozodike, duke e frazuar nga [V [PP GP]VP si ((V)P NP)GP). Një tjetër kufizim që ndikon këtu është edhe Stress-XP i cili i jep forcë V të ndahet intonacionalisht nga komplementi.

2. S2: //Ato pamje i shohin [t rit]_{FOC} //

Tab.3

1. focus in-situ	Align XP, R	WRAP XP	Align-Foc, R
(x) I	✓	✓	✓
(x) P			
[DP V [vp t [GPf]]			

Fig. 3




Në shembullin e dhënë e shohim fokusin në pozitën in-situ, që është pozita kanonike e tij. Kur fokusi realizohet në pozitën kanonike të tij (in-situ), të gjitha kufizimet e kërkuara plotësohen. Kufizmi Aling-XP XP kërkon që një sintagmë ϕ të tillë që skaji i djathtë i XP-së të përkojë me skajin e djathtë të sintagmës ϕ . Poashtu, kufizimi Wrap-XP plotësohet sepse secili përbërës sintaksor mbulohet me një sintagmë prozodike, poashtu Align Foc R, i cili kërkon që përbërësi i fokusar $[të\ ritë]_{FOC}$ të rreshtohet krejt në të djathtë të fjalisë, aty ku është edhe pozita kanonike e theksit. Kjo dukuri edhe e përmbush atë që e thotë Samek-Lodovici (2005), sipas të cilit, meqenëse thekesi është caktuar në skajin e djathtë të një fjalie, fokusi është i rreshtuar në atë mënyrë që theksi të bjerë në fokus.

3. S4: //Rastisht ma dërgoi videon [një mik]_{FOC} //

Tab.4

1. right-dislocated focus	Align XP, R	WRAP XP	Align-Foc, R
(x) I	✓	✓	✓
(x) P			
[Adv _{CL} V[vp t DP] [DP _f]]			

Fig. 4



Në shembullin e tretë, S [*një mik*] ik nga pozita e saj in-situ, për ta nxënë pozitën brenda domenit të fokusit, pasi nga të gjitha XP-të aty, DP-ja e fundit e bart informacionin e ri. Për shkak të realizimit të kësaj S si fokus në pozitë postverbale, përfitohet ky konfigurim variacional VOS. E kemi këtë renditje vetëm e vetëm që të mos shkilet kufizimi Align Foc, R. Nëse e shikojmë strukturën përbërëse të kësaj fjalie mund të supozojmë që shkilet kufizimi Wrap-XP, meqë ndeshen dy DP pranë njëra-tjetrës. Por, kur analizohen mirë lidhjet ndërmjet përbërësve vërejmë që DP-të kanë funksione të ndryshme dhe role të ndryshme theta (θ -role). Prandaj, secila prej tyre realizohet më vete si sintagmë ϕ .

2.7.3. Fokusi special apo emfatik


Fokusi special/i veçantë apo emfatik e refuzon pozitën kanonike të fokusit normal dhe mund të shfaqet në pozita të paparashikueshme, pasi është idiosinkratik dhe i qëllimshëm, d.m.th., realizohet në varësi të qëllimeve specifike të folësit që mund të mos jenë të parashikueshme nga konteksti. Prandaj, në domenin e fokusit mund të realizohet çdo përbërës sintaksor a morfologjik, varësisht nga situatë në të cilën gjendet folësi. Fokusi special shquhet për **theks emfatik**. Ky theks karakterizohet nga ngritja e tonit themelor të zanores (Rugova 2019).

1. *Kjo është goditja// që i jepet me parakrah dhe për më tepër [përpara]_{FOC} syve t Atkinson//*

Tab.5

1. emphatic focus	Aling XP, R	Align-Foc, R	WRAP-XP
(x) I	✓	*	*
(– x) P			
Pro cl V [vp t PP [PP _f GP]]			

Fig. 5




Siç po e shohim në këtë shembull përbërësi i fokusuar është një parafjalë (përpara) që është koka e sintagmës parafjalore. Edhe pse parafjala bashkë me NP llogariten si një njësi sintaksore, folësi e fokuson vetëm parafjalën e cila në këtë kontekst nuk është kokë leksikore, prandaj edhe shkilet kufizimi Wrap-XP, i cili kërkon që çdo kokë leksikore të mbulohet me një sintagmë ϕ . Po ashtu shkilet edhe kufizimi Align-Foc R, meqë një kufizim tjetër Stress-XP i jep forcë fokusit të realizohet në pozitën jokanonike, pra aty ku vendos folësi.

2. //Ka goditur [jashtëë] _{Foc} //

1. emphatic focus	Align XP, R	ËRAP- XP	Align-Foc, R
(x) I	✓	*	✓
(_ x) P			
Pro V [vp t [adv]			

Tab.6

Fig. 6



Në tabelën më lart e shohim se ndajfolja është ajo që e bart theksin emfatik. Pra, për shkak të këtij theksi ajo nuk realizohet bashkë me VP-në në një sintagmë ϕ . Edhe pse ndajfolja pritët të shkojë bashkë me VP-në, këtë nuk e lejon kufizimi Stress-XP i cili me forcë e ndan ndajfoljen nga VP-ja sepse do ta theksojë atë. Kufizimi Stress-XP e shkel edhe kufizimin Wrap-XP të cilin nuk e lejon ta mbulojë ndajfoljen dhe VP-në brenda një sintagme prozodike. Edhe semantikisht mund të shpjegohet pse kjo ndajfole e bart theksin emfatik, e me këtë tregon që goditja ka shkuar huq, pra nuk ka gol se topi ka dalë jashtë.


3. //Kukeli e kthen [praapa]_{FOC} tek Mavraj//

Tab.7

1. emphatic focus	Align XP, R	Align-Foc, R	WRAP-XP
(x)I	✓	*	*

(_ x)P			
S V [vp t [adv] [PP]			

Fig. 7



Si shembullin paraprak edhe në këtë rast ndajfolja është ajo që e bart theksin emfatik. Pra, për shkak të këtij theksi ajo nuk realizohet bashkë me VP-në në një sintagmë ϕ . Kufizimi Stress-XP është në konflikt me Wrap-XP dhe nuk e lejon ta fusë brenda një sintagme prozodike bashkë me foljen sepse forca e Stress-XP-së do që ndajfolja ta bart informacionin e ri. Kushti që fokusi të theksohet kërkon që përbërësi i fokusuar dhe theksi kryesor të përputhen me njëri-tjetrin, duke e detyruar njërin ose tjetrin të braktisë pozicionin e tyre kanonik.

2.7.4. Përfundimi


Analiza e mësipërme tregon se si domenet e fokusit, fushat prozodike, theksi i fjalisë dhe sintaksa ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Për shembull, ne pamë që, kur rendi i fjalisë është rend kanonik, fokusi shfaqet në pozitën *in-situ*, që është pozita kanonike e tij. Në këtë rast, fokusi krejt djathtas realizohet sepse theksi kryesor supozohet të shtyhet më djathtas nga kufizimet prozodike dhe kjo nga ana tjetër e tërheq fokusin më së miri për ta plotësuar kufizimin e fokusit STRESS-FOCUS. Po edhe në një konfigurim variacional të rendit të fjalëve në fjali (VOS) fokusi realizohet në pozitën e vet kanonike, pasi kryefjala (S) [NP/DP] ik nga pozita e saj *in-situ*, për ta nxënë pozitën brenda domenit të fokusit. Ndërsa, kur fokusi nuk realizohet në pozitën e tij kanonike, na hyn në punë një tjetër kufizim, Stress-XP, i cili i jep forcë XP-së që të ndahet intonacionalisht nga komplementi i saj, dhe kështu të hyjë fare vetëm në domenin e fokusit.

Ndërkaq, kur kemi të bëjmë me një fokus emfatik shpeshherë kufizimi Stress-XP bie në konflikt me Wrap-XP dhe nuk e lejon ta fusë brenda një sintagme ϕ XP-në edhe komplementin e saj, sepse forca e Stress-XP-së do që vetëm njëra ta bartë atë që përçon emocionin.

Sa i përket realizimit të fokusit në pozitën *ex-situ* në gjuhën shqipe, mendojmë që një rol të veçantë e luan edhe theksi emfatik që është tipik për ndeshjen e futbollit (pjesë e korpusit tonë), siç mund ta shihni në tabelën më poshtë, gjatë komentimit e ndeshjes së futbollit, fokusi realizohet në pozitën *ex-situ* diku rreth 90%, pasi ngjarjet që zhvillohen gjatë lojës janë të paparashikueshme dhe rrethanat ndryshojnë nga momenti në moment, prandaj komentatori nën trysinë e ngjarjeve përmes theksit emfatik e zhvendos fokusin në varësi të qëllimeve specifike që ai ka për të vënë në pah atë që do ai dhe që i konsideron si më të rëndësishme.

Statistikat e nxjerra për realizimin e fokusit në pozitën *ex-itu* në korpusin tonë mund t'i shohim në tabelën më poshtë:

Realizimi i fokusit në pozitën ex-situ që markohet përmes theksit



■ Emisioni "Pressing"

■ Ndeshja e futbollit Serbi- Shqipëri


2.8. Vetitë sintaksore të fokusit

Fokusi, periferia majtas dhe faza CP

Për ta analizuar pozitën e fokusit brenda fjalisë, do të miratohet një kornizë hartografike (Rizzi 1997, 2004; Cinque 1999, 2002; Rizzi & Cinque 2008). Në këtë kornizë supozohet se çdo CP duhet të ndahet në shtresa të ndryshme që konsistojnë në koka funksionale të dallueshme dhe të renditura dhe në projeksionet e tyre. Sipas këtij modeli, domeni CP mbyllet lart nga koka e ForceP dhe poshtë nga koka e FinP. Këtë, që u tha, Rizzi (1997) e ilustron si më poshtë:

ForcePTopP*..... FocPTopP*.....FinP

Përderisa ForceP kodon tiparet përgjegjëse për llojin e fjalisë, shpreh forcën ilokucionale të fjalisë (p.sh. deklarative, pyetëse, thirrmore), FinP përfshin vetitë flektive të domenit IP, kodon ato specifika që lidhen me mënyrat e të fjalisë. Midis këtyre kufijve, Rizzi vendos një sistem kokash të dedikuara për të shprehur vetitë specifike të fushëveprimit-diskursit, d.m.th., kokat e topikës dhe okusit.




Siç shihet në diagramin më lart, kokat e projeksioneve TopP dhe FocP janë pjesë e një zone të shtresuar të CP-së të emërtuar *periferia e majtë* e klauzës në të cilën gjenden elemente të lidhur me diskursin (shih Rizzi 1997).

Veçoritë e fushës së diskursit të koduara në këto pozicione të dedikuara rregullohen nga Kriteret (Rizzi 1997 dhe 2004b). Kriteret janë një klasë e veçantë e parimeve të cilat kërkojnë marrëveshje spec-kokë në lidhje me veçoritë e klasës përkatëse (ëh, top, foc... për pyetje, Tema, Fokus...). Një kokë funksionale e pajisur me një veçori të caktuar të fushëveprimit-diskurs, duke vepruar si sondë kriteri, tërheq një frazë që mban të njëjtin tipar (qëllim kritik) në specifikuesin e saj. Marrëveshja lokale e specifikave të kokës plotëson Kriterin përkatës. Si përafrim i parë, formati i Krieteve përcaktohet si në (2).

(2) Kriteri F

XPF dhe ZF duhet të jenë në një konfigurim të kokës së specifikave, për F=Q, Top, Foc e kështu me radhë... – formulimi nga Rizzi (2004c), më pas i ripërcaktuar në Rizzi & Shlonsky (2004) –

Për shembull, një element i strehuar në specifikuesin e kokës së Focus-it interpretohet si përbërës i fokusuar, ndërsa komplementi i saj interpretohet si presupozim. Duke pasur parasysh konfigurimin Spec - head - complement koka e projeksonit funksional FocP është një kokë Foc, një frazë e përqendruar është në pozicionin Spec dhe parasupozimi (d.m.th. ajo që është e vjetër/presupozuar në klauzolën pas frazës së përqendruar). Po e shohim më poshtë projeksonin e sintagmës së fokusit:



ZP= fokus

WP= presupozim

2.8.1. Pozicionet e fokusit në fjali

Fokusi mund të realizohet në pozicione të ndryshme sintaksore, domethënë **në in-situ (1a)** ose **ex-situ (1b)**. Tradicionalisht, siç kemi thënë pozicioni fundor në fjali (10a) konsiderohet të jetë i lidhur me një import informativ dhe mund të përkojë me përgjigjen e një pyetjeje-wh.

1a. S2: //Ato pamje i shohin [t rit]_{Foc} //

1b. S1: // [Flitet]_{Foc} për nxitje t urrejtjes //

Fokusi **in-situ** është një strategji fokusimi, e cila vë në pah një element, pa e ndryshuar vendin ose pozicionin e tij në një fjali.


Fokusi **ex-situ** në gjuhën shqipe është një strategji fokusimi që vendos rëndësinë e një elementi duke ndryshuar vendin ose pozicionin e tij in-situ në një fjali dhe duke e

vendosur përbërësin e fokusit të lëvizë nga pozita e zakonshme në pozitën *ex-situ* (1b) për disa arsye, sintaksore dhe fonetike. Sa u përket lëvizjeve sintaksore të fokusit, dallojmë dy lloje, si: *cleft* dhe *fronting*. Fokusi *ex-situ* jo vetëm që shpreh informacion të ri, por ka një vlerë kontrastive (Rochemont 1986), e cila identifikon në mënyrë shteruese përmbajtjen e tij referuese. Me fokus *ex-situ* kuptohet elementi që është në fokus e që zhvendoset në periferinë e majtë të fjalisë ku i gjithë përbërësi ndiqet nga një markues fokusi, siç është theksi në gjuhën shqipe.

2.8.2.Ndërtimet *cleft*

Ndërtimet *cleft* shprehin një ndarje strukturore të informacionit, zakonisht një ndarje të topikës dhe fokusit, të asaj që është në mënyrë të një predikimi të vetëm, duke realizuar sfondin/topikën dhe pjesën e fokusit të atij predikimi si dy klauza të ndryshme. Zakonisht, fokusi realizohet në një klauzë kryesore, ndërsa sfondi/topika në një klauzë relative të nënrenditur, dhe ndërtimi shpreh fokus identifikues, ose korrektiv.

Diagrami i *cleft* fokusit




I ashtuquajturi ndërtimi *cleft* në shqip (1) ka të njëjtin funksion të shprehjes së fokusit identifikues. Megjithatë, paraqitja e këtij kleftri, pra analiza e tij dyklasëshe është shumë e debatuar. Për një gjë, ndërtimi nuk përfshin asnjë klauzë relative në kuptimin standard. Përemri dëftor *ky/ai* pasohet nga ajo që në mënyrë sipërfaqësore është një fjali kryesore e plotë, ku përbërësi i fokusuar shpesh përballet dhe ndjek menjëherë përemrin

dëftor (por edhe kjo nuk kërkohet në përgjithësi kur mungon ky përemër). Po marrim shembuj:

2. *Është ai lojtari i vetëm shqiptar që mori pjesë në ngjarjen më të madhe të hendbollit. (Gazeta Koha)*
3. *Është ky kampionati i parë për mua dhe për Belgjikën, (Gazeta Koha)*
4. *Ishte për këtë e gjitha kjo.*


Në shembujt më lart aspektin, pozicioni i fokusit i përdorur është ex-situ, por në dy rastet e para brenda domenit të fokusit shtrihet një kryefjalë, ndërsa në rastin e tretë shtrihet një kundrinë. Më poshtë do të do t'i analizojmë *cleft*-kryefjalën dhe *cleft*-kundrinën.

Në mënyrë koherente me udhëzimet hartografike, në informacionin e ri *cleft*-kryefjala, e ilustruar në shembujt më lart, kryefjala mund të interpretohet në të njëjtin pozicion si informacion i ri e në pozitën postverbale në një gjuhë me rend fleksibël si shqipja. Prandaj, ky përbërës *cleft* synon pozicionin e fokusit periferik djathtas. Këtë propozimi të përgjithshëm do ta nxjerrim skematikisht në (1a);



Supozimi këtu është se pozicioni i subjektit dhe pozicioni i fokusit vP-periferik llogariten si pozicione të të njëjtit lloj nga parimi RM/lokalitet, prandaj subjekti llogaritet si një ndërhyrës në këtë rast:

Ndërkaq, në *kundrinat-cleft*/jo-kryefjalë, përbërësi *cleft* synon pozicionin e fokusit periferik në të majtë në komplementin e kopulës. Për shembull:



Lëvizja e objektit nga pozicioni i tij brenda kallëzuesit FinP në pozicionin Spec/Pred në klauzën CP-small do të kalonte mbi subjektin, duke shkaktuar një shkelje të drejtpërdrejtë të RM, nën supozimin se të dy pozicionet përkatëse - subjekti dhe pozicioni Spec/Pred-llogaritet si pozicione të të njëjtit lloj në lidhje me parimin.

Kështu, për shkak se pozicioni Spec/Pred në CP nuk mund të synohet nga objekti, objekti nuk mund të lëvizë në pozicionin e fokusit periferik vP në klauzën e matricës, dhe për rrjedhojë një *cleft-kundrinë* nuk mund të interpretohet si fokusi i informacionit të ri.

Kjo është arsyeja pse një *cleft-kundrinë* nuk mund të funksionojë si një përgjigje e mundshme për një pyetje të pastër informacioni. Për më tepër, lëvizja e drejtpërdrejtë e objektit në matricën vP-Fokus periferik përjashtohet gjithashtu për arsye lokaliteti. Supozimi këtu është se pozicioni i subjektit dhe pozicioni i fokusit vP-periferik llogariten si pozicione të të njëjtit lloj nga parimi RM/lokalitet, prandaj subjekti llogaritet si një ndërhyrës në këtë rast.

2.8.3. Pozicioni *fronting* (ballor) i fokusit

Kemi thënë që fokusi ndërlinguistikisht është i lidhur me një sërë strategjish të ndryshme sintaksore, të tilla, si: *frontingu*, *klefti*; si dhe markues të tjerë morfologjikë dhe prozodikë. Në disa raste, zgjedhja ndërmjet një strategjie ose tjetrës përcaktohet nga rregulla specifike të gjuhës, ndërsa në të tjera, dy ose më shumë strategji duken të jenë fakultative, dhe kështu, disi “të paidentifikueshme”. Në këtë studim eksperimental, ne hetojmë strategjitë sintaksore të përdorura në fokusimin e kundrinave në gjuhën shqipe, duke shqyrtuar veçoritë sintaksore, semantike dhe pragmatike që qëndrojnë në themel të zgjedhjes së një strategjie specifike sintaksore siç është *frontingu*.

Në veçanti, eksperimenti aktual synon të hetojë strategji të përdorura në gjuhën shqipe për realizimin e fokusimit të kundrinës në pozicionin nistor të fjalisë, përkatësisht fokusit fronting, në mënyrë që të verifikohet nëse përzgjedhja e pozicionit ndërmjet tyre ndikohet nga një lloj specifik tipari, një kombinim i veçorive të lidhura me fokusin, siç mund të jetë kategoria e foljes së përfshirë ose ndërveprimi midis disa faktorëve të tjerë.

Duke punuar brenda qasjes hartografike të Minimalizmit (krh. Cinque dhe Rizzi 2008), ne supozojmë se vetitë ligjëruese-semantike janë të lidhura me tipare formale, të bashkuara në projeksione funksionale të dedikuara në domenin C (Adger dhe Svenonius 2011) dhe se një lidhje sistematike ekziston midis vetive formale (sintaksë-prozodi) dhe semantike të kategorive të lidhura me ligjërimin (krh. Frascarelli 2007, 2018; Cinque dhe Rizzi 2008).

2.8.4 Strategjitë e fokusit ballor në gjuhën shqipe


Në këtë seksion, ne paraqesim strategjitë e ndryshme morfosintaksore të fokusit në pozicionin fronting të aplikuara në shqip. Kjo gjuhët lejon licencimin e fokusit in-situ dhe përmes frontingut, megjithëse kjo e fundit është opsionale dhe me sa duket e kufizuar në disa lloje të fokusit. Lëvizja e një përbërësi të fokusuar në një pozicion në periferinë e majtë të fjalisë nuk nënkupton domosdoshmërisht një interpretim kontrastiv.

Në gramatikën angleze, fronting i referohet çdo ndërtimi në të cilin një grup fjalësh që zakonisht ndjek foljen vendoset në fillim të një fjalie. Quhet edhe fokusi i përparmë ose preposing.

Frontingu është një lloj strategjie fokusimi që përdoret shpesh për të rritur kohezionin dhe për të treguar theksin emfatik. Kur përdoret në fillim të një bisede, ky lloj fokusi i lejon folësit të vendosë vëmendjen në fillim të një fjalie për ta bërë një thënie më bindëse.

2. [NASA]_{FocP} mbyll misionin 30-vjeçar në hapësirë
3. [Belgjikën e Qerimin]_{FocP} i presin ndeshjet me Kroacinë dhe SHBA-në
4. [Lajm i mirë vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën]_{FocP} vjen.
5. [Rrikthemi të luajmë me 11 me 11]_{FocP} sa i përket lojtarëve.
6. [Do të ruajë gjakftohtësinë]_{FocP} Cana.

[Të hyrat i kanë marramendëse dhe followersat]_{FocP} gjithashtu.



mbyll misionin 30-vjeçar në hapësirë

2.9. Përfundim:

Sic u diskutua deri më tani, fokusi është parë si një aspekt kyç i komunikimit brenda gjuhësisë. Nga puna empirike dhe analizat e bëra deri më tani tregohet se si për t'u koduar domenet e fokusit, fushat prozodike, theksi i fjalisë, semantika, pragmatika dhe sintaksa ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

Sipas diskutimeve në kuadrin e semantikës gjenerative, pamë që fokusi është identifikuar si përbërësi që i përgjigjet një pyetjeje (*wh*-question), me ç'rast informacioni që bart kjo pyetje është krejtësisht i ri dhe materiali që përmban përgjigjia që korrespondon me përbërësin në pyetjen-*wh*. Po ashtu, sipas kuadrit të semantikës alternative, funksioni i fokusit është të evokojë alternativa. Çdo shprehje tani do të ketë dy vlera të ndryshme semantike: vlerën e saj të zakonshme semantike dhe "vlerën semantike të fokusit", ku vlera semantike e fokusit do të përbëhet nga një grup alternativash.

Ai [do kafe]_{FocP} ose [do çaj]_{FocP} - *vlera semantike e fokusit*

Vlera semantike e fokusit është grupi i të gjitha propozimeve (“alternative”) të formës “[do kafe]_{FocP} ose [do çaj]_{FocP}”.

Për ta nxjerrë në pah cila prej alternativave është fokus i kemi prezantuar disa teknika që lidhen me kontekstin dhe me çiftin pyetje – përgjigje, me ç’rast përgjigja është e barabartë me fokusin. Janë disa lloje pyetjesh që bëhen për ta nxjerrë fokusin. Do t’i rendisim më poshtë:

Testi Q-A (Kasimir 2005)

Pyetjet-wh

Përgjigjet e fragmentuara

Pyetje alternative, po ashtu një rol të veçantë ka edhe

Heuristika apo ngjallja e kontekstit

Kontekstualizimi i këtyre pyetjeve tregon se cila pjesë është fokus. Përmes përgjigjes që marrim nga llojet e pyetjeve më lart, dallojmë e fokusin kallëzuesor; fokusin e kufizuar dhe fokusin e fjalisë.

Pozicionet e fokusit në fjali

Fokusi mund të realizohet në pozicione të ndryshme sintaksore, domethënë **në in-situ** ose **ex-situ**. Tradicionalisht, siç kemi thënë pozicioni fundor në fjali konsiderohet të jetë i lidhur me një import informativ dhe mund të përkojë me përgjigjen e një pyetjeje-wh.

Fokusi **in-situ** është një strategji fokusimi, e cila vë në pah një element, pa e ndryshuar vendin ose pozicionin e tij në një fjali.

Fokusi **ex-situ** në gjuhën shqipe është një strategji fokusimi që vendos rëndësinë e një elementi, duke ndryshuar vendin ose pozicionin e tij in-situ në një fjali dhe duke e vendosur përbërësin e fokusit të lëvizë nga pozita e zakonshme në pozitën ex-situ për disa arsye, sintaksore dhe fonetike. Sa u përket lëvizjeve sintaksore të fokusit, dallojmë dy lloje, si: *cleft* dhe *fronting*. Fokusi ex-situ jo vetëm që shpreh informacion të ri, por ka një vlerë kontrastive (Rochemont 1986), e cila identifikon në mënyrë shteruese përmbajtjen e tij referuese. Me fokus ex-situ, elementi që është në fokus zhvendoset në periferinë e majtë të fjalisë ku i gjithë përbërësi ndiqet nga një markues fokusi, siç është theksi emfatik në gjuhën shqipe.

Edhe në kuadrin e eksperimentit prozodik që bëme, ne pamë që, kur rendi i fjalisë është rend kanonik, fokusi shfaqet në pozitën in-situ, që është pozita kanonike e tij dhe theksi bie pikërisht në elementin që përfshihej në domenin e fokusit. Ndërkaq, fokusi krejt djathtas ose ex-situ realizohet sepse theksi kryesor supozohet të shtyhet më djathtas nga kufizimet prozodike dhe kjo nga ana tjetër e tërheq fokusin më së miri për ta plotësuar kufizimin e fokusit STRESS-FOCUS.

3. ROLI I DYFISHIMIT TË PËREMRAVE KLITIKË DHE STRUKTURA E INFORMACIONIT

3.1. Përemrat klitikë dhe roli i tyre në strukturën e informacionit

Dyfishimi klitik e përfshin dyfishimin (ose "përsëritjen") e një përemri klitik të një argumenti foljor i cili "bashkëpunon" me klitikun brenda së njëjtës strukturë propozuese ose brenda të njëjtës klauzë (CP). Rolin "e bashkëpunëtorit" brenda argumentit foljor e luan një përemër, një shprehje referuese jopëremërore, si dhe një klauzë (CP). Kur argumenti foljor ose bashkëpunëtori është një përemër ose një DP, klitiku i bart të njëjtat tipare-phi (ϕ) sikur përemri ose DP, ndërsa, kur argumenti është CP, klitiku është një element i vetëm në akuzativ (Kallulli dhe Tasmowski 2008: 1). Për ta parë që klitiku i bart të njëjtat tipare-phi "të bashkëpunëtorit", i analizojmë shembujt më poshtë:

1. *Ajo i takoi ata.*
2. *Ajo e këndoi këngën.*
3. *Ajo e dinte që nuk ishte në shtëpi.*

Me ç'rast *i* dhe *e*, janë në funksion të klitikut, kurse *ata* (pro), *këngën* (DP), *që nuk ishte në shtëpi* (CP) janë në pozitën e argumentit foljor e që funksionojnë si kundrina të drejta. Ky fenomen gramatikor i dyfishimit klitik të kundrinave të drejta në gjuhën shqipe supozohet të lidhet me praninë ose mungesën e tiparit [+/-topikë], përmes së cilit kundrinës së drejtë të dyfishuar me klitik ia jep statusin ose jo të topikës. Prandaj, sipas Kallullit, dyfishimi i kundrinave të drejta me klitikë asnjëherë nuk është opsional (Kallulli 1995, 1999, 2000, 2008). Ndërkaq, Buchholz & Fiedler (1987: 443), nxjerrin konkluzione më ndryshe nga konkluzioni më lart, me ç'rast, sipas tyre, dyfishimi klitik i kundrinave të drejta në gjuhën shqipe mund të jetë fakultativ, nëse rendi i fjalëve është kanonik (SVO). Pra, sipas tyre, jo gjithmonë rimarrja e kundrinave të drejta përmes klitikëve e sinjalizon strukturën e informacionit në gjuhën shqipe.

3.2. Rishikimi i literaturës

Në gjuhësinë moderne, dyfishimi klitik përkufizohet si "bashkëvendosja e një kundrine të drejtë ose të zhdrejtë me një përemër klitik bashkëreferencial që lidhet me foljen (Janse 2008: 165). Gabriel dhe Rinke (2010: 58-59) dyfishimi klitik është një fenomen që ndodh kur përemri klitik dhe kundrina përkatëse XP shfaqen në të njëjtën klauzë, me ç'rast klitiku i kundrinës funksionon si marker i agrimentit, ndërsa kundrina (XP) i plotëson kushtet tematike dhe të rasës brenda vP. Ndërkaq, dyfishimi i kundrinave të drejta nuk është trajtuar vetëm si fenomen morfo-sintaksor, por edhe element që jep sinjale sa i përket strukturës së informacionit (Gabriel dhe Rinke 2010; Kallulli 2000; Fridman 2008; Kapia 2008). Sipas Gabriel dhe Rinke (2010: 58-59), në bazë të informacionit që përcjellin klitikët, dallojmë dy lloje të dyfishimit të kundrinës me klitik; dyfishimi klitik dhe dyfishimi klitik në të djathtë. Me ç'rast, i dyti, interpretohet si topikë, ndërsa i pari interpretohet si fokus. Ndërkaq, Holton, Mackridge & Philippaki-Warburton (1997: 432) e përshkruajnë dyfishimin klitik si "mekanizëm që e heq kundrinën nga komenti (fokusi) i fjalisë dhe bën atë pjesë të informacionit të dhënë (topikë). Për sa i përket frazave të veçorive gjeneruese, NP-të e dyfishuara me klitikë (DP) përcaktohen si [-Fokus] në krahasim me NP-të që nuk dyfishohen me klitikë (DP), e të cilat interpretohen si [+Fokus].

Sa i përket qasjes së dyfishimit klitik në kuadër të strukturës së informacionit në gjuhën shqipe, janë bërë dy punime: nga Kallulli (2002; 2008) dhe Kapia (2010). Kallulli thekson se dyfishimi i kundrinës së drejtë përmes përemrave klitikë të vetave të treta në shqip (dhe greqishten moderne) prodhon strukturën e informacionit në një mënyrë sistematike, kështu që DP-të e dyfishuara interpretohen në mënyrë të qartë si topikë (në kuptimin "informacion i dhënë", në krahasim me informacionin "e ri" - krh. Schwarzschild 1999). Në fakt, hulumtimet e Kallullit (2000 dhe 2008), supozojnë që klitikët (veta e tretë) me të cilët rimerret kundrina e drejtë së bashku me to e krijojnë topikën në një klauzë (me disa përjashtime që lidhen me veçoritë e foljes). Pra, për t'u interpretuar si topikë këto DP, patjetër që duhet të dyfishohen me përemra klitikë. Kjo qëndron pavarësisht nga

variacionet e renditjes së fjalëve. Dhe do të thotë, që dyfishimi me përemra klitikë të kundrinave të drejta (veta e III njëjës dhe shumës) nuk është një fenomen fakultativ.

Edhe sipas Buchholz & Fiedler (1987: 443), dyfishimi klitik i kundrinës së drejtë ndodh vetëm kur sintagma emërore në rasën kallëzore e përcjell informacionin e njohur (pra, shtrihet brenda kufijve të topikës), ndërsa kur klitiku mungon, atëherë kundrinori i drejtë e përcjell informacionin e ri (pra, shtrihet brenda kufijve të fokusit). Por, dyfishimi klitik i kundrinave të drejta në gjuhën shqipe mund të jetë fakultativ dhe jo i domosdoshëm, kur rendi i fjalëve është kanonik (SVO), si për shembull, *Agim-i po Ø/e vështron hënë-n*; ndërsa dyfishimi klitik i kundrinave të zhdrejta nuk është asnjëherë opsional, si për shembull, *Shfaqj-a *Ø/i pëlqeu Agimit*.

3.3. Pyetje kërkimore

Pyetjet që do të marrin përgjigje në këtë studim aktual janë si më poshtë:

- a. A ndikon dyfishimi klitik i kundrinës (XP) në kodifikimin e strukturës së informacionit?
- b. Dyfishimi klitik i kundrinës në gjuhën shqipe a interpretohet gjithmonë si topikë, siç është bërë deri më tani?
- c. Dyfishimi klitik i kundrinave të drejta a është opsional apo i domosdoshëm në përçimin e njësive të informacionit topikës apo fokusit, pra nëse dyfishimi i klitikut ndikon në shtrirjen e kundrinës brenda kufijve të informacionit të ri apo të dhënë më parë.

3.4. Metoda

Për realizimin e këtij hulumtimi, metoda e përdorur është ajo e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, e cila synon t'i vërë në dukje të dhënat empirike kur dyfishimi klitik e

prodhon strukturën e informacionit; metoda e analizës për interpretimin e këtyre të dhënave për të parë nëse dyfishimi klitik e prodhon çdoherë strukturën e informacionit; metoda krahasuese, veçanërisht ndërmjet gjuhës së shkruar dhe të folur, për të parë nëse në të dhënat e paraqitura, realizimi i topikës përmes dyfishimit klitik të DP-së është më i përhapur në shqipen e shkruar apo në të folur.

3.5. Rimarrja ose dyfishimi i kundrinave në rrafshin diakronik

Në parim, dyfishimi i klitikut në gjuhët e Ballkanit është një fenomen novator që është shfaqur brenda vetë këtyre gjuhëve, pasi askund nuk mund të gjendet te paraardhëset e tyre që janë vërtetuar historikisht, të paktën jo në formën që e ka aktualisht (Kallulli 2008: 9).

Ka disa hipoteza për shfaqjen e dyfishimit të klitikut (rimarrjes së kundrinës) në gjuhën shqipe:

Për shembull, sipas Bokshit, krijimi i klitikëve në shqipe lidhet me nevojën për t'i realizuar funksionet e kundrinave së pari; dhe së dyti, për t'i diferencuar dy elementet e strukturës së informacionit temën dhe remën: *Nga sa u tha del se që në një periudhë të protoshqipes për të shënuar kundrinat përdorëshin trajtat atone, në fillim të të dy vetave të para e më vonë edhe të vetës së tretë njëjës. Ishin format tonike e pastaj të theksuara ato që u përdorën për ta rimarrë kundrinën. Duket, besoj qartas, se krijimi i këtyre formave atone është bërë për të realizuar funksionet e kundrinave* (Bokshi 2014: 115). Sipas tij, variantet e lidhura që gjithmonë kanë kuptim anaforik i cili përdoret për ta treguar gjënë e njohur e të përmendur më parë, ndërsa variantet e lira (kur mungojnë në klauzë) japin gjënë e re / të panjohurën. Sipas tij, përsëritja e klitikëve që nga zanafilla përlligjet vetëm kur në funksion të kundrinës e shënojnë personin e njohur e të përmendur më parë, pasi variantet e lidhura të vetës së tretë (nënkuptojmë klitikun **u**, **e** dhe **i** për vetën e tretë njëjës dhe shumës) kanë kuptim anaforik. Ndërsa variantet e lira (nënkuptojmë klitikun **e** dhe **i** për vetën e tretë njëjës dhe shumës për rasën kallëzore) përdorëshin për ta spikatur vetën dhe variantet e lira u shfaqen kur veta e tretë si vetë jashtë diskursit, ishte e nevojshme të shfaqej

edhe si subjekt i panjohur, i papërmendur më parë, pra si element i ri i kumtimit. Variantet e lira e kishin këtë mundësi, përkundrazi varianteve të lidhura. Pra, variantet e lidhura të vetës së tretë mund ta shënonin vetëm gjënë e njohur të kumtimit, kurse variantet e lira, kur mungonin, e shënonin gjënë e re. Sipas Bokshit, *variantet e lira mund ta tregonin gjënë e re të kumtimit duke qenë të shoqëruara me një gjymtyrë zgjeruese të tyre, me një fjali relative përcaktuese, p.sh.: [E pashë atë që erdhi] etj. Emri në trajtë të shquar, të cilin nyja shquese e bën të njohur, mund të dilte në funksion të kundrinës vetëm si nënvizues i gjësë a i personit të përmendur më parë, prandaj do të dilte në bashkëvajtje me trajtën e patheksuar të vetorit si rimarrës i kundrinës: [e pashë djalin, e dërgoi letrën, i tha djalit] etj., (Bokshi 2014: 116).*

Edhe për Demirajn (1994) faktori i shfaqjes së dyfishimit klitikë *që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para, me sa duket, ka qenë synimi i folësit për të vënë në dukje sa më shumë këtu gjymtyrën plotësuese kryesore të kallëzuesit, kur ajo përbënte gjënë e re të kumtimit, pra remën. Por, sipas tij, rruga se si është përftuar në zanafillë kjo dukuri, nuk është e qartë, duke qenë se në gjendjen e sotme të dijës nuk mund të thuhet asgjë me siguri se në ç'topikë ajo është shfaqur në krye të herës. Po të kihet parasysh fakti që në ndërtimet e zakonshme (jo-emfatike) rema nuk vendoset nga fillimi i fjalisë, si edhe fakti tjetër që inversioni në gjuhën shqipe përdoret jo rrallë edhe për arsye emfatike, atëherë mund të mendohet që dukuria në shqyrtim është përftuar në fillim nëpër fjali emfatike, ku kundrinat vendoseshin para foljes kallëzues. Për ta dëshmuar argumentin e tij, Demiraj jep shembuj nga autorët më të vjetër të shqipes (Buzuku, Budi, Matrënga), me ç'rast rastet e rimarrjes së kundrinave të shprehura me anë të përemrave vetorë të dy vetave të para ndeshen më fort pikërisht në këtë topikë. Megjithatë, sipas Demirajt, nuk duhet përjashtuar mundësia që një dukuri e tillë të jetë përftuar në fillim edhe nëpër fjali, ku kundrina vendosej rregullisht pas foljes kallëzues, si p.sh. nëpër fjali urdhërore dhe pyetëse. *Sido që të këtë qenë zanafilla e kësaj dukurie sintaksore, në këtë rast kemi të bëjmë me një nga pasojat e prirjes relativisht të hershme të gjuhës shqipe për një përdorim ridondant të mjeteve gjuhësore...* (Demiraj 1994: 121). Por, sipas tij, ndryshe nga Bokshi, rimarrja e kundrinave u shfaq kur folësi synonte për ta vënë në dukje kumtimin e ri, pra gjënë e re. Kjo logjikisht edhe praktikisht*

është e pamundshme. Me këtë bëhet një ngatërresë e termave gjë e re/gjë e njohur = informacion i njohur/informacion i ri.

Dyfishimi me klitikë nuk është dukuri vetëm e shqipes. Dyfishimi me klitikë është një fenomen i përhapur në gjuhët e Ballkanit siç njihet tashmë (shih: Miklosich 1862), i cili me disa fenomene të tjera gjuhësore e krijojnë të ashtuquajturin *Sprachbund*-in ballkanik. Për burimin e këtij fenomeni që krijon lidhje gjuhësore midis disa gjuhëve ballkanike, si: në shqipe, maqedonishte, rumunishte, greqishte e bullgarishte janë dhënë disa hipoteza, si hipoteza e substratit, superstratit dhe adstratit.

Duke qenë se burimi sllav dhe burimi grek i kësaj dukurie sintaksore ballkanike përjashtohen nga Miklosich-i (1862), ai u mundua ta argumentojë hipotezën e substratit (trak e ilir). Supozimi i tij për burimin e këtij fenomeni tek elementi i lashtë autokton mbetet një hipotezë e paargumentueshme, për shkak të mungesës së shkrimeve.

Ndërsa hipotezën e superstratit e mbron Ilievski (1962). Ai mendon që kjo dukuri në gjuhët ballkanike, pas gjithë gjasash, e ka burimin te latinishtja vulgare. Ai vë në dukje se në disa fragmente shkrimore nga latinishtja vulgare ballkanike hasen ndërtime me kundrina të përsëritura nëpërmjet një përemri vetor të theksuar.

Hipotezën e adstratit e argumenton Thumbi (1910). Rimarrja e kundrinave është përftuar edhe në greqishte. Sipas Thumbit, kundrinat në atë gjuhë rimerren kur folësi synon t'i vërë në dukje ato posaçërisht; përndryshe, përdoret vetëm forma e patheksuar e përemrave vetorë.

Meqenëse zhvillimi i dyfishimit klitik në gjuhët e Ballkanit nuk përcaktohet kështu gjenetikisht nga një burim i vendosur historik në asnjë mënyrë të dukshme, ka të gjitha gjasat që ai është përhapur nga një qendër e përcaktuar mirë e inovacionit brenda rajonit. Qoftë se siç mundet, siç njihet nga Lopašov (1978), situata që rezulton është larg nga homogjene: dyfishim klitik duket se i nënshtrohet kufizimeve të rrepta gramatikore në perëndim dhe në jug të zonës së tij të zgjerimit, por kushtëzohet gjithnjë e më shumë nga faktorët e ligjërimit-pragmatik drejt veriut dhe lindjes. Kjo situatë përfaqësohet me kufizim gramatikor të klitikut të dyfishuar në anën e majtë, duke u bërë më i lirë dhe domethënës

pragmatikisht (Kallulli dhe Tasmowski 2008: 9). Sipas tyre (ibid. 10), sasia e madhe e të dhënave e zgjeruar dhe e diskutuar në këtë vëllim e konfirmon mendimin se gjeneza e dyfishimit klitik duhet të kërkohet në rajonin që bashkon gegërishten qendrore të shqipes, maqedonishten perëndimore dhe rumanishten veriore.

3.5.1. Përemrat klitikë të shqipes (paradigmat):

	Rasa dhanore		Rasa kallëzore	
	njëjës	shumës	njëjës	shumës
Veta e parë	më	na	më	na
Veta e dytë	të	ju	të	ju
Veta e tretë	i	u	e	i

Përemrat klitikë janë në thelb morfema të patheksuara që shkojnë së bashku me një folje për të treguar për kë dhe kujt i referohet veprimi. Ata zënë vendin e njerëzve ose sendeve të përfaqësuar nga kundrinorët e drejtë dhe të zhdrejtë. Përemrat klitikë janë ata përemra vetorë që dalin me trajta të shkurtra gjatë lakimit të tyre në rasën dhanore: (mua) *më*, (ty) *të*, (atij, asaj) *i*; (neve) *na*, (juve) *ju*, (atyre) *u*; dhe në rasën kallëzore: (mua) *më*,

(ty) **të**, dhe (atë) **e**, (ne) **na**, (ju) **ju**, (ata,ato) **i**. Ata vendosen para foljes (proklitik) në trup të foljes (mezoklitik) dhe pas saj (enklitik) (AShASh 2002).

3.6. Ndërtimi dhe pozita e dyfishimit të klitikëve në fjali

3.6.1. Si realizohet dyfishimi i klitikëve?

Në literaturën e gjuhësisë shqiptare njihen dy lloje sa i përket pozicionit të klitikut dhe të kundrinës në fjali: *zhvendosja e klitikut në të majtë* (CLLD) dhe *dyfishimi klitik* (CD). Struktura e **zhvendosjes së klitikut në të majtë** (CLLD) pararqitet në diagramin nr. 1, me ç’rast klitiku është koka e CIP. Ndërsa kundrina DP e zë specifikuesin e atij projektioni si shembulli i lëvizjes A’ nga pozicioni kanonik i kundrinës. CLLD përfshin një kundrinë DP dhe një klitik që përputhet me të. Kundrina DP gjithmonë ndodhet në të majtë të foljes. Për shembull:

1. *Librin e lexoi dje.*

1a. *Librit i mungonin faqet e para.*


Struktura e **dyfishimit klitik** (CD) analizohet njësoj si CLLD, vetëm se folja ngritet në kokën F të FP që e dominon CIP. Po ashtu, në këtë ndërtim përfshihet kundrina DP dhe klitikët që përputhen me të. CD ndryshon minimalisht nga CLLD, pra sa i përket pozitës së kundrinës DP, që është në të djathtë të foljes.

2. *Dje e lexoi librin.*

2a. *Faqet e para i mungonin librit.*

Në literaturën e gjuhësisë janë propozuar dy analiza për ta interpretuar dallimin strukturor ndërmjet CD dhe CLLD. Ato janë *movement analysis* (analiza e zhvendosjes/lëvizjes) dhe *base-generation* (apo gjenerimi i bazës). Analiza e lëvizjes është


ndoshta analiza më e vjetër gjeneruese dhe ajo është miratuar në Kayne (1975, 1989, 1990) dhe Sportiche (1989,1990). Një ndër mbështetësit e *analizës së lëvizjes*, Agouraki (1992) propozoi një analizë të unifikuar si për dyfishimin me klitik (CD), ashtu edhe për zhvendosjen e klitikut në të majtë (CLLD) në greqishten moderne. Pasi, sipas tij, klitiku së bashku me DP-në janë në një konfigurim të agrimentit Spec-kokë, me DP në specifikesin e një CIP. Kjo e fundit është më e lartë se IP dhe më e ulët se një FP në diagramin e pemës. Në dyfishimin e klitikut (CD), folja dhe klitiku supozohet se lëvizin në kokën F të FP, duke llogaritur faktin se folja e ka statusin e fokusit në CD. Dy diagramet e mëposhtme janë bërë duke u bazuar në analizën e Agouraki (1992), pasi besojmë se një analizë e tillë u përgjigjet edhe strukturave (CD dhe CLLD) në shqipe.



(Struktura e klitikut të zhvendosur majtas –

CLLD)

2)



(Struktura e dyfishimit klitik – CD)


Pra, sipas analizës së Agouraki-t (1992), dallimi midis CLLD dhe CD është se te CLLD kundrina DP i paraprin klitikut me të cilin përshtatet, ndërsa te CD kundrina DP e ndjek klitikun përkatës. Në CD, DP është në pozitën e specifikuesit të CliticP, sikur në CLLD. Dallimi përkatës midis CD dhe CLLD është se në CD folja ngritet në kokën F të FP që e dominon CIP. Lëvizja sintaksore e foljes e kap faktin që në CD folja është fokus domosdoshmërisht. Dy analizat e mëparshme, sipas Agouraki-t (1992), e zvogëlojnë CLLD dhe CD në një strukturë të vetme përse i përket pozicionit të kundrinës DP. CD rrjedh nga CLLD në kuptimin që CD është CLLD plus fokusimi i foljes. Dallimi kryesor midis CD dhe CLLD është semantik. Sipas Agouraki-t (1992), ekziston një ndryshim thelbësor semantik midis CD dhe CLLD. Në CD folja interpretohet detyrimisht si fokus, përveç nëse ndonjë përbërës tjetër është i fokusuar në fjali. Nuk ka asnjë parim në gjuhë që thotë se çdo fjali duhet të ketë një përbërës të fokusuar. Gjithashtu, nuk ka asnjë parim që

thotë se në secilën fjali folja është domosdoshmërisht fokusi i fjalisë. Ai argumenton se ndryshimi midis CD dhe CLLD në lidhje me interpretimin e foljes si fokus lidhet plotësisht me një ndryshim strukturor. Gjegjësisht fakti që në CD folja i paraprin kundrinës, ndërsa në CLLD kundrina i paraprin foljes. Në CD folja ngritet në kokën F të një FP, ndërsa FP është më i lartë se CIP. Detyrueshmëria e fokusit të foljeve në CD mbetet e pashpjegueshme, përveç nëse supozojmë se folja është nën F. Përbërësit në pozicionet e tyre kanonike mund të përqendrohen opsionalisht si një shembull i fokusimit fonetik. Përbërësit brenda FP interpretohen detyrimisht si fokus. Nëse folja në CD është e përqendruar domosdoshmërisht, kjo do të thotë se është në mënyrë sintetike. Analiza e tanishme e CD lejon një unifikim të CLLD dhe CD. Sipas parashikimit të teorisë së tij, del se nuk ka gjuhë me CD të cilave u mungon CLLD (shih diagramin nr.3). Domethënë, sipas tij, përmes një diagrami mund të paraqiten edhe CD edhe CLLD, pasi, sipas tij, në të dyja rastet edhe klitiku dhe DP-ja janë në një konfigurim të marrëveshjes Spec-kokë, me DP në specifikuesin e një CIP. Po ashtu, pozicioni i kundrinës DP është i njëjtë si në CLLD ashtu edhe në CD.

1. *Dje e lexoi librin.*
2. *Faqet e para i mungonin librit.*

Në dy shembujt e dhënë edhe klitiku e dhe DP-ja janë përbërësit e CIP, njëri specifikues **{librin, librit}** e tjetra kokë **{e, i}** që së bashku e përbëjnë ndërtimin e klitikut (Clitic-Construction). Kur konstruktimi i klitikut (CLC) është **opsional** si rasti i klitikut *e* në akuzativ, specifikuesi i CIP-ës është në pozicion A'. Kur konstruktimi i klitikut është **i detyrueshëm** si rasti i klitikut në dativ **i** dhe **u**, specifikuesi i CIP-ës është një pozicion A, sepse është një pozitë theta (në lidhje tematike). Përmes kësaj analize nënkuptohet edhe roli i strukturës së infomacionit, pasi, sipas autorit, objektet në konstruktimin e klitikut nuk mund t'i nënshtrohen fokusimit sintaksor (përrjashton disa raste). Ky fakt rrjedh nga një parim që thotë se në LF të gjitha llojet e lejimit A'- Specifikues / Kokë duhet të jenë të hapura.

3)



Pra, Agouraki e zbaton metodën që në gjuhësinë gjenerative njihet si analiza e lëvizjes‘ (—movement analysis) propozuar nga gjuhëtari amerikan Richard Kayne (1975). Ai supozon që klitikët kanë një status të plotë argumenti dhe për pasojë ato janë të krijuara nga baza në pozicionin e argumentit të drejtuesit të tyre. Sipas kësaj analize, trajta e shkurtër është kundrina e vërtetë, dhe pozicioni i saj strukturor përpara foljes është pasojë e ‘lëvizjes‘ nga vendi bazë i kundrinës, që supozohet të jetë pas foljes, si për shembull:

1. Duhet ta gjej (atë).
2. E bleva librin.

Pra, sipas kësaj analize, rendi i fjalëve në (1 dhe 2) ku trajta e shkurtër i paraprin foljes përftohet nga lëvizja lokale e trajtës së shkurtër nga pozicioni pasfoljor në atë parafoljor (Kallulli 2014).

Ndërsa përmes një analize tjetër të Sportiche (1996: 27) shohim që një konstruksion klitik është një marrëdhënie lëvizjeje (jo-lokale) midis dy XP-ve, XP * dhe XP ^ të ndërmjetësuar nga një kokë (klitike) H, e tillë që XP ^ = [spec, HP], në mënyrë që

XP * të pajtohet me H. Nga LF, XP * duhet të ketë lëvizje në XP ^ . Disa nga parametrat e ndërtimeve janë si më poshtë:

- i. Lëvizja e XP * në XP ^ ndodh në mënyrë të hapur ose të mbyllur
- ii. H është e hapur ose e mbyllur
- iii. XP * është e hapur ose e mbyllur

Të gjitha ndërtimet e klitikëve (që përfshijnë një varësi Cl / XP *) përfshijnë lëvizje. Lëvizja e XP* është në pozicionin e specifikuesit të projeksionit që kryesohet nga klitiku, ku marrëveshja midis Cl dhe XP * është e lejuar. Kjo qasje i trajton klitikët si morfema komplekse të marrëveshjes; ajo nxjerr marrëdhënien e marrëveshjes XP* / Cl si një shembull i një lidhjeje specifikues / kokë dhe e përcakton lidhjen e lokalitetit midis klitikut dhe XP * pasi në fakt karakterizohet nga lëvizja e nevojshme lidhje midis XP ^ = [spec, CIP] dhe XP *. Në gjuhët me CD (siç është spanishtja), sipas tij, dyfishimi ndodh kur një XP* e hapur lëviz fshehurazi me një H të hapur. Ai këtë lëvizje të nevojshme e sheh si shtyrje të XP * në XP ^ deri në LF në mënyrë që të përmbushet Kriteri Klitik. Në analizën e tij, Spritche nuk e fut fare ndërtimin CLLD, po ashtu nëpërmjet këtij ndërtimi nuk paraqet elemente të strukturës së informacionit.

Por, ky rast nuk funksionon për shqipen (Kallulli 2000). Sipas Kallullit, tipari që e dyfishon klitikun e kundrinës së drejtë në shqipe nuk është specifikuesi, por fraza topike, pasi për të pasur CIP në gjuhën shqipe kërkohet që në klauzë të jetë i pranishëm tipari [-focus] ose tipari [+topic]. Po ashtu, në këtë punim Kallulli (2000) ka treguar se dyfishimi klitik i kundrinës së drejtë në shqipe e prodhon strukturën e informacionit në një mënyrë sistematike: DP-të e dyfishuara interpretohen në mënyrë të qartë si tema. Kjo sugjeron që *topikhud*-i, të paktën pjesërisht, është i koduar në sintaksën e kësaj gjuhe.

Megjithëkëtë, Kallulli nuk është e sigurt nëse në mënyrë universale paraqitja e temave përfshin të njëjtin konfigurim sintaksor ~ ndër-gjuhësor, prandaj, spas saj, mbetet çështje për studime të mëtejshme (Kallulli, *Clitic phenomena in European languages* 2000: 245). =

3.6.2. Imperativi dhe klitikët

Dyfishimi me klitikë i kundrinave të drejta (OCIs) ndodh në përgjithësi në pozicionin parafoljor, përveç në fjalitë imperative, ku mund të futet si në enklizë ashtu edhe në mezoklizë midis rrënjës foljore dhe mbaresës së vetës së dytë shumë. Sipas Savojs (2019), theksohet nga të dhënat që paraqiten në punimin e tij, se klasifikimi i OCIs në imperativ është pjesërisht i ndryshëm sa u përket varieteve të shqipes, me ç'rast e folmja e Gjirokastrës (1), e folmja e arbëreshëve të Italisë në (2) dhe gegërishtja e Shkodrës në (3) shfaqin ndryshime në pozicionin e klitikëve të vetës së parë (klitikë deiktikë) dhe të klitikëve të vetës së tretë.

Këto asimetri vihen në lojë nga vetitë thelbësore morfo-sintaksore të fjalisë:

SHNK- del se klitikët deiktikë (veta e parë) kanë një shpërndarje të ndryshme nga klitikët e vetave të treta të paktën në këto varietete.

Në të gjitha kontekstet veta e parë i paraprin klitikëve të vetave të treta (mesoklizë / postverbal / proklizë).

3.7. Përemrat klitikë dhe roli i tyre në strukturën e informacionit

Studimet e mëparshme (Kallulli 2000; Fridman 2008; Kapia 2008) kanë treguar se dyfishimi i klitikëve në gjuhë të ndryshme nuk është fenomen vetëm morfo-sintaksor, por edhe element që jep sinjale sa i përket strukturës së informacionit.

Sa i përket qasjes së dyfishimit klitik në kuadër të strukturës së informacionit në gjuhën shqipe janë bërë dy punime: nga Kallulli (2002; 2008) dhe Kapia (2010). Kallulli thekson se dyfishimi i kundrinës së drejtë përmes përemrave klitikë të vetave të treta në shqip (dhe greqishten moderne) prodhon strukturën e informacionit në një mënyrë sistematike, në atë që DP-të e dyfishuara interpretohen në mënyrë të qartë si tema (në kuptimin "informacion i dhënë", në krahasim me informacionin "e ri" - krh. Schwarzschild 1999). Në fakt, hulumtimet e Kallullit (2000 dhe 2008), supozojnë që klitikët (veta e tretë)

me të cilët rimerret kundrina e drejtë së bashku me to e krijojnë topikën në një klauzë. Por, për t'u interpretuar si topikë këto DP, patjetër që duhet të dyfishohen me përemrat klitikë. Kjo qëndron pavarësisht nga variacionet e renditjes së fjalëve. Kjo do të thotë, që dyfishimi me përemra klitikë të kundrinave të drejta (veta e III njëjës dhe shumës) nuk është një fenomen fakultativ.

Sipas Kallullit (2008) dhe Kapias (2010), ekzistojnë dy situata në të cilat CD (dyfishimi me klitikë) është e detyrueshme në shqip: (I) kur kundrina është e zhdrejtë, si në (1); (II) kur është kundrina është topikë/ temë, si në (2).

1. *Fjalët i merr era.*

2. *E shëtis qenin.*

Kallulli (2008) supozon se i ashtuquajtimi tipar [fokus] është në të vërtetë vlera e pashënuar në një teori të shenjesisë për gjuhën natyrore dhe se plotësuesi i saj, d.m.th., tipari [-fokus] ose [temë] është vlera e shënuar. Shembujt në gjuhën shqipe në (1) përbëjnë çiftet minimale që ndryshojnë në lidhje me mungesën kundrejt pranisë së elementit klitik që e dyfishon kundrinën e drejtë:

(1) a. *Ana lexoi në bibliotekë.* (Kallulli 2000: 218)

(1) b. *Ana e lexoi libr-in.*

Sipas Kallull-it (2000), dy fjalitë e para në (1a) dhe (1b) janë plotësuese ose opsionale, prandaj kundrina e drejtë është pjesë e topikës së klauzës. Ndërsa, kur është fokus ose pjesë e fushës së fokusit (siç sillet nga kontekstet e parashikuara në (2A) dhe (3A)), dyfishimi me klitikë nuk tolerohet. Është thelbësore të dihet se ndërtimi i dyfishimit mund të jetë i përshtatshëm për përgjigjet në pyetjet (4A) dhe (5A), ku kundrina e drejtë DP është pjesë e presupozimit (d.m.th., një shprehje topike), por jo për pyetjet në (2A) dhe (3A). Për më tepër, vini re se prania e një klitiku të dyfishuar në këto raste (d.m.th., në kontekstet e parashikuara nga (4A) dhe (5A)) nuk është vetëm i mjaftueshëm, por me të vërtetë i domosdoshëm. Kjo ndodh, kur kundrina e drejta në shqip duhet të dyfishohet me klitikë, në mënyrë që të interpretohen si tema ose si topikë.

- (2) A: Çfarë bëri Ana? B: *Ana (*e) lexoi libr-in.*
- (3) A: Çfarë lexoi Ana? B: *Ana (*e) lexoi libr-in.*
- (4) A: Kush e lexoi librin? B: *Ana *(e) lexoi libr-in.*
- (5) A: Çfarë bëri Ana me librin? B: *Ana *(e) lexoi libr-in.*

Pra, sipas Kallullit (2008), duke u bazuar në shpjegimin që bën, dyfishimi klitik i kundrinave të drejta nuk është një fenomen fakultativ.

Tutje, Kallulli (ibid. 231) krijon një ndarje të qartë midis kundrinave të drejta të foljeve ekzistenciale dhe llojeve të tjera. Sipas saj, kundrinat e drejta të foljeve ekzistenciale nuk mund të hyjnë kurrë në kufijtë e topikës. Në fakt, në mënyrë të përgjithësuar del se foljet ekzistenciale në shumës nuk mund të dyfishohen me klitikë (Kallulli 1999, 2006). Në mënyrë të ngjashme, emrat në numrin njëjës me përcaktues të qartë mund të dyfishohen me klitikë, pavarësisht nga veçoria e tyre e përcaktueshmërisë, ndërsa të ashtuquajturit emra të numërueshëm nuk mund të dyfishohen. Ndërtimet që në strukturën e tyre përmbajnë emra të numërueshëm të cilët dyfishohen me klitikë janë thjesht ndërtime jogramatikore, siç ilustron më poshtë:

1. Ana (*e) bleu fustan.
2. Ana (e) bleu një fustan.

Te Kallulli (2006) argumentohet se kjo ndodh, sepse foljet ekzistenciale në njëjës dhe në shumës janë domosdoshmërisht fraza të fokusit (d.m.th., ato nuk mund të jenë fraza topike), siç është argumentuar në mënyrë të pavarur për foljet ekzistenciale të padyfishuara me klitikë në numrin shumës te studimi i Cohen & Erteschik-Shir (2002).

3.7.1. Fakticiteti, dyfishimi klitik dhe IS

Nëse klitikët e dyfishtë shënojnë aleatët e tyre të dyfishuar si [+ tema] / [+ e dhëna], siç tregohet në pjesën e mëparshme, dhe duke pasur parasysh faktin se dyfishimi klitik shkakton fakticitetin, i cili nga ana e tij është përcaktuar në aspektin e presupozimit. Një pyetje që lind se cila është lidhja (nëse ka) midis informacionit të dhënë dhe presupozimit. Sipas Kallullit (citon Krifkan), një propozim mund të zhvendoset nga e dhëna e kontekstualitetit në presupozim. Kjo do të thotë, të thuash që një fjali është e supozuar mund të nënkuptojë një nga dy gjëra: ose supozimi të jetë i vërtetë, ose propozimi i shprehur me fjali është përmendur më parë. Por, përkundër kësaj, ky dallim kryesisht duket se është i paqartë, në kuptimin që propozimet që supozohen (d.m.th. supozohet se janë të vërteta) jepen (qoftë në kontekstin e menjëhershëm, ose përmes njohurive të përgjithshme), dhe ato propozime të dhëna në kontekst shpesh merren si të vërteta. Në funksion të kësaj, ndryshimi midis përdorimit faktik dhe jofaktik të 'besoj' (në shqip, anglisht, gjermanisht dhe MG) mund të deklarohet në mënyrë të arsyeshme për sa i përket strukturës së informacionit, a pamje që motivohet më tej nga gjetjet prozodike të hollësishme, sipas saj (Kallulli 233: 2008).

a. *Besova se Beni shkoi (por në fakt ai nuk shkoi).*

b. *E besova se Beni shkoi (*por në fakt ai nuk shkoi).*

Po ashtu, Kallulli supozon që në shqip, anglisht dhe gjermanisht ka zbuluar lidhje të qarta të fakticitetit në strukturën prozodike. strukturimi prozodik dhe diferencimi prozodik i fjalive me strukturën e informacionit të krahasueshëm (d.m.th., me një folje të përdorur një herë si faktike dhe një herë si jofaktike) është i krahasueshëm në të tri gjuhët në shqyrtim. Pra, sipas saj, kur folja besoj përdoret si faktike e bart theksin, ndërsa kur përdoret si jofaktike nuk e bart. Të gjitha fjalitë me foljen faktike / besoj / glauben kanë një theks bërthamor në foljen matricë, ndërsa kur folja besoj është jofaktike në ato fjali theksi nuk bie mbi foljen matricë, por ngulitet në të. Pra, sipas saj, informacioni prozodik është i koduar në sintaksë. Ky konceptim na mundëson që të nxjerrim korrelacionin midis aktualitetit dhe deakcentrimit në përputhje me Chomsky (2004: 107).

3.7.2. Klitikët e vetës së tretë në dhanore e kallëzore

Kundrinorët e rasës dhanore gjithmonë dyfishohen me klitikë, kur folja është transitive, ndërsa kundrinat në akuzativ dyfishohen klitikë vetëm nëse ato janë jashtë fushës së fokusit (dh.m.th janë tema). Nëse kundrinat në akuzativ shfaqen brenda fushës së fokusit, ato nuk mund të dyfishohen me klitikët përemërorë.

Pra, siç është vërejtur nga Kallulli (2000, 2008) dhe Kapia (2010), mungesa e dyfishimit klitik te kundrinorët në akuzativ në gjuhën shqipe lidhet me praninë e fokusit.

Kapia (2010) e dëshmon tutje rezultatin e Kallullit, por ajo, po ashtu mundohet të shpjegojë më tej nëse ka ndonjë lidhje midis dyfishimit klitik me remën ose kontrastin. A është rema apo kontrasti faktori përcaktues që kushtëzon mungesën e dyfishimit klitik të këtyre kundrinave? Për më tepër, hetimi i bashkëveprimit midis dyfishimit të detyrueshëm dhe mungesës së klitikëve. A diferencohen rema dhe kontrasti përmes sintaksës së dyfishimit të klitikut në shqip? Për t'iu përgjigjur pyetjeve të mësipërme, Kapia i ka paraqitur dy eksperimente (Kapia 2010: 904).

Në mënyrë të veçantë, këto rezultate shtojnë se vëzhgimet e Kallulli për të treguar se mungesa e dyfishimit me klitik i kundrinës në akuzativ lidhet drejtpërdrejt si me statusin retematik, ashtu edhe me kontrastivitetin e kundrinës së dyfishuar në atë që të dy llojet e kundrinave nuk dyfishohen me klitikë. Së pari, rezultatet konfirmojnë dhe rafinojnë vetitë e veçanta shpërndarëse të dyfishimit klitik në shqipe. Së dyti, ata tregojnë se dyfishimi klitik në këtë gjuhë nuk është një fenomen fakultativ, por përkundrazi është i detyrueshëm në disa raste dhe detyrimisht i pazbatueshëm në të tjerët. Së treti, rezultatet e këtij studimi tregojnë se kategoritë interpretuese të remës dhe kontrastit nuk realizohen ndryshe në gjuhë përmes sintaksës së dyfishimit të klitikut.

Pra, Kapia provon t'i vërtetojë rezultatet që ka nxjerrë Kallulli (2000), sipas saj, kundrinat që dalin si rema, si dhe kundrinat që janë kontrastive nuk ndikojnë që detyrimisht të ndodhë dublimi i kundrinorit nga një trajtë e shkurtër ose të dyfishohet me klitikë, nëse ato janë në akuzativ, dhe detyrimisht dyfishohen me klitikë ose e rimarrin kundrinën, nëse janë në dativ (Kallulli 2000). Rezultatet që nxjerr Kapia (2010) kanë treguar një

karakteristikë të rëndësishme të dyfishimit të klitikut në shqip. Kjo do të thotë, dyfishimi klitik nuk është një fenomen fakultativ: ai është i detyrueshëm në disa kontekste ose detyrimisht i pazbatueshëm në kontekste të tjera. Në mënyrë të veçantë, dyfishimi klitik është i detyrueshëm me të gjitha llojet e kundrinave në dativ, d.m.th. rematike, kontrastive, si dhe kur janë topikë. Gjithashtu, dyfishimi me klitikë i detyrueshëm është kur kundrinat janë në akuzativ e, po ashtu, gjenden brenda kufijve të topikës. Dyfishimi klitik është, megjithatë, detyrimisht i pazbatueshëm kur kundrinat që janë në akuzativ janë brenda kufijve të fokusit.

Sipas Kapias, po ashtu, kundrinat që dalin si rema, si dhe kundrinat që dalin si kontrast detyrimisht nuk dyfishohen nëse ato janë në rasën kallëzore dhe detyrimisht dyfishohen me klitikë, nëse janë në dhanore. Me fjalë të tjera, rema dhe kontrasti nuk kanë një efekt të diferencuar në asnjë lloj të kundrinave. Kjo tregon se këto dy nëntipa të fokusit (rema dhe kontrasti) nuk janë realizuar ndryshe në gjuhë përmes sintaksës së klitikëve (Kapia 2010).

Një studim më i hershëm nga Buchholz & Fiedler (1987: 443, cf. edhe Buchholz 1977: 180), nxjerr konkluzione më ndryshe nga Kapia dhe Kallulli, me ç'rast dyfishimi klitik i kundrinave të drejta në gjuhën shqipe mund të jetë fakultative, nëse rendi i fjalëve është kanonik (SVO) si nën (a), por një shfaqje fakultative e rimarrjes së kundrinës nuk lejohet për kundrinat e zhdrejta, siç shihet në (b):

- a. *Agim-i po Ø/e vështron hënë-n.*
- b. *Shfaqja *Ø/i pëlqeu Agimit.*

Ndërsa në studimet e mëvonshme, moderne të shqipes të bëra nga Rugova, Sejdiu-Rugova (2015) fjalia e dhënë nën (b) do të merrej komplet si fjali jogramatikore, pra shkarje nga norma.

Spas tyre, shqipja ka gjithashtu një seri ndërtimesh në të cilat folja merr vetëm një kundrinë të zhdrejtë, por dyfishohet nga dy përemra klitikë të bashkuar në rasën dhanore dhe kallëzore (Buchholz 1977: 183; Buchholz & Fiedler 1987: 445–46). Në gjuhën

shqipe është një grup foljesh që rimerren nga dy klitikë të bashkuar njëri në rasën dhanore e tjetri në kallëzore. Shumica e këtyre foljeve janë ndërtime që tregojnë lëvizje si në (c) ose ndërtime idiomatike, si nën (d). Sipas tye, në këtë rast dyfishimi duket se është pjesërisht një sinjal i morfologjizuar ose leksikor (Në foljet që tregojnë lëvizje është fakultativ, por në ndërtimet idiomatike është i detyrueshëm):

c. *Ia hipi kalit.*

d. *Ia dhamë gazit.*

Pra, përveç dyfishimit klitik të kundrinave të zhdrejta, sipas Friedman (2008: 48), dyfishimi klitik i kundrinës së drejtë ndodh vetëm kur sintagma emërore në rasën kallëzore e përcjell informacionin e njohur, ndërsa kur klitiku mungon, atëherë kundrinori i drejtë e përcjell informacionin e ri:

(1) *Në qendër të qytet-it, dy persona të panjohur, që flitnin*

serbisht, Ø sulmuan dhe tentuan të Ø rrëmbejnë studente-n

Aferdit-a Aliu (1973) nga Kaçanik-u i Vjetër [...]. Njër-i

nga persona-t e panjohur e paska sulmuar Aferditë-n dhe

e paska kërcënuar me revole edhe me 17 janar...

Shembulli (1) ilustron një përdorim tipik të dyfishimit për topicalizimin në shqip. Në fjalinë fillestare të artikullit, Afërdita Aliu është prezantuar për herë të parë dhe për këtë arsye është pjesë e informacionit të ri. Në fjalinë e mëvonshme ku paraqitet, Afërdita, është tashmë informacion i njohur për lexuesin. Prandaj, në këtë rast është tema dhe shkakton dyfishimin me klitik *e* (*e* paska sulmuar; *e* paska kërcënuar).

Pra, supozohet që dyfishimi me klitikë të ndodhë kur klitiku i referohet një referenti tashmë të pranishëm në ligjërim (p.sh., kjo është ajo çka nënkuptohet zakonisht me lidhjen *D* (*D – linked*), dhe kur ky referent zgjidhet nga një grup më i madh. Kusht i nevojshëm atëherë është që grupi më i madh të prezantohet më parë, duke e bërë kështu referentin konkret të disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të

dyfishimit klitik. Për shembull, për bullgarishten moderne Dimitrova-Vulchanova (2008) tregojnë që kushtet që kundrina të dyfishohet me klitik lidhen në thelb me strukturën e informacionit (një kërkesë semantike) mjaft e maskuar nga renditja sipërfaqësore e përbërësve që japin përshtypjen e p.sh., dy ndërtime të ndryshme. Pra, sipas Dimitrova-Vulchanova (2008), ndërtimi i dyfishimit klitik siguron strukturën e duhur të informacionit dhe kushtet semantike, duke licensuar kështu shfaqjen e kësaj dukurie (krh. Dimitrova-Vulchanova & Hellan 1995/1999). Po ashtu, në punimin e tyre supozohet se ndërtime të ngjashme dhe kushte të ngjashme për t'u dyfishuar kundrina me klitikë dëshmohen si në shqip (krh. Kallulli, 2008) ashtu edhe në maqedonisht (Tomić, 2008), duke nënvizuar kështu natyrën ballkanike të fenomenit.

Siç u tha edhe më lart, edhe Kallulli (2000, 2008) njësoj si studimet e Tomić-it (2008) dhe Dimitrova-Vulchanov-ës (2008) për disa nga gjuhët e Ballkanit, argumenton se dyfishimi klitik prodhon dhe kodon strukturën e informacionit në mënyrë sistematike në gjuhën shqipe, në mënyrë që kundrinat e dyfishuara me klitikë të interpretohen në mënyrë të qartë si tema/topika. Ajo e përsos më tej këtë pretendim, duke kufizuar importin interpretues të dyfishimit, për t'u aplikuar ekskluzivisht për tema më shumë kontrastuese si lidhjet kontrastuese tek Alexopoulou & Kolliakou (2002).

3.8. Analiza

3.8.1. Metodologjia

Pra, u tha se dyfishimi klitik i kundrinave të drejta nuk është një fenomen fakultativ në gjuhën shqipe (Kallulli 2000, 2008; Kapia 2010). Si dhe u argumentua se dyfishimi i klitikut prodhon dhe kodon strukturën e informacionit në mënyrë sistematike, në mënyrë që kundrinat e dyfishuara të interpretohen në mënyrë të qartë si topikë. Sipas këtij definicioni, dyfishimi ndodh kur i referohet një referenti që tashmë është i pranishëm në diskurs. Kushti i nevojshëm për dyfishim është që DP të prezantohet më parë, duke u bërë kështu referent konkret i disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të dyfishimit. Për ta parë se sa e saktë është kjo teori, ne do ta bëjmë hulumtim pragmatik

ku analizohen lidhjet anaforike dhe kataforike të referuesit me elemntin të cilit i referohet dhe, po ashtu, nëse referenti është prezantuar më herët në diskurs. Pasi ne mendojmë se nuk mjafton vetëm sintaksa për t'i definuar argumentet e lartdhëna, pra nuk mund të bëhet pa u analizuar edhe rrethanat e kontekstit në të cilin nuk ka referencë ndërmjet referuesit dhe referentit. Në bazë të hulumtimit që kemi bërë ka dalë se jo gjithmonë dyfishohet klitiku i kundrinës së drejtë edhe kur referenti prezantohet më parë në tekst. Pra, edhe kur DP është e njohur për dëgjuesin/marrësin, pra është topikë, sepse është dhënë më parë në tekst. Referenca mund të jetë anaforike dhe kataforike. Është **anaforike** kur elementi referues hyn në ligjërim pas njësisë, të cilës i referohet (Rugova, Sejdiu-Rugova 2015: 139). Ndërsa **kataforike**, kur njësia referuese i vihet përpara njësisë së referuar (ibid. 139). Pra, një klitik anaforik është një morfemë e lidhur morfologjikisht me një përbërës të përmendur më parë, i referohet atij dhe e plotëson pozicionin e një DP-je në një klauzë, për shembull: *Librin e lexoi dje. Librin* është njësia e referuar dhe *e* është njësia referuese e që po ashtu lidhen morfologjikisht mes vete. Ndërsa, një klitik kataforik është një morfemë e lidhur morfologjikisht me një përbërës që do të përmendet pas tij në ligjërim, i referohet atij dhe e plotëson pozicionin e një DP-je në një klauzë, për shembull: *E lexoi librin*.

Marrëdhëniet anaforike / kataforike ekzistojnë vetëm nëse: a) një ose më shumë klitikë e kryejnë rolin e argumentit verbal; b) një kokë referimi semantik (i cili mund të jetë frazë, fjali, diskurs ose kontekst) është e vendosur për secilin klitik (Cresti 2009).

Për ta vëzhguar rolin e dyfishimit me klitikë të kundrinave në strukturën e informacionit, janë përzgjedhur tri korpuse: gazeta *Koha*; filmi i metrazhit të gjatë *Një tregim Prishtine*; dhe komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014 Beograd). Këto lloje tekstesh janë zgjedhur me qëllim që të analizohet roli i dyfishimit klitik në strukturën e informacionit siç është lajmi, një shmangie nga rregullat dhe norma, sepse paraqet ndonjë ngjarje që nuk është e zakonshme nga e rëndomta e përditshmërisë (Whitaker et al, 2004; cit. sipas Rugova 2016: 97). Po ashtu, roli i mekanizmit të dyfishimit klitik në raport me strukturën e informacionit në një tekst siç është gjuha e filmit e cila është e mbushur me **referenca ekzoforike**, kur një përemër klitik i referohet një njësie jashtë tekstit (Rugova, Sejdiu – Rugova 2015). Ndërsa, gjuha e përdorur te komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* është përzgjedhur me qëllim që të analizohet roli i

dyfishimit klitik në strukturën e informacionit, në një korpus ndryshe, siç është gjuha e sportit që është një kod më vete, e ky kod është një njësi e përcaktuar nga konteksti...I cili paraqitet përmes parimeve rregullative të tekstit siç janë efikasiteti dhe efektshmëria (Rugova, 2006; 2016).

Shembuj nga gazeta ***Koha ditore***:

Konteksti: Fshati Korishë dallohet për vetorganizim të banorëve, këtë praktikë do ta zbatojë edhe gjatë kohës së karantinës, të imponuar për shkak të pandemisë së koronavirusit.

1. **Fshati Korishë Ø vazhdon vetorganizimin edhe gjatë karantinës** (titull) fq 4.
2. Fshati Korishë, i cili prej vitesh është dalluar për vetorganizim të banorëve, këtë praktikë do ta zbatojë edhe gjatë kohës së karantinës, të imponuar për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Në shembullin e dhënë DP-ja në funksion të kundrinës së drejtë (*vetorganizimin*) nuk është dyfishuar përmes klitikut (e) edhe pse si dukuri vetorganizimi është prezantuar më parë në tekst dhe nuk është informacion i ri për lexuesin, pra edhe pse është i njohur për lexuesin nuk po dyfishohet me trajtë të shkurtër.

Konteksti: Lëvizja Vetëvendosje në fushatë ka premtuar se do të depolitizohen ndërmarrjet publike...Albin Kurti ka thënë se këto borde janë të përkohshme dhe se ato do të merren me luftimin e krimit dhe korrupsionit brenda tyre.

3. **Kurti kritikohet se Ø ka shkelur premtimin për depolitizimin e bordeve** (titull) fq 5
4. Gjashtë muaj më vonë, qeveria në detyrë, e udhëhequr nga Albin Kurti Ø ka shkarkuar përbërjen e tri bordeve të ndërmarrjeve publike për t'i zëvendësuar ato me disa persona të afërt me këtë subjekt politik.

Në shembullin e dhënë DP-ja në funksion të kundrinës së drejtë (*premtimin*) nuk është dyfishuar përmes klitikut (e) edhe pse si koncept është i njohur për publikun, sepse është prezantuar gjatë fushatës. Pra, nuk po rimerret përmes trajtës së shkurtër edhe pse hyjnë në kufijtë e topikës dhe është informacion i dhënë më parë. Po ashtu, në nëntitull *Albin Kurti*

Ø ka shkarkuar përbërjen e tri bordeve të ndërmarrjeve publike grupi nominal (*përbërjen e tri bordeve të ndërmarrjeve publike*) nuk po rimerret përmes trajtës së shkurtër edhe pse tashmë është informacion i njohur për lexuesin përmes hironimit të dhënë në titull dhe nëntitull *depolitizimi i bordeve ~ përbërje e tri bordeve* (për hironimet shih Rugova, Sejdiu – Rugova 2015).

Konteksti: Në fotografi janë dhënë katër objekte të cilat janë identifikuar nga Komuna e Pejës që mund të shërbejnë si karantinë.

5. **Komuna e Pejës Ø ka identifikuar katër objekte për karantinë** (titull) fq 4;
6. Komuna e Pejës Ø ka identifikuar katër objekte publike, të cilat ndonëse kanë destinime të tjera, mund të shfrytëzohen edhe për vendosjen e presonave të prekur nga koronavirusi (nëntitull).

Në fotografi brenda tekstit jepen katër objektet që janë zgjedhur për karantinë, pra grupi nominal katër objekte publike në funksion të kundrinës së drejtë (shumës) është tanimë i njohur për lexuesin kështu që, sipas hulumtimeve të bëra deri më tani për dyfishimin e klitikut dhe strukturës së informacionit, ky grup nominal do të duhej të dyfishohej nga trajta e shkurtër e përemrit vetor të vetës së tretë shumës *i*.

Konteksti: Për vitin 2019 u ishin dhënë premtime më shumë sesa kishte realisht mjete. Institucionet janë futur në borxhe dhe ato do të mbulohen me buxhetin e sivjetëm.

7. *Ministria e Kulturës ndan 2.1 milionë euro për projektet e institucioneve të veta* (mbititull)
8. **Premtimet e 2019-s Ø rëndojnë buxhetin e sivjetmë të institucioneve kulturore** (titull) fq 13; 9 prill; nr. 8160

Në shembullin 9, bazuar në supozimet që jep Kallulli (2000, 2008) DP-ja, meqë nuk po përsëritet përmes klitikut, do t'i përkasë informacionit të ri. Por, bazuar në kontekst, qysh në mbititull DP-ja (buxhetin) prezantohet te lexuesi përmes hironimit (*2.1 milionë euro për projekte ~ buxhet*), prandaj ne e kategorizojmë atë brenda kufijve të informacionit të njohur edhe pse nuk rimerret përmes trajtës së shkurtër të përemrit vetor (e).

Konteksti: Reperi 24 vjeçar, Post Malone, ka ndërmarë masa ligjore kundër Taylor Armes, si kundërpërgjigje ndaj ankesës së tij se reperi nuk e ka paguar për kontributin e dhënë për realizimin e njëres prej këngëve të tij të fundit.

9. **Reperi Post Malone e padit muzikiantin që e ndihmoi** (titull) fq 15

Në shembullin 10, rimerret kundrina e drejtë (muzikantin) përmes trajtës së shkurtër e, edhe pse informacioni nuk jepet më parë në mbititull ose nëntitull, por përsëri hyn brenda kufijve të informacionit të njohur, pasi ripërsëritet edhe njëherë përmes trajtës së shkurtër e në klauzën tjetër. Pra, e njëjta kundrinë dyfishohet dy herë me klitik, prandaj edhe llogaritet si informacion i njohur për lexuesin/en. Klitiku i parë është në marrëdhënie anaforike me referentin, kurse klitiku i dytë është marrëdhënie kataforike me referentin.

Konteksti: Lidhja Demokratike është bërë e shurdhër ndaj thirrjeve të qytetarëve me protesta, shoqërisë civile...Edhe pse tarifa ndaj mallrave serbe është hequr nga Qeveria, mocioni kundër saj është deponuar në kuvend.

Mbititull: Edhe pse tarifa ndaj mallrave serbe është hequr nga Qeveria, mocioni kundër saj është deponuar në kuvend.

10. **LDK-ja Ø injoron thirrjet, Ø aktivizon mocionin** (titull) fq 1; 21 mars; nr. 8141

11. LDK-ja e ka deponuar në Kuvend mocionin... (paragrafi III i tekstit).

Në shembullin 11, kundrina e drejtë e klauzës së parë (thirrjet) nuk bëhet e qartë më herët, prandaj edhe nuk po dyfishohet me klitik, ndërsa kundrina e drejtë e klauzës së dytë (mocionin) është informacion i njohur, pasi është dhënë më parë edhe te mbititulli, megjithëkëtë nuk përsëritet me klitikun (e). Ndërsa në shembullin 12, i cili është nxjerrë nga paragrafi i tretë i tekstit, rimerret kundrina e drejtë *mocionin* përmes klitikut, e cila tashmë njihet për audiencën.

Konteksti: Kosova ka hyrë në javën kritike të pandemisë së koronavirusit, ndërsa partnerët e koalicionit kanë vazhduar përplasjet në pritje të votimit të mocionit të votëbesimit ndaj Qeverisë Kurti.

Mbititulli: Vazhdojnë përplasjet ndërmjet partnerëve të koalicionit, LDK-ja nuk e tërheq mocionin.

12. Java kritike kundër koronavirusit nuk e frenon krizën politike (titull) fq. 3; 23 mars nr. 8143

Në shembullin e dhënë, DP-ja po dyfishohet me klitik, i cili është në marrëdhënie anaforike me DP-në, prandaj lloagaritet si pjesë e informacionit të njohur, pasi ky informacioni tashmë nënkuptohet përmes hironimit që është dhënë në mbititull e që lidhet semantikisht me DP-në të titulli *përplasjet ndërmjet partnerëve të koalicionit ~ kriza politike*.

Konteksti: Senatori nga Vermonti, Bernie Sanders, i cili më pak se katër muaj më parë ishte në krye të garës për nominimin demokratik për sfidimin e presidentit republikan, Donald Trump... Sanders e rishikon garën për Shtëpinë e Bardhë pas humbjeve të thella kundruall Joen Bidenit.

13. Sanders Ø rivlerëson fushatën pas humbjeve të thella ndaj Bidenit (titull i lajmit) fq 11; 19 mars; nr.8139

14. Bernie Sanders është duke e rishikuar garën e tij për Shtëpinë e Bardhë, pas humbjeve të thella kundruall Joe Biden.... (hyrja e shkrimit fq 11).

Në shembullin 14, që është edhe titulli i lajmit DP – fushatën nuk po dyfishohet me klitik, por bazuar edhe në kontekst DP është informacion i ri pasi nuk jepet më herët në mbititull. Ndërsa, në shembullin 15, DP si kundrinë e drejtë rimerret përmes klitikut, me të cilën është në raport anaforik, po ashtu është informacion i dhënë, sepse kuptohet nga titulli përmes kolukimit (fushatë ~ garë).

Konteksti: Ylli 35 vjeçar i muzikës, Katy Parry, e cila është në pritje të fëmijës së parë me të fejuarin, Orlando Bloom,...

15. Katy Parry nuk do ta harrojë kurrë shtatzëninë në kohën e pandemisë (titull) fq 4; 28 prill; nr. 8178

Kundrina e drejtë rimerret përmes trajtës së shkurtër kur folja është në mënyrën lidhore. Raport ndërmjet klitikut dhe kundrinës është anaforik, çka na sinjalizon statusin e informacionit të dhënë që e bart DP-ja në funksionin e kundrinës së drejtë.

Konteksti: Gjatë periudhës së pandemisë, importet dhe eksportet në Kosovë kanë shënuar rënie dhe kjo ka shkaktuar ulje të deficitit tregtar 161.2 milionë.

Mbititull: Bllokimi i aktiviteteve ekonomike dhe rënia e konsumit ulin importet dhe eksportet.

16. Pandemia ul deficitin tregtar për 37 për qind fq 2; 25 maj; nr. 8206

Në shembullin 17, njësoj si në shembullin 9, bazuar në supozimet që jep Kallulli (2000, 2008) DP-ja, meqë nuk po përsëritet përmes klitikut, do t'i përkasë informacionit të ri. Por, bazuar në kontekst, qysh në mbititull DP-ja (deficitin tregtar) prezantohet te lexuesi përmes kolokimit (*importet dhe eksportet ~ deficit tregtar*), prandaj ne e kategorizojmë atë brenda kufijve të informacionit të njohur, edhe pse nuk rimerret përmes trajtës së shkurtër të përemrit vetor (e).

Konteksti: Njëri prej zanatlinjve të Lipjanit tregon se e mban familjen prej këtij zanati dhe se nuk ka të ardhura të tjera dhe se biznesi i tij po rrezikohet nga pamundësia për të punuar.

Mbititulli: Disa aktivitete ekonomike kërkojnë mbështetjen financiare të institucioneve.

17. Mbyllja e dyqaneve rrezikon mbijetesën e zanatlinjve të Lipjanit fq 6; 30 prill nr. 8180

Shembulli 18 analizohet njësoj si shembulli 17 dhe 9.

Konteksti: Debutimin e Gosensin te Gjermania e parandaloi koronavirus që u përhap më shumë në Itali.

18. Koronavirusi e detyron Gosensin ta presë rastin e tij te Gjermania fq 44; 26 Prill nr. 8176

Në shembullin 19, kundrina e drejtë (Gosensin) e cila prezantohet qysh në mbititull, pra nuk është informacion i ri për lexuesin, rimerret përmes trajtës së shkurtër e, prandaj përsëri hyn brenda kufijve të informacionit të njohur. Po ashtu, ripërsëritet edhe njëherë përmes trajtës së shkurtër e në klauzën tjetër. Pra, e njëjta kundrinë dyfishohet dy herë me klitik, prandaj edhe llogaritet si informacion i njohur për lexuesin/en. Klitiku i parë është në marrëdhënie anaforike me referentin, kurse klitiku i dytë është marrëdhënie kataforike me të.

Shembuj nga filmi i metrazhit të gjatë *Një tregim Prishtine*:

Konteksti: Familja prej tre anëtarësh (babai, nëna dhe vajza) janë në veturë. Në sfond dëgjohet një këngë e Ledrit: *Ni got për ty*. Të tre e këndojnë refrenin:

1. // ^ *E pi ni got për ty* // ^ *Masi ty e kohën s'muj mi kthy* //

Në shembullin e dhënë DP-ja në funksion të kundrinës së drejtë (*ni got*) është dyfishuar përmes klitikut (e), edhe pse po ta shkëpusim nga konteksti DP-ja nuk *ni got*, nuk e përcjell informacionin e vjetër, por vetë folja transitive (pi) e kërkon patjetër një kundrinë që e kumton një informacion të pritshëm për dëgjuesin. Ndërsa, klauza tjetër *masi ty e kohën s'muj mi kthy*, DP-ja e koordinuar (ty e kohën) funksionon si informacion i vjetër, pasi klitiku i paraqitet si kataforë.

Konteksti: Meqë janë në veturë, duke kënduar në pikun e lumturisë, gruaja e këshillon burrin të ketë kujdes:

2. // ^ *O Ben kçyr-e rrugën* //

Në shembullin e dhënë DP-ja në funksion të kundrinës së drejtë (*kçyr-e*) është dyfishuar përmes klitikut (e) në pozitën e enklizës, në trup të foljes. DP-ja rrugën, e përcjell informacionin e vjetër, pasi është e nënkuptueshme që gjatë ngasjes së veturës duhet ta kemi kujdes rrugën, e jo ndonjë gjë tjetër.

Konteksti: Pra, familja janë në veturë, këndojnë dhe në pikun e lumturisë, burri i kërkon një puthje në faqe gruas:

3. // ^ *Ama ni façe* //

Formalisht nuk shihet që ka ndonjë klitik që i referohet DP-së *façe*, e cila e përcjell informacionin e njohur, prandaj supozojmë se klitiku *e* + klitiku tjetër *më* për vetën e parë janë shkrirë me foljen *jap*, duke na e dhënë formën ***ama***.

Konteksti: Në veturë gruaja e lëndoi hundën, prandaj i referohet burrit:

4. // ^ *Me kantarjon a ma lyn edhe kto* //

Në këtë shembull DP-ja plotësohet nga përemri dëftor *kto*, dhe klitikët *më* + *e* janë në marrëdhënie semantike me DP-ën, pra me përemrin *kto*, i cili i referohet një njësie jashtëtekstore (hundës), me ç' rast krijohet referenca ekzoforike.

....

5. // ^ *Merr-e me kujdes (akuariumin)* //

6. // ^ *Kujdes / se p-e then* //

Në shembujt 5 dhe 6, DP-ja del boshe në strukturë. Në këtë rast dyfishimi klitik që gjendet në trup të foljes dhe në pjesëz krijon referencë ekzoforike me elementin të cilit i referohet (akuariumit). Prandaj, e përcjell informacionin e njohur/e vjetër.

7. // ^ *Mirpo nuk kam diagnozë konkrete* //

Në shembullin shtatë, DP-ja diagnozë nuk dyfishohet me klitik, pasi po funksionon si informacion i ri për dëgjuesin.

8. // ^ *Ashtu siç ju thash* //

Ky është një shembull konkret i cili tregon se jo gjithmonë dyfishimi klitik e përcjell informacionin e njohur, sepse në këtë shembull do të duhej që DP-ja të dyfishohej me klitik, për ta dhënë informacion e njohur, pra do të duhej të ishte // ^ *Ashtu siç jua thashë* //. Pra

edhe pse tash DP-ja boshe po futet në kufijtë e informacionit të njohur, nuk po dyfishohet me klitik.

.....

9. // ^ Komuna po do me na *i* nal *punimet* //

Në shembullin 9, DP-ja logjikisht nuk hyn brenda kufijve të informacionit të vjetër, pasi nalja e punimeve e përbën fokusin e klauzës, e që, po ashtu, dyfishohet me klitikun *i*, i cili sipas Kallullit, e përcjell informacionin e njohur për bashkëbiseduesin.

10. // ^ Ben mos ja nis // (zënkës)

Në shembullin 10 e kemi një shprehje idiomatike (mos ja nis/a ja nise a), me ç'rast, siç thotë edhe Friedman (2008), dyfishimi klitik i DP-së është i domosdoshëm dhe nuk ka lidhje me strukturën e informacionit. Pra, dyfishimi ndodh edhe kur DP-ja hyn brenda kufijve të informacionit të ri.

Shembuj nga komentimi i ndeshjes së futbollit *Serbi – Shqipëri* (14.10.2014, Beograd)

1. // *Kukeli e kthen* [\emptyset]_{TOP} [*praapa*]_{FOC} *tek Mavraj* //

Në shembullin 1, kundrina e drejtë (topin) e cila prezantohet qysh në diskursin paraprak, pra nuk është informacion i ri për lexuesin, rimerret përmes trajtës së shkurtër e, prandaj nuk përsëritet kundrina në funksion të topikës, pra realizohet përmes një pro boshe, duke e qenë e tillë hyn brenda kufijve të informacionit të dhënë, sepse është e njohur për audiencën. Rolin e kësaj pro boshe e plotëson klitiku *e*.

2. Ka një problem për Andi Lilën//Një goditje që [Ø]_{TOP} ka marrë nga topi// [E]_{TOP} kanë goditur//

Në shembullin 2, në klauzën e tretë, DP-ja meqë nuk po përsëritet përmes klitikut, do t'i përkasë informacionit të ri. Por, bazuar në kontekst dhe nga ajo që shihet në pamje, *goditja* si kundrinë e drejtë shihet qartë dhe është informacion i njohur për audiencën, prandaj ne e kategorizojmë atë brenda kufijve të informacionit të njohur, edhe pse nuk rimerret përmes trajtës së shkurtër të përemrit vetor (e). Ndërkaq në klauzën e tretë, njësoj si në shembullin 1 kundrina e drejtë (Andi Lila) e cila prezantohet qysh në diskursin paraprak, pra nuk është informacion i ri për lexuesin, se realizohet përmes trajtës së shkurtër *e*: [E]_{TOP} kanë goditur [Ø]//

3. *Topi që mbetet aty // nuk arrin dot Cana ta largojë* [Ø]_{TOP}

Në këtë shembull, në klauzën e parë kryefjala topi është në lidhje anaforike me kundrinën e kaluzës së dytë që është një *pro* boshe e e cila realizohet përmes klitikut *e*, pra trajtës së shkurtër të bashkuar *ta*. Prandaj, *pro* është e porealizur në strukturën sipërfaqësore, sepse në strukturën e thellë njihet nga audienca.

4. //Rivënia i takon [Serbisë]_{TOP} //
5. //Rivënia i takon [skuadrës vendase]_{TOP} //

Në shembujt 4 dhe 5, DP-të (Serbisë dhe skuadrës vendase) logjikisht hyn brenda kufijve të informacionit të vjetër, pasi shihet se kush e preku topin i fundit, prandaj e përbëjnë topikën e fjalive, e që, po ashtu, dyfishohen me klitikun *i*, i cili sipas Kallullit, e përcjell informacionin e njohur për bashkëbiseduesin.

6. E presin skuadrën serbe// e presin Ivanovic Ø [cënon]_{FOC} [portën e Etrit Berishës]_{TOP} //

Në shembullin e dhënë, Ivanovic Ø [cënon]_{FOC} [portën e Etrit Berishës]_{TOP}// DP-ja në funksion të kundrinës së drejtë (portën e Etrit Berishës) nuk është dyfishuar përmes klitikut (*e*) edhe pse si koncept është i njohur për publikun, sepse është prezantuar përmes videos.

Pra, nuk po rimerret përmes trajtës së shkurtër edhe pse hyjnë në kufijtë e topikës dhe është informacion i dhënë dhe i dukshëm.

7. \emptyset kontrollon [topin Nastasic]_{TOP}

Njëjtë sikur shembulli numër (6) kundrina e drejtë (topin) nuk po dyfishohet me klitik edhe pse si koncept është i njohur për publikun, sepse është prezantuar përmes videos.

8. *Kjo është goditja// që i \emptyset _{TOP} [jepet me parakrah dhe për më tepër [përpara]_{FOC} syve t Atkinson]]//*

Në video gjatë lojës jepet goditja me parakrahë që i bëhet Kukelit i cili përmendet edhe në diskursin paraprak, prandaj SE *Kukeli* në funksion të kundrinës së zhdrejtë është tanimë e njohur për shikuesin kështu që, nuk realizohet në strukturën sipërfaqësore si e plotë, rolin e kësaj e kryen klitiku *i*.

9. Nuk arrin [ta ndal \emptyset]_{TOP} Tadic

Kundrina e drejtë rimerret përmes trajtës së shkurtër kur folja është në mënyrën lidhore. Raport ndërmjet klitikut dhe kundrinës është anaforik, cka na sinjalizon statusin e informacionit të dhënë që e bart DP-ja në funksionin e kundrinës së drejtë. Por kjo DP nuk realizohet fonetikisht, rolin e saj e luan klitiku *e*.

10. E largon [Ivanovic \emptyset]_{TOP}

Si në shembullin paraprak kundrina e drejtë (topin) rimerret përmes trajtës së shkurtër, pa u realizuar fonetikisht, sepse vizualisht është e qartë.

11. Topi i vjen [\emptyset]_{TOP} nga e majta

Në shembujt 4 dhe 5, DP-të, edhe në këtë shembull kundrina e zhdrejtë (IO) e realizuar nga një *pro* logjikisht hyn brenda kufijve të informacionit të vjetër, pasi shihet se kah erdhi topi, prandaj e përbën topikën e fjalisë, duke u dyfishuar me klitikun *i*.

12. Ka faull kësaj here e ka parë [Atkinson]_{TOP}

Në shembullin 12, rimerret kundrina e drejtë (Atkinson) përmes trajtës së shkurtër *e*, sepse është përmendur në diskursin paraprak dhe hyn brenda kufijve të informacionit të njohur, pasi ripërsëritet edhe njëherë përmes trajtës së shkurtër e në klauzën tjetër.

13. Kësaj here \emptyset shikon [një hapje të krahut një pengim të kundërshtari]_{TOP}

Në shembullin 13, njësoj si në shembullin 9, bazuar në supozimet që jep Kallulli (2000, 2008) DP-ja, meqë nuk po përsëritet përmes klitikut, do t'i përkasë informacionit të ri. Por, bazuar në kontekst, në pamjen që jepen ky grup nominal nënkuptohet nga audienca.

14. Shikoni se si [e ka mbajtur Mërgim Mavrajn]_{TOP}

Si në shembullin 12, edhe këtu rimerret kundrina e drejtë (Mërgim Mavraj) përmes trajtës së shkurtër *e*, sepse është përmendur në diskursin paraprak dhe hyn brenda kufijve të informacionit të njohur.

15. Dhimbja mund t'i kthehet [\emptyset]_{TOP} në forcë.


Në shembullin 15, *pro*-ja logjikisht hyn brenda kufijve të informacionit të vjetër, sepse referohet SE-së, Kukelit, pasi është përmenduar pak përpara.

3.9.Përfundimi

Dyfishimi me klitik nuk shërben si një mjet pragmatik në strukturën e informacionit; dhe jo gjithmonë përdoret si një pajisje, për t'i markuar kundrinat e drejta si topikë.

Në bazë të të dhënave nga ky hulumtim, del se dyfishimi me klitikë i kundrinave të drejta jo gjithmonë lidhet me sinjalizimin e ndonjërit prej dy nocioneve të strukturës së informacionit, topikës apo fokusit. Në 60% të shembujve që i kemi nxjerrë nga gazeta *Koha ditore*, kemi hetuar që kundrinat e drejta nuk rimerren përmes trajtave të shkurtra (klitikëve), edhe pse mund të themi që hyjnë në kufijtë e topikës, pasi llogariten si informacion i dhënë, pra janë përmendur, në një formë, në diskursin paraprak. Ndërsa, vetëm 40% kundrinave të drejta që dyfishohen me klitikë e sinjalizojnë topikën. Ndërkaq, sa u përket filmit *Një tregim Prishtine* dhe emisionit *Pressing*, kemi vënë re që përafërsisht 25 % të rasteve kundrina e drejtë nuk dyfishohet me klitik edhe kur ajo i ka tiparet [+topikë]. Po ashtu në ndeshjet e futbollit shpeshherë kundrina në kufijtë e topikës nuk realizohet fonetikisht, pra realizohet përmes një *pro*-je në strukturën e thellë, sepse llogaritet si informacion i dhënë pasi jepet nëpërmjet pamjeve dhe me këtë i përmbahet ekonomisë gjuhësore. Megjithëkëtë, meqë edhe filmi edhe emisioni i përkasin gjuhës së folur, përafërsisht në 70% të shembujve në të dy korpuset përdorimi vetëm i klitikut, duke e lënë kundrinën të pashprehur fonetikisht (pra, të porealizuar në strukturën sipërfaqësore) e sinjalizon topikën.

Statistikat e nxjerra për dyfishimin me klitikë të kundrinave të drejta që e sinjalizojnë topikën në korpusin tonë mund t'i shohim në tabelën më poshtë:



Në bazë të rezultateve të nxjerra mund të themi se në studimet nga Kallulli (2000, 2008) dhe Kapia (2010) për lidhjen e dyfishimit me klitik dhe strukturën e informacionit shihet njëfarë tendence, për ta normëzuar përdorimin e klitikut aty ku DP-ja, në funksionin e kundrinës së drejtë, njihet nga diskursi paraprak.

4. KONFIGURIMI VARIACIONAL I RENDIT TË FJALËVE DHE NDIKIMI I STRUKTURËS SË INFORMACIONIT

Ndryshimi i rendit të fjalëve në një gjuhë konfiguruese është parë në disa këndvështrime, sipas (Hawkins 1992 Givon 1983, 1988, Jacobs 1988), përzgjedhja midis varianteve të rendit të fjalëve përcaktohet kryesisht nga pesha e “strukturës së informacionit” ose stilit, ndërkaq, sipas Lambrecht (1994), sugjeron që struktura formale e fjalive lidhet me situatat komunikuese në të cilat përdoren fjalitë. Ndërsa sipas një këndvështrimi më të ri ndërrimet e rendit të fjalëve përcaktohen plotësisht nga motive diskursive-pragmatike (Bošković 2004, Sener 2010 dhe Güner 2020). Bazuar në këtë këndvështrim do të zhvillohet edhe analiza jonë më poshtë këtij kapitulli.

Rendi i fjalive në gjuhën shqipe dhe stili

Rendi i fjalëve në fjali, përveç që është definuar si një nga mjetet me rëndësi për t’i shprehur lidhjet sintaktike, renditja e fjalëve në fjali është parë edhe si pajisje stilistike për të shprehur qëndrimin e folësit, pasi shpesh vendin e fjalës në fjali e përcakton gjendja emocionale e folësit dhe varësisht nga qëndrimi folës ndryshon edhe renditja e fjalëve në fjali: *Si një ndër mjetet me rëndësi për të shprehur lidhjet sintaktike është edhe rendi apo renditja e fjalëve në fjali. Me këtë kuptojmë vendin që duhet të zërë në mes të fjalëve të radhitura në fjali një fjalë e caktuar. Ky vend përcaktohet kryesisht nga vetë rëndësia që ka fjala në një fjali për shprehjen e mendimit tonë. Kjo do të thotë se në fjali vihet në vend të parë apo të dytë, e kështu me radhë, ajo fjalë, që tregon sendin apo faktin i cili përbën elementin kryesor për mendimin e njeriut* (Prifti 1971: 27). Me këtë kuptohet që rendi SVO nuk është absolut, pra në shqipe ekziston njëfarë lirie në renditjen e fjalëve, përveç në rastet kur kemi të bëjmë me fjalët që kanë një rend të pandryshuar, si: parafjalët, lidhëzat, disa nga pjesëzat dhe ndajfoljet mohuese, pasi këto fjalë e kanë humbur pavarësinë e tyre dhe janë të afta për t’i shprehur lidhjet përkatëse sintaktike vetëm në një pozicion të caktuar në fjali (ibid. 27).

Po ashtu, Sintaksa e AShASh-së (1976), *topikën* a rendin e fjalëve në fjali e konsideron si të lirë në një masë të madhe dhe se kryesisht ka karakter stilistik. *Rendi i gjymtyrëve në fjali në gjuhën shqipe s’ është në përgjithësi i ngulitur. Ekziston një rend i*

zakonshëm: kryefjalë + kallëzues + kundrinë + rrethator (SVO(A) (me përjashtim të fjalive pyetëse me fjalë të veçanta pyetëse e të disa fjalive të varura, sidomos të përcaktorëve lidhorë). Por ai mund të ndryshojë, pa ndryshuar në thelb raportet sintaksore, të shumtën e herës me ndryshime ngjyrimesh sintaksore stilistike.

Sipas Floqi-t (2005: 42), edhe në gjuhën shqipe që ka një sistem të pasur trajtash morfologjike dhe sistem të zhvilluar parafjalësh, rendi është në përgithësi i lirë dhe kjo liri e rendit lidhet kryesisht me karakterin stilistik.

Në një punim me karakter kontrastiv për rendin e fjalëve midis anglishtes, shqipes dhe turqishtes, Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu (2018: 299) vënë në pah se shqipja në raport me anglishten është “më e lirë” në strukturën përbërëse sa i përket rendit të fjalëve, pra është më fleksibël dhe ky rend i fjalëve është relativisht i lirë. Pjesët e ligjëratës në shqipe kuptohen qartësisht. Për më tepër, parafjalët dhe shënuesit rasorë ndihmojnë për ta hequr paqartësinë e tyre. Për më tepër, mbaresat rasore si prapashtesa të ndryshme lejojnë folësit ta ndryshojnë renditjen e fjalëve. Kjo veçori rrit ekspresivitetin dhe më shumë ngarkesë informacioni mund të nxitet nga secila prej fjalive të saj. Mbaresat verbale mund të japin informacione rreth kohës dhe kryefjalën e një fjalie. Në shqipe kryefjalët mund të hiqen lirshëm, ndërsa modifikuesit zakonisht vijnë pas emrave që i modifikojnë. Pjesëza pyetëse /a/, e cila përdoret në pyetjet po / jo, shfaqet në fillim të fjalive. Edhe pse u përket gjuhëve që përdorin SVO, shqipja mund të përdorë edhe parafjalë.

Pra, siç shihet nga studimet e lartcekura, shqipja tregon një fleksibilitet të madh në renditjen e përbërësve të fjalisë. Për shkak të këtij fakti, ajo është përmendur shpesh si një gjuhë “me rend të lirë”, me rendin SVO të përbërësve që paraqitet si themelor, por edhe jo i detyrueshëm. Ndryshimet e mundshme të renditjes së fjalëve shpesh janë konsideruar si pajisje stilistike me qëllim, për ta ndryshuar ose rritur peshën e informacionit (Sejdiu-Rugova dhe Simitçiu 2018; Xhaferi 2005). Prandaj, qëllimi i këtij punimi është ndryshimi i rendit të fjalëve brenda fjalive në gjuhën shqipe, pasi, sipas Hawkins (1992: 196), ekziston një mendim i përhapur në literaturë se përzgjedhja midis varianteve të rendit të fjalëve ekuivalente të kushtëzuara nga faktet që lejohen nga gramatika përcaktohet kryesisht nga pesha e “strukturës së informacionit”, d.m.th. nocionet pragmatiko-semantike, si: rëndësia

ose parashikueshmëria (Givon 1983, 1988), agjentët, shquarësia (Jacobs 1988) etj. Pra ky hulumtim ka për qëllim të nxjerrë në pah nëse rendi i fjalëve në fjali kushtëzohet nga struktura e informacionit, dhe nëse po: a prodhon efekte identike në tekste të ndryshme. Po ashtu, nëse ky kushtëzim kufizohet vetëm brenda diskursit emocional apo edhe llojeve të tjera të diskursit.

Një nga gjuhëtarët e parë që e njohu rëndësinë e parimeve që qëndrojnë në themel të fleksibilitetit në rendin e fjalëve ishte Mathesius (1929), themeluesi i shkollës së Pragës. Sipas tij, ndryshimet në rendin e fjalëve në fjali nuk tregojnë asgjë, nëse analizohen vetëm në këndvështrimin formal, pasi, sipas tij, në ndryshimin e rendit të fjalëve bashkëveprojnë disa faktorë. Për shembull, në çekishte, faktori i brendshëm që luan rol në rendin e fjalëve është aspekti i perspektivës së fjalisë funksionale (1929: 126). Çdo shprehje dypjesëshe përbëhet nga dy përbërës, përbërësi i parë, shpreh diçka relativisht të re dhe përmban atë që pohon fjalja. *Është ajo pjesë e fjalisë që nganjëherë quhet kallëzuesi psikologjik dhe që, për hir të një dallimi më të qartë nga kallëzuesi gramatikor me të cilin nuk përkon gjithmonë, unë preferoj ta quaj rema e shprehjes. Pjesa e dytë e fjalisë përmban bazën e shqiptimit ose temës, subjektin psikologjik sipas terminologjisë së hershme d.m.th. gjëra relativisht të njohura ose më të disponueshme për folësin si pikënisje* (ibid. 127). ***Qëllimi i folësit (shkruesit) gjen shprehjen e tij në ndarjen e fjalisë në dy pjesë. E para emërton temën e mesazhit dhe është pikënisjen e komunikimit.*** E dyta përmban mesazhin e saj. Pjesa e parë e fjalisë quhet tema e saj, dhe e dyta rema e saj. Për shembull, qëllimi i folësit është të thotë kush është autori i romanit Lufta dhe Paqja. Fjalja e cila i përgjigjet këtij qëllimi dhe mban një "ngarkesë" të tillë semantike që do të ndërtohet si më poshtë:

Autori i romanit "Lufta dhe paqja" është Leo Tolstoi.

Ndarja e një fjalie në temë dhe remë quhet perspektiva e fjalisë funksionale. Pra, Shkolla e Pragës e iniciuar nga Mathesius ka argumentuar se identifikimi i informacionit të dhënë (tema) dhe nxjerrja në pah e informacionit të ri (rema) ushtron një forcë të fuqishme në strukturën gjuhësore (Fery & Krifka 2008). Renditja e fjalëve varet nga qëllimi i folësit (ose shkrimtarit) dhe nga informacioni i ri, thelbësor që ai dëshiron të përcjellë. Këto ndryshime që ndodhin në strukturën gjuhësore ndërlidhen me funksionin

komunikues që ka të bëjë me atë se çfarë lloj i informacionit plotëson vende të caktuara në fjali. Çfarë lloje të funksionit komunikues bëjnë, për shembull, kryefjalët dhe çfarë ndryshimi ndodh nëse kryefjalët janë në fillim të fjalisë? (Johnstone 2008: 114).

4.1. Funksioni komunikues i fjalisë (si formë) dhe rendi i fjalëve

Lambrecht (1994) sugjeron që struktura formale e fjalive lidhet me situatat komunikuese në të cilat përdoren fjalitë. Ai shprehet se "kjo marrëdhënie drejtohet nga parimet dhe rregullat e gramatikës, në një përbërës të quajtur struktura e informacionit" (334). Pra, varësisht nga funksioni komunikues i fjalive ndryshojnë edhe strukturat sintaksore (të njëjtën gjë e argumentojnë edhe Givon 1983, 1988; Jacobs 1988). Sipas Lambrecht (1994), funksioni komunikues i fjalisë është i barabartë me fokusin e fjalisë (Çka definohet si fokus? - shih kapitullin për fokusin). Lambrecht (1994: 14) e koncepton strukturën e fokusit si diçka që e lidh konvencionalisht formën e fjalisë me konstruktin e fokusit. *Fusha sintaksore në një fjali e cila shpreh përbërësin e fokusit të një fjalie të strukturuar në mënyrë pragmatike* është fusha e fokusit (ibid. 241). Në temat e taksonomisë së strukturave të fokusit të zhvilluara është i llojit "fokusi i fjalisë", d.m.th. i llojit në të cilin fusha e "informacionit të ri" shtrihet mbi tërë propozimin, duke e përfshirë edhe kryefjalën. Funksioni komunikues i strukturave të tilla të fokusit të fjalive është ose të prezantojnë një referencë të re të diskursit ose (si në këtë rast) të prezantojnë një ngjarje që përfshin një referencë të re të diskursit. Fjalitë me llojin e fundit të funksionit komunikues do të quhen "fjali që raportojnë ngjarje". Për shembull:

1. Makina ime *u prish*.

Pjesa e hijezuar me italic e përbën fokusin. Ndërsa, referenca e re në diskurs do të ishte jo makina ime, por *makina e gruas*. Përveçqë, fokusi i fjalisë tregohet nëpërmjet një refernce të re të diskursit, sipas Lambrecht, fokusi, po ashtu, shenjohe nëpërmjet vendit të theksit kryesor të fjalisë, i cili karakterizohet nga lartësia e tonit. Theksi i fjalisë shërben si *shenjues i fokusit*, d.m.th. si treguesi formal i strukturës së fokusit të fjalisë. Ai po shtu jep

shembuj edhe kur theksi i fjalisë bie vetëm në temë ose kryefjalë, fusha e fokusit si domen e "informacionit të ri" shtrihet në të gjithë propozimin.

Koncepti i Lambrechtit për strukturën e fokusit zhvillohet më tej në konceptet e fushës potenciale dhe aktuale të fokusit nga Van Valin (1993). Në RRG, fusha potenciale e fokusit i referohet fushës sintaksore, ku mund të ndodhë fokusi. Fusha aktuale e fokusit është vendi ku fokusi ndodh në një strukturë të caktuar (Van Valin & LaPolla 1997: 212). Kjo kornizë ofron një alternativë ndaj FSP kur merret parasysh çështja e ndryshimeve të renditjes së fjalëve. Ashtu si në FSP, ai përfshin statusin e referuesve diskursivë në strukturën sintaksore. Presupozimi pragmatik është i ngjashëm me konceptin FSP të temës; si rema ashtu edhe fokusi shoqërohen me pozicionin përfundimtar të fjalisë në thëniet e pashënuara. Ashtu si me informacionin rematik, fokusi nuk është gjithmonë i kufizuar në pozicionin përfundimtar në fjali dhe mund të ndodhë kudo. Van Valin dhe LaPolla tregojnë se një gjuhë e caktuar mund të ketë një pozicion specifik, të quajtur pozicion i pashënuar i ngushtë i fokusit; kjo është ajo ku zakonisht vendoset materiali fokal i gjatësisë së një përbërësi të vetëm (1997: 209). Kur një material i tillë fokal ndodh në pozicione të tjera, struktura e fokusit të ngushtë të shënuar evokohet. Në fakt, përqendrimi i fokusit përcaktohet nga mënyra se si informacioni shpërndahet brenda një fjalie. Sidoqoftë, një ndryshim thelbësor midis qasjeve Lambrechtian dhe tradicionale të FSP është se i pari e trajton informacionin si një nivel të veçantë të përfaqësimit gjuhësor. Teoria e Lambrecht, siç u miratua nga Van Valin, nuk segmenton më informacionin propozues në pjesë ‘të vjetra’ dhe ‘të reja’ të cilat hartohen në sintaksë. Përkundrazi, informacioni shihet si një veti të denotative, jo e njësisive leksikore dhe e përbërësve sintaksorë. Kjo metodë lejon RRG ta marrë problemin e “rendit të lirë të fjalëve” përtej linearizimit sintaksor të përbërësve të fjalive në FSP dhe më tepër t’i eksplorojë marrëdhëniet midis formës dhe funksionit në mënyrë që të përcaktojë sesi renditen fjalët e ndryshme në gramatikë.

4.2. Rendi kanonik i fjalëve dhe variacionet konfiguracionale në gjuhën shqipe

Në fjalitë deklarative e transitive kemi rendin kanonik kryefjalë + kallëzues + kundrinë (SVO):

- a. *Vajza këndon një këngë. (SVO)*

Ky rend sipas Lambrecht-it (ibid. 17) është *pragmatikisht i pashënuar* dhe se ky model ka shpërndarje më të madhe. Ndërsa, renditjet e tjera alternative janë *pragmatikisht të shënuara*. Ato supozojmë të ndodhin për shkak të ndikimit të strukturës së informacionit, pra për shkak se motivohen nga dukuritë pragmatiko-semantike. Të tilla janë: OVS; SOV; VSO; VS; SV.

- b. *Një këngë këndon vajza. (OVS)*
c. *Vajza një këngë këndon. (SOV)*
d. *Këndon vajza një këngë. (VSO)*
e. *Këndohej kënga. (VS)*
f. *Këngë këndohet. (SV)*

Sipas Rugova dhe Sejdiu-Rugova (2015: 118), transformimet e tilla në rendin e fjalëve të fjalisë nën a, si në: b, c dhe d janë variante të së parës dhe në rrafshin gramatikor janë korrekte, ndonëse shembulli i fjalisë së parë në gjuhën shqipe është më i pritshëm.

Ndërkaq, sa u përket ndryshimeve të mundshme të renditjes së fjalëve, sipas gjenaritivizmit, në gjuhët me rend të lirë, pra konfigurimeve variacionale është argumentuar se këto janë një pasojë që shkaktohet nga lëvizja *A-bar*. Prandaj, për t'i vëshguar alternativet në renditjen e fjalëve i referohemi Programit Minimalist të Chomskyt (1993, 1995) nëpërmjet të cilit analizohen lëvizjet që shkaktohen në strukturën e fjalisë. Sipas këtij programi, strukturat janë ndërtuar përmes "Merge". "Merge" klasifikohet më tej si "external merge" (EM) dhe "internal merge" (IM). Chomsky (2008: 140) sugjeron që "(...) EM jep strukturë të përgjithshme të argumentit (rolet theta, hierarkitë kartografike); dhe IM jep veti të lidhura me diskursin, siç janë informacioni dhe specifikimi i njohur, së bashku me efektet e fushave. " Në një kuptim, fazat, kokat e të cilave janë vendi i të gjitha

tipareve, rrjedhin përmes “external merge”. Pra, varësisht nga gjendja e “external merge” ndryshon edhe struktura e përgjithshme e “internal merge”. Prandaj, në një gjuhë si shqipja është e nevojshme të studiohet struktura e frazave, duke iu referuar Programit Minimalist, pasi operacionet e lëvizjes shkaktohen nga qëllime të lidhura me diskursin.

Këtë do ta diskutojmë më gjerësisht më poshtë.

4.3. Periferia dhe hartografia majtas

Propozimi që zhvillohet në këtë kapitull merr si pikënisje idenë e *hartografisë klauzale* të popullarizuar nga Rizzi (1997) (dhe të përpunuar në një numër punimesh nga Rizzi 2001, 2004, 2006, Belletti 2004, Beninca dhe Polletto 2004, Frascarelli dhe Hinterhölzl 2007, ndër të tjera), megjithëse largohet nga propozimi origjinal i Rizzi-it (1997) dhe të tjerët të përmendur më lart në disa aspekte në zbatim.

Një veti thelbësore e qasjeve *hartografike* ndaj strukturës së klauzës është se ato supozojnë një hartë transparente sintaksë-diskurs. Në strukturën e artikuluar të CP-së së sugjeruar nga Rizzi (2004) të dhënë në (1), për shembull, pozicioni specifikues i Top(ic)P është hartuar si më poshtë në fig.1, ndërsa XP-të që mund shtrihen brenda domenit të topikës mund të kenë funksione të ndryshme sintaksore, si: IO ose DO, dhe këto mund të lëvizin në pozitën e specifikuesit të topikës për arsye të funksionit diskursiv që mund të kenë. Po e shohim diagramin më poshtë:





Fig.1

Në strukturën e artikuluar të CP të sugjeruar në Rizzi (2004) të dhënë në (1), për shembull, pozicioni specifikues i Top(ic)P është hartuar ekskluzivisht në një funksion subjektit, dhe pozicioni specifikues i Foc (us)P është hartuar ekskluzivisht në një funksion fokus (që zakonisht e përfshin predikatin), dhe kështu me radhë.

Ky diagram mund të jetë ideal për fjalitë me rend kanonik (SVO), ku S do të jetë në pozitën e topikës dhe V së bashku me O në projektionin e fokusit, kur fokusi është fokus i ngushtë.

Topika është e koduar në sintaksë, duke projektuar kështu strukturën e saj të frazës si **TopP** (Rizzi, 1997). Në shqip, zakonisht topika realizohet në periferinë e majtë të një fjalie dhe karakterizohet nga një ton i ulët dhe kur një kundrinë topikalizohet, pra zhvendoset majtas shkaktohet një operacion i lëvizjes sintaksore, kështu shfaqet një alternim i renditjes së fjalëve. Po e marrim një shembull, si: *Këngën këndon vajza* dhe po e paraqesim sipas parimeve minimaliste. Fjalja më poshtë e ilustron topikalizimin e një kundrine të drejtë në shqip:



Ndërkaq sa i përket pozitës së fokusit në hartën minimaliste, ekziston një projektion unik i fokusit i vendosur midis projeksioneve të shumëfishta të topikave, të cilat janë rekursive (e kemi parë në kapitullin paraprak për fokusin).

4.4. Aleternimi i XP-ve në pozitën e fokusit dhe topikës

Tani do t'i shohim disa raste të alternimeve të XP-ve që kanë funksione të ndryshme sintaksore në gjuhën shqipe, por që varësisht nga funksioni diskursiv lëvizin në domentet e topikës ose fokusit. Për shembull, një DO dhe IO mund ta zënë pozitën e topikës jo vetëm subjekti i fjalisë.

1. Ai ia kushtoi një këngë asaj

S V DO IO

2. Një këngë ia kushtoi ai asaj

DO V S IO

3. Asaj një këngë ia kushtoi ai

IO DO V S

Më lart e pamë që zakonisht topika (TopP) realizohet në periferinë e majtë të një fjalie dhe karakterizohet nga një ton i ulët. Në domenin e saj mund të plotësohet nga kryefjalë si në rastin (1), po ashtu nga një kundrinë e drejtë si në rastin (2) dhe mund të plotësohet nga një kundrinë e zhdrejtë si në rastin (3). Në dy rastet e fundit një DO dhe IO lëviz ose ngjitet lart në pozicionin e Spec. Kur një kundrinë (e drejtë ose ë zhdrejtë) topikalizohet, pra zhvendoset majtas shkaktohet një operacion i lëvizjes sintaksore, kështu shfaqet një alternativim i renditjes së fjalëve. Arsyeja e lëvizjes së kundrinave (IO dhe DO) në

pozitën e Spec është se i nënshtrohen lëvizjes DA dhe rendi linear varet nga funksioni diskursiv i kundrinave (Şener 2010).

Për lëvizjet sintaksore që ndodhin dhe shkaktojnë alternime në renditjen e fjalëve janë dhënë disa teori. Ndër teoritë e para është ajo e Chomsky (1995) që u pasua nga Rizzi (1997, 2004). Sipas tyre, sa u përket ndryshimeve të mundshme të renditjes së fjalëve në gjuhët me rend të lirë, shihet si rezultat i operacioneve lëvizëse krejtësisht opsionale nga disa gjuhëtarë dhe është argumentuar se ajo është një pasojë që shkaktohet nga lëvizja *A-bar*. Kjo do të na detyronte të konkludojmë se subjektet e brendshme të VP (si dhe argumentet e tjera) mund të lëvizin vetëm në pozicionet *A-bar*. Së Kështu, sipas këtij këndvështrimi, në një gjuhë si anglishtja, e cila e ka topikën të parë në fjalitë deklarative, ky pozicion para I do të ishte një pozicion *A-bar*. Kjo ngre të njëjtin problem siç u përmend më lart, d.m.th., nëse objekti lëviz në një pozicion të jashtëm VP për të marrë veçorinë e rasës (*case*), atëherë kjo lëvizje do të ishte në një pozicion *A-bar* (theta jo (potencial) duke rezultuar në një zinxhir koka e të cilit është e markuar me *case*. Pikëpamja mbizotëruese është se *case* është caktuar në bishtin e një zinxhiri të formuar nga lëvizja nga një pozicion A në një pozicion *A-bar*.

Po e marrim këtë shembull:

[_{IP} Genci [_{VP} duket [_{CP} se vetë [_{VP} ka qëlluar Lumin]

Meqenëse *vetë* duhet të jetë i lidhur me SE *Genci*, ndërsa SE *Genci* duhet të jetë i lirë prej *vetë*, SE *Genci* duhet të zërë një pozicion që është në domenin e kushteve detyruese A dhe B. Kjo do të thotë, *Genci* duhet të jetë në një pozicion A. Ky argument në vetvete tregon se duhet të ketë pozicione A të jashtme nga VP. Në këtë rast përdoren argumente të këtij lloji që përfshijnë efekte të dobëta të kryqëzimit, kufizime të detyrueshme dhe të lokalitetit në lëvizje për të treguar se ka një shumëllojshmëri pozicionesh që kanë karakterin e pozicionit të zënë nga SE *Genci* në fjalinë më lart.

Chomsky (2000, 2001) propozon që kontrollimi i veçorive, mekanizmi i licencimit dhe lëvizjes sintaksore, të bëhet me anë të operacionit Agree. Në këtë sistem, elementet sintaksore mund të hyjnë në derivacion me veçori që janë [uF], të cilat më pas

kontrollohen dhe fshihen gjatë derivimit. Ekziston një lidhje Agree midis dy objekteve sintaksore, Probe dhe Goal. Për Chomsky (2001), Agree zbatohet kur plotësohen kushtet më poshtë:

- a. D(P) (i.e., domain of P(robe)) is the sister of P.
- b. Locality reduces to ‘closest c-command’
- c. P and G(oal) must be active (=Activity Condition, see below).

Një tjetër vështrim për lëvizjet sintaksore:

Ideja e theksimit të fokusit dhe lidhjes së tij me agrimentin shtrohet në një teori që postulon tipare formale që përputhen, si në rastin, për shembull, të veçorive ϕ , dhe së bashku me EPP-në, ngre një XP me 'përputhje' me Specin e TP. Kjo është një teori e lëvizjes.

Por lëvizja nuk kufizohet vetëm në ngritjen e DP-së nominative në Spec të TP-së nga EPP. Ka edhe lëvizje të tjera XP. Më poshtë është një listë e pjeshme që përfshin lëvizjen “marrëveshje” të SE-së.

(1) Lëvizjet në TP dhe më lart sipas Miyagawa (2007)

- lëvizja-wh
- lëvizja e fokusit
- Lëvizja “agreement”
- scrambling (Miyagawa 2007)

Analiza e këtyre operacioneve është se ato janë në thelb të njëjta: pas Chomsky-t (2000), të gjitha janë shkaktuar nga veçoria EPP në kokën përkatëse. Qoftë lëvizja e subjektit në Spec të TP për të përmbushur kërkesën EPP të T, ose lëvizje e sintagmës-wh

në Spec të CP, lëvizja nxitet nga EPP. EPP fillimisht u sugjerua nga Chomsky (1981) për shkak të shfaqjes së shprehjes në ndërtimet ekzistenciale. Te studimet e Chomsky-t (2000,2001), lëvizja e X drejtohet nga tipari/vetia EPP e C°:

Në të kundërt, për shembull, marrëveshja temë-folje, zakonisht interpretohet si në T. Ndërsa nuk është plotësisht e pabesueshme që dy tipare në koka thelbësisht të ndryshme të ndryshojnë parametrikisht, do të ishte më e besueshme nëse ato nuk janë në koka kaq shumë të ndryshme. Ka prova të mjaftueshme për të lidhur fokusin me një kokë më të lartë se T, kështu që nëse do të bëjmë diçka për 'barazinë e kokës', duhet të shohim marrëveshjen. Për të arritur drejt te pika, unë sugjeroj që marrëveshja, për shembull, marrëveshja temë-folje, lidhet kryesisht me C-në. Ndërsa një numër gjuhëtarësh kanë propozuar që marrëveshja plotësues-subjekt është një shembull i marrëveshjes për ngritjen e T në C, Carstens (2003) argumenton se marrëveshja e ka origjinën në C (shih Carstens (2003) për referenca shtesë pro dhe kundër kësaj ideje). Në këta shembuj, folja e ngulitur prek gjithashtu për marrëveshje, duke sugjeruar që marrëveshja shfaqet edhe në T. Kjo sugjeron që marrëveshja për C mund të depërtojë nga C në T. Duke ruajtur pikëpamjen se EPP është në T, ne kemi përfaqësimet e mëposhtme për fokus dhe agreement.

Sipas Miyagawa (2007), karakteristika e fokusit/marrëveshjes përputhet me një veçori në një kategori në sintaksë dhe, në shumicën e rasteve, kjo kategori ngrihet në Spec të TP për të kënaqur EPP-në. A përbëjnë fokusi dhe marrëveshja një lloj klase natyrore? Simpson dhe Wu (2001) tregojnë se historikisht, marrëveshja në një sërë gjuhësh u zhvillua nga një strukturë fokusi. Megjithëse disa nga ato me të cilat ata trajtojnë është përputhshmëria, si në frëngjisht *ne...pas*, argumenti i tyre se varësitë si përputhshmëria/marrëveshja gjejnë burim historik në strukturën e fokusit është sugjerues i fokusit dhe marrëveshjes që përbëjnë dy polaritetet e një variacioni parametrik.

Dy teoritë që diskutuam më lart supozojmë që nuk përshtaten me natyrën dhe analizën që do të bëjmë për shqipen. Prandaj, mendojmë që teoria e tretë që do ta diskutojmë më poshtë përshtatet më shumë dhe përmes saj mund t'i nxjerrim rezultatet që supozojmë se pranohen nga natyra e shqipes.

Kjo teori që e diskuton hollësisht Şener (2010) ka të bëjë me lëvizjen e XP-ve, të cilat ai supozon se bartin disa tipare formale të lidhura me diskursin si [tema], [DA], me pozicionet Spec të projeksioneve funksionale në ndarje të domenit CP. Dhe pyetja specifike që mund të bëjmë është se çfarë e shtyn lëvizjen e XP-ve në domenin CP në një gjuhë si shqipja. Sener (2010) ka vënë në dukje tashmë një përgjigje të mundshme për këtë pyetje që shprehëm më lart dhe përgjigjen e kësaj pyetje e jep duke e mështetur teorinë e tij me teorinë e Rizzit, përkatësisht me Qasjen e Kriterit të Rizzi (1997). Ai fillon me një përmbledhje të shkurtër të analizës së pyetjeve-wh të ofruara në Chomsky (2000, 2001) me supozimin se tiparet formale të diskursit që janë të rëndësishme për llogaritjen sintaksore kanë një afinitet me tiparin [wh/Q] (shih Bošković 2008 për diskutim).

Analiza e pyetjeve-wh nga Chomsky (2000, 2001) mbështetet shumë në Kushtin e Aktivitetit (AC) të dhënë më lart, i cili thotë se një element X mund t'i nënshtrohet Agree dhe/ose Move vetëm nëse ka një [uF]. Në sistemin e Chomsky (2000, 2001), Probe dhe Objektivi ndajnë një veçori dhe kjo veçori duhet të jetë e pakuptueshme në Probe. Merrni parasysh tani skenarin e kontrollit të veçorive të dhënë në (45): Supozoni se një SE-wh ka veçorinë [uWh] përveç veçorisë [iQ], dhe në këtë mënyrë është e dukshme për C për Agree. Te studimet e Chomsky (2000,2001), lëvizja e X drejtohet nga tipari/vetia EPP e C°:

C NP-wh

[uQ] [iQ]

EPP [uWh]

Tipari [uWh] në elementin-wh është ajo që e bën atë të dukshëm për Agree dhe lëvizjen në Spec-CP, duke e lejuar atë të kontrollojë veçorinë EPP të pyetjes C: Tipari [uQ] i C i nënshtrohet kontrollit me [iQ] tipari i NP-wh, dhe [uWh] i NP-wh kontrollohet si një refleks i lidhjes kontrolluese midis veçorisë [uQ] dhe [iQ] të C dhe NP-wh.

E thënë thjesht, sipas Şener (2010), të gjitha këto tipare të përmendura më lart lidhen edhe me veçoritë diskursive për të shkaktuar lëvizjen e një XP -je nga pozicioni i saj në një tjetër pozicion.

4.5. Veçoritë e lidhura me diskursin dhe shpërndarja e [OP] në shqip


Şener (2010) mendon se përveç veçorive infeksionale si [phi] dhe [Case] edhe XP-të argumentuese dhe joargumentuese mbajnë gjithmonë një sërë veçorish [diskursive] Këtë mund ta provojmë edhe në shqip. Përpara se ta zgjerojmë analizën duhet ta dimë që të gjitha XP-të që e kanë veçorinë DA, janë të përmenduar më parë në diskurs, pra janë të njohura për dëgjuesin dhe hyjnë në domenin e topikës. Prandaj një XP që e ka veçorinë [DA] është TopP, ndërsa një XP që nuk e ka veçorinë [DA] është fokus.

Po e marrim një shembull:

Konteksti: Fshati Korishë dallohet për vetorganizim të banorëve, këtë praktikë do ta zbatojë edhe gjatë kohës së karantinës, të imponuar për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Vetorganizimin nuk e harrojnë edhe gjatë karantinës (tekst) fq 4.

DP-ja apo objekti *vetorganizimin* e ka veçorinë [DA], meqë përmendet më përpara në diskurs. Andaj në diagramin e mëposhtëm do të shohim si lëvizë nga pozicioni bazë drejt pozicionit të TopP.



Objekti DP me grupin e veçorive [iTopic] dhe [uOP]² i nënshtrohet lëvizjes në Spec të TopP përmes skajit të vP, siç diktohet në diagram, duke qenë se vP është një fazë. Ndërsa, Move i nënshtrohet PIC në sistemin aktual (ndryshe nga Agree). Prania e [uOP]

² Të përbërësit që mbajnë një veçori [topikë] ose një veçori [anaforike të diskursit] kanë gjithashtu një veçori [uOP], e cila shkakton lëvizjen e tyre. Me fjalë të tjera, veçoria [uOP] shkakton operacionet e lëvizjes së drejtuar nga diskursi.

në objektin DP është ajo që detyron lëvizjen e tij dhe gjithashtu shndërrimin e tij në një Probe-me-lëvizje; duke qenë një Probe në Spec të TopP, objekti DP c-komandon dhe kështu vendos një lidhje Agree me veçoritë përkatëse të kontrollit të funksionit plotësues Top°. Meqenëse folja VP ka [iFocus], i mungon [uOP], prandaj nuk mund t'i nënshtrohet lëvizjes.

Megjithëse fjalia e dhënë dhe derivimi i saj është i thjeshtë, zbulon një model të përgjithshëm analize sipas sistemit aktual: Fokusi mbetet in-situ ndërsa çdo përbërës me jo-fokus lëviz në pozicionet periferike majtas. Natyrisht, ky është një sistem mjaft i lidhur në atë që të gjitha operacionet e lëvizjes drejtohen nga tipare të bazuara në ligjërim.

4.6. Efektet diskursive-pragmatike në konfigurimet variacionale

Një pikë kryesore e bërë në këtë disertacion deri më tani ka qenë se fleksibiliteti i rendit të fjalëve në shqip është shumë i lidhur nga tiparet diskursive-pragmatike për t'u trajtuar në këtë kapitull. Lëvizja e drejtuar nga tiparet e argumentuar këtu është treguar se ofron një qasje të suksesshme për ndryshimin e rendit të fjalëve në shqip dhe hartimi i tyre ndërthuret me diskursin e pragmatikën.

Të dhënat që do të shqyrtohen në vazhdim që përfshijnë lidhjen midis renditjes dhe tipareve [DA] duke ofruar për këtë sistem “të lidhur ngushtë” ku të gjitha lëvizjet ndodhin nën efekte ligjëruese-pragmatike.


4.7. Renditja kanonike e fjalëve në gjuhën shqipe

Në një fjali kalimtare kanonike, kryefjala i paraprin foljes dhe objekti e ndjek atë. Së bashku, folja dhe objekti funksionojnë si një fokus për temën parafjalore. Gundel (1988)


vëren se çdo fjali duhet të ketë një koment (fokus), por jo të gjitha fjalitë duhet të kanë një fokus të ngushtë. Po i marrim disa shembuj:

1. *Mavraj largon topin.* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)
2. *Hysa do ta largojë topin.* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)
3. *(Sonte) Ø kam ftuar një panel të zgjeruar.* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
4. *Ø mos me dhonë naj deklaratë....* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
5. *Prokuroria kërkon dënimin e Agim Ademit dhe Muharrem Ramës.* (*Koha ditore*, 10 mars 2023)
6. *Papa Françesku do ta vizitojë Ukrainën.* (*Koha ditore*, 11 mars 2023)
7. *Dendias viziton Kosovën të dielën.* (*Koha ditore*, 12 mars 2023)

Shembullin e parë do ta paraqesim përmes diagramit:



Siç po shihet në diagram, TopP është në periferinë e majtë, duke qenë si pozicion i synuar për subjektet apo kryefjalët në rendin SVO. Ndërsa FocP projektohet mbi domenin vP që përfshin foljen V dhe kundrinën e drejtë (DO). Si në rastin më poshtë:



Ky rend asnjans ose neutral në të gjitha fjalitë SVO paraqet gjithashtu një model prozodik neutral në gjuhën shqipe, në të cilin theksi bërthamor ose kulmi i intonacionit të fjalisë bie në rrokjen e theksuar në të djathtë, në rastin e shembullit të parë *Mavraj largon topin*, bie në morën e rrokjes së theksuar, në TOP-in.

Por siç thamë, në gjuhët konfiguruese kemi fleksibilitet të rendit të fjalëve në fjali dhe rendi SVO nuk është i vetmi se shfaqet me konfiguracionet variacionale. Prandaj, do ta shohim realizimin e tyre dhe lëvizjet që shkaktohen.

4.8. Konfiguracionet variacionale të SOV dhe OSV në gjuhën shqipe

4.8.1 Rendi OSV

Deri më tani kemi argumentuar se kushti kryesor për lëvizshmërinë e një përbërësi ka të bëjë nëse ai ka veçori [përqendrimi] apo jo; Përbërësit [–fokus] duhet të

lëvizin, ndërsa [+fokus] duhet të qëndrojnë në pozicionin bazë të gjeneruar, përveç rasteve kur është fokusi emfatik. Kemi supozuar gjithashtu praninë e dy llojeve të përbërësve [-fokus]; Temat dhe DA. Duke lënë mënjane përkohësisht DA-të e postuara, do të përqendrohemi në Temat dhe ato DA që vendosen në fushën parafoljore (domethënë, DA-të kontrastive).


Fjali të tilla (OSV) ofrojnë mbështetje të mëtejshme për pretendimet se (i) Fokusi mbetet in-situ, (ii) kopjet bazë të XP-ve në funksion të kundrinave që e kanë veçorinë DA zhvendosen në TopP, ndërkaq NP-të në funksion të kryefjalës nuk arrijnë të kalojnë në Spec, IP, por qëndrojnë në një projektion më poshtë. Kalimi i XP-ve që janë në funksion të kundrinave që e kanë veçorinë DA në TopP ndodh pasi është e pamundur të rindërtohet topika brenda në domenin e fokusit, është e pamundur të rindërtohet topika në pozicionin bazë, për shkak të funksionimit të konvertimit të gjurmëve (trace). Prandaj, DO ashtu edhe subjekti i nënshtrohen lëvizjes periferike majtas (tema dhe lëvizja DA, respektivisht) Po i marrim disa shembuj nga korpusi ynë:

8. *Alban Krasniqin, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka emëruar të premtën anëtar të ri të Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). (OSV) (Koha ditore, 24 shkurt 2023)*

Titulli: Alban Krasniqi emërohet anëtar i ri i Vetëvendosjes në KQZ

Konteksti: Lajmi është bërë i njohur për audiencën që nga titulli. Prandaj, DP-ja që është në funksion të kundrinës e ka veçorinë DA dhe ka tendencë të zhvendost nga pozita in-situ në pozitën e Spec, të TopP. Ndërkaq, subjekti tjetër do të bjerë më poshtë dhe do të rindërtohet në një pozitë më poshtë të Spec, IP.

Këtë do ta paraqesim përmes diagramit të kuadrit minimalist:



Shembuj të tjerë:

Të hyrat i kanë marramendëse (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

Konteksti: Ajo për të cilën po bëhët fjalë janë paratë që fitojnë reperët në Kosovë nga koncertet dhe në këtë rast të hyrat përdoret pasi u nënkuptua që po bëhët fjalë për përfitimet e tyre. Kështu që, DP-ja (*të hyrat*) që është në funksion të kundrinës e ka veçorinë DA, meqë u bë e njohur përmes hironimit. Prandaj, ka tendencë të zhvendost nga pozita in-situ në pozitën e Spec, të TopP. Ndërsa, subjekti elipsë do të bjerë më poshtë dhe do të rindërtohet në një pozitë më poshtë të Spec, IP.

Për çdo lloj zhvillimi kontenstojnë... (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Shqipja manifeston një model shumë të ngjashëm të markimit të informacionit të dhënë jo vetëm nëpërmjet kundrinave të drejta, por edhe nëpërmjet kundrinave të zhdrejta. Dhe kjo renditje e OSV-së e është e përshtatshme në kontekstet vetëm kur kundrina e zhdrejtë përmban informacionin e dhënë.

Konteksti: Komentatori në këtë rast na bën me dije se përsëri po ndodh një zhvillim që kontestohet, pra nuk është i vetmi zhvillim që u kontestua. Andaj IO (*për çdo lloj zhvillimi*) është bërë e qartë më herët, kështu që e ka veçorinë DA dhe ka tendencë të zhvendost nga pozita in-situ në pozitën e Spec, të TopP. Ndërkaq, subjekti tjetër do të bjerë më poshtë dhe do të rindërtohet në një pozitë më poshtë të Spec, IP.

4.9.2. Rendi SOV

Në variacionin konfiguracional SOV, XP-ja që funksionon si subjekt bart veçorinë DA, pasi njihet nga konteksti, ndërsa XP-ja që funksionon si objekt bart veçorinë DA1 dhe në raport me variacionin konfiguracional OSV, në këtë variacion DO, meqë është DA2 i nënshtrohet lëvizjes nga pozita e TopP. Në këtë rast pozitat e subjektit dhe objektit alternohen për shkak të funksionit diskursiv.

Shembujt


Kina SHBA-në e ka akuzuar se po përhap dezinformata për armatosjen e Ruisë nga Pekini. (Koha ditore, 20 shkurt 2023)

Titulli: Kina akuzon SHBA-në për fushatë dezinformuese

Mbititull: *Kina ka akuzuar SHBA-në se po përhap dezinformata për armatosjen e Ruisë nga Pekini duke i kërkuar Uashingtonit që të ndalojë “heqjen e fajit dhe përhapjen e dezinformatave”.*

Konteksti: Lajmi është bërë i njohur për audiencën që nga titulli dhe mbititulli. Prandaj, DP-ja (Kina) në funksion të subjektit është në pozitën e specifikuesit në TopP që, ndërkaq DP-ja (ShBA-në) që është në funksion të kundrinës e ka veçorinë DA1 dhe ka tendencë të zhvendost nga pozita in-situ në VP në pozitën e Spec, të DA1. Kundrina, subjekti tjetër do të bjerë më poshtë dhe do të rindërtohet në një pozitë më poshtë të Spec, IP.

Po e japim shembullin përmes diagramit:



Për të plotësuar paradigmen, paraqesim shembujt më poshtë. Modelet e mëposhtme janë të njëjta si modeli lart.

Unë si laik pamje të tilla vetëm në filma kam pa... (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)


Konteksti: në këtë emision po diskutohet për vrasjen që ishte kryer dhe kishte video, ato pamje i pa i tërë publiku. Dhe tani po flitej pikërisht për ato pamje. Folësi 1, meqë është fjala për DP (pamje të tilla) në tanimë ajo shtrihet në domenin e topikës, pasi është e njohur për dëgjuesit, prandaj edhe alternohet, pra ikën nga pozita in-situ, para predikatit që është fokusi i fjalisë. Prandaj sikur te fjalia paraprake, DP-ja realizohet dhe ngjitet lart nën kupolën e Da1, për të qenë sa më pranë specifikuesit të TopP, për të qëndruar në domenin e saj. Prandaj, e kemi këtë renditje SOV.

Po ti mos um fol për repin në Amerik / po flasim për repin e Kosovës.... (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

Konteksti: Po flitet për repin në Kosovë dhe debati nxehet midis F3 dhe F4, kur F3 flet për repin në Amerikë dhe F4 i nxehur i drejtohet me fjalinë që kemi marrë për shembull. Në këtë rast *ti* shkon në pozitën e specifikuesit TopP, ndërsa klitiku *um* (variant i *më*) rri në pozitën Da1.

Strukturisht, një XP që lëviz në Spec, DaP2 në mënyrë të qartë c-komandon një XP para-verbal që është Focus, por një XP i tillë nuk c-komandon XP-të e zhvendosura me temë ose DA1-të lëvizur në vendet e tyre përfundimtare të uljes që nga Temat para-verbale. dhe DA-të janë strukturalisht më të larta se një XP i lëvizur nga DA2.

Shembull që përputhet me diagramin e mëposhtëm: //po flasim për repin e Kosovës...// (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)



4.8.3. Konfiguracioni VS

Në disa kontekste, siç kemi thënë, topika mund të realizohet në mënyrë postverbale. Në rastet e mëposhtme të nxjerra nga korpusi ynë shihet se subjekti, duke qenë në rolin e e topikës e ndjek gjithmonë një folje në zgjedhimin jovepror. Pra, kemi një rend të përmbysur kallëzues/kryefjalë ose topikë/fokus, si në rastin më poshtë: ***Propozohet shtrenjtimi i faturave të mbeturinave***. Kjo lloj përmbysjeje është trajtuar si një manifestim ndërgjuhësor.

Ndërtimi VS në shumë gjuhë është interpretuar si një element tetik. Nuk ka shprehje të topikës në fjali, kështu që e gjithë fjalia ka një funksion fokusi. Topika pragmatike është është tipar i shumë gjuhëve, shqipja është një shembull tjetër i një gjuhe

që përdor format pasive të foljes për të shprehur një fjali tetike (1). Interpretimi tetik mund të nxirret nga përdorimi në fillim të ngjarjeve.

Po ilustrojmë një rend VS i cili mund të shqiptohet pa kontekst tekstual.

2. Ishte përballje e vështirë (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)
3. E tepron Mitrovic (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)
4. Vazhdon ta sulmojë... (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)
5. Propozohet shtrenjtimi i faturave të mbeturinav (Koha ditore, 12 mars 2023)
6. Zhduket një e mitur në Gjilan (Koha ditore, 11 mars 2023)
7. Vdes një foshnje dymuajshe në Prishtinë. (Koha ditore, 11 mars 2023)

Konstruksioni VS përdoret më së shumti për të shprehur llojin e fjalisë tetike që Lambrecht (1994) i referohet si “qendër e ngjarjes” së fjalisë tetike, ose si “entitet qendror”. Në të parën paraqitet një ngjarje ose situatë dhe në të dytën një entitet ose individ.

4.9.4. Variacionet konfiguracionale ditransitive

Shqipja në parim lejon edhe rendin IO»DO dhe DO»IO. Megjithatë, kur zbatohet për fjalitë ditransitive, rendi më i zakonshëm është DO»IO dhe DO-të janë strukturalisht më të larta se IO-të. Po i marrim dy shembuj:

Unë ia tregova ngjarjen secilit koleg.

Unë ia tregova secilit koleg ngjarjen.


DO në (1 dhe 2) është një NP *ngjarjen* dhe një IO është një QP. Dhe të dyja format janë korrekte dhe të pranueshme për dëgjuesin. E vetmja gjë që ndryshon është renditja DO»IO dhe IO»DO. Dallimi ndërmjet (1) dhe (2) ka të bëjë me funksionin diskursiv që kanë dhe folësit zgjedhin njëren ose tjetren varësisht nga rëndësia që kanë. Por ajo që është e rëndësishme është se në të dyja fjalitë DO-të dhe IO-të janë fokus, prandaj ato mbeten in-situ. Prandaj, më poshtë do t'i marrim dy shembuj të tjerë ku DO dhe IO lëvizin nga pozita e in-situ e fokusit.

Ngjarjen ia tregova secilit koleg.

Secilit koleg ia tregova ngjarjen.


Këtu edhe DO dhe IO në të dyja fjalitë i nënshtrohen lëvizjes DA, për shkak të funksionit që e kanë në diskurs, pra shtrihen në domenin e topikës. Po e paraqesim përmes diagramit:

*[DO[...vbl...]]_{CT} » FOCUS » V [IOQP]



Disponueshmëria e lidhjes së variablave në (1) tregon edhe një herë se një DO që i nënshtrohet lëvizjes DA në fushën parafoljore mund të rindërtohet në pozicionin e tij bazë nën IO sasiore, që është fokus, pra i palëvizur.

$[[IO_{[vbl^i]}]]_{CT} \gg [Subj]_{FOCUS} \gg V [DO]_{DA}$



Derivimi i (1) është përshkruar në (2) më poshtë, ku si IO sasiore ashtu edhe bartësi i ndryshores përemërore, domethënë DO, i nënshtrohen lëvizjes në pozicionet e tyre përfundimtare përmes skajit të fazës vP. Kjo është ajo që e bën të mundur lidhjen e variablave edhe pse DO e zhvendosur nga TopP nuk mund të rindërtohet në pozicionin e saj origjinal nën NP që është fokusi; rindërtimi i ndërmjetëm është i mjaftueshëm pasi IO gjithashtu lëviz.

Në dritën e këtyre vëzhgimeve, mund të vërtetojmë se kjo lëvizje është një pasojë e natyrshme e rendit/hierarkisë bazë të IO dhe DO në shqip, që është se folja komandon IO dhe DO.

Megjithëkëtë, në një rend kanonik të fjalëve në fjali DO zë pozitë më të lartë në diagram kur edhe IO dhe DO janë pjesë e fokusit. Mbështetje e mëtejshme për analizën e mësipërme vjen nga vëzhgimi se lidhja e ndryshueshme bëhet e mundur kur DO sasiore nuk i nënshtrohet lëvizjes, i nënshtrohet lëvizjes DA- siç tregohet më poshtë, ku IO është fokus:

Po e marrim një shembull tjetër:

A: Pse nuk e ke librin?

4.9. Përfundim:

Duke u nisur nga ideja e Şener (2010) që të gjitha XP-të argumentuese dhe joargumentuese mbajnë gjithmonë një sërë veçorish diskursive, që ndryshe njihen si elemente të diskursit anaforik (DA), pra janë një sërë veçorish të orientuara nga diskursi, supozojmë se të gjitha ata përbërës sintaksorë që kanë veçoritë DA, pra janë përmendur më parë në diskurs kanë tendencë të zhvendosen në periferinë e majtë, pozicion tipik i TopP, prandaj gjithë këta përbërës me vetinë DA synojnë të alternohen majtas, pra të lëvizin nga pozita e tyre in-situ.

Siç u përmend më lart, elementet/DA-të anaforike të ligjërit zakonisht shënojnë informacionin e dhënë në ligjërim dhe përemrat janë shembuj prototipikë të DA-ve. Sidoqoftë, duhet pasur shumë kujdes në lidhje me elemente të tilla në shqip, pasi shqipja është një gjuhë që lejon strategji të shumta për të akomoduar elementin [DA].

Në kuadër të këtij kapitulli për variacionet konfiguracionale kemi arritur që të vërtetojmë se elementet [DA] shtrihen brenda domenit të topikës. Ne, po ashtu, pamë disa raste të alternimeve të XP-ve që kanë funksione të ndryshme sintaksore në gjuhën shqipe, por që varësisht nga veçoria diskursive [+/-DA] lëvizin në domentet e topikës ose fokusit. Për shembull, edhe një DO dhe IO mund ta zë pozitën e topikës jo vetëm subjekti i fjalisë.

5. PËRFUNDIME

Në këtë punim është hetuar mënyra se si kodifikohet struktura e informacionit në gjuhën shqipe brenda fjalisë. Duke u nisur nga premisa se struktura e informacionit markohet gjuhësisht ndryshe në gjuhë të ndryshme, janë analizuar strategjitë gjuhësore që sinjalizojnë dy nocionet themelore (topikë dhe fokus) të SI-së në gjuhën shqipe. Këto strategji gjuhësore përbëhen nga ndërfaqet e shumëllojshme të faktorëve semantikë, pragmatikë, sintaksorë dhe prozodikë. Ndër mekanizmat gjuhësorë, që mendohet se luajnë rol në kodifikimin dhe strukturimin e informacionit në gjuhën shqipe, janë: mjetet prozodike që hamendësohet se e markojnë fokusin (FocP), duke e dalluar atë nga topika (TopP); tjetër mekanizëm është dyfishimi i kundrinave përmes klitikëve përemërorë, për të cilët pretendohet se e kodifikojnë topikën ose informacionin e dhënë më parë në diskursin paraprak; një strategji tjetër që besohet se përdor shqipja për ta realizuar strukturën e informacionit është konfigurimi variacional i fjalive, meqë është një gjuhë deri diku me rend të lirë.

Qysh në kapitullin hyrës është diskutuar për konceptin e strukturës së informacionit në përgjithësi, duke mos i ndarë “me thikë” njësitë e informacionit, pra topikën dhe fokusin. Megjithatë, gjithnjë është pranuar se secila fjali ndahet në dy njësi informimi **topika** dhe **fokusi**. Fokusi dhe topika janë nocione strukturore të rëndësishme të informacionit gjuhësor, pasi ato pasqyrojnë kufizimet e paketimit të informacionit në realizimin formal të fjalive.

Megjithëkëtë, vetëm këto nocione nuk i përthekojnë studimet mbi strukturën e informacionit, sepse ky nuk është përdorimi i vetëm i mundshëm i termit informacion, pasi ai gjithashtu mund ta përshkruajë mënyrën e përgjithshme në të cilën strukturohet informacioni i çfarëdo lloji qoftë. Madje, një nga gjërat e pakta mbi të cilat pajtohen plotësisht dhe praktikisht të gjithë studiuesit që merren me strukturën e informacionit është se terminologjia me të cilën përshkruhet struktura e informacionit është shumë e paqëndrueshme dhe konfuze (Bott 2007:1).

Andaj, në dy kapitujt e parë që u kushtohen nocionit të topikës dhe fokusit si dhe kodimit të tyre në gjuhën shqipe janë shtjelluar hollësisht të dy nocionet në disa këndvështrime, duke i nxjerrë në pah karakteristikat tipike semantike të tyre, karakteristikat tipike sintaksore të tyre, karakteristikat tipike prozodike të fokusit etj.

1. Sa i përket përkufizimit të **nocionit të temës/topikës dhe kodimit të topikës** në gjuhën shqipe, si rezultat i punës empirike të bërë janë nxjerrë disa përfundime:

❖ Topika është pjesa e fjalisë që lidhet kontekstualisht; ajo korrespondon me artikujt që folësi supozon se janë aktivizuar në kujtesën e dëgjuesit në një moment të caktuar kohe (Sgall et al. 1986:29).

❖ Tema është ai informacion për të cilin folësi supozon të jetë tashmë i pranishëm në vetëdijen e adresuesit gjatë kohës kur flet. (informacioni i dhënë, Chafe 1974: 111)

❖ Një referent interpretohet si temë e një propozimi, nëse në një situatë të caktuar propozimi është interpretuar si i lidhur me këtë referent, si shprehje e informacionit që është relevante dhe që rrit njohurinë e adresuesit për këtë referent (Lambrecht 1994: 131).

Ndërkaq, bazuar në rezultatet e analizës sintaksore dhe hulumtimit të bërë për sintagmën e topikës (TopP) janë nxjerrë disa përfundime:

Për një gjuhë si shqipja, së pari, mund të propozohet një ndarje themelore për mënyrën se si realizohen sintagmat e topikës. Sintagmat e topikës në gjuhën shqipe mund të kodohet në këto mënyra: topika mund të kodohet brenda një sintagme boshe, pra që nuk shprehet fonetikisht dhe, po ashtu, të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore. Topika mund të realizohet me kryefjalë boshe, me kundrinë boshe, të cilat nuk realizohet fonetikisht, por projektohet në mënyrë

sintaksore, duke u plotësuar pozicioni i saj në strukturën e thellë nga një përemër zero (*pro*).

Siç thamë, topika në gjuhën shqipe mund të realizohet nëpërmjet sintagmave apo përbërësve të tjerë sintaksorë që nuk shfaqen fare në strukturën sipërfaqësore, por në strukturën e thellë ata ekzistojnë. Zakonisht në këta përbërës të pashprehur sipërfaqësisht fshihet elementi topik, prandaj, pikërisht, ato kategori sintaksore që shtrihen në kufijtë e topikës mund të mos realizohen në strukturën sipërfaqësore (Rizzi 1982, Caselles 2004, Frascarelli 2007). Meqë këta përbërës sintaksorë (sintagmat e topikës) janë aktivizuar më parë në diskurs, janë entitete të njohura për dëgjuesin dhe folësin, nuk përsëriten, por mbesin entitete të heshtura/të pathëna (*silent*), por që realizohen në strukturën e thellë. Në gjuhën shqipe janë vënë re këto këto kategori boshe përmes së cilave realizohet topika:

d) *Genci nuk erdhi me ne. [∅]_{TopP} kishte shkuar më herët.* (kryefjalë me kategori boshe/null subject *pro*)

e) *Një top i rrezikshëm brenda zonës / [∅]_{TopP} e ka larguar më pas Mërgim Mavraj.* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Po ashtu, topika mund të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore. Këto janë rastet kur *TopP* kodohet nëpërmjet klitikëve, nëpërmjet përemrave, nëpërmjet zhvendosjes djathtas ose majtas, dhe nëpërmjet sintagmave leksikore (XP). Po e marrim nga një shembull për secilin rast:

a) *[E]_{TopP} ka larguar (topin).* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

b) *Një polic i njësisë antidrogë ka qëlluar aty rastësisht afër vendit të ngjarjes / e ka ndalu dorasin / [Ai]_{TopP} ka arritë me goditë...* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

c) *Kosovës i mungon [puna ekipore në luftën kundër kancerit]_{TopP}.* (*Koha ditore*, 5 tetor 2014)

Konteksti: - “Plani evropian shumë pak i adreson kërkesat e serbëve në Kosovë” (3 mars 2023, Koha)

d) Analistët serbë në veri e shohin [*Planin evropian si njohje të Kosovës*] _{TopP}. (3 mars 2023, Koha).

2. Sa i përket përkufizimit të **nocionit të fokusit/remës dhe kodimit të fokusit** në gjuhën shqipe, nga puna empirike dhe analizat e bëra deri më tani tregohet se si për t’u koduar domenet e fokusit, fushat prozodike, theksi i fjalisë, semantika, pragmatika dhe sintaksa ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

❖ Sipas semantikës së fokusit në një kornizë gjenerative, fokusi i kundërvihet presupozimit, me ç’rast fokusi përkufizohet “si fraza që përmban qendrën e intonacionit”; ndërsa presupozimi përkufizohet si “informacioni në fjali që supozohet nga folësi, për t’u ndarë nga ai dhe dëgjuesi.

❖ Sipas kësaj semantike brenda kuadrit gjenerativist, tërheqja e propozimit më lart qëndron në llogarinë që ofron për interpretimin e fokusit si *informacion i ri* dhe se fokusi është “informacioni në fjali që supozohet nga folësi që nuk duhet të ndahet nga ai dhe dëgjuesi”.

❖ Tutje, të qenit *informacion i ri* në një fjali është një kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm për interpretimin si fokus.

❖ Tradicionalisht, fokusi është identifikuar si përbërësi që i përgjigjet një pyetjeje (*wh-question*), me ç’rast informacioni që bart kjo pyetje është krejtësisht i ri (Erteschik-Shir 1997, 2007). Materiali në përgjigje që korrespondon me përbërësin në pyetjen-*wh* që është i fokusuar (Büring 2007). Ndërkaq, presupozimi është ai që e bart informacionin e dhënë.

❖ Ndërkaq, sipas kuadrit të semantikës alternative, funksioni i fokusit është të evokojë alternativa. Çdo shprehje tani do të ketë dy vlera të ndryshme semantike: vlerën e saj të zakonshme semantike dhe “vlerën

semantike të fokusit”, ku vlera semantike e fokusit do të përbëhet nga një grup alternativash:

Ai [do kafe]_{Foc} ose [do çaj]_{Foc} vlera semantike e fokusit

Vlera semantike e fokusit të tij është grupi i të gjitha propozimeve (“alternative”) të formës “[do kafe]_{Foc} ose [do çaj]_{Foc}”.

3. Diagnostikimi i fokusit në gjuhën shqipe

Për shqipen mund të përdorim disa teknika që e nxjerrin në pah fokusin që përdoren edhe nëpër gjuhë të tjera (Shih: Jenneke 2016), një nga këto teknika është teknika e elicimitit përmes së cilës për të nxjerrë fokusin, ngjallet konteksti, po e marrim një shembull:

e) **Konteksti:** *Ka një problem për Andi Lilën//Një goditje që [Ø]TOP ka marrë nga topi// [E] TOP [kanë goditur]_{FocP}//* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Nga konteksti nënkuptohet se Andi Lila është ai që është lënduar dhe ka një problem. Ky problem që ndaloi ndeshjen ka të bëjë me lëndimin e Lilës që e mori nga goditja.

Çfarë problemi ka Lila? – E [kanë goditur]_{FocP}.

Teknikat e tjera që e nxjerrin në pah fokusin lidhen me çiftin pyetje – përgjigje, me ç’rast përgjigjja e nxjerrë është e barabartë me fokusin. Janë disa lloje pyetjesh që bëhen për ta nxjerrë fokusin. Do t’i rendisim më poshtë: **Pyetjet-wh**; Testi *pyetje-përgjigje (Q-A)*; Përgjigjet e fragmentuara; Pyetje alternative;

Përmes këtij testi do t’i analizojmë edhe disa shembuj nga korpusi ynë:

1. *Dy zyrtarë të Serbisë nesër me leje vizitojnë Kosovën* (Koha Ditore 19 prill 2018)

Varësisht nga vlera semantike e përbërësve sintaksorë në këtë fjali për lexuesin dhe varësisht nga ajo që do të nxjerrë lexuesi e formulon edhe pyetjen me të cilën e nxjerr përgjigjen, pra përbërësin sintaksor që e përmban fokusin. Për shembull:

Çfarë do të bëjnë zyrtarët serbë nesër?

- *Do ta vizitojnë Kosovën*/_{FocP}

Kur do ta vizitojnë?

- *Nesër*/_{FocP}

4. *Kukeli e kthen prapa tek Mavraj*. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Çfarë po bën Kukeli me topin?

- *E kthen prapa tek Mavraj*/_{FocP}

5. *Kendrick Lamar osht ni rep artist amerikan që tash osht në toplistë*.
(Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)

a. Kush është Kendrick Lamar?

- *Osht ni rep artist amerikan*/_{FocP}

4. A: Kujt i dha librin ajo?
B: [Gencit] ~~ia dha~~. } Përgjigje e fragmentuar

5. A: Do të shkojmë në Dhërmi a po në Jalë?
B: Në Dhërmi. } Përgjigje alternative

4. Pozicionet e fokusit në fjali

Fokusi mund të realizohet në pozicione të ndryshme sintaksore, domethënë në **in-situ** ose **ex-situ**. Tradicionalisht, siç kemi thënë pozicioni fundor në fjali konsiderohet të jetë i lidhur me një import informativ dhe mund të përkojë me përgjigjen e një pyetjeje-wh.

Fokusi **in-situ** është një strategji fokusimi, e cila vë në pah një element, pa e ndryshuar vendin ose pozicionin e tij në një fjali. Për shembull:

1a. S2: //Ato pamje i shohin [t rit] FOC //

Fokusi **ex-situ** në gjuhën shqipe është një strategji fokusimi që vendos rëndësinë e një elementi duke ndryshuar vendin ose pozicionin e tij in-situ në një fjali dhe duke e vendosur përbërësin e fokusit të lëvizë nga pozita e zakonshme në pozitën ex-situ (1b) për disa arsye, sintaksore dhe fonetike.

Sa i përket realizimit të fokusit në pozitën **ex-situ** në gjuhën shqipe, mendojmë që një rol të veçantë e luan edhe theksi emfatik që është tipik për ndeshjen e futbollit (pjesë e korpusit tonë), siç mund ta shihni në tabelën më poshtë, gjatë komentimit e ndeshjes së futbollit, fokusi realizohet në pozitën ex-situ diku rreth 90%, pasi ngjarjet që zhvillohen gjatë lojës janë të paparashikueshme dhe rrethanat ndryshojnë nga momenti në moment, prandaj komentatori nën trysinë e ngjarjeve përmes theksit emfatik e zhvendos fokusin në varësi të qëllimeve specifike që ai ka për të vënë në pah atë që do ai dhe që i konsideron si më të rëndësishme.

Ndërsa, sa u përket lëvizjeve sintaksore të fokusit, dallojmë dy lloje, si: *cleft* dhe *fronting*. Fokusi ex-situ jo vetëm që shpreh informacion të ri, por ka një vlerë kontrastive (Rochemont 1986), e cila identifikon në mënyrë shteruese përmbajtjen e tij referuese. Me fokus ex-situ, elementi që është në fokus zhvendoset në periferinë e majtë të fjalisë ku i gjithë përbërësi ndiqet nga një markues fokusi, siç është theksi në gjuhën shqipe.

Është ky kampionati i parë për mua dhe për Belgjikën, (Gazeta Koha) cleft
[Do të ruajë gjakftohtësinë]_{FocP} [Cana]_{TopP} (Komentimi i ndeshjes Serbi-
Shqipëri, 14.10.2014) – fokusi ballor

Analiza e bërë në fushën prozodike tregon se si domenet e fokusit, fushat prozodike, theksi i fjalisë dhe sintaksa ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Për shembull, ne pamë që, kur rendi i fjalisë është rend kanonik, fokusi shfaqet në pozitën in-situ, që është pozita kanonike e tij. Në këtë rast, fokusi krejt djathtas realizohet, sepse theksi kryesor supozohet të shtyhet më djathtas nga kufizimet prozodike dhe kjo nga ana tjetër e tërheq fokusin më së miri për ta plotësuar kufizimin e fokusit STRESS-FOCUS. Po edhe në një konfigurim variacional të rendit të fjalëve në fjali (VOS) fokusi realizohet në pozitën e vet kanonike, pasi kryefjala (S) [NP/DP] ik nga pozita e saj in-situ, për ta nxënë pozitën brenda domenit të fokusit. Ndërsa, kur fokusi nuk realizohet në pozitën e tij kanonike, na hyn në punë një tjetër kufizim, Stress-XP, i cili i jep forcë XP-së që të ndahet intonacionalisht nga komplementi i saj, dhe kështu të hyjë fare vetëm në domenin e fokusit.

Në kuadrin *e dyfishimit klitik dhe efektit të tij në strukturën e informacionit*, kemi vënë re se dyfishimi me klitik nuk shërben si një mjet pragmatik në strukturën e informacionit; dhe jo gjithmonë përdoret si një pajisje, për t'i markuar kundrinat e drejta si topikë.

Në bazë të të dhënave nga ky hulumtim, del se dyfishimi me klitikë i kundrinave të drejta jo gjithmonë lidhet me sinjalizimin e ndonjërit prej dy nocioneve të strukturës së informacionit, topikës apo fokusit. Në 60% të shembujve që i kemi nxjerrë nga gazeta *Koha ditore*, kemi hetuar që kundrinat e drejta nuk rimerren përmes trajtave të shkurtra (klitikëve), edhe pse mund të themi që hyjnë në kufijtë e topikës, pasi llogariten si informacion i dhënë, pra janë përmendur, në një formë, në diskursin paraparak. Ndërsa, vetëm 40% kundrinave të drejta që dyfishohen me klitikë e sinjalizojnë topikën. Ndërkaq, sa u përket filmit *Një tregim Prishtine* dhe emisionit *Pressing*, kemi vënë re që përafërsisht 25 % të rasteve kundrina e drejtë nuk dyfishohet me klitik edhe kur ajo i ka tiparet [+topikë]. Po ashtu në ndeshjet e futbollit shpeshherë kundrina në kufijtë e topikës nuk

realizohet fonetikisht, pra realizohet përmes një *pro*-je në strukturën e thellë, sepse llogaritet si informacion i dhënë pasi jepet nëpërmjet pamjeve dhe me këtë i përmbahet ekonomisë gjuhësore. Megjithatë, meqë edhe filmi edhe emisioni i përkasin gjuhës së folur, përfaqësojnë në 70% të shembujve në të dy korpuset përdorimi vetëm i klitikut, duke e lënë kundrinën të pashprehur fonetikisht (pra, të përealizuar në strukturën sipërfaqësore) e sinjalizon topikën.

Në bazë të rezultateve të nxjerra mund të themi se në studimet nga Kallulli (2000, 2008) dhe Kapia (2010) për lidhjen e dyfishimit me klitik dhe strukturën e informacionit shihet njëfarë tendence, për ta normëzuar përdorimin e klitikut aty ku DP-ja, në funksionin e kundrinës së drejtë, njihet nga diskursi paraprak.

Sa i përket *konfiguracionit variacional të rendit të fjalëve*, kemi supozuar që struktura e informacionit është një pikë kyçe që luan në fleksibilitetin e rendit të fjalëve në gjuhën e shqipe dhe se të gjitha lëvizjet e përbërësve sintaksorë që bëhen në strukturën e fjalisë shtyhen nga faktorë diskursivë ose pragmatikë.

Duke u nisur nga ideja e Şener (2010) që të gjitha XP-të argumentuese dhe joargumentuese mbajnë gjithmonë një sërë veçorish diskursive, që ndryshe njihen si elemente diskursive anaforik (DA), pra janë një sërë veçorish të orientuara nga diskursi, supozojmë se të gjithë ata përbërës sintaksorë që kanë veçoritë DA, pra janë përmendur më parë në diskurs kanë tendencë të zhvendosen në periferinë e majtë, pozicion tipik i TopP, prandaj gjithë këta përbërës me vetinë DA synojnë të alternohen majtas, pra të lëvizin nga pozita e tyre in-situ.

Siç u përmend më lart, elementet/DA-të anaforike të ligjërit zakonisht shënojnë informacionin e dhënë në ligjërime dhe përemrat janë shembuj prototipikë të DA-ve. Sidoqoftë, duhet pasur shumë kujdes në lidhje me elemente të tilla në shqip, pasi shqipja është një gjuhë që lejon strategji të shumta për të akomoduar DA.

Në kuadër të këtij kapitulli për variacionet konfiguracionale kemi arritur që të vërtetojmë se elementet DA shtrihen brenda domenit të topikës. Tani do t'i shohim disa raste të alternimeve të XP-ve që kanë funksione të ndryshme sintaksore në gjuhën shqipe

por që varësisht nga veçoria diskursive [+/-DA] lëvizin në domentet e topikës ose fokusit. Për shembull, edhe një DO dhe IO mund ta zë pozitën e topikës jo vetëm subjekti i fjalisë.

Alban Krasniqi, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka emëruar të premtën anëtar të ri të Lëvizjes Vetëvendosje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). (OSV) (Koha ditore, 24 shkurt 2023)

Titulli: Alban Krasniqi emërohet anëtar i ri i Vetëvendosjes në KQZ

Konteksti: Lajmi është bërë i njohur për audiencën që nga titulli. Prandaj, DP-ja që është në funksion të kundrinës e ka veçorinë DA dhe ka tendencë të zhvendost nga pozita in-situ në pozitën e Spec, të TopP. Ndërkaq, subjekti tjetër do të bjerë më poshtë dhe do të rindërtohet në një pozitë më poshtë të Spec, IP.

Për lëvizjet sintaksore që ndodhin dhe shkaktojnë alternime në renditjen e fjalëve shkaktohet nga funksioni diskursiv i XP-ve. Prandaj, ne mendojmë që e gjithë lëvizja në shqip drejtohet nga veçoria e operatorit [OP] në elementin lëvizës, prandaj analiza e paraqitur këtu mund të merret si një argument në favor të sistemit të drejtuar nga elementi lëvizës. [OP] është një veçori që u caktohet përbërësve që kanë veçori të caktuara diskursi. Topika dhe DA përmbajnë veçoritë diskursive, prandaj futen në derivim me veçorinë [OP], duke bërë kështu që nga rendi kanonik i fjalëve në fjali të derivojnë variacione konfiguracionale të rendit të fjalëve në fjali.

Një këngë këndon vajza. (OVS)

Vajza një këngë këndon. (SOV)

Këndon vajza një këngë. (VSO)

Këndohej kënga. (VS)

Kënga këndohet. (SV)

Ndryshimet në lëvizje më lart që ndodhin kanë efekte diskursive-pragmatike. Përbërësit që kanë veçoritë [DA] synojnë gjithmonë një pozicion periferik majtas të caktuar për ta, pavarësisht se çfarë nënloj topikash janë. Por edhe përbërësit që përfshihen në domenin e fokusit mund t'i nënshtrohen lëvizjes në pozicionin periferik majtas, kur ky

element përmban theksin emfatik dhe kjo do të thotë se edhe fokusi në gjuhën shqipe e ka veçorinë [OP] dhe mund të lëvizë në disa raste.

BIBLIOGRAFIA

- Agalliu, Fatmir – Angoni, Engjëll – Demiraj, Shaban – Dhrimo, Ali – Hysa, Enver – Lafe, Emil – Likaj, Ethem (2002). Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II. AShASh. Tiranë.
- Adli, A. (2011). A heuristic mathematical approach for modeling constraint cumulativity: Contrastive focus in Spanish and Catalan.
- Agouraki, Y. (1992). Clitic-left-dislocation and clitic doubling: A unification. *UCL Working Papers in Linguistics*, 4, 45-70.
- Bortolussi, B., & Sznajder, L. (2014). Topicalization versus left-dislocation in Biblical Latin. *Journal of Latin Linguistics*, 13(2), 163-195.
- Bošković, Željko. 2007. On the locality and motivation of Move and Agree: An even more minimal theory. *Linguistic Inquiry* 38. 589–644.
- Bošković, Željko. 2008. On the clausal and NP structure of Serbo-Croatian. In Richard Compton, Magdalena Goledzinowska & Ulyana Savchenko (eds), *Proceedings of FASL 15*, 42–75. Michigan Slavic Publications.
- Brisard, F. Östman, J.-O. Verschueren, J. (Eds.) (2009) *Grammar, Meaning and Pragmatics: Handbook of Pragmatics Highlights 5*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Buchholz, O. & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopadie.
- Büring, Daniel. 2010. Towards a typology of focus realization. In *Information structure. Theoretical, typological, and experimental perspectives*, eds. Malte Zimmermann and Caroline Féry, 177–205.
- Casielles-Suárez, E. (2004). *The syntax-information structure interface: Evidence from Spanish and English*. Routledge.
- Chafe, Wallace L.(1976). Givenness, contrastiveness, definiteness, subjects, topics and point of view. In *Subject and Topic*, edited by Charles N. Li. 25--55.
- Chomsky, Noam (1995). *The minimalist program*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Chomsky, Noam (2000). Minimalist inquiries: The framework. In Roger Martin, David Michaels & Juan Uriagereka (eds.), *Step by step: Essays on minimalist syntax in honor of Howard Lasnik*, 89–155. Cambridge, MA: MIT Pre.

- Cipo, Kristo (1952). Sintaksa. Instituti i Shkencave. Tiranë.
- Cresti, E. (2009) Clitics and anaphoric relations in informational patterning: A corpus-driven research on spontaneous spoken Italian (C-ORAL-ROM). In L. Mereu (Ed.), *Information Structure and its Interfaces* (pp. 169-202). Berlin, New York: De Gruyter Mouton.
- Domi, Mahir (1996). Gramatika e gjuhës shqipe: Sintaksa. Enti i teksteve Prishtinë.
- Ellert, M. (2013). Information structure affects the resolution of the subject pronouns er and der in spoken German discourse. *Discours. Revue de linguistique, psycholinguistique et informatique. A journal of linguistics, psycholinguistics and computational linguistics*, (12).
- Erteschik-Shir, Nomi (2007). *Information structure: The syntax-discourse interface*. Oxford: Oxford University Press.
- Erteschik-Shir, Nomi (2007). *Information structure: The syntax-discourse interface*. Oxford: Oxford University Press.
- Féry, C. (2013). Focus as prosodic alignment. *Natural Language & Linguistic Theory*, 31(3), 683-734.
- Frascarelli, Mara (2012). The interpretation of discourse categories. Cartography for a crash-proof syntax. In Valentina Bianchi & Cristiano Chesi. <http://www.ciscl.unisi.it/gg60/papers/frascarelli.pdf>
- Friedman, Victor (2008). Balkan object reduplication in areal and dialectological perspective. In D. Kalluli and L. Tasmowski (eds.) *Clitic Doubling in the Balkan Languages*, Amsterdam: J. Benjamins. Pp. 35-60
- Gabriel, C., Rinke, E. (2010) Information packaging and the rise of clitic doubling in the history of panish. // *Diachronic studies on information structure. Language acquisition and change*, 63-86 p.
- Givon, Talmy (1983). *Topic Continuity in Discourse: A Quantitative Cross-Language Study*. Amsterdam: John Benjamins.
- Givon, Talmy. (1988). The pragmatics of word order: Predictability, importance and attention. In: *Studies in Syntactic Typology*, ed. by M. Hammond, E. A. Moravcsik & J. Wirth. Amsterdam: John Benjamins, 243 - 284.

- Gürer, A. (2020). *Information Structure Within Interfaces: Consequences for the Phrase Structure*. Berlin, Boston: De Gruyter Mouton.
- Gürer, Aslı (2010). *Subject positions, case checking and EPP in complex noun phrase constructions in Turkish*. Boğaziçi University MA thesis.
- Hajicová, E., Partee, B. B., & Sgall, P. (2013). *Topic-focus articulation, tripartite structures, and semantic content* (Vol. 71). Springer Science & Business Media.
- Halliday, Michael (1985 [2014]). *Introduction to Functional Grammar*. University of Birmingham. United Kingdom
- Hawkins, John A. (1991). Syntactic weight versus information structure in word order variation. *Linguistische Berichte*. Special issue on *Information Structure and Grammar*.
- Hockett, Charles (1958). *A course in modern linguistics*. Neë York: Macmillan
- Holton, D., Mackridge, P., Philippaki-Warbuton. (1997) *Greek: A comprehensive grammar of the modern language*. London: Routledge, 432 p.
- Huddleston, R. Pullum, G. K. (2005). *A student's introduction to English Grammar*. Cambridge University Press.
- Huddleston, Rodney (1984). *Introduction to the Grammar of English*. Cambridge University Press.
- Jackendoff, R. S. (1972). *Semantic interpretation in generative grammar*.
- Janse, M. (2008) *Clitic doubling from ancient to Asia Minor Greek*. // *Clitic doubling in the Balkan languages*, (Ed. by Dalina Kallulli, Liliane Tasmowski), John Benjamins, 165 p.
- Kallulli, Dalina & Liliane Tasmowski (2008). *Clitic doubling in the Balkan Languages*, 1–34.
- Kapia, E. (2010). *The role of syntax and pragmatics in the structure and acquisition of clitic doubling in Albanian*. Boston University.
- Koleci, F., & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes* (Vol. 1). Shblu.
- Krifka, Manfred (2008). *Basic notions of information structure*. *Acta Linguistica Hungarica*. 55 (3–4): 243–276.

- Kučerová Ivona; Neeleman Ad (2012). *Contrasts and positions in information structure*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Kügler, F., & Calhoun, S. (2020). Prosodic encoding of information structure: A typological perspective.
- Ladd, D. R. (2008). *Intonational phonology*. Cambridge University Press.
- Lambrecht Kund (1994). *Information structure and sentence form. Topic, focus, and the representation of mental referents in discourse*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Lambrecht, Kund (1986). *Topic, Focus and the Grammar of Spoken French*. PhD dissertation, University of California Berkeley.
- Levinson, Stephen C. (1983). *Pragmatics*. Cambridge Textbooks in Linguistics.
- Li, Charles N. (ed.): *Subject and Topic*. London: Academic Press. 27–55.
- López, Luis (2009a). *A Derivational Syntax for Information Structure*. Oxford University Press
- Lyons, John (1977). *Semantics 2*. Cambridge, Cambridge University Press.
- Prince, E. F. (1981, June). Topicalization, focus-movement, and Yiddish-movement: A pragmatic differentiation. In Annual meeting of the Berkeley linguistics society (Vol. 7, pp. 249-264).
- Rizzi, Luigi (1997). The fine structure of the left periphery. In Liliane Haegeman (ed.), *Elements of grammar*, 281–337. Kluwer, Dordrecht.
- Rizzi, L. (2005). On some properties of subjects and topics. In *Proceedings of the XXX Incontro di Grammatica Generativa* (pp. 203-224).
- Rochemont, M. (1986). Focus in generative grammar. *Focus in Generative Grammar*, 1-231.
- Rooth, M. (1992). A theory of focus interpretation. *Natural language semantics*, 75-116.
- Rooth, M. (1996, August). On the interface principles for intonational focus. In *Semantics and Linguistic Theory* (Vol. 6, pp. 202-226).
- Rooth, M. E. (1985). *Association with focus (montague grammar, semantics, only, even)*. University of Massachusetts Amherst.

- Rugova Bardh (2006 dhe 2007) Gjuha e sportit. *Filologji* 14/15, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, pp 141 - 156.
- Rugova Bardh (2009). *Gjuha e gazetave. Koha*. Prishtinë.
- Rugova Bardh, Sejdiu - Rugova Linditë (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Trembelat. Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2014). *Imazhi i shqiptarit dhe i Shqipërisë në New York Times, në kohën e shpalljes së pavarësisë (1911-1913)*. Trembelat. Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2016). *Riçe rome, itaçi e zakucati*. Trembelat. Prishtinë.
- Rugova, Bardh (2019). *Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*. AShAK. Prishtinë.
- Rugova, L., Simitçiu, R. (2018). *Word Order in Albanian, Turkish and English – A Pragmatically Oriented Research*. Motif Vakfi Uluslararası Sosyal Bilimler Sempozyumu. Çanakkale.
- Rugova, Linditë (2019). *Strukturë dhe funksion studime në sintaksë të shqipes*. Trembelat. Prishtinë.
- Samek-Lodovici, V. (2005), *Prosody-syntax interaction in the expression of focus*. *Natural Language and Linguistic Theory*, 23, 687-755.
- Selkirk, Elisabeth (1995). *Sentence prosody: intonation, stress, and phrasing*. In John A. Goldsmith (ed.), *The handbook of phonological theory*, 550–569. Cambridge, MA, and Oxford, UK: Blackwell.
- Selkirk, Elisabeth (1995). *Sentence prosody: intonation, stress, and phrasing*. In John A. Goldsmith (ed.), *The handbook of phonological theory*, 550–569. Cambridge, MA, and Oxford, UK: Blackwell.
- Selkirk, Elisabeth (2002). *Contrastive focus vs. presentational focus: Prosodic evidence from right node raising in English*. In Bernard Bel & Isabelle Marlien (eds.), *Speech Prosody 2002: Proceedings of the 1st international conference on speech prosody*, 643–646. Aix-en-Provence, France.
- Selkirk, Elisabeth (2002). *Contrastive focus vs. presentational focus: Prosodic evidence from right node raising in English*. In Bernard Bel & Isabelle Marlien (eds.), *Speech Prosody 2002: Proceedings of the 1st international conference on speech prosody*, 643–646. Aix-en-Provence, France.

- Schwarzschild, R. (1999). GIVENness, AvoidF and other constraints on the placement of accent. *Natural language semantics*, 7(2), 141-177.
- Şener, Serkan (2010). Non- peripheral matters in Turkish syntax. University of Connecticut dissertation.
- Truckenbrodt, H. (1995). Phonological phrases--their relation to syntax, focus, and prominence (Doctoral dissertation, Massachusetts Institute of Technology).
- Truckenbrodt, H. (1999). On the relation between syntactic phrases and phonological phrases. *Linguistic inquiry*, 30(2), 219-255.
- Vallduví, Enric. & Maria Vilkuna (1998). On rheme and kontrast. *The Limits of Syntax. Syntax and Semantics 29*, eds. Peter Culicover & Louise McNally, 161-184. NewYork: Academic Press.
- Van der Wal, Jenneke. 2016. Diagnosing Focus. *Studies in Language* 40: 259–301.
- Van Valin, Robert D. and LaPolla, Randy J. (1997). *Syntax: Structure, Meaning, and Function*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Zubizarreta. (1998), *Prosody, Focus, and Word Order*. *Linguistic Inquiry monograph #33*. Cambridge, Mass.: MIT Press.

INDEKSI I EMRAVE

A		H	
Adli	107, 209	Hajičová	55,212
Agouraki	143, 144, 146	Halliday	4, 9, 21, 22, 27, 29, 45, 46, 56, 57, 63, 211
AShASh	142, 170, 209	Hawkins	170, 171, 211
B		Hinterhölzl	24, 29, 109, 176
Bianchi	64, 210	Hockett	45, 64, 211
Bokshi	138, 139	Huddleston	211
Bošković	7, 12, 32, 33, 170, 183, 209	J	
Bott	23, 26, 51, 198	Jackendoff	25, 80, 82, 83, 84, 85, 87, 88, 90, 211
Buchholz & Fiedler	135, 137, 153	Jacobs	170, 172, 173
Büiring	80, 84, 108, 109, 201, 209	Janse	136, 211
C		Jenneke	27, 101, 102, 202, 214
Calhoun	108, 109, 212	K	
Casielles	26, 42, 48, 49, 50, 51, 52, 62, 63, 65, 200, 209	Kallulli	6, 11, 31, 32, 70, 135, 136, 138, 141, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 155, 169, 206, 211
Casielles-Suarez	48, 51, 52, 62, 63	Kapia	6, 11, 31, 32, 70, 136, 148, 152, 153, 155, 169, 206, 211
Chafe	21, 29, 45, 46, 53, 63, 77, 109, 199, 209	Kasimir	15, 102, 103, 133
Chomsky	7, 12, 25, 32, 33, 40, 66, 68, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 88, 151, 175, 180, 181, 183, 209	Kiss	24
Cinque	125, 131	Komagata	53
D		Kratzer	80
Daneš	46	Krifka	22, 52, 102, 106, 172, 211
Demiraj	139, 209	Kügler	108, 109, 212
E		L	
Erteschik-Shir	46, 50, 52, 62, 80, 82, 83, 84, 88, 89, 150, 201, 210	Ladd	80, 108, 109, 212
Erteschirik-Shir	21, 32, 48	Lambrecht	5, 21, 26, 49, 51, 52, 53, 54, 57, 58, 61, 62, 64, 72, 73, 77, 80, 102, 104, 109, 170, 173, 174, 175, 194, 199, 212
F		LaPolla	174, 214
Féry	24, 108, 209, 210	Lee	108, 111, 114
Firbas	42, 44, 45, 82	Li	48, 49, 209, 212
Floqi	171	M	
Frascarelli	24, 29, 64, 65, 69, 109, 131, 176, 200, 210	Mathesius	42, 43, 44, 49, 63, 172
Friedman	154, 210	Miklosich	140
G		Miyagawa	34, 181, 182
Gabriel	70, 136, 210	O	
Givon	170, 172, 173, 210	Onea	27, 102, 108
Gürer	6, 7, 11, 12, 24, 32, 33, 91, 170, 211		

P	
Partee	94
Prifti	170
Prince	28, 49, 50, 51, 212
Pullum	211

R	
Reinhart	46, 49
Rinke	70, 136, 210
Rizzi	7, 12, 29, 32, 34, 52, 64, 65, 66, 67, 68, 125, 126, 131, 176, 177, 178, 180, 183, 200, 212
Rochemont	59, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 128, 133, 204, 212
Rooth	80, 89, 90, 91, 93, 94, 95, 97, 98, 99, 100, 102, 107, 212
Rrokaj	47
Rugova	7, 12, 25, 28, 29, 33, 38, 39, 43, 47, 56, 71, 115, 119, 153, 156, 175, 213
Rugova B	213

S	
Samek-Lodovici	109, 111, 112, 114, 118, 213
Schwabe	23
Sejdiu-Rugova	3, 7, 12, 25, 28, 29, 32, 39, 47, 56, 71, 153, 156, 171, 175
Selkirk	23, 108, 109, 110, 111, 114, 213
Selkrik	30, 38
semantik	25, 37, 38, 80, 88, 89, 92, 93, 95, 100, 144, 156
Şener	7, 32, 184, 214

Sgall	45, 54, 55, 64, 77, 199
Simitçiu	7, 12, 32, 43, 171, 213
Strawson	46

T	
Tasmowski	135, 141, 210, 211
Thompson	48, 49
Thumbi	140
Truckenbrodt	111, 113, 114, 116, 214

V	
Vallduvi	52, 76
Vallduví	26, 41, 76, 77, 214
Valluvdi	5, 10
Van Valin	174, 214
Von Heusinger	80

W	
Ward	50

X	
Xhaferi	7, 12, 33, 171

Z	
Zimmermann	24, 27, 102, 108, 209